



Themelet e Rivendosjes

Manuali i Mësuesit
Feja 225

Një Kurs Themeltar

Manuali i Mësuesit – Themelet e Rivendosjes

Feja 225

Botuar nga
Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme
Solt-Lejk-Siti, Juta

Kapak arti: *Rivendosja e Priftërisë Melkizedeke*, nga Walter Rane

Komentet dhe korrigjimet vlerësohen. Ju lutemi, dërgojini ato, duke përfshirë gabimet tipografike, në adresën:

Seminaries and Institutes of Religion Curriculum Services
50 E. North Temple St., Floor 8
Salt Lake City, Utah 84150-0008
USA

Posta elektronike: ces-manuals@ldschurch.org

Ju lutemi, shënoni emrin e plotë, adresën, lagjen dhe kunjin tuaj.

Sigurohuni që të përfshini titullin e manualit. Më pas bëni komentet tuaja.

© 2015 nga Intellectual Reserve, Inc.

I rezervohen të gjitha të drejtat.

Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Varianti 2, 6/15

Miratur për anglisht: 8/14

Miratur për përkthim: 8/14

Përkthim i *Foundations of the Restoration Teacher Manual*

Albanian

PD10052298 101

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje për Manualin e Mësuesit – Themelet e Rivendosjes (Feja 225)

1

Një Punë e Mrekullueshme dhe një Çudi

2

Vegimi i Parë

3

Dalja në Dritë e Librit të Mormonit

4

Libri i Mormonit – Gurthemeli i Besimit Tonë

5

Rivendosja e Priftërisë

6

Organizimi i Kishës

7

Shpallni Ungjillin e Përjetshëm

8

Mbledhja e Izraelit të Ditëve të Mëvonshme

9

Ndiqni Profetin e Gjallë

10

Kërkoni të Vërtetën

11

Zëri i Zotit të Doktrina e Besëlidhje

12

Shkrime të Shenjta Shtesë të Kohës Sonë

13

“Vegimi”

14

Tempulli i Kirtlandit dhe Çelësat e Priftërisë

15

Forca në Mes të Kundërshtimit

16

Shëlbimi i të Vdekurve

17	
Mësimet e Ungjillit në Navu	
18	
Shoqata e Ndhmës dhe Kisha	
19	
Doktrina e Martesës dhe Familjes së Përjetshme	
20	
Martesa me Shumë Gra	
21	
Misioni Profetik i Jozef Smithit	
22	
Martirizimi i Profetit Jozef Smith	
23	
Vijueshmëria në Presidencë	
24	
Largimi nga Navuja dhe Udhëtimi drejt Perëndimit	
25	
Lufta e Jutas dhe Masakra e Livadheve Malore	
26	
Zbulesa mbi Priftërinë	
27	
Përgatitja e Botës për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit.	
28	
Përshpejtimi i Punës për Shpëtim	

Hyrje për Manualin e Mësuesit – Themelet e Rivendosjes (Feja 225)

Çfarë pritet nga një mësues feje?

Ndërsa përgatiteni për të dhënë mësim, është e rëndësishme që të kuptoni Synimin e Seminareve dhe Instituteve të Fesë:

“Qëllimi ynë është të ndihmojmë rininë dhe të rinjtë në moshë madhore që t’i kuptojnë dhe të mbështeten te mësimet dhe Shlyerja e Jezu Krishtit, të kualifikohen për bekimet e tempullit dhe të përgatitin vetveten, familjet e tyre dhe të tjerët për jetën e përjetshme me Atin e tyre në Qiell”
(*Mësimdhënia dhe të Mësuarit e Ungjillit: Një Manual për Mësuesit dhe Udhëheqësit në Seminare dhe Institutet e Fesë* [2012], f. x).

Ju mund ta arrini këtë synim duke e jetuar me zell ungjillin, duke ua mësuar në mënyrë të efektshme ungjillin studentëve tuaj dhe duke e administruar siç duhet orën mësimore ose programin tuaj. Ndërsa përgatiteni dhe e jepni mësim ungjillin në këto mënyra, ju do të kualifikoheni për ndikimin e Frymës së Shenjtë (shih DeB 42:14).

Është mundësia juaj që t’i ndihmoni studentët të mësojnë me anë të Shpirtit, që të mund ta forcojnë besimin e tyre dhe ta thellojnë kthimin e tyre në besim. Ju mund t’i ndihmoni studentët që ta arrijnë këtë, ndërkohë që i udhëhiqni ata që ta gjejnë, kuptojnë, ndiejnë të vërtetën dhe rëndësinë e saj, dhe të zbatojnë doktrinat e parimet domethënëse të ungjillit të Jezu Krishtit.

Manuali *Mësimdhënia dhe të Mësuarit e Ungjillit* është një burim thelbësor për të kuptuar procesin e mësimdhënies dhe për të mësuar mënyrën se si të bëheni të suksesshëm në klasë. Drejtojuini shpesh këtij manuali.

Cilat janë synimet e këtij kursi?

Ky kurs, Themelet e Rivendosjes (Feja 225), u jep studentëve mundësinë për të studiuar zbulatat themelore, doktrinat, ngjarjet historike dhe njerëzit e rëndësishëm në shpalesjen e Rivendosjes së Kishës së Jezu Krishtit, sikurse gjendet në veprat standarde të shkrimeve të shenjta, në mësimet e dhëna nga profetët e ditëve të mëvonshme dhe në historinë e Kishës. Kursi do t’i sigurojë studentët me themelin doktrinor dhe kontekstin historik të nevojshëm për një kuptueshmëri të saktë të doktrinës dhe të historisë së Kishës. Studentët do t’i shtojnë aftësitë e tyre për të kërkuar të vërtetën, për të vlerësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e materialit burimor dhe për ta dalluar të vërtetën nga gabimi. Studentët do të studiojnë shkrimet e shenjta, doktrinat e Kishës dhe historinë e Kishës në mënyra që i përshtaten jetës dhe rrethanave të tyre. Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) dëshmoi për realitetin e Rivendosjes:



“Kjo është Kisha e rivendosur e Jezu Krishtit. Ne si një popull jemi shenjtë të ditëve të mëvonshme. Ne dëshmojmë se qiejt janë hapur, se perdet janë larguar, se Perëndia ka folur dhe se Jezu Krishti e ka shfaqur Vetën e Tij. ...

Falënderuar qoftë Perëndia për dhënien e Tij të mahnitshme të dëshmisë, autoritetit dhe doktrinës së lidhur me këtë, Kishën e rivendosur të Jezu Krishtit.

Ky duhet të jetë mesazhi ynë i madhërishtë dhe i vetëm drejtuar botës. Ne nuk e ofrojmë atë me mburrje. Ne dëshmojmë me përlësi, por me dinjitet dhe sinqeritet tërësor” (“The Marvelous Foundation of Our Faith”, *Ensign*, nëntor 2002, f. 81).

Ndërkohë që studentët zhvillojnë besim më të madh te Jezu Krishti dhe dëshmi më të forta për ungjillin e rivendosur, ata do ta shtojnë zotimin e tyre që të bëjnë e mbajnë besëlidhje të shenjta dhe të përgatiten më mirë për ta shpërndarë mesazhin e Rivendosjes.

Çfarë pritet prej studentëve?

Me qëllim që të marrin kredite për diplomimin nga instituti, studentëve u kërkohet të lexojnë fragmentet e shkrimeve të shenjta, bisedat e konferencave të përgjithshme dhe materiale të tjera të renditura te pjesa Materiale Leximi për Studentin e çdo mësimi. Studentët gjithashtu duhet të përmbushin kërkesat e frekuentimit dhe të tregojnë zotërim të materialit të kursit.

Si janë ndërtuar mësimet në këtë manual?

Ky kurs është hartuar si një kurs i plotë semestral me 28 mësimet të shkruara për orë mësimore 50-minutëshe. Nëse klasa juaj mblidhet dy herë çdo javë, jepeni një mësim në çdo orë mësimore. Nëse klasa juaj mblidhet vetëm një herë çdo javë për 90 ose 100 minuta, ndërthurini dhe jepini dy mësimet për çdo orë mësimore. Çdo plan mësimor përbëhet nga katër pjesë:

- Hyrje
- Lexim Konteksti
- Sugjerime për Mësimdhënien
- Materiale Leximi për Studentin

Hyrje

Kjo pjesë jep një hyrje të shkurtër të temave dhe synimeve të mëimit.

Lexim Konteksti

Kjo pjesë rekomandon burimet, të tilla si mesazhe nga profetët e ditëve të mëvonshme, që mund t'ju ndihmojnë t'i kuptoni më mirë doktrinën, parimet dhe të vërtetat e ungjillit të trajtuara në planin mësimor.

Sugjerime për Mësimdhënien

Pjesa Sugjerime për Mësimdhënien përfshin materialin që ju ndihmon të dini *çfarë* të jepni mësim, si edhe mënyrën *se si* ta jepni mësim atë (shih edhe pjesët 4.3.3 dhe 4.3.4 te manuali *Mësimdhënia dhe të Mësuarit e Ungjillit*). Veprimtaritë e sugjeruara të të mësuarit janë hartuar për t'i ndihmuar studentët të gjejnë, kuptojnë e zbatojnë të vërtetën të shenjta. Ju mund të zgjidhni të përdorni disa ose të gjitha sugjerimet, ndërsa i përshtatni ato që të përputhen me stilin tuaj vetjak të mësimdhënies dhe që të përmbushin nevojat dhe rrethanat e studentëve tuaj. Ndërsa merrni parasysh mënyrën se si t'i përshtatni materialet mësimore, ndiqni këtë këshillë nga Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



"Shpesh e kam dëgjuar Presidentin Paker të japë mësim që ne së pari përvetësojmë, pastaj përshtatim. Nëse jemi tërësisht të ngulitur në mësimin e përkruar, të cilin na duhet ta japim, atëherë ne mund të ndjekim Shpirtin për ta përshtatur atë. Por ka një tundim, kur flasim për këtë mundësi për ndryshueshmëri, që t'ia nisim nga përshtatja në vend që t'ia nisim nga përvetësimi. Është një baraspeshim. Është një sfidë e vazhdueshme. Por mënyra e të përvetësuarit së pari dhe pastaj të përshtaturit është një mënyrë e mirë

për të qëndruar në baza të shëndosha” (“A Panel Discussion with Elder Dallin H. Oaks” [transmetim satelitor për Seminaret dhe Institutet e Fesë, 7 gusht 2012]; lds.org/broadcasts).

Ky kurs përfshin thënie nga udhëheqës të Kishës që ka mundësi të jenë në dispozicion në shumë gjuhë. Ndërsa përgatiteni për të dhënë mësim, ju mund të doni t’i përshtatni mësimet duke përdorur thënie të tjera që i keni në dispozicion nga udhëheqësit e Kishës, të cilat janë domethënëse për lëndën e temës.

Pjesa Sugjerime për Mësimdhënien përmban të paktën një thënie të doktrinës ose të parimit, e cila paraqitet me germa të theksuara. Ndërsa studentët i zbulojnë këto doktrina e parime dhe shprehin atë që kanë mësuar, fjalët e tyre mund të ndryshojnë nga ato të përdorura në manual. Kur ndodh kjo, bëni kujdes të mos nënkuptoni që përgjigjet e tyre janë të gabuara. Sidoqoftë, nëse një thënie mund të ishte më e saktë, ndihmoni me kujdes që ta qartësoni të kuptuarin.

Ky program mësimor jep shembuj se si të ndërthuren parimet themelore të mësimdhënies dhe të të mësuarit të ungjillit në një kurs tematik (shih *Mësimdhënia dhe të Mësuarit e Ungjillit*, f. 10, 23–31, 38–41). Në muajt e ardhshëm, Seminaret dhe Institutet do të botojnë një dokument të quajtur “Mësimdhënia dhe të Mësuarit e Shkrimeve të Shenjta në Institutet e Fesë”, që do të shpjegojë më tej mënyrën se si të ndërthuren parimet themelore të mësimdhënies dhe të mësuarit të ungjillit në një kurs tematik.

Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, përshkroi disa prej përfitimeve që vijnë nga të studiuarit e ungjillit në mënyrë tematike:

“Megjithëse leximi i një libri të shkrimit të shenjtë nga fillimi deri në fund siguron një gjerësi bazë të diturisë, studimi sipas temës e shton thellësinë e diturisë sonë. Kërkimi nëpër zbulesa të lidhjeve, modeleve dhe temave e ndërton dhe e shton njohurinë tonë shpirtërore...; ai zgjeron këndvështrimin dhe kuptueshmërinë tonë për planin e shpëtimit.

Sipas mendimit tim, kërkimi me zell për të zbuluar lidhjet, modelet dhe temat është pjesë e asaj që do të thotë të ‘ushqehemi me bollëk’ me fjalët e Krishtit. Kjo mënyrë mund t’i hapë dyert e përmytjes së rezervuarit shpirtëror, ta ndriçojë kuptueshmërinë tonë nëpërmjet Shpirtit të Tij dhe të prodhojë një thellësi të mirënjohjes për shkrimet e shenjta dhe një shkallë të zotimit shpirtëror që nuk mund të merret në asnjë mënyrë tjetër. Një kërkim i tillë na bën të aftë të ndërtojmë mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë dhe t’u bëjmë ballë erërave të ligësisë në këto ditë të fundit” (“A Reservoir of Living Water” [mbledhje rreth vatrës në Universitetin “Brigam Jang”, 4 shkurt 2007], f. 3, speeches.byu.edu).

Një pjesë e materialit të këtij manuali bazohet mbi materialin te *Manuali për Doktrinën e Besëlidhjet dhe Historinë e Kishës për Seminarin*.

Materiale Leximi për Studentin

Kjo pjesë rendit fragmente të shkrimeve të shenjta, biseda nga udhëheqës të Kishës dhe materiale të tjera që do ta pasurojnë kuptueshmërinë e studentëve për temat që theksohen te mësimet. Caktojini dhe nxitini studentët që t’i lexojnë këto materiale përpara se të vijnë në çdo orë mësimore. Kur i studiojnë këto materiale të frymëzuara, ata jo vetëm që do të jenë të përgatitur më mirë për të marrë pjesë në diskutimet e orës mësimore, por gjithashtu do të fitojnë një kuptim më të gjerë dhe më të thellë të

temave të kursit. Jepuni studentëve një listë të të gjitha pjesëve Materiale Leximi për Studentin në fillim të semestrit.



Si mund të përgatitem për të dhënë mësim?

Zoti do t'ju ndihmojë ndërsa përgatiteni për të dhënë mësim. Ndërsa përgatiteni, mund t'ju duket e dobishme t'i bëni vetes pyetjet vijuese:

- A jam lutur për të marrë udhëheqjen e Frymës së Shenjtë?
- A i kam studiuar blloqet e caktuara të shkrimeve të shenjta dhe leximin e kontekstit?
- A e kam lexuar programin mësimor dhe a kam përcaktuar nëse ka ndonjë gjë që duhet ta përshtat ose rregulloj për të përmbushur nevojat e studentëve të mi?
- Si mund ta ndjek ecurinë me studentët për t'u siguruar që ata po përfitojnë nga shumica e leximeve të caktuara?
- Si mund ta ndihmoj secilin prej studentëve të mi që të marrë pjesë plotësisht në mësim?

Sugjerimet vijuese mund të jenë gjithashtu të dobishme:

- Nxitini studentët që t'i lexojnë fragmentet e shkrimit të shenjtë dhe artikujt e caktuar përpara çdo ore mësimore.
- Prisni nga studentët që ta përmbushin rolin e tyre për të mësuar.
- Siguroni mundësi të vazhdueshme për studentët që të shpjegojnë doktrina e parime me fjalët e tyre, të tregojnë përvoja të përshtatshme dhe të dëshmojnë për atë që dinë e ndiejnë.
- Ndryshojini veprimtaritë dhe metodat mësimore që përdorni në çdo orë mësimore dhe gjithashtu nga dita në ditë.
- Krijoni një mjedis të të mësuarit që fton Shpirtin dhe u jep studentëve privilegjin dhe përgjegjësinë që të japin mësim dhe të mësojnë nga njëri-tjetri (shih DeB 88:78, 122).

Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, na mësoi:



“Sigurohuni që ka pjesëmarrje të shumtë, sepse ai përdorim i lirisë së zgjedhjes nga një student e autorizon Frymën e Shenjtë që të udhëzojë. ... Kur studentët i shprehin të vërtetat me fjalët e tyre, ata përforcohen në shpirtat e tyre dhe i forcojnë dëshmitë e tyre vetjake” (“To Understand and Live Truth” [mbrëmje me Plakun Riçard G. Skot, 4 shkurt 2005], f. 3; si.lds.org).

Si mund t'i përshtat mësimet për njerëzit me paaftësi?

Ndërsa përgatiteni që të jepni mësim, jini të vëmendshëm ndaj studentëve që kanë nevoja të veçanta. Përshtatini veprimtaritë dhe rezultatet që prisni për t'i ndihmuar ata që t'ia dalin mbanë.

Për më shumë ide dhe burime, drejtojuni faqes Disability Resources [Burime për Paaftësitë] te disabilities.lds.org dhe seksionit të manualit të rregullave të Seminareve dhe Instituteve të Fesë, të titulluar “Orë dhe Programe Mësimi të Përshtatura për Studentë me Paaftësi”.

Themelet e Rivendosjes (Feja 225)

Materiale Leximi për Studentin

Shënim: Nuk ju kërkohet të lexoni ndonjë nga materialet e sugjeruara që nuk janë në dispozicion në gjuhën tuaj.

Mësimi	Titulli	Materiale Leximi të Sugjeruara
1	Një Punë e Mrekullueshme dhe një Çudi	<ul style="list-style-type: none"> Isaia 29:13–14; Amos 8:11–12; 2 Nefi 27:1–5, 25–26; Doktrina e Besëlidhje 1:12–30; Joseph Smith – Historia 1:5–10. Gordon B. Hinckley, "At the Summit of the Ages", <i>Ensign</i>, nëntor 1999, f. 72–74. <i>Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar</i> (2004), f. 31–36.
2	Vegimi i Parë	<ul style="list-style-type: none"> Joseph Smith – Historia 1:1–26. Gordon B. Hinckley, "The Marvelous Foundation of Our Faith", <i>Ensign</i>, nëntor 2002, f. 78–81. "First Vision Accounts", Gospel Topics, lds.org/topics.
3	Dalja në Dritë e Librit të Mormonit	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 17; Joseph Smith – Historia 1:29–54. Neal A. Maxwell, "By the Gift and Power of God", <i>Ensign</i>, janar 1997, f. 36–41. "Book of Mormon Translation", Gospel Topics, lds.org/topics. "Coming Forth of the Book of Mormon and Restoration of the Priesthood", kapitulli 5 te <i>Church History in the Fulness of Times Student Manual</i>, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 52–66.
4	Libri i Mormonit – Gurthemeli i Besimit Tonë	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 17:6; 19:26; 20:5–12. Ezra Taft Benson, "The Book of Mormon – Keystone of Our Religion", <i>Ensign</i>, nëntor 1986, f. 4–7. Jeffrey R. Holland, "Siguri për Shpirtin Njerëzor", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2009, f. 88–90.
5	Rivendosja e Priftërisë	<ul style="list-style-type: none"> Joseph Smith – Historia 1:68–72; Doktrina e Besëlidhje 13:1; 84:18–22; 107:1–19. Tomas S. Monson, "Priftëria – një Dhuratë e Shenjtë", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2007, f. 57–60.
6	Organizimi i Kishës	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 1:30; 20:1–3, 17–37, 68–69. Henri B. Ajring, "Kisha e Vërtetë dhe e Gjallë", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2008, f. 20–24.
7	Shpallni Ungjillin e Përjetshëm	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 4:1–7; 18:10–16; 29:4–7; 31:1–12; 33:2–7; 34:5–6; 39:20–23; 88:81. Nil L. Andersen, "Është një Mrekulli", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2013, f. 77–80.

Mësimi	Titulli	Materiale Leximi të Sugjeruara
8	Mbledhja e Izraelit të Ditëve të Mëvonshme	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 37:1–3; 38:31–33; 39:15; 45:62–67; 95:8; 110:9; 115:5–6. Russell M. Nelson, “The Gathering of Scattered Israel”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2006, f. 79–82.
9	Ndiqni Profetin e Gjallë	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 21:1–6; 28:2, 6–7; 43:1–7; 90:1–6, 16. Kevin R. Dankan, “Pikërisht Mbijetesa Jonë”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2010, f. 34–36. Rasëll M. Nelson, “Mbështetja e Profetëve”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2014, f. 74–77.
10	Kërkoni të Vërtetën	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 88:118–126; 91:1–6. Diter F. Uhtdorf, “Ç’është e Vërteta?” (takim shpirtëror i Sistemit Arsimor të Kishës, 13 janar 2013), lds.org/broadcasts. David A. Bednar, “Quick to Observe”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, dhjetor 2006, f. 31–36.
11	Zëri i Zotit te Doktrina e Besëlidhje	<ul style="list-style-type: none"> Parathënia për Doktrinën e Besëlidhjet; Doktrina e Besëlidhje 1:1–39; 5:10. Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon and the Doctrine and Covenants”, <i>Ensign</i>, janar 2005, f. 24–28.
12	Shkrime të Shenjta Shtesë të Kohës Sonë	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 1:38; 42:56; 45:60–62; 68:3–5; 76:15–19; 93:53; 94:10. Xhefri R. Holland, “Fjalët e Mia ... Kurrë s’Pushojnë”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2008, f. 91–94. “Translation and Historicity of the Book of Abraham” [“Përkthimi dhe Historiku i Librit të Abrahamit”], <i>Gospel Topics</i>, lds.org/topics.
13	“Vegimi”	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 76. L. Tom Perry, “The Plan of Salvation”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2006, f. 69–72.
14	Tempulli i Kirtlandit dhe Çelësat e Priftërisë	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 109:1–28; 110:1–16. Jeffrey R. Holland, “Our Most Distinguishing Feature”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2005, f. 43–45. Dejvid A. Bednar, “Me Nder do të Mbajë një Emër e Qëndrim”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2009, f. 97–100.
15	Forca në Mes të Kundërshtimit	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 112:10–15; 121:1–10, 16–17; 122:1–9. Nil L. Andersen, “Prova e Besimit Tuaj”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2012, f. 39–42.

Mësimi	Titulli	Materiale Leximi të Sugjeruara
16	Shëlbimi i të Vdekurve	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 124:30–41; 127:1–9; 128:1–18; 137:1–10; 138:28–37. Riçard G. Skot, "Gëzimi i Shëlbimit të të Vdekurve", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2012, f. 93–95. D. Todd Christofferson, "The Redemption of the Dead and the Testimony of Jesus", <i>Ensign</i>, nëntor 2000, f. 9–12.
17	Mësimet e Ungjillit në Navu	<ul style="list-style-type: none"> Psalmëve 82:6; Mateu 5:48; Gjoni 10:32–34; Romakëve 8:16–17; 2 Pjetër 1:3–4; 1 Gjoni 3:2–3; Doktrina e Besëlidhje 93:11–22; 124:25–28, 37–42; 132:20–24. "Mësimdhënia dhe të Mësuarit e Ungjillit", kapitulli 2 te <i>Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith</i> (2009), f. 39–46. "Becoming Like God", Gospel Topics, lds.org/topics.
18	Shoqata e Ndhmës dhe Kisha	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 25. Dallin H. Ouks, "Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2014, f. 49–52. Xhuli B. Bek, "Vizioni i Profetëve lidhur me Shoqatën e Ndhmës: Besimi, Familja, Ndhma", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2012, f. 83–85.
19	Doktrina e Martesës dhe Familjes së Përgjeshme	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 49:15–17; 131:1–4; 132:1–24. Rusëll M. Nelson, "Martesa Çelestiale", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2008, f. 92–95. Joshua J. Perkey, "Why Temple Marriage?" <i>New Era</i>, gusht 2013, f. 30–32.
20	Martesa me Shumë Gra	<ul style="list-style-type: none"> Jakobi [LiM] 2:27–30; Doktrina e Besëlidhje 132:1–3, 34–48, 54, 63; Deklarata Zyrtare 1. "Plural Marriage in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints", Gospel Topics, lds.org/topics. <p>Merrni parasysh të lexoni sa vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> "Plural Marriage in Kirtland and Nauvoo", Gospel Topics, lds.org/topics. "Plural Marriage and Families in Early Utah", Gospel Topics, lds.org/topics. "The Manifesto and the End of Plural Marriage", Gospel Topics, lds.org/topics.
21	Misioni Profetik i Jozef Smithit	<ul style="list-style-type: none"> 2 Nefi 3:1–21; Doktrina e Besëlidhje 122:1–2; 135:3; Joseph Smith – Historia 1:33. Nil L. Andersen, "Jozef Smithi", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2014, f. 28–31. Ted R. Kelister, "Jozef Smithi – Profeti i Rivendosjes", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2009, f. 35–37.

Mësimi	Titulli	Materiale Leximi të Sugjeruara
22	Martirizimi i Profetit Jozef Smith	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 135:1–7; 136:36–39. Thomas S. Monson, "The Prophet Joseph Smith: Teacher by Example", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2005, f. 67–70. "The Martyrdom", kapitulli 22 te <i>Church History in the Fulness of Times Student Manual</i>, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 273–285.
23	Vijueshmëria në Presidencë	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 107:33; 112:30–32; 124:127–28. Bojd K. Paker, "Të Dymbëdhjetët", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2008, f. 83–87. "The Twelve to Bear Off the Kingdom", kapitulli 23 te <i>Church History in the Fulness of Times Student Manual</i>, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 286–296.
24	Largimi nga Navuja dhe Udhëtimi drejt Perëndimit	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 136. Gordon B. Hinckley, "True to the Faith", <i>Ensign</i>, maj 1997, f. 65–67. "Besim në Çdo Hap", kapitulli 6 te <i>Trashëgimia Jonë: Një Histori e Shkurtër e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme</i> (2010), f. 69–80.
25	Lufta e Jutas dhe Masakra e Livadheve Malore	<ul style="list-style-type: none"> "Peace and Violence among 19th-Century Latter-day Saints", Gospel Topics, lds.org/topics. Richard E. Turley Jr., "The Mountain Meadows Massacre", <i>Ensign</i>, shtator 2007, f. 17–21.
26	Zbulesa mbi Priftërinë	<ul style="list-style-type: none"> 2 Nefi 26:33; Deklarata Zyrtare 2. "Race and the Priesthood", Gospel Topics, lds.org/topics. Ahmad Corbitt, "A Personal Essay on Race and the Priesthood", pjesa 1–4, seritë Perspectives on Church History, history.lds.org/section/perspectives-on-church-history.
27	Përgatitja e Botës për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 29:7–9; 34:5–7; 39:19–23; 45:15–46, 56–57; 88:81–87. Nil L. Andersen, "Të Përgatisësh Botën për Ardhjen e Dytë", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2011, f. 49–52. "Preparing for the Second Coming of Christ", kapitulli 44 te <i>Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith</i> (1998), f. 389–397.
28	Përshpjetimi i Punës për Shpëtim	<ul style="list-style-type: none"> Diter F. Uhtdorf, "A Po Flini Gjatë Rivendosjes?" <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2014, f. 58–62. "Përshpjetimi i Punës për Shpëtim", <i>Liahona</i>, tetor 2013, f. 36–39.

Një Punë e Mrekullueshme dhe një Çudi

1

Hyrje

Gjatë gjithë historisë, Ati Qiellor i ka përfunduar periudhat e braktisjes nëpërmjet thirrjes së profetëve, të cilët marrin autoritet hyjnor për ta rivendosur plotësinë e ungjillit dhe për ta ngritur Kishën e Jezu Krishtit. Jozef Smithi ishte ky profet në periudhën tonë të kujdestarisë ungjillore. Të kuptuarit se si Perëndia e

udhëheq popullin e Tij dhe se si e themelon Kishën e Tij nëpërmjet profetëve, do t'i ndihmojë studentët të zhvillojnë një vlerësim më të thellë të nevojës për një Rivendosje dhe një aftësi më të madhe për t'u mësuar të tjerëve rreth Rivendosjes.

Lexim Konteksti

- M. Russell Ballard, "The Miracle of the Holy Bible", *Ensign* ose *Liahona*, maj 2007, f. 80–82.
- Gordon B. Hinckley, "At the Summit of the Ages", *Ensign*, nëntor 1999, f. 72–74.
- Neal A. Maxwell, "From the Beginning", *Ensign*, nëntor 1993, f. 18–20.
- *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 31–36.

Sugjerime për Mësimdhënien

Amos 8:11–12; Joseph Smith – Historia 1:5–10

Braktisja e Madhe dhe nevoja për Rivendosjen

Fillojeni mësimin duke shkruar sa vijon në tabelë:

Uri =

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Amos 8:11–12. Kërkojuni studentëve ta ndjekin dhe të përcaktojnë se si fjala *uri* përdoret si një simbol.

- Çfarë lloj urie profetizoi Amosi se do të ndodhte? (Shkruani përgjigjet e studentëve në tabelë pranë fjalës "Uri =".)
- Çfarë profetizoi Amosi se njerëzit do të bënin për shkak të kësaj urie?
- Çfarë prove keni parë në botë që ka pasur një uri "për të dëgjuar fjalët e Zotit"? (Amos 8:11).

Shpjegoni se, edhe pse profecia që gjendet tek Amos 8:11–12 ka mundësi të jetë përmbushur shumë herë përgjatë historisë, një përmbushje e rëndësishme njihet si Braktisja e Madhe. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët të shkruajnë *Braktisje, duke përfshirë Braktisjen e Madhe* në anë të faqes së shkrimeve të tyre të shenjta pranë Amosit 8:11–12.

Paraqitni thënien vijuese dhe ftojini një student që ta lexojë atë me zë të lartë. Vëritni studentët të kërkojnë për disa prej faktorëve që luajtën rol në Braktisjen e Madhe.

"Pas vdekjes së Jezu Krishtit, njerëz dashakeqë i përdoqën Apostujt dhe anëtarët e Kishës dhe vranë shumë prej tyre. Me vdekjen e apostujve, çelësat e priftërisë dhe autoriteti kryesues i priftërisë u morën nga toka. Apostujt i kishin mbajtur doktrinat e ungjillit të pastra dhe kishin ruajtur kërkesat dhe standardin e denjësisë për anëtarët e Kishës. Pa Apostujt, me kalimin e kohës doktrinat u korruptuan

dhe u bënë ndryshime të paautorizuara në organizimin e Kishës dhe të ordinancave të priftërisë, të tilla si pagëzimi dhe dhënia e dhuratës së Frymës së Shenjtë.

Pa zbuluesën dhe autoritetin e priftërisë, njerëzit u mbështetën tek urtësia njerëzore për t'i interpretuar shkrimet e shenjta dhe parimet e ordinancat e ungjillit të Jezu Krishtit. Ide të rreme u mësuan si të vërteta. Shumë nga njohuria e karakterit dhe natyrës së vërtetë të Perëndisë Atit, Birit të Tij Jezu Krisht dhe Frymës së Shenjtë humbi. Doktrinat e besimit në Jezu Krishtin, pendimit, pagëzimit dhe dhuratës së Frymës së Shenjtë, u shtrembëruan ose u harruan. Autoriteti i priftërisë dhënë Apostujve të Krishtit nuk gjendej më në tokë" (*Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* [2004], f. 35).

- Sipas kësaj thënieje, cilët ishin disa prej faktorëve që luajtën rol në Braktisjen e Madhe?
- Përse është thelbësore të kuptojmë që Braktisja e Madhe ndodhi me të vërtetë? (Studentët mund të përdorin fjalë të ndryshme, por sigurohuni që ata të përcaktojnë parimin vijues: **Dituria që pati një Braktisje të Madhe, mund të na ndihmojë të dallojmë nevojën për Rivendosjen e ungjillit.**)

Shpjegoni se gjatë kësaj periudhe të braktisjes, Ati Qiellor vazhdoi ta ushtronte ndikimin e Tij në botë nëpërmjet Dritës së Krishtit, që "i jepet çdo njeriu" (Moroni 7:16) dhe nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, e cila dëshmon që ungjilli është i vërtetë (shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, "Frymë e Shenjtë", f. 52; ose scriptures.lds.org). Ai frymëzoi burra e gra në shumë kultura, të cilat e kërkuan ndihmën e Tij gjatë asaj kohe. Reformuesit e krishterë, të tillë si Martin Luteri dhe Uilliam Tindejlli, punuan për t'i ndihmuar të krishterët që të jetonin më pranë idealeve që gjendeshin në Bibël. Përpjekjet e reformuesve, filozofëve dhe madje drejtuesve të shteteve në Evropë dhe Amerikën Veriore çuan drejt një theksimi të shtuar mbi dinjitetin njerëzor dhe lirinë fetare në shumë pjesë të botës. Pavarësisht nga këto zhvillime të rëndësishme, Perëndia ende nuk e kishte rivendosur tërësisht Kishën e Tij. (Shih *Predikoni Ungjillin Tim*, f. 45–46.)

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli (1910-2008) dhe ftojini një student ta lexojë me zë të lartë:



"Për shekuj qiejt mbetën të vulosur. Burra e gra të mira, jo pak veta – me të vërtetë njerëz të mëdhenj dhe të mrekullueshëm – u përpoqën t'i korriginin, forconin dhe përmirësonin sistemet e tyre të adhurimit dhe strukturën e tyre të doktrinës. Atyre unë iu jap nderim dhe respekt. Sa më e mirë është bota për shkak të veprimit të tyre të guximshëm. Ndërkohë që besoj se puna e tyre ishte e frymëzuar, ajo nuk u favorizua me hapjen e qiejve, me shfaqjen e Hyjnisë" ("The Marvelous Foundation of Our Faith", *Ensign*, nëntor 2002, f. 80).

Kujtojini studentët se në vitin 1820 i riu Jozef Smith po kërkonte Kishën e vërtetë, por nuk mund ta gjente atë. Ftojini studentët ta lexojnë në heshtje Joseph Smith – Historia 1:5–10, duke kërkuar fraza që përshkruajnë sfidat e shkaktuara nga Braktisja e Madhe.

- Cilat janë disa nga frazat që Jozef Smithi i përdori për t'iu drejtuar sfidave shpirtërore të kohës së tij?
- Si i përshkroi Jozefi ndjenjat e tij që erdhën si rrjedhim i një përshtjellimi fetar që e rrethonte atë?

Kujtojini studentët se kërkimi i Jozef Smithit për të vërtetën çoi te Vegimi i Parë dhe thirrja e tij si një profet. (Këto do të diskutohen në mësimin e ardhshëm.) Vini në dukje

që thirrja e Profetit Jozef Smith dhe Rivendosja e ungjillit ndoqën një model të themeluar nga Perëndia, i cili është përsëritur gjatë gjithë historisë. Për shembull, thirrja e Enokut (shih Moisiu 6:26–32) dhe e Noeut (shih Moisiu 8:17–20) e ndoqën këtë model. Paraqitni shpjegimin vijues të këtij modeli dhe ftojeni një student ta lexojë atë me zë të lartë:

“Historia biblike ka shënuar shumë raste kur Perëndia u ka folur profetëve dhe gjithashtu tregon shumë raste të braktisjes. Në fund të çdo periudhe të një braktisjeje të përgjithshme, Perëndia ka treguar dashurinë Tij për fëmijët e Tij duke thirrur një profet tjetër dhe duke i dhënë atij autoritet priftërie për të rivendosur dhe për t’u mësuar njerëzve sërish ungjillin e Jezu Krishtit. Në thelb, profeti vepron si një kujdestar për të mbikëqyrur familjen e Perëndisë këtu në tokë. Periudha të tilla kohore të kryesuar nga përgjegjësi profetike janë quajtur periudha [të kujdestarisë] ungjillore” (*Predikoni Ungjillin Tim*, f. 33; shih edhe Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Periudhë”, f. 146).

- Si ndjek Rivendosja e ungjillit nëpërmjet Jozef Smithit një model të shikuar në periudhat e mëparshme ungjillore? (Studentët mund të përdorin fjalë të ndryshme, por sigurohuni që ata të përcaktojnë doktrinën vijuese: **Pas periudhave të braktisjes së përgjithshme, Perëndia i thërret profetët dhe iu jep atyre autoritet që të rivendosin dhe t’ua mësojnë njerëzve sërish ungjillin.** Studentët duhet të kuptojnë edhe këtë doktrinë: **Jozef Smithi u thirr nga Perëndia që të rivendoste ungjillin për periudhën tonë të kujdestarisë ungjillore.**)
- Si mund t’ju ndihmojë të kuptuarit e këtij modeli që t’ia shpjegoni Rivendosjen e ungjillit një njeriu të një besimi tjetër?

Theksoni se në Vegimin e Parë, Jozef Smithi mësoi se asnjë Kishë e vërtetë nuk ekzistonte në tokë dhe se plotësia e ungjillit të Krishtit nevojitej të rivendosej. Edhe pse Bibla përmban profeci për Braktisjen e Madhe, prova më e rëndësishme që kjo braktisje ndodhi, është fakti që Jozef Smithi u thirr të ishte një profet dhe që u rivendos plotësia e ungjillit.

2 Nefi 27:25–26; Doktrina e Besëlidhje 1:12–30

Rivendosja e ungjillit është “një punë e mrekullueshme dhe një çudi”

Shpjegoni se shkrimet e shenjta tregojnë disa arsye të Zotit për rivendosjen e ungjillit të Tij në tokë në ditët e fundit.

Ftojini studentët të lexojnë në heshtje profecinë e Isaias për Rivendosjen që gjendet te 2 Nefi 27:25–26, duke kërkuar përshkrimin e Zotit për gjendjen shpirtërore të botës në kohën e Rivendosjes. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët të shenjojnë fjalë dhe fraza që i përshkruajnë këto kushte shpirtërore. (*Shënim*: Një nga mënyrat më të dobishme për studentët që të zotërojnë dhe të ruajnë atë që e mësojnë nga shkrimet e shenjta, është të shenjojnë fjalë dhe fraza të rëndësishme.) Pas një kohe të mjaftueshme, kërkojuni studentëve të tregojnë atë që gjetën.

- Si mendoni, përse i drejtohem Rivendosjes së ungjillit si “një punë e mrekullueshme dhe një çudi”?
- Çfarë gjeni “[të] mrekullueshme” dhe një “çudi” rreth Rivendosjes? (Teksa studentët përgjigjen, vini në dukje se Rivendosja e ungjillit si një “punë e mrekullueshme dhe një çudi”, është shembull i një teme të përsëritur në Doktrinën e Besëlidhjet. “Temat janë cilësi ose ide të ndërthurura, të përsëritura dhe

bashkuese" [David A. Bednar, "A Reservoir of Living Water" (mbledhje rreth vatrës në Universitetin "Brigam Jang", 4 shkurt 2007), f. 6, speeches.byu.edu.]

Ftojini gjysmën e klasës të studiojë Doktrinën e Besëlidhjet 1:12–17, duke kërkuar arsyet që Zoti i dha për sjelljen në dritë të Rivendosjes së ungjillit. Ftojini gjysmën tjetër të klasës të studiojë Doktrinën e Besëlidhjet 1:18–30, duke kërkuar mënyrat se si Rivendosja e ungjillit do t'i bekojë fëmijët e Perëndisë. (*Shënim*: Doktrina e Besëlidhje 1:30 do të studiohet me më shumë hollësi në mësimin 6.)

Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini studentët të tregojnë atë që gjetën. Sigurohuni që studentët e kuptojnë të vërtetën vijuese: **Rivendosja e ungjillit i ndihmon ata që besojnë në Krishtin për ta shtuar besimin dhe për t'i kapërcyer fatkeqësitë e ditëve të fundit.**

Lexoni me zë të lartë thënien vijuese nga Profeti Jozef Smith (1805–1844):



"[Profetët] e kanë shpresuar me pritje të gëzuar ditën në të cilën jetojmë ne; dhe të frymëzuar me pritje qiellore dhe të gëzueshme ata kanë kënduar dhe shkruar dhe profetizuar për këtë ditën tonë" (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 194).

- Përse profetët e së shkuarës mezi e kanë pritur ditën tonë? (Një ide që studentët ka mundësi ta përcaktojnë është që **Rivendosja do të përhapet përmes globit dhe do ta përgatitë botën për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit.**)

Shfaqeni thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli dhe kërkojuni disa studentëve ta lexojnë atë me radhë me zë të lartë:



"Vëllezërit dhe motrat e mi, a e kuptoni se çfarë kemi? A e dalloni vendin tonë në dramën e madhe të historisë njerëzore? Kjo është pika qendrore e të gjithë asaj që ka ndodhur më parë. ...

... Vepra e të Plotfuqishmit në ditët e mëvonshme, ajo për të cilën folën të lashtët, ajo për të cilën profetizuan profetët dhe apostujt, ka ardhur. Është këtu. Për një arsye të panjohur për ne, por në urtësinë e Perëndisë, ne jemi privilegjuar të vijmë në tokë në këtë epokë të lavdishme. ...

Bazuar në atë që kemi dhe atë që dimë, ne duhet të jemi një popull më i mirë se sa jemi. Ne duhet të jemi më të ngjashëm me Krishtin, më falës, më ndihmues dhe më të vëmendshëm ndaj gjithë njerëzve përreth nesh.

Ne qëndrojmë në pikën kulmore të epokave, të mahnitur nga ndjenja e madhërishe dhe solemne e historisë. Kjo është periudha e fundit dhe përfundimtare e kujdestarisë ungjillore, drejt së cilës ka treguar gjithçka nga e kaluara. Unë jap dëshmi dhe dëshmoj për realitetin dhe vërtetësinë e këtyre gjërave" ("At the Summit of the Ages", *Ensign*, nëntor 1999, f. 74).

- Çfarë mendimesh e ndjenjash nxit brenda jush thënia "ne qëndrojmë në pikën kulmore të epokave"?
- Nëse nuk është shumë vetjake, tregoni një përvojë nga jeta juaj që e forcoi dëshminë tuaj për ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit.
- Çfarë mund të bëjmë për ta treguar mirënjohjen tonë për Rivendosjen e ungjillit?

Materiale Leximi për Studentin

- Isaia 29:13–14; Amos 8:11–12; 2 Nefi 27:1–5, 25–26; Doktrina e Besëlidhje 1:12–30; Joseph Smith – Historia 1:5–10.
- Gordon B. Hinckley, “At the Summit of the Ages”, *Ensign*, nëntor 1999, f. 72–74.
- *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 31–36.

2

Vegimi i Parë

Hyrje

Rrëfimi i Vegimit të Parë të Jozef Smithit, siç shënohet te Perla me Vlerë të Madhe, u shkrua me qëllim që të korrigjonte artikuj të rremë rreth Kishës. Gjatë gjithë jetës së tij, Profeti Jozef Smith dha disa rrëfime të Vegimit të Parë. Këto rrëfime mund ta shtojnë

kuptueshmërinë tonë për atë përvojë dhe ta forcojnë besimin tonë te Rivendosja. Ky mësim ka për qëllim që t'i ndihmojë studentët të kuptojnë rëndësinë e të pasurit të një dëshmie për këtë ngjarje të rëndësishme, të pashoqe.

Lexim Konteksti

- Gordon B. Hinckley, "The Marvelous Foundation of Our Faith", *Ensign*, nëntor 2002, f. 78–81.
- "First Vision Accounts", Gospel Topics, [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics).

Sugjerime për Mësimdhënien

Joseph Smith – Historia 1:1–2

Profeti shkroi rreth Vegimit të Parë për të korrigjuar artikuj të rremë

Shpjegoni se në vitin 1838, Jozef Smithi filloi të punonte për historinë e tij zyrtare. Pjesa në Perlën me Vlerë të Madhe, e njohur si Joseph Smith – Historia u nxor nga ajo histori që ishte shumë më e gjatë.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Joseph Smith – Historinë 1:1–2. Vëreni klasën ta ndjekë dhe të kërkojë arsytet që dha Jozef Smithi për përgatitjen e historisë së tij.

- Sipas vargut 1, çfarë po qarkullonte mes njerëzve gjatë ditëve të hershme të Kishës?
- Cili ishte synimi i atyre njerëzve që i nxitën artikujt e botuar kundër Kishës?
- Çfarë ngjashmëri me këtë gjendje ekzistojnë në kohën tonë?

Shpjegoni se sot vazhdojnë të gjenden individë dhe grupe që përhapin informacion të rremë ose çorientues rreth Kishës me qëllimin që ta shkatërrojnë besimin.

- Cilat arsye dha Jozefi për shkrimin e historisë së tij? (Për ta "korrigjuar mendjen publike dhe për t'i vendosur të gjithë kërkuesit e së vërtetës në zotërim të fakteve, siç ... ndodh[ën] ato" [Joseph Smith – Historia 1:1].)
- Përse është e rëndësishme që "kërkuesit e së vërtetës" për Rivendosjen të mbështeten te rrëfimi i mirëfilltë i Jozef Smithit? (Studentët mund të përdorin fjalë të ndryshme, por sigurohuni që është e qartë se **mbështetja te rrëfimi i Profetit mund t'i ndihmojë individët që të shmangin qenien të mashtruar prej informacionit të rremë ose çorientues.**)

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Nil. L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftojini studentët ta lexojnë atë në heshtje:



“Përherë ka pasur disa që duan ta turpërojnë Kishën dhe të shkatërrojnë besimin. Sot ata përdorin internetin.

Disa informacione lidhur me Kishën, sado bindëse qofshin, thjesht nuk janë të vërteta” (“Prova e Besimit Tuaj”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 41).

- Cilat burime duhet t’i kërkojmë dhe t’i mirëbesojmë në kërkimin tonë vetjak për të ditur të vërtetën lidhur me Vegimin e Parë, Rivendosjen e ungjillit dhe ngjarje të tjera në historinë e Kishës? Përse? (Ndhimojini studentët të kuptojnë parimin vijues: **Për t’iu shmangur mashtrimin nga informacioni i rremë ose çorientues, ata njerëz që kërkojnë të vërtetën, duhet të kërkojnë burime të besueshme të informacionit rreth Kishës dhe historisë së saj, në vend të pranimit të thjeshtë të informacionit që dëgjojnë ose lexojnë, duke përfshirë informacionin që vjen nga një kërkim në internet.**)

Shpjegoni se kritikuesit e Kishës japin argumente kundër realitetit të Vegimit të Parë duke thënë se Jozef Smithi nuk e shënoi këtë përvojë me vegimin deri shumë vite pasi ndodhi. Shpjegoni se Jozef Smithi 14-vjeçar u bë ngurrues të fliste rreth vegimit të tij pas reagimit të atyre që ua tha fillimisht (shih Joseph Smith – Historia 1:21–26). Ai e shënoi përvojën kur e ndjeu se ishte koha e duhur për ta bërë këtë. Shpëtimtari i udhëzoi Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin që të mos flisnin për përvojën e tyre në Malin e Shpërfytyrimit deri pas Ringjalljes së Tij (shih Mateu 17:9), duke e bërë të qartë se disa përvoja të shenjta duhet të tregohen vetëm sipas nxitjeve nga Shpirti.

Rrëfimet e Vegimit të Parë

Shënim: Ndërsa jepni këtë pjesë të mësimin, lejoni kohë të përshtatshme për të dhënë mësim pjesën e fundit të mësimin, që mbulon Joseph Smith – Historinë 1:8–20.

Shpjegojuni studentëve që Jozef Smithi shkroi, qoftë vetë ose me ndihmën e shkruesve, të paktën katër rrëfime të ndryshme të Vegimit të Parë. Përveç këtyre, disa rrëfime të këtij vegimi u shënuan nga bashkëkohësit e Jozef Smithit. Secili rrëfim thekson aspekte të ndryshme të përvojës së Jozefit, por ato të gjitha kanë të përbashkëta elemente thelbësore të asaj që Jozefi pa e dëgjoji. Që t’i ndihmoni të shpjegojnë përse ka ndryshime në rrëfimet e ndryshme, kërkojuni studentëve të marrin parasysht:

- Mendoni për një përvojë domethënëse ose kuptimplote që e keni pasur në jetën tuaj. Si mund të ndryshonte rrëfimi juaj për atë përvojë në varësi nga cilët janë dëgjuesit tuaj? Si mund të ndryshonte ai në varësi nga koha kur po tregoni ose arsyeja përse po tregoni rreth përvojës?

Ftojuni një student të lexojë me zë të lartë thënien vijuese dhe kërkojuni studentëve të dëgjojnë për atë që historianët e presin kur një përvojë tregohet shumë herë:

“Rrëfimet e ndryshme të Vegimit të Parë tregojnë të njëjtën histori, edhe pse natyrisht ato ndryshojnë në theksime dhe hollësi. Historianët presin që kur një individ e ritregon një përvojë në mjedis të shumta, për dëgjues të ndryshëm, përgjatë shumë viteve, secili rrëfim do të theksojë aspekte të ndryshme të përvojës dhe do të përmbajë hollësi të veçanta. Me të vërtetë, ndryshime të ngjashme me atë të rrëfimeve të Vegimit të Parë ekzistojnë në rrëfimet e shumta të shkrimeve të shenjta për vegimin e Palit në rrugën për në Damask dhe për përvojën e Apostujve në Malin e Shpërfytyrimit [Veprat e Apostujve 9:3–9; 22:6–21; 26:12–18; Mateu 17:1–13; Marku 9:2–13; Lluka 9:28–36]. Prapëseprapë, pavarësisht nga ndryshimet, një qëndrueshmëri bazë mbetet mes të gjitha rrëfimeve të Vegimit të Parë. Disa njerëz në mënyrë të gabuar kanë debatuar që ndonjë ndryshim në ritregimin e

historisë është provë e trillimit. Në të kundërtën, anali i pasur historik na aftëson që të mësojmë më shumë rreth kësaj ngjarjeje mbresëlënëse, nga sa mundeshim nëse ajo nuk do të ishte e dokumentuar aq mirë” (“First Vision Accounts”, Gospel Topics, lds.org/topics).

Si një shembull të ndryshimeve në rrëfimet, ju mund t’u tregoni studentëve se “edhe pse rrëfimi i vitit 1832 thekson historinë më vetjake të Jozef Smithit si një i ri duke kërkuar falje, rrëfimi i vitit 1838 përqendrohet te vegimi si fillimi i ‘ngritjes dhe i përparimit të Kishës’” (“First Vision Accounts”, Gospel Topics, lds.org/topics). Kujtojeni studentët se leximi i caktuar atyre përfshin artikullin e Gospel Topics “First Vision Accounts” [“Rrëfimet e Vegimit të Parë”], i cili siguron një analizë më të hollësishme të secilit prej rrëfimeve të ndryshme të Vegimit të Parë. Ftojini studentët ta studiojnë artikullin jashtë orës mësimore për të kuptuar më mirë se si secili rrëfim luan rol në njohurinë tonë rreth Vegimit të Parë. (*Shënim:* Kujtojeni studentët për rëndësinë e leximit të pjesëve të caktuara nën “Leximet e Studentëve” përpara orës mësimore. Bërja e kësaj do t’i ndihmojë ata të japin ndihmesë në diskutimet e klasës.)

- Si mund ta mbështetnin rrëfimet e shumta të Vegimit të Parë vlefshmërinë e kësaj ngjarjeje të shenjtë dhe si mund ta pasuronin kuptueshmërinë tonë për këtë ngjarje? (Ndihmojini studentët të kuptojnë se **rrëfimet e shumta të Vegimit të Parë të Jozef Smithit na aftësojnë që të mësojmë më shumë rreth kësaj përvoje të shenjtë nga sa mundeshim, në qoftë se ajo do të ishte më pak e dokumentuar.**)

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) dhe ftojini një student ta lexojë me zë të lartë:



“Nuk shqetësohem që Profeti Jozef Smith dha një numër variantesh të Vegimit të Parë, më shumë se sa të shqetësohem që ka katër shkruar të ndryshëm të ungjillevë të Dhiatës së Re, secili me vetë idetë e tij, secili duke i treguar ngjarjet që të përmbushte vetë qëllimin e tij të shkrimit të asaj kohe” (“God Hath Not Given Us the Spirit of Fear”, *Ensign*, tetor 1984, f. 5).

Jepni dëshminë tuaj për realitetin e Vegimit të Parë dhe të Rivendosjes së ungjillit nëpërmjet Profetit Jozef Smith.

Joseph Smith – Historia 1:8–20

Vlefshmëria e Kishës qëndron mbi vërtetësinë e Vegimit të Parë

Ftojini disa studentë që të lexojnë me radhë, me zë të lartë nga Joseph Smith – Historia 1:8–15.

- Cilat ishin disa nga gjërat që bëri Jozef Smithi për të gjetur përgjigje për pyetjet e tij?
- Si mendoni, përse Satani u përpoq ta ndalonte Jozef Smithin që të lutej?

Ftojini disa studentë që të lexojnë me radhë, me zë të lartë nga Joseph Smith – Historia 1:16–19.

- Cilat janë disa të vërteta të rëndësishme që mësojmë nga vargjet 16–17? (Teksa studentët përgjigjen, theksoni që **të vërtetat e përjetshme u rivendosën në tokë kur Ati Qiellor dhe Jezu Krishti iu shfaqën Jozef Smithit.**)

Paraqitni dhe lexoni me zë të lartë thënien vijuese nga Plaku Ted R. Kelister, i cili shërbeu në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve. Teksa e lexoni këtë thënie, ju mund të

doni të sugjeroni që studentët të shenjojnë në shkrimet e tyre të shenjta të vërtetat që i theksoi Vëllai Kelister. Ju mund të doni gjithashtu të sugjeroni që ata t'i shkruajnë të vërtetat që Jozefi i mësoi në anë të faqes pranë Joseph Smith – Historia 1:16–19. (Shënim: Të mësuarit për t'i shenjuar dhe dalluar shkrimet e shenjta është një teknikë e rëndësishme për studimin e shkrimeve të shenjta që ju mund t'i ndihmoni studentët ta zhvillojnë [shih *Gospel Teaching and Learning: A Handbook for Teachers and Leaders in Seminaries and Institutes of Religion* (2012), f. 21].)



“Jozef Smithi ishte i vajosuri i Zotit për të rivendosur Kishën e Krishtit në tokë. Kur doli nga korija me pemë, ai përfundimisht mësoi katër të vërteta themelore që në atë kohë nuk mësoheshin nga shumica e botës bashkëkohore të krishterë.

Së pari, ai mësoi se Perëndia, Ati, dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, janë dy qenie të veçanta e të dallueshme. ...

E vërteta e dytë e madhe që zbuloi Jozef Smithi ishte se Ati dhe Biri kanë trupa të përlëvdur prej mishi dhe kockash. ...

E vërteta e tretë që mësoi Jozef Smithi ishte se Perëndia ende i flet njeriut sot – se qiejt nuk janë mbyllur. ...

E vërteta e katërt që mësoi Jozef Smithi ishte se Kisha e tërë dhe e plotë e Jezu Krishtit nuk qe atëherë në tokë” (“Jozef Smithi – Profeti i Rivendosjes”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2009, f. 35–36).

- Si mendoni, përse këto të vërteta rreth Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit janë thelbësore që të dihen dhe të kuptohen?
- Si mund të ndihmojë nevoja për ato të vërteta që të shpjegohet përse Satani u përpoq ta pengonte që të lutej të riun Jozef Smith?

Për ta vënë në dukje rëndësinë e Vegimit të Parë të Jozef Smithit, paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli dhe ftojini një student ta lexojë me zë të lartë:



“E gjithë forca qëndron mbi vlefshmërinë e [Vegimit të Parë]. Ai ose ndodhi, ose nuk ndodhi. Nëse nuk ndodhi, atëherë kjo vepër është një mashtrim. Nëse ndodhi, atëherë ajo është vepra më e rëndësishme dhe më e mrekullueshme nën qiejt. ...

... Në vitin 1820 ajo shfaqje e lavdishme erdhi në përgjigje të lutjes së një djali, i cili kishte lexuar në Biblën e familjes së tij fjalët e Jakobit: ‘Në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe atij do t’i jepet’ (Jakobi [Bibël] 1:5).

Mbi atë përvojë të pashoqe dhe të mrekullueshme qëndron vlefshmëria e kësaj Kise” (“The Marvelous Foundation of Our Faith”, *Ensign*, nëntor 2002, f. 80).

- Si lidhet vlefshmëria e Kishës me Vegimin e Parë të Jozef Smithit?
- Përse është e rëndësishme të kemi një dëshmi që Jozef Smithi i pa Perëndinë, Atin, dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin? (Studentët mund të japin një llojshmëri përgjigjesh, por sigurohuni që parimi vijues është i qartë: **Kur marrim një dëshmi që Jozef Smithi e pa Perëndinë, Atin, dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin, ne gjithashtu mund të arrijmë të dimë vërtetësinë e Rivendosjes së ungjillit.**)

Teksa e mbyllni mësimin, theksoni rëndësinë e të pasurit të një dëshmie vetjake për të vërtetën e Vegimit të Parë. Kjo dëshmi vetjake, e ngritur mbi shkëmbin e zbulësës, na ndihmon të qëndrojmë të fortë në besimin tonë kur ndeshemi me informacion të rremë rreth Profetit Jozef Smith dhe Kishës. Dëshmoni se mënyra e Jozef Smithit për të

mësuar të vërtetën, do të veprojnë edhe për ne. Ne mund të kërkojmë të vërtetën, të lexojmë shkrimet e shenjta, të përsiatim dhe më së fundi t'i kërkojmë Perëndisë, dhe Ai do të japë përgjigje (shih Jakobi [LiM] 1:5). Ftojini studentët të përsiatin se si ata e kanë marrë një dëshmi që Ati dhe Biri iu shfaqën Jozef Smithit. Lejoni kohë për një ose dy studentë që të shprehin se si ata e morën një dëshmi për Vegimin e Parë.

Materiale Leximi për Studentin

- Joseph Smith – Historia 1:1–26.
- Gordon B. Hinckley, “The Marvelous Foundation of Our Faith”, *Ensign*, nëntor 2002, f. 78–81.
- “First Vision Accounts”, Gospel Topics, [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics).

Dalja në Dritë e Librit të Mormonit

3

Hyrje

Zoti dërgoi engjëllin Moroni që të përgatiste Jozef Smithin për të marrë e përkthyer Librin e Mormonit. Dihet pak rreth procesit të mirëfilltë të përkthimit. Jozef Smithi tha se Libri i Mormonit u përkthye “nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë” (parathënia

e Librit të Mormonit, botim i vitit 2005). Në përputhje me ligjin e dëshmitarëve (shih 2 Korintasve 13:1), Zoti lejoi disa njerëz të tjerë të ishin dëshmitarë të këtij anali të lashtë. Dëshmitë e tyre e forcuan besueshmërinë e Librit të Mormonit për të gjithë botën.

Lexim Konteksti

- Neal A. Maxwell, “By the Gift and Power of God”, *Ensign*, janar 1997, f. 36–41.
- “Book of Mormon Translation”, Gospel Topics, lds.org/topics.
- “Coming Forth of the Book of Mormon and Restoration of the Priesthood”, kapitulli 5, te *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 52–66.

Sugjerime për Mësimdhënien

Joseph Smith – Historia 1:30–35, 42–54

Përkthyer nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë

Ftoni një ose dy vullnetarë të përmbledhin për klasën atë që ata mbajnë mend rreth vizitës së engjëllit Moroni tek i riu Jozef Smith natën e 21 shtatorit 1823. Nëse nevojitet, jepni informacionin vijues:

“Natën e 21 shtatorit 1823, Jozefi shkoi në dhomën e tij të gjumit në papafingo, në shtëpinë prej trarësh të familjes së tij në Palmira të Nju-Jorkut, por qëndroi zgjuar pasi të tjerët në dhomë kishin shkuar për të fjetur dhe u lut me zell që të dinte më shumë mbi qëllimet e Perëndisë për të. ...

Në përgjigje të lutjes së tij, Jozefi pa një dritë që u shfaq në dhomën e tij, që vazhdoi të rritej derisa dhoma ishte ‘më e shndritshme se në mesditë’. Një lajmëtar qiellor u shfaq pranë shtratit të tij, duke qëndruar në ajër, i veshur me një rrobë ‘të bardhësisë më të jashtëzakonshme’. (Joseph Smith – Historia 1:30–31.) Ky lajmëtar ishte Moroni, profeti i fundit nefit, që shekuj më parë kishte goposur fletët mbi të cilat ishte shkruar Libri i Mormonit dhe që tani mbante çelësat në lidhje me këtë anal të shenjtë (shih DeB 27:5). Atë e kishin dërguar t’i thoshte Jozefit se Perëndia i kishte falur mëkatet e tij dhe që kishte një punë të madhe për të për ta kryer. Si pjesë e kësaj pune, Jozefi duhej të shkonte te një kodër aty pranë, ku ishte vendosur një anal i shenjtë, i shkruar mbi fletë të arta. ... Jozefi duhej ta përkthente analin dhe t’ia sillte në dritë botës.

Të nesërmen, Jozefi shkoi te kodra ku ishin goposur fletët e Librit të Mormonit. Atje takoi Moronin dhe i pa fletët, por iu tha se nuk mund t’i merrte ato për katër vjet. ...

... Më 22 shtator 1827, [gruaja e Jozefit, Ema] shkoi bashkë me të te kodra dhe priti aty pranë ndërkohë që Moroni i dorëzoi fletët në duart e Profetit” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 61–62).

Ftojini studentët të kthehen te faqja e titullit të Librit të Mormonit dhe t’i hedhin një vështrim të shpejtë paragrafit të parë, duke kërkuar informacion rreth mënyrës se si ky anal i lashtë do të dilte në dritë dhe do të përkthehej. Pasi studentët të kenë lexuar, kërkojuni të tregojnë atë që gjetën. (Studentët duhet të përcaktojnë të vërtetën vijuese: **Libri i Mormonit u përkthye nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë.**)

Ftojeni një student të lexojë me zë të lartë Joseph Smith – Historinë 1:34–35. Vëreni klasën ta ndjekë dhe të kërkojë për një mënyrë se si Zoti e ndihmoi Jozef Smithin që ta përkthente Librin e Mormonit.

- Sipas këtyre vargjeve, cila është një mënyrë se si Zoti e ndihmoi Jozef Smithin në përkthimin e analit të lashtë? (Zoti siguroi Urimin e Thumimin për përkthimin.)

Shpjegoni se një tjetër mjet që Jozef Smithi e përdori teksa përkthente Librin e Mormonit, ishte një gur i vogël vezak, nganjëherë i quajtur si një “gur shikues”, që ai e zbuloi disa vite përpara se të merrte fletët e arta (shih “Book of Mormon Translation”, Gospel Topics, lds.org/topics). Rrëfimi historik vë në dukje që Profeti për të përkthyer nganjëherë përdori Urimin e Thumimin dhe nganjëherë përdori gurin shikues.

Lexoni me zë të lartë thënien vijuese për t’i ndihmuar studentët të kuptojnë se Zoti ia zbuloi Profetit përkthimin në anglisht të Librit të Mormonit nëpërmjet Urimit e Thumimit dhe gurit shikues:

“Kur u nxit që të jepte hollësi rreth procesit të përkthimit, Jozefi e përsëriti në disa raste se përkthimi ishte bërë ‘nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë’ dhe njëherë shtoi: ‘Nuk ishte qëllimi që t’i tregoheshin botës të gjitha detajet e daljes në dritë të Librit të Mormonit’.

Sidoqoftë, shkruesit dhe njerëz të tjerë që e vëzhguan përkthimin, dhanë rrëfime të shumta që japin ide lidhur me procesin. Disa rrëfime vënë në dukje se Jozefi i studioi shkronjat mbi fletët. Shumica e rrëfimeve flasin rreth përdorimit të Urimit e Thumimit nga Jozefi (qoftë të interpretuesve ose të gurit shikues) dhe shumë rrëfime flasin për përdorimin nga ai të një guri të vetëm. Sipas këtyre rrëfimeve, Jozefi i vendosi qoftë interpretuesit ose gurin shikues në një kapelë, e ngjeshi fytyrën e tij brenda kapelës që ta bllokonte dritën e jashtme dhe lexoi me zë të lartë fjalët në anglisht që shfaqeshin mbi mjetin. Procesi siç u përshkrua, sjell ndërmend një fragment nga Libri i Mormonit që flet rreth Perëndisë duke përgatitur ‘një gur i cili do të bëjë që drita e tij të ndriçojë në errësirë’ [Alma 37: 23–24] (“Book of Mormon Translation”, Gospel Topics, lds.org/topics).

Shpjegoni se ndihma e Zotit ishte gjithashtu e dukshme në sasinë e shkurtër të kohës në të cilën Jozef Smithi e përktheu Librin e Mormonit. Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftoni një student ta lexojë me zë të lartë:



“Mendoni për kohën e shkurtër që iu desh Jozefit për të përkthyer Librin e Mormonit. Duke punuar nga prilli deri në qershor të vitit 1828, Jozefi përktheu 116 faqet që më vonë i humbi Martin Harris. Jozefi e filloi përkthimin sërish më 7 prill 1829, me Oliver Kaudërin si shkrues. Dorëshkrimi u përfundua tetëdhjetë e pesë ditë më vonë, më 30 qershor të atij viti. Sigurisht, jo e gjithë ajo kohë u kalua duke punuar me përkthimin. ...

E vlerësuar në mënyrë të kujdesshme, kjo la gjashtëdhjetë e pesë ditë pune ose më pak, në të cilat profeti dhe shkruesit e tij e përkthyen këtë libër, i cili përmban 531 faqe në botimin e tij të tanishëm. (Shih John W. Welch, *Ensign*, janar 1988, f. 46–47.) Kjo llogaritet si një mesatare prej tetë faqesh në ditë. Merreni këtë parasysh kur përktheni një libër ose ndërkohë që bëni planin e leximit tuaj të Librit të Mormonit” (“A Treasured Testament”, *Ensign*, korrik 1993, f. 61–62).

- Cilat janë disa nga mënyrat se si dalja në dritë e Librit të Mormonit ndodhi “nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë”?
- Nëse nuk i dimë të gjitha hollësitë që e rrethuan daljes në dritë të Librit të Mormonit, si mund ta dimë që ky libër është i vërtetë? (Ne mund të marrim një dëshmi shpirtërore të Librit të Mormonit pa i ditur të gjitha hollësitë lidhur me përkthimin e tij.)

- Çfarë ju ka ndihmuar të fitoni një dëshmi për Librin e Mormonit?

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli:



“Fillimisht erdhi Moroni me fletët nga të cilat u përkthye Libri i Mormonit. Ç’gjë e pashoqe dhe e mrekullueshme ishte kjo. Historia e Jozefit për fletët e arta ishte fantastike. Ishte e vështirë të besohej dhe e lehtë të sfidohej. A mund ta kishte shkruar atë bazuar në vetë aftësinë e tij? Ai libër është këtu, vëllezërit dhe motrat e mia, për çdo njeri që ta shohë, ta mbajë në dorë, ta lexojë. Çdo përpjekje për ta shpjeguar origjinën e tij, ndryshe nga ajo që dha Jozefi, ka rënë si e pavlerë. Ai ishte kryesisht i pashkolluar; dhe prapëseprapë, brenda një kohe shumë të shkurtër, solli në dritë përkthimin që në formën e botuar arrin në më shumë se 500 faqe. ...

Përgjatë gjithë këtyre viteve kritikët janë përpjekur ta shpjegojnë atë libër. Kanë folur kundër tij. Janë tallur me të. Por ai libër i ka mbijetuar të gjitha ato dhe ndikimi i tij sot është më i madh sesa në ndonjë kohë në historinë e tij” (“The Stone Cut Out of the Mountain”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2007, f. 85).

- Çfarë mund të thoni për ta ndihmuar dikë që e ka të vështirë ta besojë se Libri i Mormonit është i vërtetë?

Dëshmoni se Libri i Mormonit erdhi në dritë nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë.

Doktrina e Besëlidhje 17

Dëshmitë e Tre Dëshmitarëve dhe të Tetë Dëshmitarëve

Shpjegoni se ndërsa Jozef Smithi po përkthente Librin e Mormonit, ai mësoi se Zoti do të caktonte njerëz të tjerë që të ishin dëshmitarë të analit të lashtë (shih 2 Nefi 27:12–13; Ethëri 5:2–5). Në atë kohë, Oliver Kaudëri, Dejvid Uitmeri dhe Martin Harris secili shprehën një dëshirë që të ishin këta dëshmitarë të veçantë. Doktrina e Besëlidhje 17 përmban udhëzimet e Zotit drejtuar këtyre burrave.

Ftojini disa studentë të lexojnë me radhë, me zë të lartë nga Doktrina e Besëlidhje 17:1–6. Vëreni klasën ta ndjekë, duke kërkuar atë që Zoti i udhëzoi të bënë dëshmitarët pasi t’i shihnin fletët. Pasi studentët të tregojnë atë që gjetën, pyetni:

- Si mendoni, përse këta burra kishin nevojë të tregonin besim si profetët e lashtë përpara se Zoti t’i lejonte të shihnin fletët?
- Sipas vargjeve 3–5, çfarë përgjegjësie do të kishin këta dëshmitarë pasi t’i shihnin fletët?
- Çfarë përgjegjësie kemi ne kur Zoti na e shfaq vërtetësinë e Librit të Mormonit? (Studentët duhet të përcaktojnë një parim të ngjashëm me sa vijon: **Pasi marrim një dëshmi të së vërtetës, ne kemi përgjegjësinë që të dëshmojmë për të.** [Shih edhe DeB 88:81.]) Mund të vini në dukje që ky parim është edhe një shembull i një modeli që mund ta gjejmë në shkrimet e shenjta. “Një model është një plan, një maket ose standard që mund të përdoret si udhërrëfyes për bërjen ose përgatitjen e përsëritur të diçkaje” (mbrëmje rreth vatrës në Universitetin “Brigam Jang”, 4 shkurt 2007), f. 5, speeches.byu.edu.)
- Si mund të jetë të dëshmuar për të vërtetën një shprehje e besimit tonë?

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë rrëfimin e Jozef Smithit për përvojën e tij me Tre Dëshmitarët:

“Martin Harris, Dejvid Uitmeri, Oliver Kaudëri dhe unë, ramë dakord të tërhiqeshim në pyll dhe u përpoqëm të merrim, me anë të lutjes së zjarrtë e të përlurur, plotësimin e premtimeve. ... [Pas] dështimit tonë të dytë, Martin Harris propozoi që ai duhej të tërhiqej nga ne, duke besuar, siç e shprehu ai vetë, se prania e tij ishte shkaku që nuk po merrnin atë që dëshironim. Prandaj ai u tërhoq prej nesh dhe ne u gjuhëzuan sërish, dhe nuk kishim shumë minuta që ishim përfshirë në lutje, kur ... një engjëll [Moroni] qëndroi para nesh. Në duart e tij ai mbante fletët. ... Ai i ktheu fletët një e nga një, që të mund t'i shihnim dhe të dallonim gdhendjet e dallueshme mbi to. ... Ne dëgjua një zë nga drita e shndritshme mbi ne, duke thënë: ‘Këto fletë janë zbuluar nëpërmjet fuqisë së Perëndisë dhe ato janë përkthyer nëpërmjet fuqisë së Perëndisë. Përkthimi i tyre, të cilin e keni parë, është i saktë dhe unë ju urdhëroj të jepni dëshmi për atë që ju tani shihni e dëgjoni’.

Tani, unë i lashë Dejvidin e Oliverin dhe shkova në kërkim të Martin Harrisit, të cilin e gjeta në një largësi të konsiderueshme, të përfshirë me zjarr në lutje. Megjithatë, ai shpejt më tha se nuk e kishte bindur ende Zotin dhe më kërkoi me këmbëngulje që të bashkohesha me të në lutje, që edhe ai të merrte të njëjtat bekime që ne sapo i kishim marrë. Prandaj, ne u bashkuam në lutje dhe përfundimisht e arritëm dëshirën tonë, sepse para se të kishim mbaruar, i njëjti vegim u hap për sytë tanë, të paktën m'u hap sërish mua, dhe unë pashë e dëgjova edhe njëherë të njëjtat gjëra; ndërsa po në të njëjtin çast, Martin Harris thirri, me sa duket në një ngazëllim prej gëzimit: ‘Kjo mjafton; kjo mjafton; sytë e mi kanë parë, sytë e mi kanë parë’” (në *History of the Church*, 1:54–55).

Jozefi u kthye në shtëpinë e familjes Uitmer dhe u tha prindërve të tij: “Zoti ka bërë që fletët t'u tregohen edhe tre burrave përveç meje, të cilët gjithashtu e kanë parë një engjëll dhe do të duhet të dëshmojnë për të vërtetën e asaj që kam thënë unë, sepse tani ata e dinë vetë, se unë nuk shkoj andej-këtej për t'i mashtruar njerëzit, dhe vërtet e ndiej sikur u çirova nga një barrë e tmerrshme, e cila ishte thajse shumë e rëndë për mua për ta mbajtur, ... dhe kjo vërtet e gëzon shpirtin tim, që nuk jam më tërësisht i vetëm në botë” (në Lucy Mack Smith, *History, 1844–1845*, libri 8, faqe 11, josephsmithpapers.org/paperSummarylucy-mack-smith-history-1844-1845).

- Si mendoni, përse Jozef Smithi u gëzua pas kësaj përvoje? (Ai nuk ishte më i vetëm si dëshmitar i fletëve dhe i lajmëtarit qiellor.)

Shpjegoni se edhe tetë dëshmitarë të tjerë e patën mundësinë për të parë fletët.

Ftojini gjysmën e klasës të lexojë “Dëshmia e Tre Dëshmitarëve” dhe gjysmën tjetër të lexojë “Dëshmia e Tetë Dëshmitarëve”, që të dyja mund të gjenden në faqet e hyrjes së Librit të Mormonit. Vërinë studentët të kërkojnë elementë të rëndësishëm të përvojave të dëshmitarëve. Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini studentët të tregojnë atë që zbuluan.

- Si ndryshonte përvoja e Tre Dëshmitarëve nga ajo e Tetë Dëshmitarëve? (Tre Dëshmitarët e dëgjuan zërin e Perëndisë dhe panë një engjëll, por nuk i mbajtën në duar fletët. Tetë Dëshmitarëve iu treguan fletët nga Jozef Smithi dhe ishin në gjendje t'i mbanin ato në duar. Tetë Dëshmitarët patën një dëshmi më fizike të realitetit të fletëve, ndërsa Tre Dëshmitarët patën një përvojë më shpirtërore.)
- Si mendoni, përse të pasurit e dëshmitarëve të shumtë ishte kaq i rëndësishëm për daljen në dritë të Librit të Mormonit?

Disa studentë mund të mos e dinë se që të Tre Dëshmitarët dhe disa prej Tetë Dëshmitarëve në fund të fundit u larguan nga Kisha. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë thënien vijuese nga Plaku Dallin H. Oaks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“E matur kundrejt gjithë ... kundërshtimeve të mundshme, dëshmia e Tre Dëshmitarëve për Librin e Mormonit qëndron dukshëm me forcë të madhe. ... Siç dihet mirë, për shkak të mosmarrëveshjeve ose xhelozive që përfshinë udhëheqës të tjerë të Kishës, secili prej këtyre tre dëshmitarëve u shkishërua nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme rreth tetë vjet pas botimit të dëshmisë së tyre. ... Prapëseprapë, deri në fund të jetës së tyre ... asnjëri prej këtyre dëshmitarëve nuk iu shmang dëshmisë së tij të botuar ose nuk tha asgjë që hedh ndonjë dyshim mbi vërtetësinë e saj.

Për më tepër, dëshmia e tyre qëndron e pakundërshtuar nga cilido dëshmitar tjetër. Dikush mund ta mohojë atë, por si i shpjegon ai tre burrat me karakter të mirë, të bashkuar e këmbëngulës në këtë dëshmi të botuar, deri në fund të jetës së tyre, përballë talljes së madhe dhe asnjë përfitimi tjetër vetjak? Ashtu si vetë Libri i Mormonit, nuk ka asnjë shpjegim më të mirë sesa ai që jepet në vetë dëshminë, në shpalljen solemne të burrave të mirë e të ndershëm të cilët treguan atë që panë” (“The Witness: Martin Harris”, *Ensign*, maj 1999, f. 36).

- Si mendoni se dëshmia e Tre Dëshmitarëve forcohet nga fakti që ata kurrë nuk e mohuan dëshminë e tyre, edhe pasi u shkishëruan nga Kisha? (Shpjegoni se Oliver Kaudëri dhe Martin Harris i u pagëzuan sërish më vonë.)

Drejtojini studentët përsëri te Doktrina e Besëlidhje 17:6 dhe theksoni se ky varg përmban dëshminë më të madhërishtme të mundshme për vërtetësinë e Librit të Mormonit. Ky varg përmban dëshminë e Perëndisë Vetë, të dhënë me një betim, se Libri i Mormonit është i vërtetë.

Kërkojuni studentëve të përfytyrojnë sikur dëshmia e tyre vetjake për Librin e Mormonit të mund t’i shtohet çdo kopjeje të Librit të Mormonit. Ftojini studentët të tregojnë se çfarë do të përfshinin në dëshminë ose dëshmimin e tyre.

Ftojini studentët t’ia japin dëshminë e tyre për Librin e Mormonit dikujt përpara orës së ardhshme mësimore.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 17; Joseph Smith – Historia 1:29–54.
- Neal A. Maxwell, “By the Gift and Power of God”, *Ensign*, janar 1997, f. 36–41.
- “Book of Mormon Translation”, Gospel Topics, lds.org/topics.
- “Coming Forth of the Book of Mormon and Restoration of the Priesthood”, kapitulli 5 në *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 52–66.

4

Libri i Mormonit – Gurthemeli i Besimit Tonë

Hyrje

Libri i Mormonit është gurthemeli i besimit tonë dhe provë që Perëndia e ka rivendosur ungjillin e Jezu Krishtit në tokë në kohën tonë. Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994) na mësoi se Libri i Mormonit “është gurthemeli i dëshimit tonë për Krishtin. Ai është gurthemeli i doktrinës sonë. Ai është gurthemeli i dëshmisë” (“The

Book of Mormon – Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 5). Ndërkohë që studentët i thellojnë dëshmitë e tyre për Librin e Mormonit, ata mund të bëhen të forcuar kundrejt atyre që kërkojnë ta hedhin poshtë vërtetësinë e tij.

Lexim Konteksti

- Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon – Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 4–7.
- Xhefri R. Holland, “Siguri për Shpirtin Njerëzor”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2009, f. 88–90.
- “Book of Mormon and DNA Studies”, Gospel Topics, [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics).

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 17:6; 19:26; 20:5–12

Libri i Mormonit është provë se Perëndia e ka rivendosur të vërtetën në kohën tonë
Përpara orës mësimore, shkruani datat dhe ngjarjet vijuese në tabelë.

1820	<i>Vegimi i Parë u mor</i>
1823	<i>Vizitat e Moronit filluan</i>
1829	<i>Priftëria u rivendos</i>
qershor 1829	<i>Përkthimi i Librit të Mormonit u përfundua</i>
6 prill 1830	<i>Kisha u organizua</i>

- Çfarë mund të mësojmë nga renditja e këtyre ngjarjeve rreth rolit të Librit të Mormonit në Rivendosjen e ungjillit? (Libri i Mormonit duhej të përfundohej përpara se Kisha të mund të rivendosej. Ai do të luante një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e ungjillit.)

Shpjegoni se kur u organizua Kisha në prill të vitit 1830, botimi i Librit të Mormonit sapo ishte përfunduar dhe libri ishte reklamuar për shitje më pak se dy javë më parë. Kërkojuni studentëve të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 20:8–12, duke kërkuar atë që përmban Libri i Mormonit dhe atë që provon Libri i Mormonit. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët ta shenjojnë atë që zbulojnë. (*Shënim:* Përgjatë gjithë këtij kursi, ju mund t’i nxitni studentët të shenjojnë të vërteta të rëndësishme që i zbuluan në shkrimet e tyre të shenjta.) Teksa studentët lexojnë, shkruani thënien e paplotë vijuese në tabelë:

<i>Libri i Mormonit i provon botës se ...</i>

Pas një kohe të mjaftueshme, bëjuni studentëve pyetjet vijuese:

- Nisur nga ato që lexuat, si do ta plotësonit shprehjen në tabelë? (Studentët mund të përdorin fjalë të ndryshme, por sigurohuni që ata të përcaktojnë të vërtetën vijuese: **Libri i Mormonit i provon botës se shkrimet e shenjta janë të vërteta, se Perëndia i frymëzon dhe i thërret njerëzit për të bërë punën e Tij në kohën tonë dhe se Perëndia është i pandryshueshëm.**)
- Si e provon Libri i Mormonit se Perëndia i frymëzon dhe i thërret njerëzit për të bërë punën e Tij në kohën tonë?
- Kur një njeri arrin të dijë që Libri i Mormonit është i vërtetë, çfarë diturie fiton ai ose ajo rreth Profetit Jozef Smith?

Ftojini studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 17:6 dhe 19:26, duke kërkuar atë që dy vargjet kanë të përbashkët.

- Çfarë kanë të përbashkët këto dy vargje? (Shpalljen e Zotit për vërtetësinë e Librit të Mormonit.)
- Çfarë vlere ka për ju të dini që Zoti e ka shpallur dëshminë e Tij për vërtetësinë e Librit të Mormonit?

Libri i Mormonit është gurthemeli i besimit tonë

Shkruani në tabelë të vërtetën vijuese: **Libri i Mormonit është gurthemeli i besimit tonë.**

- Çfarë mendoni se do të thotë kjo frazë?

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994) dhe ftojini një student ta lexojë me zë të lartë:



“Ka tri mënyra në të cilat Libri i Mormonit është gurthemeli i besimit tonë. Ai është gurthemeli i dëshmimit tonë për Krishtin. Ai është gurthemeli i doktrinës sonë. Ai është gurthemeli i dëshmisë” (“The Book of Mormon – Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 5).

Ndajeni klasën në grupe të vogla. Caktoni secilin grup të diskutojë një prej temave vijuese: si është Libri i Mormonit “gurthemeli i dëshmimit tonë për Krishtin”, si është ai “gurthemeli i doktrinës sonë” ose si është ai “gurthemeli i dëshmisë”. (Ju mund të keni nevojë t’ia caktoni secilën temë më shumë se një grupi.) Jepini secilit grup një kopje të fletushkës vijuese dhe iu kërkonit atyre të përdorin thënien që përputhet me temën e tyre në diskutimet e tyre.

Libri i Mormonit – Gurthemeli i Besimit Tonë

“Gurthemeli i Dëshmimit Tonë për Krishtin”



“Libri i Mormonit është gurthemeli në dëshmimin tonë për Jezu Krishtin, i cili është Vetë gurthemeli i çdo gjëje që bëjmë. Ai dëshmon për realitetin e Tij. ... Dëshmia e tij për Mësuesin është e qartë, e padobësuar dhe plot me fuqi. ... Shumica e botës së krishterë sot e hedh poshtë hyjninë e Shpëtimtarit. Ata e vënë në pikëpyetje lindjen e Tij të mrekullueshme, jetën e Tij të përsosur dhe vërtetësinë e ringjalljes së Tij të lavdishme. Libri i Mormonit na mëson me terma të qarta dhe të pagabueshme rreth të vërtetës së këtyre të gjithave. Ai gjithashtu na jep shpjegimin më të plotë të doktrinës së Shlyerjes” (Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon – Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 5).



“Gurthemeli i Doktrinës Sonë”



“Në Librin e Mormonit ne do të gjejmë plotësinë e atyre doktrinaeve që kërkohen për shpëtimin tonë. Dhe ato janë dhënë mësim thjesht dhe qartë në mënyrë që edhe fëmijët të mund t’i mësojnë mënyrat e shpëtimit dhe të ekzaltimit. Libri i Mormonit ofron kaq shumë saqë zgjeron kuptueshmërinë tonë për doktrinat e shpëtimit. Pa të, shumica prej asaj që jepet mësim në shkrimet e tjera të shenjta, nuk do të jetë aq e qartë dhe e çmuar” (Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon – Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 6).

“Gurthemeli i Dëshmisë”



“Libri i Mormonit është gurthemeli i dëshmisë. Ashtu si harku shembet, në qoftë se i hiqet gurthemeli, po kështu edhe e gjithë Kisha qëndron ose bie me vërtetësinë e Librit të Mormonit. ... Në qoftë se Libri i Mormonit është i vërtetë ... atëherë duhen pranuar pretendimet ndaj Rivendosjes dhe gjithçkaje që lidhet me të” (Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon – Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 6).

Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini grupet që t’i tregojnë klasës për atë që diskutuan. Përfundojeni këtë pjesë të mësimi duke iu kërkuar studentëve të tregojnë se si ndihen rreth Librit të Mormonit dhe të tregojnë se si ai ka qenë gurthemeli i vetë dëshmimeve të tyre.

Armiqtë përpiqen ta hedhin poshtë Librin e Mormonit

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë thënien vijuese nga Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Për [më shumë se 180] vjet, ky libër është shqyrtuar e përfolur, mohuar e zbërthyer, vënë nën shënjestër e grisur copë-copë, ndoshta si asnjë libër tjetër në historinë fetare bashkëkohore – ndoshta si asnjë libër tjetër në *ndonjë* histori fetare. Dhe ai ende qëndron. Teori të dështuara rreth origjinës së tij kanë lindur, janë përsëritur e janë shuar – që nga autorësia e Ithën Smithit apo Solomon Spaldingut ose deri te paranojakë të lojtur apo te gjenitë dinakë. Asnjë prej këtyre përgjigjeve, sinqerisht për t’u mëshiruar, lidhur me këtë libër, nuk i ka rezistuar analizës, për arsye se *nuk ka asnjë përgjigje tjetër* veç asaj që dha Jozefi si përkthyesi i tij i pashkolluar. Në këtë unë bashkohem me vetë stërgjyshin tim, i cili thjesht tha: ‘Asnjë njeri i lig nuk mund ta shkruante dot një libër si ky; dhe asnjë njeri i mirë nuk do ta shkruante atë, po të mos ishte i vërtetë dhe po të mos urdhërohej nga Perëndia për këtë’” (“Siguri për Shpirtin Njerëzor”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2009, f. 89).

- Përse është e rëndësishme të kujtojmë se armiqtë bashkëkohorë të Kishës shpesh përpiqen ta diskreditojnë Librin e Mormonit?
- Si e mbështet thënia e stërgjyshit të Plakut Holland vërtetësinë e Librit të Mormonit?

Si shembull, ju mund të doni të shpjegoni se një mënyrë se si armiqtë bashkëkohorë të Kishës përpiqen ta diskreditojnë Librin e Mormonit është duke përdorur prova të ADN-së për t’u përpjekur që ta zhvlerësojnë çdo lidhje midis popujve të Librit të Mormonit dhe indianëve të Amerikës. Nëse studentët kanë pyetje rreth kësaj çështjeje, nxitini të lexojnë artikullin te Gospel Topics “Book of Mormon and DNA Studies”, që mund të gjendet te [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics).

Mbahuni fort pas asaj që e dini se është e vërtetë

Kërkojuni studentëve të përfytyrojnë që një shok ka thënë se ai ose ajo ka dëgjuar diçka që duket se bie në kundërshtim me vërtetësinë e Librit të Mormonit.

- Çfarë këshille do t'i jepnit shokut apo shoqes tuaj?
- Si mund t'ju ndihmojë dëshmia juaj që Libri i Mormonit është i vërtetë, kur ndesheni me kritika ndaj Librit të Mormonit?

Ftojuni një student të lexojë me zë të lartë thënien vijuese nga Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Në çaste ... dyshimi, ose kohë shqetësimi, mos u largoni nga besimi që keni fituar tashmë, edhe pse ai mund të jetë i kufizuar. ... Kur ato çaste vijnë dhe shqetësimet shfaqen, zgjidhja e të cilave nuk po afrohet menjëherë, *mbahuni fort tek ajo që tashmë e dini dhe qëndroni të paepur derisa vjen dija e mëtejshme*” (“Unë Besoj, o Zot”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2013, f. 93–94).

- Si mund ta vini në jetë thënien e Plakut Holland kur hasni pyetje rreth vërtetësisë së Librit të Mormonit? (Studentët mund të sugjerojnë një larmi përgjigjesh, por ju mund të doni të theksoni parimin vijues: **Kur hasim pyetje ose dyshime rreth ungjillit, ne duhet të mbahemi fort tek ajo që e dimë tashmë se është e vërtetë dhe të mirëbesojmë që ne mund të gjejmë një përgjigje nëpërmjet studimit të mëtejshëm, ose që Perëndia do ta zbulojë përgjigjen në një kohë të ardhshme.**)
- Çfarë të vërtetash njihni tashmë rreth Librit të Mormonit dhe parimeve që përmban ai? Si keni arritur tek ajo dituri?

Mbylleni mësimin duke paraqitur thënien vijuese nga Presidenti Ezra Taft Benson dhe duke e ftuar një student ta lexojë atë me zë të lartë:



“Çdo shenjtor i ditëve të mëvonshme duhet ta bëjë studimin e këtij libri një përkushtim që zgjat gjithë jetën. Në të kundërt ai po e vendos shpirtin e tij në rrezik dhe po shpërfill atë që mund t'i japë unitet shpirtëror dhe intelektual gjithë jetës së tij. Ka një ndryshim midis një të kthyeri që është i vendosur mbi shkëmbin e Krishtit nëpërmjet Librit të Mormonit dhe mbahet fort tek ajo shufër e hekurt, dhe atij që nuk është i tillë” (“The Book of Mormon Is the Word of God”, *Ensign*, janar 1988, f. 5).

- Si ju ka ndihmuar studimi rregullisht i Librit të Mormonit kundër atyre që dëshirojnë ta shkatërrojnë besimin tuaj?

Dëshmoni për vërtetësinë e Librit të Mormonit. Ftojuni studentët të marrim parasysh se si Libri i Mormonit e ka ndikuar jetën e tyre. Kërkojuni atyre të mendojnë rreth asaj që mund ta bënë për t'i dhënë përparësi më të madhe studimit të Librit të Mormonit. Kujtojuni studentëve premtimin e Moroni, që gjendet te Moroni 10:3–5, se ata që dëshirojnë ta forcojnë dëshminë e tyre për Librin e Mormonit mund ta bëjnë këtë nëpërmjet studimit të librit dhe lutjes rreth vërtetësisë së tij.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 17:6; 19:26; 20:5–12.
- Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon – Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 4–7.

- Xhefri R. Holland, “Siguri për Shpirtin Njerëzor”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2009, f. 88–90.

Hyrje

Më 15 maj 1829, Gjon Pagëzori iu shfaq Jozef Smithit e Oliver Kaudërit dhe rivendosi Priftërinë Aarone. Pak kohë pas kësaj, Apostujt e lashtë, Pjetri, Jakobi dhe Gjoni iu shfaqën Jozefit e Oliverit dhe rivendosën Priftërinë Melkizedeke. Priftëria

Melkizedeke mban autoritetin mbi të gjitha detyrat në Kishë dhe i administron të gjitha gjërat shpirtërore. Ky mësim do t'ju ndihmojë studentët të kuptojnë se si Kisha funksionon nën drejtimin e Priftërisë Melkizedeke.

Lexim Konteksti

- Thomas S. Monson, "The Priesthood – a Sacred Gift", *Ensign* ose *Liahona*, maj 2007, f. 57–60.
- Dallin H. Oaks, "Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë", *Ensign* ose *Liahona*, maj 2014, f. 49–52.
- Larry C. Porter, "The Restoration of the Aaronic and Melchizedek Priesthoods", *Ensign*, dhjetor 1996, f. 30–47.

Sugjerime për Mësimdhënien

Joseph Smith – Historia 1:68–71; Doktrina e Besëlidhje 13:1

Gjon Pagëzori rivendosi Priftërinë Aarone

Paraqitni një figurë të një pagëzimi (shih I Ri Duke u Pagëzuar [*Libri i Figurave Artistike të Ungjillit* (2009), nr. 103; shih edhe LDS.org]) dhe një figurë që tregon administrimin e sakramentit (shih Bekimi i Sakramentit [*Libri i Figurave Artistike të Ungjillit*, nr. 107; shih edhe LDS.org]). Kërkojuni studentëve të përshkruajnë se si jeta e tyre do të ishte e ndryshme nëse nuk i kishin në dispozicion këto ordinanca të shenjta. Kujtojini studentët që këto ordinanca përfaqësojnë disa nga bekimet që i marrim për shkak të rivendosjes së Priftërisë Aarone.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Joseph Smith – Historinë 1:68. Vëreni klasën ta ndjekë dhe të përcaktojë atë që Jozef Smithi dhe Oliver Kaudëri po bënin, që i bëri ata t'ju kërkonin Zotit rreth pagëzimit. Kërkojuni atyre të raportojnë atë që zbuluan.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Joseph Smith – Historinë 1:69. Vini në dukje që fjalët e lajmëtarit, i cili ishte Gjon Pagëzori, gjithashtu shënohen te Doktrina e Besëlidhje 13. Pyeteni klasën:

- Përse ishte e domosdoshme për Jozef Smithin dhe Oliver Kaudërin që ta merrnin priftërinë nga një lajmëtar qiellor? (Nuk kishte asnjë njeri në tokë në atë kohë që mbante çelësat e priftërisë [shih Nenet e Besimit 1:5].)

Ftojini studentët të lexojnë Joseph Smith – Historia 1:70–71. Shpjegoni se këto vargje qartësojnë që Profeti Jozef ishte i pari që e ushtroi priftërinë në këtë periudhë të kujdestarisë ungjillore. Disa njerëz pyesin veten përse Gjon Pagëzori nuk i pagëzoi Jozef Smithin e Oliver Kaudërin dhe përse dy burrat u urdhëruan që t'ia rrijnë priftërinë njëri-tjetrit. Ju mund të doni të shpjegoni se, ndërkohë që është e nevojshme për një lajmëtar qiellor që e mban autoritetin e duhur, për ta rivendosur autoritetin e priftërisë në tokë për një periudhë të re të kujdestarisë ungjillore, pasi ky autoritet të rivendosej, të gjitha ordiancat tokësore, të tilla si pagëzimi e shugurimi, duhej të



kryheshin nga qenie të vdekshme. Përveç kësaj, udhëzimi i Gjon Pagëzorit që Jozefi dhe Oliveri t'ia rijepnin priftërinë njëri-tjetrit e vendosi "shugurimin dhe pagëzimin në marrëdhënien e duhur [ose rendin e duhur]" (Joseph Fielding Smith, *Doctrines of Salvation*, përmb. Bruce R. McConkie, 3 vëll. [1954–1956], 3:91).

Shkruajeni pyetjen vijuese në tabelë:

Si na ndihmon Priftëria Aarone që t'i marrim bekimet e Shlyerjes së Jezu Krishtit?

Nxitini studentët ta marrin parasysh këtë pyetje teksa ju lexoni me zë të lartë thënien vijuese nga Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



"Çfarë do të thotë që Priftëria Aarone mban 'çelësin e shërbesës së engjëjve' dhe të 'ungjillit të pendimit e të pagëzimit dhe të heqjes së mëkateve'? Kuptimi gjendet në ordinancën e pagëzimit dhe në sakramentin. Pagëzimi është për heqjen e mëkateve dhe sakramenti është një ripërtëritje e besëlidhjeve dhe bekimeve të pagëzimit. Që të dyja duhet të paraprihen nga pendimi. ...

Askush prej [nesh] nuk ka jetuar pa mëkat që nga pagëzimi [ynë]. Pa disa masa për pastrimin e mëtejshëm pas pagëzimit tonë, secili prej nesh është i humbur prej gjërave shpirtërore. ...

Ne urdhërohemi të pendohemi për mëkatet tona dhe të vijmë te Zoti me një zemër të thyer e një shpirt të penduar dhe të marrim sakramentin në përputhje me besëlidhjet e tij. Kur ne i ripërtërijmë besëlidhjet tona të pagëzimit në këtë mënyrë, Zoti e ripërtërin ndikimin pastrues të pagëzimit tonë. ...

Ne nuk mund ta mbivlerësojmë rëndësinë e Priftërisë Aarone në këtë gjë. Gjithë këto hapa jetësorë, që lidhen me heqjen e mëkateve, kryhen nëpërmjet ordinancës shpëtuese të pagëzimit dhe ordinancës ripërtëritëse të sakramentit" ("The Aaronic Priesthood and the Sacrament", *Ensign*, nëntor 1998, f. 37–38).

Ftojini studentët të japin përgjigjet e tyre ndaj pyetjes në tabelë. Dëshmoni që **ordinancat e Priftërisë Aarone vënë në dispozicion shumë bekime të Shlyerjes së Jezu Krishtit, duke përfshirë pagëzimin për heqjen e mëkateve.**

Joseph Smith – Historia 1:72; Doktrina e Besëlidhje 84:19–22; 107:8, 18–19 Pjetri, Jakobi dhe Gjoni Rivendosën Priftërinë Melkizedeke

Ftojini klasën që ta ndjekë, teksa një student lexon me zë të lartë Joseph Smith – Historia 1:72. Për t'i ndihmuar studentët ta zgjerojnë kuptueshmërinë e tyre për kontekstin e këtij fragmenti, shpjegoni që pak kohë pas vizitës së Gjon Pagëzorit, Jozef Smithi dhe Oliver Kaudëri e morën Priftërinë Melkizedeke nga Pjetri, Jakobi dhe Gjoni. Kjo ndodhi në maj të vitit 1829 diku pranë lumit Saskehana (shih Larry C. Porter, "The Restoration of the Aaronic and Melchizedek Priesthoods", *Ensign*, dhjetor 1996, f. 30–47). Pas organizimit të Kishës, Profeti mori zbulesa të tjera mbi doktrinën dhe qëllimin e priftërisë. Priftëria është një temë e përbashkët gjatë gjithë Doktrinës e Besëlidhjeve.

Ftojini studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 84:19 dhe 107:8, 18–19, duke kërkuar mënyrën se si këto vargje përshkruajnë autoritetin e Priftërisë Melkizedeke. Ju mund të doni t'u sugjeroni studentëve që ata t'i kryqëzojnë referencat e këtyre fragmenteve. (*Shënim:* Kryqëzimi i referencave është një mjet i studimit të shkrimit të shenjtë që mund të sigurojë informacion dhe ide shtesë për pjesën që po studiohet.) Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini studentët që të tregojnë atë që mësuuan rreth Priftërisë Melkizedeke. Ndërsa studentët përgjigjen, shkruani frazat vijuese në tabelë:

Administron ungjillin

Mban çelësat e mistereve të mbretërisë

Mban çelësin e diturisë së Perëndisë

Mban çelësat e bekimeve shpirtërore të Kishës

Mban çelësat e marrjes së zbulësës

Mban çelësat e kuendimit me banorët qiellorë dhe të banimit me Atin dhe Birin

Ju mund t'i përmbliidhni përgjigjet në tabelë duke theksuar të vërtetën vijuese:

Priftëria Melkizedeke mban çelësat e të gjitha ordinancave dhe bekimeve shpirtërore të Kishës. Për t'i ndihmuar studentët që t'i kuptojnë më mirë frazat në tabelë, diskutoni disa ose të gjitha pyetjet vijuese:

- Cilat janë disa mënyra në të cilat Priftëria Melkizedeke e “administron ungjillin”? (DeB 84:19). (Përgjigjet mund të përfshijnë administrimin e ordinancave të veçanta dhe kryesimin mbi Kishën dhe drejtimin e saj.)
- Çfarë mendoni se do të thotë që Priftëria Melkizedeke “mban çelësin e mistereve të mbretërisë”? (DeB 84:19). (Ju mund të doni të shpjegoni që “misteret e Perëndisë janë të vërteta shpirtërore të njohura vetëm nëpërmjet zbulësës” [Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Mistere të Perëndisë”, f. 121; ose scriptures.lds.org]. Midis mistereve të tjera, ky varg i drejtohet ordinancave të tempullit që shpejt do t'i zbuloheshin Jozef Smithit dhe faktit që ato duhej të administroheshin nëpërmjet autoritetit të Priftërisë Melkizedeke. Në tempull, anëtarët e denjë të Kishës mund të mësojnë disa nga “misteret e Perëndisë” teksa marrin pjesë në ordinancat e administruara atje dhe i mbajnë besëlidhjet që lidhen me to.)
- Si na ndihmon Priftëria Melkizedeke që të fitojmë “dituri[në e] Perëndisë”? (DeB 84:19). (Ne e fitojmë diturinë e Perëndisë kur marrim pjesë në ordinancat që kryhen nëpërmjet Priftërisë Melkizedeke.)

Për t'i ndihmuar studentët që ta kuptojnë frazën “dituri[a e] Perëndisë”, ju mund të doni të lexoni thënien vijuese nga Presidenti Xhejms E. Faust (1920–2007), i Presidencës së Parë:



“Cili është çelësi i diturisë së Perëndisë dhe a mund ta fitojë kushdo atë? Pa priftërinë mund të mos ketë asnjë plotësi të diturisë për Perëndinë. Profeti Jozef Smith tha se ‘Priftëria Melkizedeke ... është kanali nëpërmjet të cilit zbulohet nga qielli gjithë njohuria, doktrina, plani i shpëtimit dhe çdo çështje e rëndësishme’ [Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith (2009), f. 112]” (“The Key of the Knowledge of God”, *Ensign*, nëntor 2004, f. 52).

Ftojini një student të lexojë Doktrinën e Besëlidhjet 84:20–22. Vëreni klasën ta ndjekë, duke kërkuar mënyra se si bekimet shpirtërore që janë në dispozicion me anë të Priftërisë Melkizedeke, mund të gëzohen nga çdo anëtar i Kishës. Më pas bëni pyetjet vijuese:

- Cilat ordinanca mund të administrohen vetëm nëpërmjet autoritetit të Priftërisë Melkizedeke? (Konfirmimi, dhënia e Priftërisë Melkizedeke, ordinancat e tempullit, bekimi i foshnjave, administrimi i të sëmurëve, bekimet patriarkale, veçimi i një njeriu për një thirrje.)

- Si mund ta ndihmojnë ordinancat e priftërisë një njeri që të përjetojë “fuqi[në] e perëndishmërisë”, domethënë fuqinë për t’u bërë si Perëndia?
- Si mund të na përgatitin ordinancat e Priftërisë Melkizedeke që ta shohim fytyrën e Perëndisë?
- Si ju kanë ndihmuar ordinancat e priftërisë që të bëheni më tepër si Perëndia?
- Çfarë përvojash të tjera kanë dhënë ndihmesë në vlerësimin dhe dëshminë tuaj për priftërinë?

Merrni parasysh të jepni vetë dëshminë tuaj për bekimet e priftërisë. Nxitini studentët të marrin parasysh atë që ata mund të bënin që ta përputhin veten e tyre më mirë me drejtimin që vjen nga udhëheqësit e tyre të priftërisë.

Materiale Leximi për Studentin

- Joseph Smith – Historia 1:68–72; Doktrina e Besëlidhje 13:1; 84:18–22; 107:1–19.
- Thomas S. Monson, “The Priesthood—a Sacred Gift”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2007, f. 57–60.

Hyrje

Në një zbulësë drejtuar Profetit Jozef Smith, Zoti urdhëroi që Kisha e Tij të organizohej më 6 prill 1830 (shih DeB 20, kreu i seksionit; DeB 20:1). Kjo zbulësë gjithashtu u siguroi anëtarëve një kuptueshmëri më të madhe të misionit dhe mësimëve të Shpëtimtarit. Në një zbulësë të shënuar te Doktrina e Besëlidhje

1:30, Zoti e përcaktoi Kishën e rivendosur si e “vetm[ja] kishë [e] vërtetë dhe [e] gjallë mbi faqen e tërë dheut”, gjë që thekson rolin e rëndësishëm që luan Kisha në ditët e mëvonshme dhe në jetën tonë.

Lexim Konteksti

- Henri B. Ajring, “Kisha e Vërtetë dhe e Gjallë”, *Ensign ose Liahona*, maj 2008, f. 20–24.
- “Organization of the Church of Jesus Christ” [“Organizimi i Kishës së Jezu Krishtit”], kapitulli 6 te *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 67–68.
- Boyd K. Packer, “The Only True Church”, *Ensign*, nëntor 1985, f. 80–83.
- Jeffrey G. Cannon, “‘Build Up My Church’: DeB 18, 20, 21, 22,” seritë Revelations in Context, 3 janar 2013, history.lds.org.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 20:1–3

Rivendosja e Kishës së Jezu Krishtit

Fillojeni orën mësimore duke iu kërkuar studentëve të përshkruajnë atë që dinë rreth Kishës së themeluar nga Jezu Krishti gjatë periudhës kohore të Dhiatës së Re. Më pas pyetni:

- Çfarë besojmë se i ndodhi Kishës së Jezu Krishtit pas vdekjes së Apostujve?
- Si e shpjegon kjo nevojën për rivendosjen e Kishës së Jezu Krishtit?

Kërkojini një studenti të lexojë thënien vijuese me zë të lartë, ndërkohë që klasa dëgjon për mënyra në të cilat organizimi i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme rivendosi tipare të rëndësishme të Kishës së themeluar nga Jezu Krishti në kohët e Dhiatës së Re.

“Më 6 prill 1830, vetëm njëmbëdhjetë ditë pasi Libri i Mormonit u reklamua për shitje, një grup prej gati 60 njerëzish u mbledhën në shtëpinë prej trarësh të Piter Uitmer Plakut, në Fajet të Nju-Jorkut. Atje Jozef Smithi organizoi zyrtarisht Kishën, të quajtur më vonë me anë të zbulësës si Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme (shih DeB 115:4). Ishte një ngjarje e gëzueshme, me një derdhje të madhe të Shpirtit. Sakramenti u administrua, besimtarët u pagëzuan, dhurata e Frymës së Shenjtë u dhurua dhe disa burra u shuguruan në priftëri. Në një zbulësë të marrë gjatë mbledhjes, Zoti e caktoi Jozef Smithin si udhëheqësin e Kishës: një ‘shikues, përkthyes, profet, apostull [të] Jezu Krishtit, plak [të] kishës nëpërmjet vullnetit të Perëndisë, Atit dhe hirit të Zotit tuaj Jezu Krisht’ (DeB 21:1). Kisha e Jezu Krishtit u vendos edhe një herë në tokë.” (*Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 8–9).

Ftojini studentët që të përshkruajnë disa tipare të Kishës së rivendosur të Jezu Krishtit, që ishin të ngjashëm me ato të Kishës së Dhiatës së Re.

Shpjegoni që kur lexoni nga Doktrina e Besëlidhje, mund të jetë e dobishme që të lexoni krerët e seksioneve. Kjo ndihmon për të krijuar kontekstin historik të zbulesave. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë kreun e seksionit për Doktrinën e Besëlidhjet 20. (Ju mund të vini në dukje që në botimin e vitit 2013 të Doktrinës e Besëlidhjeve, ca informacion historik, i përfshirë në botimin e vitit 1981, iu shtua kreut të seksionit.) Ftojini një student tjetër të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 20:1–3. Vëreni klasën ta ndjekë, duke kërkuar ide rreth Rivendosjes së ungjillit. Pyetni:

- Cilat të vërteta lidhur me Rivendosjen e ungjillit jepen mësim në këto vargje? (Një nga të vërtetat që studentët mund të përcaktojnë është që **Jozef Smithi u thirr nga Perëndia dhe u urdhërua të organizonte Kishën e Jezu Krishtit.**)

Lexoni me zë të lartë thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008):



"Jozef Smithi dhe shoqëruetit e tij u mblodhën në shtëpinë e thjeshtë me trarë në fermën e Piter Uitmerit, në fshatin e qetë të Fajetit në Nju-Jork dhe organizuan Kishën e Krishtit. ...

Nga gjashtë anëtarët fillestarë është rritur një familje e gjerë e adhuruesve. ... Nga ai fshat i qetë është rritur një lëvizje që sot është shpërndarë përmes gati 160 kombeve të tokës. ... Ky është një zhvillim mbresëlënës. Më shumë anëtarë të Kishës jetojnë jashtë këtij kombi sesa në të. Ajo, gjithashtu, është diçka mbresëlënëse. Asnjë kishë tjetër, e dalë nga toka e Amerikës, nuk është rritur kaq shpejt, as nuk është shpërndarë kaq gjerësisht. ... Është një fenomen si asnjë më parë" ("The Church Goes Forward", *Ensign*, maj 2002, f. 4).

- Çfarë është mbresëlënëse për ju rreth rritjes së shpejtë të Kishës në ditët e mëvonshme?
- Si mund ta ndihmojmë ne si individë Kishën e Zotit që të vazhdojë të rritet në kohën tonë?

Doktrina e Besëlidhje 20:17–37, 68–69

Doktrina e Kishës së Jezu Krishtit dhe detyrat e anëtarëve të pagëzuar

Shpjegoni se seksioni 20 i Doktrinës e Besëlidhjeve u njoh prej anëtarëve të hershëm të Kishës si Nenet dhe Besëlidhjet e Kishës. Ky seksion përmban shumë nga udhëzimet e Zotit lidhur me doktrinën e Kishës së Jezu Krishtit dhe detyrat e anëtarëve të saj. Kjo zbulesë u lexua me zë të lartë në disa konferenca të hershme të Kishës.

Ftojini studentët të përfytyrojnë se ata janë anëtarë të rinj të Kishës në vitin 1830 dhe po kërkojnë të dinë se çfarë duhet të besojnë si një anëtar i Kishës së Jezu Krishtit. Ftojini gjysmën e klasës të lexojë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 20:17–28 dhe gjysmën tjetër të lexojë vargjet 29–36, duke kërkuar doktrinën që është e rëndësishme për t'u ditur nga çdo anëtar i Kishës së rivendosur të Zotit. Ju mund të doni të sugjeroni që ata ta shenjojnë atë që gjejnë.

Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini studentët të tregojnë të vërteta që i përcaktuan dhe të shpjegojnë përse secila e vërtetë është domethënëse për ta. Merrni parasysh të shkruani të vërtetën vijuese në tabelë: **Nëpërmjet zbulesës, Zoti qartësoi doktrinën dhe parimet mbi të cilat themelohet ungjilli i Tij.**

Merrni parasysh ta ftoni gjysmën e klasës të lexojë Doktrinën e Besëlidhjet 20:37, duke gjetur kërkesat për ata që dëshirojnë të pagëzohen. Vëreni gjysmën tjetër të klasës të lexojë Doktrinën e Besëlidhjet 20:68–69, duke kërkuar ato gjëra që Zoti i pret nga ne pas pagëzimit tonë. Vini në dukje se udhëzimet që gjenden në këto vargje formojnë një model të qartë për anëtarët e Kishës që ta ndjekin.

Diskutoni pyetjet vijuese me klasën:

- Çfarë duhet të shfaqë një individ përpara se ai ose ajo të mund të pagëzohet? (Studentët duhet të përcaktojnë sa vijon: **Përpara se individët mund të pagëzohen, ata duhet të jenë të përlulur, të penduar, të gatshëm për të marrë mbi vete emrin e Jezu Krishtit dhe të vendosur për t'i shërbyer Atij deri në fund.**)
- Çfarë pret Zoti nga ne pasi të pagëzohemi? (Përgjigjet e studentëve mund të ndryshojnë, por ata duhet të përcaktojnë të vërtetën vijuese: **Pas pagëzimit, ne ia tregojmë Zotit denjësinë tonë nëpërmjet të ecurit dhe të folurit tonë të perëndishëm.**)
- Çfarë mendoni se do të thotë të “trego[sh]... një të ecur dhe të folur të perëndishëm”? (DeB 20:69).
- Përse mund t’iu vijnë bekime anëtarëve të Kishës të cilët “ec[in] në shenjtëri përpara Zotit”? (DeB 20:69).

Nëse e lejon koha, ju mund t’iu vini në dukje studentëve që doktrinën dhe praktikën e Kishës, të shënuara te Doktrina e Besëlidhje 20, përshkruhen gjithashtu në Librin e Mormonit, duke na ndihmuar të kuptojmë se Kisha e Jezu Krishtit ka qenë në thelb e njëjtë në të gjitha periudhat e kujdestarisë ungjillore. Për shembull, doktrinën e përshkruara te Doktrina e Besëlidhje 20:17–36, gjithashtu përshkruhen në Librin e Mormonit. Në mënyrë të ngjashme, ordinancat dhe praktikën e shënuara te Doktrina e Besëlidhje 20:73–80, gjithashtu shënohen në Librin e Mormonit.

Doktrina e Besëlidhje 1:30

“Të vetmen kishë të vërtetë dhe të gjallë”

Shpjegoni se shumë njerëz në kohën tonë besojnë se të gjitha kishat janë të vërteta dhe janë njësoj të drejta në sytë e Perëndisë. Megjithatë, rreth një vit e gjysmë pasi Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme u organizua, Zoti dha një përshkrim të rëndësishëm të Kishës. Ftojini studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 1:30. Më pas pyetni:

- Si e përshkroi Zoti Kishën e rivendosur? (Studentët duhet të shprehin të vërtetën vijuese: **Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është e vetmja kishë e vërtetë dhe e gjallë mbi tokë.**)
- Çfarë do të thotë për ju që Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është e “vetm[ja] kishë [e] vërtetë dhe [e] gjallë” mbi tokë? (Përpara se studentët të përgjigjen, ju mund të doni t’i kujtoni ata që kjo doktrinë nuk ka për qëllim të nënkuptojë që ne duhet të ndihemi më të mirë se të tjerët.)

Paraqitni thëniet vijuese nga Presidenti Henri B. Ajring, i Presidencës së Parë, dhe nga Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftoni një student t’i lexojë ato me zë të lartë. Vëreni pjesën tjetër të klasës ta ndjekë, duke kërkuar arsyen përse Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme konsiderohet si e “vetm[ja] kishë [e] vërtetë dhe [e] gjallë”.



"Kjo është Kisha e vërtetë, e vetmja Kishë e vërtetë, sepse në të janë çelësat e priftërisë. Vetëm në këtë Kishë Zoti ka depozituar fuqinë për të vulosur në tokë dhe për të vulosur në qiell, ashtu si bëri në kohën e Apostullit Pjetër. Ata çelësa iu rivendosën Jozef Smithit i cili atëherë u autorizua t'ua dhuronte ato anëtarëve të Kuoromit të Të Dymbëdhjetëve" (Henri B. Ajring, "Kisha e Vërtetë dhe e Gjallë", *Ensign ose Liahona*, maj 2008, f. 20).



"Zoti ka deklaruar se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është e 'vetm[ja] kishë [e] vërtetë dhe [e] gjallë mbi faqen e tërë dheut' (DeB 1:30). Kjo Kishë e rivendosur është e vërtetë, sepse është Kisha e Shpëtimtarit; Ai është 'udha, e vërteta dhe jeta' (Gjoni 14:6). Dhe është një kishë e gjallë për shkak të funksionimit dhe dhuratave të Frymës së Shenjtë" (Dejvid A. Bednar, "Merrni Frymën e Shenjtë", *Ensign ose Liahona*, nëntor 2010, f. 97).

- Si e bëjnë të vërtetat e përcaktuara nga Presidenti Ajring dhe Plaku Bednar Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme të ndryshme nga çdo kishë tjetër mbi tokë? (Ajo është Kisha e Shpëtimtarit, ka funksionimin dhe dhuratat e Frymës së Shenjtë, dhe çelësat e priftërisë gjenden në të. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët t'i shkruajnë disa nga këto ide në anë të faqes së shkrimeve të tyre të shenjta pranë Doktrinës e Besëlidhjeve 1:30.)

Shpjegoni se Presidenti Bojd K. Paker, i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve, citoi nga Doktrina e Besëlidhjeve 1:30 dhe më pas shpjegoi përse ky përshkrim i dhënë në mënyrë hyjnore për Kishën është kaq i rëndësishëm. Ftoni një student që ta lexojë me zë të lartë thënien vijuese nga Presidenti Paker:



"Hiqni dorë nga kjo doktrinë dhe ju nuk mund ta justifikoni Rivendosjen. ...

Ne nuk e shpikëm doktrinën e së vetmes kishë të vërtetë. Erdhi nga Zoti. Cilado qoftë ideja që kanë të tjerët për ne, sado mendjemëdhenj që duket se jemi, çfarëdo kritike që na drejtohet, ne duhet t'ua mësojmë atë të gjithë atyre që do të dëgjojnë. ...

Ne nuk shpallim që të tjerat nuk kanë të vërteta. Zoti i përshkroi ato si të kishin "një formë të perëndishmërisë". Njerëzit e kthyer në besim në Kishë mund të sjellin me vete gjithë të vërtetën që zotërojnë dhe mbi të do t'iu shtohet" ("The Only True Church", *Ensign*, nëntor 1985, f. 82).

- Si e qartëson kjo doktrinë nevojën për Rivendosjen?

Ftojini studentët të shpjegojnë se si individët mund të arrijnë që të dinë për veten e tyre se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është e vërtetë.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhjeve 1:30; 20:1–3, 17–37, 68–69.
- Henri B. Ajring, "Kisha e Vërtetë dhe e Gjallë", *Ensign ose Liahona*, maj 2008, f. 20–24.

Shpallni Ungjillin e Përjetshëm

7

Hyrje

Doktrina e Besëlidhje përmban zbulesa nga Zoti për anëtarë të caktuar të Kishës, nëpërmjet Profetit Jozef Smith, duke i urdhëruar anëtarët të shpallnin pendim dhe të mbledhnin të zgjedhurit e Tij. Kisha u rrit me të shpejtë teksa misionarë u thirrën nga Profeti

Jozef Smith dhe u bënë mjete në duart e Zotit. Anëtarët e Kishës sot marrin bekime nga puna misionare kur ata e dallojnë dhe e përmbushin përgjegjësinë e tyre për të ndihmuar në shpërndarjen e ungjillit.

Lexim Konteksti

- Nil L. Andersen, “Është një Mrekulli”, *Ensign ose Liahona*, maj 2013, f. 77–80.
- L. Tom Perry, “Sillni Shpirtra tek Unë”, *Ensign ose Liahona*, maj 2009, f. 109–112.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 29:4–7; 33:2–7

Zoti thërret shërbëtorë që të ndihmojnë për t’i mbledhur fëmijët e Tij

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli (1910-2008) dhe ftojini një student ta lexojë atë me zë të lartë:



“Puna misionare është gjaku jetëdhënës i Kishës. Është mjete kryesor me anë të të cilit ajo rritet. Është për shkak të këtij shërbimi që Kisha ka arritur përmasën e saj të tanishme” (“Missionary Service”, *Mbledhja e Parë Mbarëbotërore për Trajnimin e Udhëheqjes*, 11 janar 2003, f. 17).

- Sipas mendimit tuaj, në çfarë mënyrash mund të konsiderohet puna misionare “gjaku jetëdhënës i Kishës”?

Shpjegoni se në fillim të Rivendosjes, individët shpesh e pyetën Profetin që të kërkonte zbulesa në emër të tyre, për t’i ndihmuar ata të dinin se si të mund të luanin rol në punën e Zotit. Nganjëherë këto zbulesa u morën për një individ të vetëm dhe nganjëherë për shumë individë. Shpjegoni se Doktrina e Besëlidhje 33 është një shembull i një zbulese të marrë në emër të dy individëve: Ezra Thajrit (ose Thajërit) dhe Northrop Suitit.

Ftojini disa studentë që të lexojnë me radhë, me zë të lartë nga Doktrina e Besëlidhje 33:2–7. Vëreni klasën ta ndjekë, duke kërkuar fjalë, fraza ose simbole që Zoti i përdori, të cilat gjejnë zbatim ndaj rolit tonë në punën misionare dhe të cilat theksojnë rëndësinë e shpalljes së ungjillit në ditët e mëvonshme.

- Çfarë simbolesh përdori Zoti? (Ndërsa studentët përgjigjen, ju mund të doni t’i shkruani përgjigjet e tyre në tabelë.)
- Si e ilustron këto simbole rolin tuaj në punën misionare dhe si e theksojnë rëndësinë e shpalljes së ungjillit?

Ftojini studentët të studiojnë me kujdes vargun 6 dhe të përcaktojnë atë që arrihet, ndërkohë që ne ua shpallim ungjillin të tjerëve. Më pas u kërkon të thonë me fjalët e veta atë që gjetën. (Studentët mund të përdorin fjalë të ndryshme, por ata duhet të përcaktojnë parimin vijues: **Kur ua shpallim ungjillin e Jezu Krishtit të tjerëve, ne**

ndihmojmë për t'i mbledhur të zgjedhurit e Zotit. Ju mund të doni të tregoni se pas kësaj zbuluese, Ezra Thajri “e mbushi hambarin e tij” me njerëz që të dëgjonin Jozef Smithin dhe njerëz të tjerë duke predikuar ungjillin [*Documents, Vëllimi 1: korrik 1828–qershor 1831*, vëll. 1 i serisë Documents të *The Joseph Smith Papers* (2013), f. 206].)

Ndani me studentët përkufizimin vijues për mbledhjen e Izraelit nga Plaku Brus R. Mek-Konki (1915–1985), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Mbledhja e Izraelit përbëhet nga të besuarit, të pranuarit dhe të jetuarit në përputhje me të gjitha ato që Zoti i ofroi dikur popullit të tij të lashtë, të zgjedhur. ... Ajo përbëhet nga besimi në ungjillin, bashkimi me Kishën dhe hyrja në mbretërinë” (*A New Witness for the Articles of Faith* [1985], f. 515).

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë tregimin vijues rreth disa prej misionarëve të parë, të thirrur pas organizimit të Kishës. Vëreni klasën të dëgjojë për mënyrën se si këta misionarë të hershëm ia dolën me sukses të mblidhnin disa prej të zgjedhurve të Zotit.

“[Në vjeshtën e vitit 1830], Zoti i zbuloi Jozef Smithit se Oliver Kaudëri, Piter Uitmer i Riu, Parli P. Prati dhe Ziba Pitersoni duhej të ‘shko[nin] te Lamanitët dhe t’u prediko[nin] atyre ungjillin tim’ (DeB 28:8; 30:5–6; 32:1–3). Këta misionarë udhëtuan rreth 2.400 kilometra, duke predikuar për një kohë të shkurtër mes fiseve të ndryshme të indianëve. ... Megjithatë, sukcesi më i madh i misionarëve erdhi kur ata u ndalën në zonën e Kirtlandit të Ohajos. Atje ata pagëzuan rreth 130 të kthyer në besim, kryesisht ndërmjet [grumbullimeve] të baptistëve të reformuar të Sidni Rigdonit, duke hapur atë që do të bëhej një vend mbledhjeje për qindra anëtarë të Kishës në vitin pasues. Misionarët gjetën gjithashtu disa të kthyer në besim midis kolonëve në kontonë Xhekson të Misurit, ku do të themelohej më vonë qyteti i Sionit” (*Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 159; shih edhe Richard Dilworth Rust, “A Mission to the Lamanites: D&C 28, 30, 32”, seritë Revelations in Context, 22 shkurt 2013, history.lds.org).

Shpjegoni se këto biseda në Ohajon veriore e shtuan më shumë se dyfish anëtarësinë e Kishës në atë kohë.

Vëreni studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 29:4–7, duke kërkuar një përkrahim të shprehjes “të zgjedhurit e Zotit”.

- Si i përshkroi Shpëtimtari të zgjedhurit e Tij?

Shpjegojuni studentëve se puna e misionarëve të parë duke shërbyer jashtë Amerikës Veriore përfshin një shembull mbresëlënës të mënyrës se si Zoti i përdor shërbëtorët e Tij për t’i mbledhur të zgjedhurit e Tij. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë përmbledhjen vijuese. Kërkojini klasës ta ndjekë dhe të dëgjojë për këshillën e Profetit Jozef Smith drejtuar Plakut Hibër C. Kimball (1801–1868).

“Hibër C. Kimballi, një anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, kujtoi: ‘Rreth ditës së parë të qershorit 1837, Profeti Jozef erdhi tek unë, ndërsa isha i ulur në ... Tempull, në Kirtland dhe, duke më pëshpëritur, më tha: “Vëllai Hibër, Shpirti i Zotit më ka pëshpëritur: ‘Shërbëtori im Hibër le të shkojë në Angli, dhe të predikojë ungjillin tim, dhe të hapë derën e shpëtimit për atë komb’ ”.’ Plaku Kimball u hutua nga mendimi i një ndërmarrjeje të tillë: ‘E ndieja veten si një prej më të dobëtëve fare prej shërbëtorëve të Perëndisë. E pyeta Jozefin se çfarë duhej të thosha kur të shkoja atje; ai më tha të shkoja tek Zoti dhe Ai do të më udhëhiqte e do të fliste përmes meje me anë të të njëjtit shpirt që [e drejtonte] atë.’

Profeti u drejtoi thirrje gjithashtu Orson Hajdit, Uillard Riçardsit dhe Jozef Fildingut në Kirtland, si dhe Isak Rasëllit, Xhon Snajdërit dhe Xhon Gudsanit në Toronto të Kanadasë. Këta vëllezër duhet të bashkoheshin me Plakun Kimball në misionin e tij në Angli. Të mbledhur në Nju-Jork-Siti, ata lundruan me anijen *Gerik* drejt Britanisë së Madhe më 1 korrik 1837. [Ky] mision i parë jashtë Amerikës së Veriut solli në Kishë rreth 2.000 të kthyer në besim gjatë vitit të parë të misionarëve në Angli. Plaku Kimball i shkroi me gëzim Profetit: 'Lavdi Perëndisë, Jozef, Zoti është me ne mes kombeve!'

Një mision i dytë i apostujve në Britani, duke përfshirë shumicën e anëtarëve të Të Dymbëdhjetëve nën udhëheqjen e Brigam Jangut, u drejtua nga Profeti prej Navusë. Të nisur në vjeshtën e 1839-ës, Të Dymbëdhjetët arritën në Angli në vitin 1840. Atje ata filluan një punë që deri në vitin 1841 do të sillte mbi 6.000 të kthyer në besim në Kishë" (*Mësimet: Jozef Smith, f. 349, 351*).

- Çfarë këshille mori Hibër C. Kimballi nga Profeti Jozef Smith?
- Përshkruani një kohë kur e përjetuat ndihmën e Zotit në përpjekjet tuaja për ta shpërndarë ungjillin.

Doktrina e Besëlidhje 4:1–7; 18:10–16; 31:1–12; 34:5–6; 39:20–23; 88:81

Ata që janë paralajmëruar duhet të paralajmërojnë të afërmit e tyre

Shpjegoni se Doktrina e Besëlidhje në mënyrë të përsëritur i kujton anëtarët e Kishës për përgjegjësinë dhe bekimet e pjesëmarrjes në punën misionare. Përgjegjësia jonë për ta ndarë ungjillin me të tjerët është një model dhe temë e përsëritur në zbulesat e shënuara të Doktrina e Besëlidhje. Të mësuarit për t'i dalluar modelet dhe temat i aftëson lexuesit që të ushqehen akoma më me bollëk me fjalët e Krishtit (shih David A. Bednar, "A Reservoir of Living Water" [mbledhje rreth vatrës në Universitetin "Brigam Jang", 4 shkurt 2007], speeches.byu.edu).

Ftojini studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 88:81 dhe më pas të përmbledhin me vetë fjalët e tyre mënyrën se si ajo zbatohet tek anëtarët e tanishëm të Kishës. (Një përgjigje që mund ta japin studentët është që **të gjithë ata që e kanë pranuar ungjillin e Jezu Krishtit, kanë një detyrë për ta ndarë atë me të tjerët.**)

Paraqitni figurën vijuese ose kopjojeni atë në tabelë. Ndajeni klasën në tri grupe dhe caktojini secilit grup një nga fragmentet e shkrimit të shenjtë. Vërieni studentët të lexojnë fragmentet e caktuara atyre dhe të kërkojnë përgjegjësitë dhe bekimet e premtuara për ndarjen e ungjillit.

	<i>Përgjegjësitë</i>	<i>Bekimet</i>
<i>Doktrina e Besëlidhje 4:1–7</i>		
<i>Doktrina e Besëlidhje 18:10–16</i>		
<i>Doktrina e Besëlidhje 31:1–12</i>		

Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini studentët të ndajnë gjetjet e tyre me klasën.

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftojini një student ta lexojë atë me zë të lartë. Vëreni klasën të dëgjojë përshkrimin e Plakut Bednar për përgjegjësinë tonë individuale për ta shpërndarë ungjillin.



“Dishepujt e përkushtuar të Jezu Krishtit gjithmonë kanë qenë dhe gjithmonë do të jenë misionarë të guximshëm. Një misionar është një pasues i Krishtit, i cili dëshmon për Të se Ai është Shëlbuesi dhe shpall të vërtetat e ungjillit të Tij.

Kisha e Jezu Krishtit gjithmonë ka qenë dhe gjithmonë do të jetë një kishë misionare. Anëtarët individualë të Kishës së Shpëtimtarit kanë pranuar detyrimin solemn që të ndihmojnë në përbushjen e misionit hyjnor, të dhënë nga Zoti Apostujve të Tij, siç shënohet në Dhiatën e Re:

‘Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar.

Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës. Amen’ (Mateu 28:19–20).

Shenjtorët e ditëve të mëvonshme e marrin me seriozitet këtë përgjegjësi për t’u mësuar gjithë njerëzve në mbarë kombet rreth Zotit Jezu Krisht dhe ungjillit të Tij të rivendosur. ...

Me të vërtetë, ne ndiejmë një përgjegjësi solemne për t’ia çuar këtë mesazh çdo kombi, fisi, gjuhe dhe populli” (“Ejani dhe Shikoni”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2014, f. 107).

- Përse anëtarët e Kishës së Shpëtimtarit e shohin punën misionare si një detyrim solemn?

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku L. Tom Peri, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftojini një student ta lexojë atë me zë të lartë. Kërkojini klasës ta ndjekë dhe të përsiatë përse ata mund të dëshirojnë ta marrin parasysht për t’u bërë më të zellshëm në shpërndarjen e ungjillit.



“Ungjilli përqendrohet te Shlyerja e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë. Shlyerja siguron fuqinë për t’i pastruar mëkatet, për të shëruar dhe për të dhënë jetë të përjetshme. Të gjitha bekimet e paparashikueshme të Shlyerjes mund t’u jepen vetëm atyre që i jetojnë parimet dhe i marrin ordinancat e ungjillit – besim te Jezu Krishti, pendim, pagëzim, marrje të Frymës së Shenjtë dhe durim deri në fund. Mesazhi ynë i madhërishtëm misionar drejtuar botës është që i gjithë njerëzimi [është i ftuar] që të shpëtohet dhe që të hyjë në tufën e Bariut të Mirë, madje Jezu Krishtit.

Mesazhi ynë misionar forcohet nga dituria për Rivendosjen. Ne e dimë që Perëndia u flet profetëve të Tij sot, ashtu sikurse Ai u foli në lashtësi. Ne gjithashtu e dimë që ungjilli i Tij administrohet me fuqinë dhe autoritetin e priftërisë së rivendosur. Asnjë mesazh tjetër nuk ka domethënie kaq të madhe, të përjetshme për çdo njeri që jeton në tokë sot” (“Sillni Shpirtra tek Unë”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2009, f. 110–111).

- Si mendoni, përse secili prej nesh duhet të bëhet më i zellshëm në shpërndarjen e ungjillit? (Përgjigjet duhet të përfshijnë sa vijon: **Kur e ndajmë ungjillin me të tjerët, ne u ofrojmë atyre afrimin të bekimet e Shlyerjes së Jezu Krishtit.**)

Ftojini studentët të studiojnë Doktrinën e Besëlidhjet 34:5–6; 39:20–23, duke kërkuar një arsye tjetër të rëndësishme përse Zoti na ka urdhëruar që ta ndajmë mesazhin e ungjillit me të tjerët. (Studentët mund të përdorin fjalë të ndryshme, por ata duhet të përcaktojnë të vërtetën vijuese: **Kur e ndajmë mesazhin e ungjillit me të tjerët, ne i ndihmojmë ata të përgatiten për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit.**)

- Si ju ndihmon të kuptuarit e domethënies së përjetshme të ungjillit që të nxiteni për ta ndarë atë me njerëzit që nuk janë të besimit tonë?
- Përshkruani një përvojë që e keni pasur me ndarjen e mesazhit të ungjillit me të tjerët.

Jepuni studentëve disa minuta që të përsiatin dhe të shkruajnë atë që mund të bëjnë për të marrë pjesë në shpërndarjen e ungjillit. Për shembull, ata mund të shkruajnë emrin e dikujt që e njohin, i cili nuk është tashmë anëtar i Kishës, dhe të zotohen për ta ndarë ungjillin me atë njeri. Ftojini disa studentë të ndajnë atë që planifikojnë të bëjnë. Nxitini studentët të veprojnë sipas ndonjë përshtypjeje që e kanë marrë dhe të luten çdo ditë për një mundësi për ta ndarë ungjillin me të tjerët.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 4:1–7; 18:10–16; 29:4–7; 31:1–12; 33:2–7; 34:5–6; 39:20–23; 88:81.
- Nil L. Andersen, “Është një Mrekulli”, *Ensign ose Liahona*, maj 2013, f. 77–80.

8

Mbledhja e Izraelit të Ditëve të Mëvonshme

Hyrje

Brenda një viti të organizimit të Kishës, Zoti i urdhëroi shenjtorët të mbledheshin në zonën e Ohajos (shih DeB 37:3). Që nga ajo kohë, shenjtorët e ditëve të mëvonshme janë mbledhur në vendndodhje të ndryshme teksa kanë kërkuar ta ndjekin profetin e gjallë dhe të

krijojnë vende të sigurta për të jetuar. Në këtë mësim, studentët do të mësojnë se Zoti i mbledh njerëzit e Tij për t'i forcuar ata dhe për t'i përgatitur që të marrin bekime më të mëdha, duke përfshirë bekimet e tempullit (shih DeB 84:4).

Lexim Konteksti

- Russell M. Nelson, "The Gathering of Scattered Israel", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2006, f. 79–82.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 38:31–33; 39:15; 95:8; 110:9

Thirrja për t'u mbledhur në Ohajo

Paraqitni hartën "Zona e New York-ut, Pennsylvania-s dhe Ohio-s në SHBA" (Harta Historike të Kishës, nr. 3), e vendosur në pjesën pas Doktrinës e Besëlidhjeve, ose ndonjë hartë tjetër të kësaj zone.



Ftojini studentët të përcaktojnë vendndodhjet e përgjithshme të ngjarjeve të rëndësishme vijuese të Rivendosjes: Vegimi i Parë (Manchester, Nju-Jork), rivendosja e priftërisë (Harmoni, Pensilvania) dhe organizimi i Kishës (Fajet, Nju-Jork).

Më pas kërkoni disa studentëve që të lexojnë me radhë me zë të lartë nga thënia vijuese:

"Sidni Rigdoni, një ish-shërbëstar dhe anëtar i sapokthyer në besim nga zona e Kirtlandit, dhe një mik joanëtar, i quajtur Eduard Partrixh, ishin të etur të takonin Profetin dhe të mësonin më shumë për mësimet e Kishës. Në dhjetor 1830 ata udhëtuan më shumë se 400 kilometra deri në Fajet të Nju-Jorkut, për të vizituar Jozef Smithin. Ata i kërkuan atij të pyeste për vullnetin e Zotit me anë të zbulësës në lidhje me ata vetë dhe shenjtorët në Kirtland. Si përgjigje, Zoti zbuloi që shenjtorët e Nju-Jorkut duhej 'të mbledheshin së bashku në Ohio' (DeB 37:3). Në konferencën e tretë dhe të fundit të Kishës në Nju-Jork, të zhvilluar tek ferma e Uitmer më 2 janar 1831, Zoti e përsëriti udhëzimin e Tij [që

anëtarët e Kishës të lëviznin për në Ohajo]. ... Kjo ishte thirrja e parë në këtë periudhë ungjillore që shenjtorët të mblidheshin së bashku. ...

... Rreth 68 anëtarë nga Kolesvilli kishin nisur rrugën e tyre për në Ohajo nga mesi i prillit 1831. Po aq të bindur ndaj urdhrit të Zotit ishin 80 shenjtorë nga dega e Fajetit dhe 50 veta nga dega e Mançesterit, që i lanë shtëpitë e tyre në fillim të majit 1831. ... Nga mesi i majit, të gjitha degët e Kishës nga Nju-Jorku kishin qenë në gjendje të udhëtonin me anije përmes liqenit Erie për në limanin Ferport të Ohajos, ku i takuan bashkëshenjtorët dhe i çuan në destinacione në qytezat e Kirtlandit dhe Tompsonit. Mbledhja e madhe e Izraelit të ditëve të fundit kishte filluar” (*Trashëgimia Jonë: Një Histori e Shkurtër e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme* [2010], f. 17–19).

Ftojani një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 38:31–33. Vëreni klasën ta ndjekë dhe të përcaktojë mënyrat se si shenjtorët do të bekoheshin nëse do t’i bindeshin urdhërimit për t’u mbledhur në Ohajo. Studentët duhet të përcaktojnë katër bekime: 1) ata “mund t’i shpëtoni[n] pushtetit të armikut”; 2) ata do të “mblidhe[shin] tek [Perëndia] një popull i drejtë”; 3) ata do të merrnin ligjin e Perëndisë; dhe 4) atyre do t’iu “dhurohe[j] fuqi nga lart”. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët t’i shenjojnë këto katër bekime në shkrimet e tyre të shenjta. (*Shënim: Përcaktimi i listave në shkrimet e shenjta mund t’i ndihmojë studentët të dallojnë pika kyçe që po i thekson Zoti ose profeti.*)

Shkruani në tabelë sa vijon: **Zoti e mbledh popullin e Tij për t’i mbrojtur dhe për t’i forcuar ata shpirtërisht.** Mund të vini në dukje që në shkrimet e shenjta, doktrina e mbledhjes shpesh lidhet me mbrojtjen. “Një lidhje është një marrëdhënie ose një hallkë midis ideve, njerëzve, gjërave ose ngjarjeve, dhe shkrimet e shenjta janë plot me lidhje” (David A. Bednar, “A Reservoir of Living Water” (mbrëmje rreth vatrës në Universitetin “Brigam Jang”, 4 shkurt 2007), f. 4, speeches.byu.edu).

Shpjegoni se, ashtu si Zoti e çoi Izraelin e lashtë te mali Sinai dhe u dha atyre ligjin e Tij, po ashtu Ai i udhëzoi shenjtorët e ditëve të mëvonshme të mblidheshin në Ohajo që ata të mund ta merrnin ligjin e Tij në këtë periudhë ungjillore (shih DeB 38:32). Në Ohajo, Zoti filloi t’ia zbulonte ligjin e Tij Kishës (shih kreun e seksionit DeB 42). Më pas pyetni:

- Si ju ndihmon të mbroheni prej fuqisë së Satanit mbledhja me ata që kanë të njëjtat bindje dhe standarde si ju?
- Si na ndihmon pranimi i ligjeve të Perëndisë që ne të forcohemi shpirtërisht?
- Si mendoni, çfarë do të thotë që në Ohajo shenjtorëve do t’iu “dhurohe[j] fuqi nga lart”?

Shpjegoni se bekimi i premtuar i të qenit të “dhur[uar me] fuqi nga lart” filloi të përmbushej kur Tempulli i Kirtlandit u përfundua pesë vjet pasi shenjtorët u mblodhën në Ohajo. Lajmëtarë qiellorë e vizituan tempullin e përfunduar që t’i rivendosnin Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit çelësat dhe autoritetin e nevojshëm për t’i kryer ordinancat e shenjta. Manifestime shpirtërore u derdhën mbi shumë shenjtorë në kohën e përkushtimit të tempullit. Dhe një numër i vogël i shenjtorëve në tempull morën larjet dhe vajosjet e tempullit. Pak vite më pas në Navu, premtimi i të qenit të dhuruar me fuqi u përmbush më tej kur ordinancat e dhurimit [indaumentit] të tempullit iu paraqitën shenjtorëve. Tregoni thënien vijuese të dhënë në Navu nga Profeti Jozef Smith dhe kërkoni një student të lexojë me zë të lartë:



“Cili ishte qëllimi i mbledhjes së ... popullit të Perëndisë në çfarëdo epoke të botës? ... Qëllimi kryesor ishte ndërtimi i një shtëpie për Zotin, në të cilën Ai të mund t’i zbulonte popullit të Tij ordiancat e shtëpisë së Tij dhe lavditë e mbretërisë së Tij dhe t’u mësonte njerëzve udhën e shpëtimit” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 444–445).

- Në çfarë mënyrash keni vëzhguar që Perëndia i bekon shenjtorët e ditëve të mëvonshme kur ata mblidhen dhe ndërtojnë tempuj siç i ka drejtuar Ai?

Doktrina e Besëlidhje 45:62-67

Zoti përshkruan Jerusalemin e Ri, ose Sionin

Shpjegoni se jo shumë kohë pasi shenjtorët e Nju-Jorkut ishin mbledhur në Ohajo, shumë histori të rreme dhe thashetheme nëpër gazeta e paraqitën keq dhe e morën nëpër gojë Kishën. Gjatë kësaj kohe, Profeti Jozef Smith mori një zbulësë rreth një vendi paqeje dhe sigurie, të caktuar për mbledhjen.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 45:62–67. Kërkojini klasës që ta ndjekë dhe të përcaktojë qëllimet e Zotit në urdhërimin e shenjtorëve që të mblidheshin drejt “shtete[ve] perëndimore” (DeB 45:64). Merrni parasysh të bëni pyetjet që vijojnë:

- Çfarë tha Zoti se ishte “madje te dera”? Çfarë do të thotë për ju fraza “madje te dera”?
- Çfarë donte Zoti të bënin shenjtorët teksa mblidheshin së bashku drejt shteteve perëndimore?
- Përse duhej që ata t’i mblidhnin pasuritë e tyre? Shpjegoni se fjala *trashëgim* i drejtohet tokës që ata duhej ta blinin, ku mund të banonin dhe adhuronin Zotin.)
- Si do të quhej toka e trashëgimit të shenjtorëve?

Shpjegoni se në shkrimet e shenjta, fjala *Sion* mund të ketë disa kuptime. Nganjëherë u drejtohet njerëzve të Sionit dhe i përshkruan ata si “të kulluarit në zemër” (DeB 97:21). Diku tjetër *Sioni* i drejtohet tërë Kishës dhe kunjeve të saj (shih DeB 82:14). Fjala *Sion* gjithashtu mund t’i drejtohet vendndodhjeve të veçanta gjeografike. Te Doktrina e Besëlidhje 45:66–67, *Sioni* i drejtohet një qyteti fizik që shenjtorët do ta ngrinin dhe në të cilin ata do të mblidheshin, nganjëherë i quajtur Jerusalemi i Ri (shih edhe 3 Nefi 20:22; 21:23; Ethëri 13:1–8; Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Sion”, f. 169). Diskutoni pyetjet vijuese:

- Si e përshkroi Zoti Jerusalemin e Ri, ose Sionin? (Studentët duhet të përcaktojnë doktrinën vijuese: **Jerusalemi i Ri do të ishte një vend i paqes, strehimit e sigurisë dhe lavdia e Zotit do të ishte atje.**)
- Në ç’mënyra të qenit një anëtar i Kishës ju ka dhënë sigurinë dhe paqen që gjenden në Sion?


Shpjegoni se në mbylljen e konferencës së katërt të Kishës, të mbajtur në qershor të vitit 1831 në Kirtland të Ohajos, Zoti urdhëroi Jozef Smithin dhe pleq të tjerë të udhëtonin në dyshe për afërsisht 1,400 kilometra drejt Misurit, duke predikuar përgjatë udhës (shih DeB 52, përmbledhja e vargjeve). Pas mbërritjes, Profeti mori një zbulësë që e përcaktoi Misurin si “toka e premtimit dhe vendi për qytetin e Sionit” me Indipendëns në Misuri, të përcaktuar si “vendi qendror” (DeB 57:1–3). Përgjatë dy viteve të ardhshme, qindra shenjtorë të ditëve të mëvonshme, të zellshëm për ta

ndërtuar Sionin, lëvizën drejt zonës së kontesë Xhekson në Misuri. Për fat të keq, konflikti u shtua midis anëtarëve të Kishës e qytetarëve të tjerë të zonës dhe gjendja më së fundi u bë e dhunshme. Shenjtorët u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre në kontenë Xhekson në nëntor e dhjetor të vitit 1833.

Doktrina e Besëlidhje 115:5–6

Njerëzit e Perëndisë sot mblidhen në kunjët e Sionit

Për t'i ilustruar përpjekjet e shenjtorëve që të mblidheshin në vendet shtesë të sigurisë e paqes, paraqitni hartën "Lëvizja e Kishës drejt Perëndimit" (Harta të Historisë së Kishës, nr. 6), e vendosur pas Doktrinës e Besëlidhjeve.



Shpjegoni se shenjtorët më së fundi u detyruan të largoheshin nga Kirtlandi në Ohajo, si edhe nga vendndodhjet në Misurin perëndimor. Në vitin 1839, shenjtorët filluan të mblidheshin në Navu të Illinoisit, ku ata ngritën një qytet të madh. Por pak kohë pas vdekjes së Profetit Jozef Smith, anëtarët e Kishës u detyruan përsëri të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Ata u zhvendosën drejt Maleve Shkëmbore dhe ngritën koloni përgjatë pjesës perëndimore të Amerikës Veriore, me zyrat qendrore të Kishës të ngritura në Solt-Lejk-Siti.

Ftojini studentët të lexojnë Doktrinën e Besëlidhjet 115:5–6. Më pas pyetni:

- Sipas këtyre vargjeve, çfarë bekimesh iu premtohen atyre që mblidhen në kunjët e Sionit? (Përgjigjet duhet të përfshijnë të vërtetën vijuese: **Ne mblidhemi në kunjët e Sionit për mbrojtje dhe për strehim kundrejt ligësisë.**)
- Në çfarë mënyrash mund t'i sigurojnë kunjët e Sionit anëtarët e Kishës me mbrojtje dhe strehim në vendlindjet e tyre amtare?
- Kur keni ndier forcë dhe mbrojtje teksa jeni mbledhur me shenjtorët në vetë lagjen ose degën tuaj?

Për t'i ndihmuar studentët të kuptojnë më tej se çfarë do të thotë sot për anëtarët e Kishës që të mblidhen në kunjët e Sionit, paraqitni thënien vijuese nga Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftojini një student ta lexojë atë me zë të lartë:



"Në vitet e hershme të kësaj periudhe të fundit të kujdestarisë ungjillore, një mbledhje në Sion përfshinte vendndodhje të ndryshme në Shtetet e Bashkuara: në Kirtland, në Misuri, në Navu dhe në majën e maleve. Gjithmonë këto ishin mbledhje për tempuj të ardhshëm. Me krijimin e kungeve dhe ndërtimin e tempujve në shumë kombe me popullsi të konsiderueshme të anëtarëve besnikë, urdhërimi i tanishëm është të mos mblidhen në një vend, por të mblidhen në kunjët në vendlindjet e tyre amtare. Atje anëtarët besnikë

mund të gëzojnë bekimet e plota të përjetësisë në një shtëpi të Zotit. ... Në këtë mënyrë, kunjët e Sionit janë 'për mbrojtje e për strehim nga stuhia dhe nga zemërimi, kur të derdhen pa u zvogëluar mbi tërë dheun' (DeB 115:6) ("Preparation for the Second Coming", *Ensign* ose *Liahona*, maj 2004, f. 8).

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë thënien vijuese nga Presidenti Spenser W. Kimball (1895–1985):



"Tani, mbledhja e Izraelit përbëhet nga bashkimi me kishën e vërtetë dhe nga ardhja e tyre te një dije për Perëndinë e vërtetë. ... Si rrjedhim, çdo njeri që e ka pranuar ungjillin e rivendosur dhe që tani kërkon ta adhurojë Zotin në gjuhën e vet dhe me shenjtoret në kombet ku ai jeton, ka vepruar në pajtim me ligjin e mbledhjes së Izraelit dhe është trashëgimtar i të gjitha bekimeve të premtuara shenjtoreve në këto ditë të fundit" (*The Teachings of Spencer W. Kimball*, bot. Edward L. Kimball [1982], f. 439).

- Çfarë keni parë të ndodhë me numrin e tempujve që ka ngritur Kisha gjatë jetës suaj?
- Si jeni bekuar nga anëtarësia në një kunj ose distrikt të Sionit? Si jeni bekuar ju nëpërmjet tempujve të shenjtë?

Mbylleni duke u kërkuar studentëve të marrin parasysh se çfarë mund të bëjnë ata për t'i ndihmuar të tjerët që të marrin mbrojtje dhe forcë shpirtërore, që vjen nga pjesëmarrja besnike në kunjët e Sionit dhe nga adhurimi në tempujt e shenjtë. Ftojini studentët të veprojnë sipas nxitjeve të Shpirtit që mund t'i kenë marrë.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 37:1–3; 38:31–33; 39:15; 45:62–67; 95:8; 110:9; 115:5–6.
- Russell M. Nelson, "The Gathering of Scattered Israel", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2006, f. 79–82.

Ndiqni Profetin e Gjallë

9

Hyrje

Në ditën që Kisha u organizua, Zoti u premtoi siguri shpirtërore atyre që do t'ua vinin veshin fjalëve të profetit (shih DeB 21:4–6). Pak kohë pas kësaj, për t'i ndihmuar anëtarët e Kishës që ta shmangin mashtrimin, Zoti zbuloi më tej se vetëm profeti

autorizohet që të marrë zbulësë për të gjithë Kishën (shih DeB 28:1–7). Profeti gjithashtu ka autoritetin të qartësojë shkrimin e shenjtë. Kuptueshmëria e këtyre të vërtetave sjell siguri të shtuar shpirtërore në këto ditë të mëvonshme.

Lexim Konteksti

- Rasëll M. Nelson, “Mbështetja e Profetëve”, *Ensign ose Liahona*, nëntor 2014, f. 74–77.
- Ezra Taft Benson, “Fourteen Fundamentals in Following the Prophet” [takim shpirtëror në Universitetin “Brigam Jang”, 26 shkurt 1980], *speeches.byu.edu*; shih edhe *Tambuli*, qershor 1981, f. 1–8.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 21:1–6

Vëruani veshin fjalëve të profetit

Pyetini studentët se çfarë titujsh përdorim ne nganjëherë për t'iu drejtuar Presidentit të Kishës. Shkruajini përgjigjet e studentëve në tabelë. Më pas ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 21:1, ndërsa klasa e ndjek. Renditeni ndonjë titull shtesë në tabelë. Më pas pyetni:

- Si e përshkruajnë secili prej titujve në këtë varg punën e Presidentit të Kishës?

Ndihmohjini studentët të kuptojnë kontekstin e Doktrinës e Besëlidhjeve 21, duke shpjeguar se zbulësia që shënon, u dha në ditën që u organizua Kisha. (*Shënim*: Kur studentët mësojnë ta kuptojnë kontekstin e një shkrimi të shenjtë, ka më shumë mundësi që ata të kuptojnë domethënien dhe rëndësinë e asaj që lexojnë.) Më pas pyetni:

- Përse do të kishte qenë e rëndësishme për anëtarët e hershëm të Kishës që të dallonin se thirrja e Jozef Smithit si profet ndryshonte në mënyrë domethënëse nga rolet e udhëheqësve të kishave të tjera?

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 21:4–5, ndërsa klasa e ndjek. Më pas diskutoni sa vijon:

- Përse nganjëherë kërkohet durim e besim për t'ia vënë veshin këshillës së profetit?

Siç nevojitet, merrni parasysh t'ua tregoni studentëve thënien vijuese nga Presidenti Harold B. Li (1899–1973):



“Ne duhet të mësojmë t'ua vëmë veshin fjalëve dhe urdhërimeve që Zoti do t'i japë nëpërmjet profetit të Tij. ... Ju mund të mos e pëlqeni atë që vjen nga autoriteti i Kishës. Ajo mund të kundërshtojë pikëpamjet tuaja politike. Ajo mund të kundërshtojë pikëpamjet tuaja shoqërore. Ajo mund të ndërhyjë me një pjesë të jetës suaj shoqërore. Por nëse ua vini veshin këtyre gjërave, si nga goja e Zotit Vetë, me durim e besim, premtimi është që 'portat e ferrit nuk do të hapen kundër jush; po, dhe Zoti Perëndi do t'i shpërndajë

fuqitë e errësirës përpara jush dhe do të bëjë që qiejt të dridhen për të mirën tuaj dhe për lavdinë e emrit të tij' (DeB 21:6)" (*Teachings of Presidents of the Church: Harold B. Lee* [2000], f. 84).

Siç nxiteni nga Shpirti, ju mund të shpjegoni sa vijon:

1. Si shenjtorë të ditëve të mëvonshme, ne nuk besojmë që profetët janë njerëz të përsosur. Megjithatë, Zoti kurrë nuk do t'i lejojë ata ta udhëheqin Kishën në udhë të gabuar (shih Deklarata Zyrtare 1, "Pjesë të Shkëputura nga Tre Fjalime të Presidentit Wilford Woodruff Lidhur me Manifestin").
2. Ne besojmë dhe gëzohemi në zbulesën e vazhdueshme. Ka pasur raste në historinë e Kishës kur një profet e ka qartësuar këshillën profetike të mëparshme apo ka përcaktuar mësimet ose praktikat që dikur pranoheshin gjerësisht, të cilat më vonë kishin nevojë të ndryshoheshin. Për shembull, në vitet e hershme të Kishës, anëtarët u nxitën që të mblidheshin në një vendndodhje qendrore, të tillë si Kirtlandi në Ohajo ose konteja Xhekson në Misuri. Sot, anëtarët e Kishës nxitën të mblidhen në kunjete ose distriktet e tyre vendore.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 21:6. Kërkojini klasës ta ndjekë dhe të përcaktojë premtimet e dhëna atyre që ua vënë veshin fjalëve të profetit. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët ta shenjojnë atë që gjejnë. Më pas pyetni:

- Si do t'i përmbledhni premtimet e dhëna atyre që ua vënë veshin fjalëve të profetit? (Edhe pse ata mund të përdorin fjalë të ndryshme, studentët duhet të përcaktojnë parimin vijues: **Nëse ua vëmë veshin fjalëve të profetit, ne do të mbrohemi ndaj kundërshtarit.** Teksa studentët përgjigjen, ju mund të doni të shpjegoni se një kuptim i fjalës *dridhen* është ta shkëputësh apo ta lëshosh diçka nga një mbështetëse apo një mbajtëse. Pra, një interpretim i vargut 6 mund të jetë që kur qiejt dridhen "për të mirën [tonë]", zbulesat dhe bekimet "lëshohen" e derdhen mbi ne.)

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Henri B. Ajring, i Presidencës së Parë, dhe kërkojini një student të lexojë me zë të lartë:



"Kërkimi i shtegut drejt sigurisë në këshillën e profetëve ka kuptim për ata me besim të fortë. Kur flet një profet, ata me pak besim mund të mendojnë se po dëgjojnë vetëm një njeri të urtë duke dhënë këshilla të mira. ...

... Por zgjedhja për të mos e zbatuar këshillën profetike e ndryshon vetë terrenin mbi të cilin qëndrojmë. Ai bëhet më i rrezikshëm. Mospranimi i këshillës profetike e pakëson fuqinë tonë për të marrë këshillë të frymëzuar në të ardhmen" (*"Finding Safety in Counsel"*, *Ensign*, maj 1997, f. 25).

- Përse do të bëhej "vetë terreni mbi të cilin qëndrojmë" "më i rrezikshëm", në qoftë se nuk e pranojmë këshillën e profetëve? Cilët shembuj e tregojnë se kjo është e vërtetë?
- Kur jeni bekuar ju apo dikush që e njihni, ngaqë ia vutë veshin këshillës së profetëve të gjallë?
- Si mund të zbatohet parimi për t'ia vënë veshin këshillës profetike kundrejt çështjeve fetare, morale dhe shoqërore të kohës sonë?

Nxitini studentët të përsiatin atë që mund të bëjnë për të marrë bekimet e premtuara te Doktrina e Besëlidhje 21:6. Sigurojini ata se, ndërsa ia vënë veshin me zell fjalëve të profetëve të gjallë, ata do të marrin bekime të mëdha tani dhe në përjetësitë. Shpjegoni se t'ia vëmë veshin këshillës së profetëve nuk nënkupton që ne t'iu bindemi verbërisht fjalëve të tyre.

Lexoni me zë të lartë thënien vijuese nga Presidenti Harold B. Li:



“Nuk është vetëm e mjaftueshme për ne si shenjtorë të ditëve të mëvonshme që t'i ndjekim udhëheqësit tanë dhe ta pranojmë këshillën e tyre, por ne kemi përgjegjësinë më të madhe që të fitojmë për veten tonë dëshminë e patundur për caktimin hyjnor të këtyre burrave dhe dëshminë që ajo që ata na kanë thënë, është vullneti i Atit tonë Qiellor” (*Teachings: Harold B. Lee*, f. 45).

Doktrina e Besëlidhje 28:2, 6–7; 43:1–7

Zoti jep zbulesë në një mënyrë të rregullt

Shpjegoni se shpejt pasi u organizua Kisha, disa anëtarë të Kishës u mashtruan nga përpjekjet e kundërshtarit për të dhënë drejtim të gënjeshtërt profetik. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë kreun e seksionit te Doktrina e Besëlidhje 28, ndërsa klasa e ndjek (shih edhe Jeffrey G. Cannon, “All Things Must Be Done in Order: D&C 28, 43”, seritë Revelations in Context, 4 prill 2013, history.lds.org). Më pas pyetni:

- Nëse anëtarët e Kishës do të kishin vazhduar të besonin në zbulesën e hamendësuar nga Hajrëm Peixhi, çfarë problemesh mund të kishin ndodhur?

Jepuni studentëve një çast që të studiojnë Doktrinën e Besëlidhjet 28:2, 6–7. Më pas pyetni:

- Si e sqaroi ky mesazh nga Zoti rolin e Presidentit të Kishës? (Studentët duhet të kuptojnë doktrinën vijuese: **Presidenti i Kishës mban çelësat për të marrë zbulesë për Kishën.**)

Për t'i ndihmuar studentët ta thellojnë kuptueshmërinë e tyre për këtë doktrinë, kërkojini një student të lexojë me zë të lartë sfondin historik në vijim për Doktrinën e Besëlidhjet 43:

Në shkurt të vitit 1831, një grua e quajtur zonja Habëll erdhi mes shenjtorëve në Kirtland të Ohajos. Ajo shpalli se ishte një profeteshë, se kishte marrë zbulesa për Kishën, se e dinte që Libri i Mormonit ishte i vërtetë dhe se ajo duhej të bëhej një mësuese në Kishë. Ajo ishte në gjendje të mashtronte disa shenjtorë. Jozef Smithi dhe të tjerët ishin të shqetësuar rreth ndikimit të saj dhe rreth zbulesave të tjera të rreme mes shenjtorëve. Profeti vendosi t'i kërkonte Zotit rreth asaj që duhej bërë dhe ai mori një zbulesë, tani të shënuar te Doktrina e Besëlidhje 43 (shih *Documents, Vëllimi 1: korrik 1828–qershor 1831*, vëll. 1 i serisë së Dokumenteve të *The Joseph Smith Papers* [2013], f. 257).

Ftojini studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 43:1–7, duke kërkuar doktrinën që Zoti i sqaroi në atë kohë. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët ta shenjojnë atë që gjejnë. Ju mund të sugjeroni gjithashtu që ata të kryqëzojnë si referencë këto vargje me Doktrinën e Besëlidhjet 28:2. Vini në dukje se zbulesa e shënuar te seksioni 28 iu drejtua shenjtorëve në Nju-Jork dhe zbulesa e shënuar te seksioni 43 iu drejtua shenjtorëve në Kirtland. Më pas pyetni:

- Në kohën kur u dha zbulesa e shënuar te Doktrina e Besëlidhje 43, kush u caktua të merrte urdhërimet e zbulesa për të gjithë Kishën?

- Çfarë doktrinash mund të mësojmë nga këto vargje? (Studentët mund të përdorin fjalë të ndryshme, por ata duhet të përcaktojnë doktrinën vijuese: **Ka vetëm një njeri të caktuar në një kohë për të marrë zbuluesë për të gjithë Kishën. Ata që ia vënë veshin Presidentit të Kishës, nuk do të mashtrohen.**)

Merrni parasysh të lexoni thënien vijuese nga Plaku L. Tom Peri, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



"Ka rregull në mënyrën se si Zoti ia bën të ditur vullnetin e Tij njerëzimit. Ne të gjithë kemi të drejtën t'i kërkojmë Zotit dhe të marrim frymëzim nëpërmjet Shpirtit të Tij brenda sferës së kujdestarisë sonë. Prindërit mund të marrin zbuluesë për vetë familjen e tyre, një peshkop për bashkësinë e caktuar atij dhe Presidenca e Parë për të gjithë Kishën. ... Profeti Jozef Smith shpalli:

'Është në kundërshtim me rendin e Perëndisë që ndonjë anëtar i Kishës, ose kushdo [tjetër], të marrë udhëzime për ata që janë në autoritet, më të lartë se vetja' [*Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith (2009), 207*] ("We Believe All That God Has Revealed," *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2003, f. 85–86).

- Si ndihmon që ta shmangni mashtrimin, dituria që zbuluesë nga Perëndia gjithmonë vjen nëpërmjet kanaleve të njohura të priftërisë? Si mund të sjellë kjo dituri paqe në jetën tuaj?
- Si e mban rregullin në Kishë modeli i Zotit për zbuluesë?

Doktrina e Besëlidhje 90:1–6

Zoti vendosi rregull në Kishë

Shpjegoni se ndërsa Kisha rritej, Zoti e udhëzoi Profetin Jozef Smith në organizimin e priftërisë dhe të anëtarësisë së Kishës.

Lexoni me zë të lartë ose përmbliidhni thënien vijuese:

"Ndërsa Kisha rritej në anëtarësi, Profeti vazhdoi të merrte zbuluesë mbi detyrat e priftërisë. Siç u drejtua nga Zoti, ai organizoi Presidencën e Parë, të përbërë nga ai vetë si President dhe Sidni Rigdoni e Frederik G. Uilliamsi si Këshilltarë. Ai organizoi gjithashtu Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve dhe Kuorumin e Parë të Të Shtatëdhjetëve. Ai thirri e shuguroi peshkopë dhe këshilltarët e tyre, priftërinj të lartë, patriarkë, këshilltarë të lartë, të shtatëdhjetë dhe pleq. Ai organizoi kunjët e para të Kishës" (*Trashëgimia Jonë: Një Histori e Shkurtër e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme* [2010], f. 26).

Shpjegoni se Presidenca e Parë mban një pozitë të pashoqe në Kishë. Ftojini studentët të studiojnë Doktrinën e Besëlidhjet 90:1–6 dhe të përcaktojnë detyrat e veçanta të Presidencës së Parë. (Presidenca e Parë "mba[n] çelësat e mbretërisë" [vargu 2] dhe është mjete nëpërmjet të cilit "orakujt do t'i jepen" Kishës [vargu 4]). Pasi studentët të përgjigjen, juve mund t'ju duhet të shpjegoni që fjala "orakujt" i drejtohet zbuluesave nga Perëndia të dhëna nëpërmjet profetëve të Tij.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë thënien vijuese nga Plaku D. Tod Kristoferson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Kërkojini klasës të dëgjojë për dy mënyra të ndryshme në të cilat doktrina themelohet në Kishë.



“Në vitin 1954, Presidenti J. Ruben Klark i Riu, në atë kohë një këshilltar në Presidencën e Parë, shpjegoi mënyrën si bëhet e njohur doktrina në Kishë dhe rolin parësor të Presidentit të Kishës. Duke folur për anëtarët e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ai tha: ‘[Ne] duhet të [sjellim] ndër mend se disave prej Autoriteteve të Përgjithshme iu është caktuar një thirrje e veçantë; ata zotërojnë një dhuratë të veçantë; ata mbështeten si profetë, shikues e zbulues, gjë që u jep atyre një dhurim të veçantë shpirtëror në lidhje me mësimet që ata u japin njerëzve. Ata kanë të drejtën, fuqinë dhe autoritetin për t’u deklaruar njerëzve të Tij mendimet dhe vullnetin e Perëndisë, në varësi të fuqisë dhe autoritetit të plotë të Presidentit të Kishës. ...’

... Presidenti i Kishës mund të njoftojë ose të interpretojë doktrina bazuar te zbulimet që i jepen atij (shih për shembull DeB 138). Interpretimi doktrinor mund të vijë edhe nëpërmjet këshillit të bashkuar të Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve (shih për shembull, Deklaratën Zyrtare 2) (“Doktrina e Krishtit”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2012, f. 86–88).

- Përse është e rëndësishme që ta kujtojmë kush e ka autoritetin për t’ia shpallur “mendimet dhe vullnetin e Perëndisë” botës?

Përfundojeni duke iu kërkuar studentëve të marrin parasysht atë që ata e kanë mësuar nga mesazhet e profetëve dhe apostujve të gjallë. Ftojini studentët të japin dëshmitë e tyre për mënyrën se si këto mesazhe i kanë bekuar ata.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 21:1–6; 28:2, 6–7; 43:1–7; 90:1–6, 16.
- Kevin R. Dankan, “Pikërisht Mbijetesa Jonë”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2010, f. 34–36.
- Rasëll M. Nelson, “Mbështetja e Profetëve”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2014, f. 74–77.

10

Kërkoni të Vërtetën

Hyrje

Fëmijët e Perëndisë nxiten që të “kërkojnë] të mësojnë], ... me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit” (DeB 88:118). Ndjekja e këtij modeli i ndihmon individët që të kualifikohen për ndihmën e Frymës së Shenjtë në procesin e të mësuarit. Sot, interneti dhe burime të tjera sigurojnë një mori informacioni – një pjesë i vërtetë, një pjesë i rremë dhe një pjesë çorientues – rreth

doktrinës, historisë dhe pozitës së Kishës për çështje shoqërore, duke e bërë veçanërisht të rëndësishme për ne që të mbështetemi te Fryma e Shenjtë për të na ndihmuar të dallojmë të vërtetën nga gabimi. Të mësuarit se si të përcaktojmë e përdorim burime të duhura të informacionit, është pjesë e këtij procesi.

Lexim Konteksti

- Diter F. Uhtdorf, “Ç’është e Vërteta?” (Church Educational System devotional, Jan. 13, 2013), lds.org/broadcasts.
- “Gospel Learning”, Gospel Topics, lds.org/topics.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 88:118, 121–126

Një model për të mësuarin

Lexoni me zë të lartë përshkrimin vijues për Shkollën e Profetëve, të mbajtur në Kirtland të Ohajos:

“Në vitin 1833, Profeti dhe një grup i shenjtorëve të Kirtlandit patën një mundësi të pasoqë për të studiuar ungjillin. Në janar të atij viti, në përputhje me urdhrin e Zotit (shih DeB 88:127–41), Profeti organizoi Shkollën e Profetëve për t’i mësuar mbajtësit e priftërisë për punën e tyre në shërbesë dhe për t’i përgatitur ata që të predikonin ungjillin. Shkolla u mbajt në një dhomë në katin e dytë në dyqanin e Njull K. Uitnit, ku jetonte Profeti. Morën pjesë rreth 25 vëllezër, disa duke udhëtuar qindra kilometra për të pasur privilegjin që ta studionin ungjillin në një dhomë me përmasa jo më të mëdha se 3,35 me 4,27 metra. Shumë nga këta burra më vonë u bënë Apostuj, Të Shtatëdhjetë dhe udhëheqës të tjerë të Kishës. Ndonëse Profeti dhe vëllezërit e tjerë me raste studiuuan gjuhësinë, ata u përqendruan së pari në mësimin e doktrinave të ungjillit, duke vazhduar me zell studimet e tyre nga mëngjesi herët deri pasdite vonë. Kjo shkollë zgjati katër muaj dhe shkolla të ngjashme u mbajtën më vonë në Kirtland dhe gjithashtu në Misuri, në të cilat morën pjesë qindra njerëz” (*Mësimet të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith [2007], f. 277*).

Shpjegoni se Doktrina e Besëlidhje 88 përmban udhëzime nga Zoti për ata që do të merrnin pjesë në Shkollën e Profetëve. Ftojini studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 88:118, duke kërkuar modelin e të mësuarit të përshkruar nga Zoti. Më pas diskutoni pyetjet vijuese:

- Ç’mendoni se do të thotë të “kërkojnë] të mësojnë], ... me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit”?
- Në ç’mënyra ndjekja e këtij modeli mund ta rriste aftësinë tonë për të mësuar? (Studentët mund të japin një llojshmëri përgjigjesh, por sigurohuni që është e qartë se, **kur e përfshijmë besimin në procesin e mësimdhënies, ne kualifikohemi për ndihmën e Zotit.**)

Ftojini disa studentë të lexojnë me radhë me zë të lartë nga Doktrina e Besëlidhje 88:121–126, e cila shënon udhëzime të mëtejshme nga Zoti drejtuar Shkollës së Profetëve. Vëreni klasën që ta ndjekë, duke kërkuar parime që na ndihmojnë të kuptojmë se si të mësojmë me anë të besimit. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët ta shenjojnë atë që gjejnë. Merrni parasysh t’i renditni këto parime në tabelë teksa studentët i thonë ato. Ju gjithashtu mund të doni të sugjeroni që studentët të shkruajnë frazën “parime që na mësojnë se si të mësojmë vetë me anë të besimit” në anë të faqes së shkrimeve të tyre të shenjta pranë këtyre vargjeve. (*Shënim:* Bërja e shënimeve në anë të faqeve të shkrimeve të shenjta mund t’i ndihmojë studentët të gjejnë e të kujtojnë më me lehtësi parime të rëndësishme.) Nëse ka kohë, ju mund t’i vini studentët të kërkojnë Almën 32:28, 41–43 dhe Gjonin 7:17 për parime shitesë.

- Si na ndihmon të jetuarit e parimeve të dhëna mësim në këto vargje që të mësojmë vetë me anë të studimit dhe me anë të besimit? (Ndërsa studentët përgjigjen, ju mund të dëshironi të theksoni se ndjekja e këtyre parimeve do të na ndihmojë që të kualifikohemi për ndihmën e Shpirtit.)
- Kur kualifikohemi ta kemi Shpirtin e Zotit me ne, si e ndikon ky Shpirt kërkimin tonë për të vërtetën?

Doktrina e Besëlidhje 91:1–6

Dallimi i së vërtetës prej së gabuarës

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Diter F. Uhtdorf, i Presidencës së Parë, dhe ftojini një student ta lexojë me zë të lartë:



“Kurrë në historinë e botës nuk kemi pasur të drejtë përdorimi më të lehtë të më shumë informacioni – disa prej tij i vërtetë, disa prej tij i rremë dhe shumë prej tij pjesërisht i vërtetë.

Si pasojë, kurrë në historinë e botës nuk ka qenë më e rëndësishme që të mësojmë se si të dallojmë me saktësi midis së vërtetës dhe së gabuarës” (“Ç’është e Vërteta?” [takim shpirtëror i Sistemit Arsimor të Kishës, 13 janar 2013], f. 3, [lds.org/broadcasts](https://www.lds.org/broadcasts)).

- Cilat janë pasojat e mundshme nëse nuk mësojmë të dallojmë midis së vërtetës dhe së gabuarës?

Shkruajeni pyetjen vijuese në tabelë:

Si mund të dallojmë siç duhet midis së vërtetës dhe së gabuarës?

Shpjegoni se zbulesa e shënuar te Doktrina e Besëlidhje 91 i mësoi Jozef Smithit se si ta dallonte nëse diçka që po e lexonte tek Apokrifia ishte e vërtetë. Kërkojini një student të lexojë me zë të lartë kreun e seksionit 91, ndërsa klasa e ndjek. Më pas ftojini studentët të marrin parasysh pyetjen në tabelë, teksa e studiojnë si klasë Doktrinën e Besëlidhjet 91.

Shpjegoni se Apokrifia është një përmbledhje e librave të shenjtë të popullit të judenjve. Këta libra nuk u përfshinë fillimisht në Biblën hebrease (Dhiatën e Vjetër), por u përfshinë në përkthimin grek të Biblës pak kohë përpara kohës së Krishtit. Kur të krishterët e hershëm i përmbledhën librat e Biblës shekuj më vonë, ata i përfshinë librat e Apokrifës si një shtojcë. Disa fe të krishtera i marrin parasysh librat e Apokrifës si shkrime të shenjta, por fe të tjera nuk besojnë se ato janë shkrime të frymëzuara. Kopja e Biblës që po përdorte Jozef Smithi për të krijuar përkthimin e tij të frymëzuar, e

përbante Apokrifën. Jozefi i kërkoi Zotit nëse përkthimi i tij i Biblës duhej t'i përfshinte këta libra.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 91:1–3.

- Çfarë mësoi Jozef Smithi rreth Apokrifës? (Ju mund të keni nevojë të shpjegoni se *ndërfutja* është një material që është futur në një dorëshkrim, nganjëherë duke çuar në prishjen e tekstit original.)

Ftojini një student tjetër të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 91:4–6.

- Si mund të na ndihmojë ne këshilla te vargjet 4–6 për të dalluar të vërtetën prej së gabuarës dhe për ta vlerësuar besueshmërinë e asaj që lexojmë? (Studentët mund të përdorin fjalë të ndryshme, por sigurohuni që ata të përcaktojnë të vërtetën vijuese: **Fryma e Shenjtë mund të na ndihmojë të dimë nëse gjërat që lexojmë janë të vërteta.**)

Shpjegoni se bollëku i informacionit që është në dispozicion në internet ka krijuar një nevojë në rritje për secilin prej nesh që të kemi dhuratën shpirtërore të dallimit (shih DeB 46:23), me qëllim që të dimë se si ta dallojmë siç duhet të vërtetën prej së gabuarës. (Për informacion të mëtejshëm rreth arsyes përse dhurata e dallimit është kaq e rëndësishme në jetën tonë, shih artikullin e Plakut Dejvid A. Bednar "Quick to Observe", *Ensign ose Liahona*, dhjetor 2006, f. 31–36.)

Jepini secilit student një kopje të thënies vijuese nga Plaku Stiven E. Snou, i Të Shtatëdhjetëve. Ftojini studentët të kërkojnë në dy paragrafët e parë për këshillën që Plaku Snou e dha rreth vlerësimit të informacionit që mund të lexojmë rreth historisë dhe mësimëve të Kishës.



Baraspeshimi i Historisë së Kishës



Plaku Stiven E. Snou, i Të Shtatëdhjetëve tha:

"Interneti ka vendosur të gjitha llojet e informacionit në majë të gishtave tanë – të mirë, të keq, të vërtetë, të pavërtetë – duke përfshirë informacionin e historisë së Kishës. Ju mund të lexoni shumë rreth historisë sonë, por është e rëndësishme të lexoni rreth saj dhe ta kuptoni atë në kontekstin e saj. Vështirësia me një pjesë të informacionit në internet është që ajo është jashtë kontekstit dhe ju nuk e shihni me të vërtetë pamjen e plotë.

Informacioni që përpiqet ta poshtërojë Kishën, është në përgjithësi shumë subjektiv dhe i padrejtë. Ne duhet të kërkojmë burime që i përshkruajnë në mënyrë më objektive gjërat që ne besojmë dhe historinë tonë. Disa faqe interneti janë shumë keqdashëse dhe mund të jenë të bujshme në mënyrën se si e paraqesin informacionin. Kërkoni burime nga historianët të njohur e të respektuar, qofshin ata anëtarë të Kishës ose jo.

Disa të rinj zihen në befasi dhe tronditen nga materiali anti-mormon në internet, sepse ata nuk e kanë fortifikuar veten e tyre kundrejt tij. Ata mund të mos kenë shpenzuar kohë të mjaftueshme lidhur me anën shpirtërore, që ta përgatitin dhe forcojnë vetveten për atë që mund të vijë. Kur përvojnë jetësore vijnë për t'ua lëkundur themelet e ngritura nën vete, është e rëndësishme që ata të bëjnë ato gjëra bazë për të cilat ne gjithmonë flasim: vazhdimin e studimit të shkrimeve të shenjta dhe pasjen e lutjeve domethënëse me Atin tonë Qiellor. Ato gjëra bazë i përgatitin njerëzit për të gjitha llojet e kundërshtimit, duke përfshirë artikujt anti-mormonë që do të vijnë nëpërmjet internetit" ("Balancing Church History", *New Era*, qershor 2013, f. 21–22).

- Ngaqë na nevojitet ta vlerësojmë me kujdes besueshmërinë e burimeve të informacionit rreth historisë dhe mësimëve të Kishës, si mund t'i përdorni mësimet

e Plakut Snou për t'ju ndihmuar që ta vlerësoni besueshmërinë e diçkaje që lexoni rreth Kishës?

Ftojini studentët të lexojnë në heshtje paragrafin e tretë të thënies së Plakut Snou. Më pas diskutoni pyetjen vijuese:

- Si do t'ju ndihmojë këshilla e Plakut Snou kur ndesheni me informacione që mund t'i sfidojnë bindjet tuaja?

Qëndrimi besnik kur lindin pyetje

Shpjegoni se anëtarët e Kishës nganjëherë mund të kenë pyetje ose madje dyshime rreth doktrinës, historisë ose pozitës së Kishës për çështje shoqërore. Lexojeni thënien vijuese nga Presidenti Diter F. Uhtdorf, i Presidencës së Parë me studentët tuaj:



“Është e natyrshme të kemi pyetje – fara e kërkimit të çiltër shpesh është çelur dhe është rritur në një dushk të madh të të kuptuarit. Ka pak anëtarë të Kishës të cilët, në një kohë apo në një tjetër, nuk janë munduar me pyetje serioze ose të ndjeshme. Një nga qëllimet e Kishës është të ushqejë dhe kultivojë farën e besimit – ndonjëherë edhe në tokën plot rërë të dyshimit dhe pasigurisë” (“Ejani, Bashkohuni me Ne”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2013, f. 23).

Jepini secilit student një kopje të fletushkës “Dallimi i së Vërtetës prej së Gabuarës”, që përfshin këshillë nga udhëheqësit e Kishës për ata që kanë pyetje ose dyshime. Ftojini studentët të lexojnë në heshtje thëniet në fletushkë dhe të përcaktojnë parimet që do ta ndihmonin dikë për t'iu drejtuar pyetjeve ose dyshimeve në një mënyrë besnike. Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini studentët të shpjegojnë se si diçka që e lexojnë në fletushkë mund ta ndihmonte dikë që ka një pyetje ose një dyshim rreth doktrinës, historisë ose pozitës së Kishës për çështje shoqërore.

Teksa e mbyllni mësimin, theksoni se edhe pse mund të ketë disa pyetje që ne nuk mund t'ua gjejmë përgjigjet gjatë jetës sonë, **ne mund të gjejmë përgjigje për pyetjet tona më të mëdha kur iu bindemi urdhërimeve, i studiojmë burimet e duhura të informacionit – veçanërisht fjalët e profetëve të gjallë – kërkojmë udhërrëfim nëpërmjet lutjes dhe ushtrimeve durim e besim.**

Ftojini studentët të tregojnë përvoja që i kanë pasur kur ata e ndien ndihmën e Zotit duke i udhëzuar për të gjetur të vërtetën dhe përgjigjet për pyetjet e tyre.

Kërkojuni studentëve që t'i shqyrtojnë thëniet në fletushkë dhe ftojini ata të ndjekin këshillën nga mësimi për të kërkuar mësim me anë të studimit dhe me anë të besimit.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 88:118–126; 91:1–6.
- Diter F. Uhtdorf, “Ç’është e Vërteta?” (takim shpirtëror i Sistemit Arsimor të Kishës, 13 janar 2013), lds.org/broadcasts.
- David A. Bednar, “Quick to Observe”, *Ensign* ose *Liahona*, dhjetor 2006, f. 31–36.

Dallimi i së Vërtetës prej së Gabuarës

Në të gjitha periudhat e kujdestarisë së ungjillit, forcat e ligësisë e kanë kundërshtuar Perëndinë dhe veprën e Tij. Por vepra e Perëndisë nuk do të pengohet. Në këto ditë të mëvonshme, guri është shkëputur nga mali dhe do të “përhapet derisa të ketë mbushur tërë tokën” (DeB 65:2). Megjithatë,



ngaqë anëtarë individualë të Kishës mund të mashtrohen, ne secili kemi nevojë t'i "mbajmë" sytë hapur dhe të lute[m] gjithnjë" (3 Nefi 18:18).



"Nuk ka nevojë që ju ose unë, në këtë periudhë të ndriçuar, kur plotësia e ungjillit është rivendosur, të lundrojmë [në] dete të paeksploruara apo të udhëtojmë në rrugë të panjohura, në kërkim të së vërtetës. Një Atë i dashur Qiellor na e ka shënuar rrugën dhe na ka siguruar një hartë të pagabueshme – madje *bindjen*. Një dituri për të vërtetën dhe përgjigjet për pyetjet tona më të mëdha na vijnë kur jemi të bindur ndaj urdhërimeve të Perëndisë" (Tomas S. Monson, "Bindja Sjell Bekime", *Ensign ose Liahona*, maj 2013, f. 89).



"Miqte e mi të dashur – ju lutem, së pari kini dyshim te dyshimet tuaja përpara se të keni dyshim te besimi juaj. Ne kurrë nuk duhet ta lejojmë dyshimin që të na mbajë të burgosur dhe të na largojë nga dashuria hyjnore, paqja dhe dhuratat që vijnë nëpërmjet besimit te Zoti Jezu Krisht" (Diter F. Uhtdorf, "Ejani, Bashkohuni me Ne", *Ensign ose Liahona*, nëntor 2013, f. 23).



"Satani është mashtruesi i madh, 'paditësi i vëllezërve' [Zbulesa 12:10], ati i gjithë gënjeshtreve, [shih Gjoni 8:44], i cili vazhdimisht përpiket të mashtrojë që të mund të na mposhtë [shih DeB 50:3]. ...

Për ata që tashmë e përqafojnë të vërtetën, strategjia e tij kryesore është të shpërndajë farat e dyshimit. Për shembull, ai i ka bërë shumë anëtarë të Kishës të pengohen kur zbulojnë informacion rreth Kishës, që duket se bie në kundërshtim me atë që kishin mësuar më parë.

Kur e përjetoni një çast të tillë, kujtoni se në këtë epokë të informacionit ka shumë që krijojnë dyshim rreth ndonjë gjëje dhe gjithçkaje, në çdo kohë dhe në çdo vend. ...

... Dhe është gjithmonë mirë të mbajmë në mendje që, thjesht sepse diçka botohet në gazetë, shfaqet në internet, përsëritet shpesh ose ka një grup të fuqishëm pasuesish, nuk bëhet e vërtetë.

Nganjëherë deklarata ose informacione jo të vërteta paraqiten në një mënyrë të tillë që duken mjaft të besueshme. ...

... Ajo që mund të duket kundërshtuese tani, në mënyrë të përsosur mund të jetë e kuptueshme kur kërkojmë dhe marrim më shumë informacion të denjë për t'u besuar" (Diter F. Uhtdorf, "Ç'është e Vërteta?" [takim shpirtëror i Sistemit Arsimor të Kishës, 13 janar 2013], *lds.org/broadcasts*).



"Kur fillojmë t'i matim praktikat dhe propozimet bashkëkohore kundrejt asaj që dimë nga plani i Perëndisë dhe kushtet paraprake të dhëna në fjalën e Perëndisë dhe mësimet e profetëve të Tij të gjallë, ... e dimë se kjo na vendos përjetësisht mbi një bazë të sigurt" (Dallin H. Oaks, "As He Thinketh in His Heart" [mbrëmje me Plakun Dallin H. Oaks, 8 shkurt 2013], *lds.org/broadcasts*).



"Në çaste frike apo dyshimi, ose kohë shqetësimi, mos u largoni nga besimi që keni fituar tashmë, edhe pse ai mund të jetë i kufizuar. ... Kur ato çaste vijnë dhe shqetësimet shfaqen, zgjidhja e të cilave nuk po afrohet menjëherë, *mbahuni fort tek ajo që tashmë e dini dhe qëndroni të paepur derisa vjen dija e mëtejshme*" (Xhefri R. Holland, "Unë Besoj, o Zot" *Ensign ose Liahona*, maj 2013, f. 94).



"Ne mund t'i kujtojmë kërkuesit të singertë se informacioni në internet nuk ka një filtër të 'së vërtetës'. Disa informacione lidhur me Kishën, sado bindëse qofshin, thjesht nuk janë të vërteta" (Nil L. Andersen, "Jozef Smithi", *Ensign ose Liahona*, nëntor 2014, f. 29).



"Përgjigjet ndaj pyetjeve shpirtërore u jepen individëve që nuk i ngurtësojnë zemrat e tyre; që kërkojnë me besim, duke besuar se do të marrin; dhe që i zbatojnë urdhërimet me zell" (Paul V. Johnson, "A Pattern for Learning Spiritual Things" [bisedë drejtuar arsimtarëve fetarë të Sistemit Arsimor të Kishës, 7 gusht 2012], *si.lds.org*).



"Të studiuarit e Kishës ... nëpërmjet syve të braktisësve të saj [është] sikur të intervistosh Judën për të kuptuar Jezusin" (Neal A. Maxwell, "All Hell Is Moved" [takim shpirtëror në Universitetin "Brigam Jang", 8 nëntor 1977], f. 3, speeches.byu.edu).

11

Zëri i Zotit te Doktrina e Besëlidhje

Hyrje

Doktrina e Besëlidhje është provë që Perëndia u flet profetëve në ditët e mëvonshme dhe që Ai po e përgatit botën për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit. Kur i lexojmë zbulosat që gjenden te Doktrina

e Besëlidhje, ne mund të dëgjojmë zërin e Jezu Krishtit. Kur arrijmë ta kuptojmë rëndësinë e Doktrinës e Besëlidhjeve, ne vërtet do t'i vlerësojmë mësimet e saj mbi të gjithë pasurinë e tokës.

Lexim Konteksti

- Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon and the Doctrine and Covenants”, *Ensign*, janar 2005, f. 24–28.

Sugjerime për Mësimdhënien

Parathënia për Doktrinën e Besëlidhjet

Zëri i Zotit te Doktrina e Besëlidhje

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994). Kërkojini një student të lexojë me zë të lartë ndërsa klasa e ndjek.



“Libri i Mormonit i sjell njerëzit te Krishti. Doktrina e Besëlidhje i sjell njerëzit te mbretëria e Krishtit, madje Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, e ‘vetm[ja] kishë [e] vërtetë dhe [e] gjallë mbi faqen e tërë dheut’ [DeB 1:30]. Unë e di këtë.

Libri i Mormonit është ‘gurthemeli’ i fesë sonë dhe Doktrina e Besëlidhje është guri kulmor, me zbulësën e vazhdueshme të ditëve të mëvonshme. Zoti e ka vendosur vulën e Tij të miratimit si mbi gurin e themelit, ashtu edhe mbi gurin kulmor” (“The Book of Mormon and the Doctrine and Covenants”, *Ensign*, janar 2005, f. 26).

- Çfarë keni gjetur te Doktrina e Besëlidhje që tregon rëndësinë e librit për Kishën dhe për anëtarët individualë?

Kërkojini klasës t’i hapin shkrimet e tyre të shenjta te parathënia për Doktrinën e Besëlidhjet, që gjendet në fillimin e Doktrinës e Besëlidhjeve. Ftojini dy studentë të lexojnë me radhë me zë të lartë paragrafët një dhe tre, teksa pjesa tjetër e klasës i ndjek. Vëreni klasën të kërkojë mënyra sipas të cilave Doktrina e Besëlidhje ndryshon nga librat e tjerë të shkrimit të shenjtë dhe të vërë në dukje theksimet e parathënies lidhur me dëgjimin e zërit të Zotit. Më pas pyetni:

- Si është Doktrina e Besëlidhje e ndryshme nga veprat e tjera standarde?
- Çfarë thotë parathënia rreth “zëri[t] ... të Zotit Jezu Krisht”? (Ndihmohuni studentët të kuptojnë se **kur e studiojmë Doktrinën e Besëlidhjet, ne mund të mësojmë që ta dallojmë zërin e Zotit Jezu Krisht.** Shpjegoni se fraza “zëri i Zotit” ose një variant i saj, gjendet më shumë se 40 herë te Doktrina e Besëlidhje [për shembull, shih DeB 1:2; 18:35–36; 76:30]; fraza “kështu thotë Zoti” gjendet më shumë se 60 herë te Doktrina e Besëlidhje [për shembull, shih DeB 36:1; 56:14].) Të dëgjuarit e zërit të Zotit është një temë e rëndësishme te Doktrina e Besëlidhje.

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Nil A. Maksuell (1926–2004), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Kërkojini një studenti ta lexojë me zë të lartë ndërsa klasa e ndjek.



“Nëse pyeten se cili libër i shkrimit të shenjtë jep mundësinë më të shpeshtë për ta ‘dëgjuar’ Zotin të flasë, shumica e individëve fillimisht do të mendonin për Dhiatën e Re. Dhiata e Re është një përmbledhje e mrekullueshme e veprimeve dhe e shumë prej doktrinarave të Mesias. Por te Doktrina e Besëlidhje ne marrim zërin, si edhe fjalën e Zotit. Ne pothuajse mund ta ‘dëgjojmë’ atë duke folur” (“The Doctrine and Covenants: The Voice of the Lord”, *Ensign*, dhjetor 1978, f. 4).

- Si mund të sjellë një ndryshim në jetën tuaj të mësuarit për ta dëgjuar e dalluar zërin e Zotit nëpërmjet studimit të Doktrinës e Besëlidhjeve?

Jepuni studentëve disa minuta që të studiojnë paragrafin e tetë të parathënies së Doktrinës e Besëlidhjeve. Kërkojuni atyre të përcaktojnë doktrinën që shënohen te Doktrina e Besëlidhje. Pas një kohe të mjaftueshme, pyetni:

- Çfarë e bën Doktrinën e Besëlidhjet “me më shumë vlerë [për Kishën] se sa pasuritë e gjithë tokës”?

Merrni parasysh atë që Plaku Stiven E. Snou, i Të Shtatëdhjetëve, tha rreth zbulësive që gjenden te Doktrina e Besëlidhjeve:



“Nëpërmjet këtyre zbulësive frymëzuese dhe lartësuese, Doktrina e Besëlidhje na mëson dhe na përsërit një doktrinë të rëndësishme. ... Plaku Xhon A. Uitso (1872–1952) shkroi: ‘Çdo doktrinë e dhënë mësim në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme gjendet, qoftë e nënvizuar ose e nxjerrë në pah, në Librin e Doktrinës e Besëlidhjeve. Për aq sa di unë, nuk ka asnjë doktrinë të dhënë mësim nga Kisha, e cila nuk gjendet në një farë mënyre ose forme në këtë libër.’ Ai shtoi se Doktrina e Besëlidhje është thelbësore ngaqë ‘asnjë libër tjetër i librave tona të shenjta nuk mund të bëjë të njëjtën shpallje për një vëzhgim të plotë të të gjitha doktrinarave të Kishës’ [*The Message of the Doctrine and Covenants* (1969), f. 117]” (“*Treasuring the Doctrine and Covenants*”, *Ensign*, janar 2009, f. 52).

Ftojini studentët të tregojnë se si studimi i Doktrinës e Besëlidhjeve e ka bekuar jetën e tyre.

Doktrina e Besëlidhje 1:1–17; 5:10

Sfondi Historik i Doktrinës e Besëlidhjeve

Shpjegojuni studentëve se zbulësia e shënuar te Doktrina e Besëlidhje 1 fillimisht u dha nga Zoti si një parathënie për Librin e Urdhërimeve, i cili ishte përmbledhja e parë e zbulësive të Jozef Smithit. Kjo përmbledhje e zbulësive, së bashku me më shumë prej zbulësive të Profetit dhe *Lectures on Faith* [*Leksione mbi Besimin*], u botuan më vonë si Doktrina e Besëlidhje. Seksioni 1 i drejtohet nevojës për këtë libër të shkrimit të shenjtë në kohën tonë. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë hyrjen e seksionit te Doktrina e Besëlidhje 1. Ndihmojini studentët ta analizojnë hyrjen e seksionit duke bërë pyetjen vijuese:

- Për çfarë vendimi u ra dakord te konferenca e veçantë e pleqve? (Zbulësat që Jozef Smithi i mori deri në këtë kohë, do të botoheshin në një libër. Kujtojini studentët se, edhe pse ky libër u quajt fillimisht Libri i Urdhërimeve, ai më vonë do të quhej Doktrina e Besëlidhje.)

Ftojini disa studentë që të lexojnë me radhë, me zë të lartë nga Doktrina e Besëlidhje 1:1–5. Më pas pyeteni klasën:

- Kujt po i fliste Jezu Krishti në këto vargje?
- Si do ta përmbledhnit mesazhin qendror të shënuar në këto vargje?
- Si tha Zoti se do t’ua dorëzonte paralajmërimet e Tij të gjithë njerëzve? (Studentët duhet të përcaktojnë doktrinën vijuese: **Zoti ua thotë paralajmërimet e Tij të gjithë njerëzve nëpërmjet dishepujve të Tij të zgjedhur.**)

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 1:12. Më pas pyetni:

- Sipas shënimit 12b në fund të faqes, për cilën ngjarje dëshiron Zoti të përgatitet bota? (Pasi studentët të përgjigjen, ju mund t’i nxitni që t’u drejtohen rregullisht shënimeve në fund të faqeve për ta qartësuar e thelluar kuptueshmërinë e tyre për tekstin e shkrimit të shenjtë.)

Vërieni studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 1:14–16, duke kërkuar përshkrimin e Zotit për botën në të cilën jetojmë. Pasi studentët të tregojnë atë që kanë gjetur, kërkojuni atyre të lexojnë vargun 17 dhe të shpjegojnë atë që Zoti e bëri për t’iu drejtuar problemit të përshkruar te vargjet 14–16.

Kërkojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 5:10 ndërsa klasa e ndjek. Më pas diskutoni pyetjet vijuese:

- Çfarë mësoni nga ky fragment rreth thirrjes së pashoqe të Jozef Smithit? (Studentët duhet të përcaktojnë të vërtetën vijuese: **Zoti e thirri Jozef Smithin që t’ia jepte fjalën e Tij botës.**)

Ftojini një student të lexojë thënien vijuese nga Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Në gjithçka tjetër që ai përmbushi ... Jozef [Smithi] na la neve, mbi gjithçka tjetër, trashëgiminë e patundur të zbulesës hyjnore – jo të një zbulose të vetme, të izoluar, pa provë ose pasojë, dhe jo ‘një lloj të zbutur të frymëzimit duke depërtuar në mendjet e të gjithë njerëzve të mirë’ kudo, por të udhëzimeve të veçanta, të dokumentuara, të vazhdueshme nga Perëndia. Si një mik i mirë dhe një studiues besnik SHDM e ka thënë atë në mënyrë të përmbledhur: ‘Në një kohë kur fillesat e krishtërit ishin nën sulmin e forcave të arsyetimit të Ndricimit të Mendjes, Jozef Smithi [pa asnjë mëdyshje dhe i vetëm] e ktheu krishtërimin modern drejt fillesës së tij me anë të zbulesës’ [Richard L. Bushman, “A Joseph Smith for the Twenty-First Century”, te *Believing History* (2004), f. 274] (“Prophets, Seers, and Revelators”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2004, f. 8).

- Si e ka thelluar ky mësim kuptueshmërinë tuaj për qëllimin dhe rëndësinë e Doktrinës e Besëlidhjeve?
- Si e ka forcuar Doktrina e Besëlidhje dëshminë tuaj për thirrjen hyjnore të Jozef Smithit si një profet i Perëndisë?

Mbylleni duke pyetur nëse ndonjë nga studentët do të donte të ndante dëshminë e vet për doktrinën, parimet dhe të vërtetat e shënuara te Doktrina e Besëlidhje.

Materiale Leximi për Studentin

- Parathënie për Doktrinën e Besëlidhjet; Doktrina e Besëlidhje 1:1–39; 5:10.
- Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon and the Doctrine and Covenants”, *Ensign*, janar 2005, f. 24–28.

Shkrime të Shenjta Shtesë në Kohën Tonë

12

Hyrje

Zoti vazhdon të na japë udhëzime hyjnor duke ua zbuluar fjalën e Tij dhe vullnetin e Tij shërbëtorëve të Tij nëpërmjet Frymës së Shenjtë. Ngaqë Perëndia vazhdon t'u flasë profetëve bashkëkohorë, kanuni i shkrimit të shenjtë mbahet i hapur. Shkrime të shenjta shtesë, të

nxjerra në dritë në kohën tonë – të tilla si Përkthimi i Biblës prej Joseph Smith-it dhe libri i Abrahamit – e pohojnë, qartësojnë dhe zgjerojnë kuptueshmërinë tonë për ungjillin.

Lexim Konteksti

- Xhefri R. Holland, “Fjalët e Mia ... Kurrë s’Pushojnë”, *Ensign ose Liahona*, maj 2008, f. 91–94.
- “Translation and Historicity of the Book of Abraham”, *Gospel Topics*, lds.org/topics.
- Elizabeth Maki, “Joseph Smith’s Bible Translation: D&C 45, 76, 77, 86, 91”, seritë Revelations in Context, 20 mars 2013, history.lds.org.

Sugjerime për Mësimdhënien

Shkrime të shenjta të ditëve të mëvonshme

Ftojini studentët të përfytyrojnë se një shok i pyet sinqerisht: “Përse mormonët kanë më shumë shkrime të shenjta se sa Biblën? Mendoja se Bibla përmbante fjalën e plotë të Perëndisë.” Kërkojuni studentëve të ngrenë dorën nëse u është bërë një pyetje si kjo. Ftojini disa studentë që të tregojnë se si ata iu përgjigjën pyetjes dhe se si u ndien, ndërkohë që u dëshmuar të tjerëve për shkrimet e shenjta.

Shkruajeni në tabelë fjalën *kanun*. Paraqitni thëniet vijuese nga Plaku Xhefri R. Holland dhe Plaku Dallin H. Ouks, të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftojini dy studentë ta bëjnë me radhë duke i lexuar ato me zë të lartë. Vëreni klasën të dëgjojë për kuptimin e fjalës *kanun* në kontekstin e këtyre thënieve.



“Disa të krishterë, në përmasa të mëdha, kryesisht për shkak të dashurisë së tyre të pastër për Biblën, kanë deklaruar se nuk mund të ketë më shkrim të shenjtë të autorizuar përtej Biblës. Në këtë, duke e shpallur të mbyllur kanunin e zbulesës, miqtë tanë të disa besimeve të tjera ia mbyllin derën fjalës hyjnore që ne në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme e kemi të shtrenjtë: Librit të Mormonit, Doktrinës e Besëlidhjeve, Perlës me Vlerë të Madhe dhe udhëheqjes së vazhdueshme të marrë nga profetët dhe apostujt e vajosur të Perëndisë” (Xhefri R. Holland, “Fjalët e Mia ... Kurrë s’Pushojnë”, *Ensign ose Liahona*, maj 2008, f. 91).



“Shumica e të krishterëve besojnë se Perëndia e mbylli kanunin e shkrimeve të shenjta – përmbledhjen autoritare të librave të shenjtë, të përdorur si shkrime të shenjta – pak kohë pas vdekjes së Krishtit dhe se nuk ka pasur asnjë zbulesë të krahasueshme që nga ajo kohë. Jozef Smithi dha mësim dhe tregoi se kanuni i shkrimit të shenjtë është i hapur [shih *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 204]. ...

... Jozef Smithi dha mësim se Perëndia do t’i udhërrëfejë fëmijët e Tij nëpërmjet dhënies së shtesave të reja të kanunit të shkrimeve të shenjta. Libri i Mormonit është një shtesë e tillë. Po kështu janë

zbulosat në Doktrinën e Besëlidhjet dhe në Perlën me Vlerë të Madhe” (Dallin H. Oaks, “Fundamental to Our Faith”, *Ensign*, janar 2011, f. 29).

- Çfarë do të thotë fraza “kanun i shkrimit të shenjtë”? (Ai është “një mbledhje e njohur, autoritare e librave të shenjtë. Në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, librat kanonikë quhen veprat standarde” [Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Kanun”, f. 83; scriptures.lds.org].)
- Çfarë do të thotë që shenjtorët e ditëve të mëvonshme besojnë në një kanun të hapur? (Edhe pse ata mund të përdorin fjalë të ndryshme, sigurohuni që studentët e kuptojnë të vërtetën vijuese: **Fjala autoritare e Perëndisë nuk përmbahet vetëm në Bibël** [shih Nenet e Besimit 1:9].)
- Çfarë ndryshimi sjell të besojmë që Zoti ende u zbulon shkrim të shenjtë profetëve të ditëve të mëvonshme?

Doktrina e Besëlidhje 42:56; 45:60–62; 76:15–19; 93:53; 94:10

Përkthimi i Biblës prej Joseph Smith-it

Shkruajeni të vërtetën vijuese në tabelë:

Nëpërmjet Profetit Jozef Smith, Zoti zbuloi një shkrim të shenjtë shtesë që e pohnon, qartëson dhe zgjeron diturinë tonë për të vërtetën.

Ftojeni një student të lexojë me zë të lartë hyrjen e seksionit të Doktrina e Besëlidhje 35. Vëreni klasën ta ndjekë dhe të kërkojë atë që Profeti Jozef Smith dhe Sidni Rigdoni po e bënë kur e morën zbuluesën e përmbajtur në këtë seksion.

- Në çfarë pune ishin përfshirë Profeti Jozef Smith dhe Sidni Rigdoni kur e morën këtë zbuluesë?

Për të ndihmuar që ta shpjegoni se çfarë është Përkthimi i Biblës prej Joseph Smith-it, ftojeni një student të lexojë me zë të lartë dy paragrafët vijues:

Pranë verës së vitit 1830, Zoti e urdhëroi Jozef Smithin që të përkthente Biblën. Jozef Smithi nuk e përktheu Biblën nga një gjuhë në një tjetër, as nuk kishte një dorëshkrim biblik origjinal nga i cili të punonte. Në vend të kësaj, Jozefi lexoi e studioi fragmente nga Varianti i Mbretit Xhejms të Biblës dhe më pas bëri korrigjime dhe shtesa siç u frymëzua nga Fryma e Shenjtë. Kështu, përkthimi ishte më shumë një rishikim i frymëzuar sesa një përkthim tradicional.

Përkthimi prej Joseph Smith-it ndikoi mbi 3.000 vargje në Variantin e Mbretit Xhejms të Biblës. Këto ndryshime përfshijnë shtesa (për të qartësuar kuptimin ose kontekstin apo për të rivendosur shkrime profetike, të tilla si libri i Moisiut), heqje, vargje të riorganizuar dhe ristrukturime tërësore të kapitujve të caktuar. Për më shumë informacion rreth Përkthimit prej Joseph Smith-it, shih Bible Dictionary [Fjalorin Biblik] ose Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta “Përkthimi prej Joseph Smith-it (PJS)”, f. 149.

Kopjojeni listën vijuese në tabelë:

<i>Doktrina e Besëlidhje 45:60–62</i>	<i>Krerët e seksioneve për Doktrinën e Besëlidhjet 35; 76; 77; 86; 91</i>
<i>Doktrina e Besëlidhje 42:56, shënimi a në fund të faqes</i>	<i>Doktrina e Besëlidhje 94:10, shënimi b në fund të faqes</i>
<i>Doktrina e Besëlidhje 76:15–19</i>	
<i>Doktrina e Besëlidhje 93:53</i>	

Ndajeni klasën në dy grupe. Ftojini secilin grup të studiojë materialin në një prej kolonave, duke kërkuar informacionin rreth Përkthimit të Biblës prej Joseph Smith-it. Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini studentët të tregojnë atë që mësuuan. Më pas bëni pyetjen vijuese:

- Çfarë ndikimi mendoni se pati puna e përkthimit mbi shkollimin shpirtëror të Jozef Smithit dhe mbi rivendosjen e të vërtetave të ungjillit?

Për t'i ndihmuar studentët që ta vlerësojnë ndikimin që puna e Jozef Smithit për përkthimin e Biblës pati mbi Kishën, ftojini studentët të kthehen te “Rendi Kronologjik i Përmbajtjes” (i vendosur në fillimin e Doktrinës e Besëlidhjeve) dhe shpjegoni se Profeti punoi me përkthimin kryesisht midis qershorit të vitit 1830 dhe korrikut të vitit 1833. Më pas pyetni:

- Sa seksione të Doktrinës e Besëlidhjeve u morën gjatë qershorit të vitit 1830 dhe korrikut të vitit 1833? (Profeti mori 74 zbulesa që u bënë pjesë e Doktrinës e Besëlidhjeve në këtë periudhë kohore.)

Gjithashtu mund të vini në dukje që librat e Moisiut dhe Joseph Smith – Mateut, të cilët që të dy janë në Perlën me Vlerë të Madhe, janë edhe pjesë e përkthimit të Biblës prej Joseph Smith-it dhe u morën gjatë kësaj periudhe kohore. Libri i Moisiut është Përkthimi prej Joseph Smith-it për tetë kapitujt e parë të Zanafillës. Jozef Smithi u bë i vetëdijshëm se sa shumë mungonte nga Bibla teksa përkthente vargjet rreth Enokut. Bibla e Mbretit Xhejms përmban 109 fjalë rreth Enokut dhe Libri i Moisiut përmban 5.240 fjalë rreth Enokut.

- Çfarë mund të sugjerojë numri i madh i zbulësive të marra gjatë kësaj periudhe kohore rreth rolit që Përkthimi prej Joseph Smith-it luajti në Rivendosjen?
- Teksa i shihni seksionet e Doktrinës e Besëlidhjeve, të marra gjatë kësaj periudhe kohore, cilat janë disa prej doktrinave të rëndësishme që u zbuluan gjatë kësaj kohe? (Shembujt e doktrinave të rëndësishme, të zbuluara gjatë kësaj periudhe kohore mund të gjenden te seksionet 29, 42, 45, 76, 88 dhe 93.)

Paraqitni sa vijon dhe ftojini një student që ta lexojë atë me zë të lartë:

“Përkthimi i Biblës prej Profetit ishte një pjesë e rëndësishme e vetë edukimit të tij shpirtëror dhe e rivendosjes së shpalosur të së vërtetës së ungjillit. Ndërsa rishikoi Dhiatën e Vjetër dhe të Re, shpesh ai mori zbulesa që i qartësonin ose zgjerorin fragmente biblike. Në këtë mënyrë, Profeti mori shumë doktrina nga Zoti, përfshirë ato që gjenden tani te Doktrina e Besëlidhje 74, 76, 77, 86 dhe 91, si dhe në pjesë të shumë seksioneve të tjera të Doktrinës e Besëlidhjeve” (*Mësimet: Jozef Smith, f. 218*).

Dëshmoni se Zoti zbuloi një pjesë të rëndësishme të Doktrinës e Besëlidhjeve si një pasojë e drejtpërdrejtë e punës së Jozef Smithit me përkthimin e Biblës. Ju gjithashtu mund të shpjegoni se pjesë të Përkthimit prej Jozef Smithit iu shtuan botimit SHDM të

vitit 1979 të Variantit të Mbretit Xhejms të Biblës, duke i vënë këto zbulesa të rëndësishme më në dispozicion për ta bekuar jetën e anëtarëve të Kishës.

Libri i Abrahamit

Ftojini studentët të shohin me të shpejtë krerët e kapitujve të Librit të Abrahamit. Shkurtimisht diskutojeni përmbajtjen e librit të Abrahamit me klasën. Më pas shpjegoni se në verën e vitit 1835, një burrë i quajtur Majkëll Çendlër solli në Kirtland të Ohajos katër mumie egjiptiane dhe disa rrotulla papirusi që përmbanin shkrime të lashta egjiptiane. Anëtarët e Kishës i blenë mumiet dhe rrotullat prej papirusi. Edhe pse metoda e saktë e përkthimit është e panjohur, Profeti Jozef Smith i përktheu disa nga shkrimet në muajt pas blerjes së papiruseve egjiptiane. Duke filluar në mars të vitit 1842, fragmente të librit të Abrahamit u botuan në një gazetë të Kishës të quajtur *Times and Seasons*. Libri i Abrahamit u botua më vonë te Perla me Vlerë të Madhe.

Tregojeni përmbledhjen vijuese rreth ardhjes në dritë të librit të Abrahamit. Ftojini studentët të dëgjojnë për atë që ne e dimë rreth procesit të përkthimit.

Një kundërshtim i zakonshëm ndaj vërtetësisë së librit të Abrahamit është se dorëshkrimet (papuruset) nuk janë mjaft të vjetra që të jenë shkruar nga Abrahami, i cili jetoi pothuajse 2.000 vjet para Jezu Krishtit. Jozef Smithi kurrë nuk shpalli se papiruset ishin shkruar nga vetë Abrahami ose që ato e kishin origjinën nga koha e Abrahamit. "Dokumentet e lashtë shpesh u përcuan si kopje ose si kopje të kopjeve. Anali i Abrahamit mund të ishte redaktuar ... nga shkruar të mëvonshëm, sikurse profetët-historianë të Librit të Mormoni, Mormoni dhe Moroni, rishikuan shkrimet e njerëzve më të hershëm" ("Translation and Historicity of the Book of Abraham", Gospel Topics, lds.org/topics).

Ndërkohë që përkthente, Profeti Jozef Smith mund të ketë punuar me fragmente të papiruseve, të cilat u shkatërruan më vonë. Kështu, "është e padobishme ta vlerësojmë aftësinë e Jozefit për t'i përkthyer papiruset kur ne tani kemi vetëm një pjesë të papiruseve që ai i pati në zotërimin e tij" ("Translation and Historicity of the Book of Abraham"). Është gjithashtu e mundshme që shqyrtimi i kujdesshëm i Jozef Smithit për shkrimet e çoi atë të merrte "zbulesë rreth ngjarjeve dhe mësimave kyçe në jetën e Abrahamit, sikurse ai kishte marrë më përpara një zbulësë rreth jetës së Moisiut, ndërkohë që studioi Biblën" ("Translation and Historicity of the Book of Abraham"). Edhe pse nuk e dimë saktësisht se si Jozef Smithi e përktheu librin e Abrahamit, ne vërtet e dimë që përkthimi u bë nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë.

- Cilët janë disa shembuj të mënyrës se si shkrimet shitesë, të vëna në dispozicion nëpërmjet Profetit Jozef Smith, luajnë rol në kuptueshmërinë tonë të planit të Perëndisë për fëmijët e Tij?

Ju mund të doni të dëshmoni që teksta studentët e studiojnë librin e Abrahamit, i cili është i rëndësishëm nga ana doktrimore, Fryma e Shenjtë do t'iu dëshmojë për rëndësinë dhe vërtetësinë e tij.

Doktrina e Besëlidhje 1:38; 68:3–5

Zbulesa e vazhdueshme vjen nëpërmjet profetëve të gjallë

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 1:38 dhe ftojini një student tjetër të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 68:4. Pyeteni klasën se çfarë mësojnë nga këto fragmente. (Studentët duhet të përcaktojnë parimin vijues: **Kur shërbëtorët e Zotit flasin me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë, fjalët e tyre përçojnë vullnetin e Zotit.**)

- Çfarë përvajash keni pasur që ju bënë të ndiheni mirënjohës që Zoti vazhdon të derdhë zbulesa sot?

Shpjegojuni studentëve se në Kishë, zbulesa të caktuara të profetëve të ditëve të mëvonshme kanonizohen (pranohen si shkrime të shenjta) nëpërmjet ligjit të miratimit të përbashkët (shih DeB 26:1–2). Anëtarëve të Kishës iu kërkohet t'i mbështetin profetin dhe apostujt në shtimin e një zbuluese në shkrimet e shenjta. Për shembull, në konferencën e përgjithshme të tetorit të vitit 1978, anëtarët e Kishës e mbështetën profetin dhe apostujt në shtimin e Deklaratës Zyrtare 2, e cila iu dha priftërinë të gjithë anëtarëve meshkuj të denjë, në kanunin e shkrimeve të shenjta.

Ftojini studentët të kthehen drejt dikujt që është ulur pranë tyre dhe shkurtimisht të diskutojnë atë që mund t'i thonin dikujt, i cili beson se kanuni i shkrimeve të shenjta është i mbyllur dhe ne nuk mund të marrim më shkrime të shenjta shitesë nga Perëndia.

Mbylleni duke iu kërkuar studentëve të mendojnë për atë që mund të bënin për ta forcuar dëshminë e tyre që qiejt janë hapur dhe që Zoti vazhdon t'i zbulojë fjalët e Tij në kohën tonë.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 1:38; 42:56; 45:60–62; 68:3–5; 76:15–19; 93:53; 94:10.
- Xhefri R. Holland, "Fjalët e Mia ... Kurrë s'Pushojnë", *Ensign* ose *Liahona*, maj 2008, f. 91–94.
- "Translation and Historicity of the Book of Abraham", Gospel Topics, [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics).

13

“Vegimi”

Hyrje

Vegimi i dhënë Profetit Jozef Smith, që tani shënohet te Doktrina e Besëlidhje 76, na jep një kuptueshmëri themelore të jetës pas vdekjes, duke përfshirë shkallët e lavdisë. Nga ajo mësojmë atë që

ne duhet të bëjmë për të jetuar sërish në praninë e Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit.

Lexim Konteksti

- L. Tom Perry, “The Plan of Salvation”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2006, f. 69–72.
- Matthew McBride, “The Vision’: D&C 76”, seritë Revelations in Context, 11 mars 2013, history.lds.org.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 76

Kuptueshmëria themelore e jetës pas vdekjes

Shpjegoni se në vitet 1830, shumë të krishterë kishin një nga dy besimet e përgjithshme rreth qiellit dhe ferrit, nganjëherë të përshkruara si pikëpamjet “tradicionale” dhe “universale”. Pikëpamja “tradicionale” ishte thjesht qielli për të drejtët dhe ferri për të pabindurit. Pikëpamja “universale” ishte që Perëndia nuk do t’i ndëshkonte përjetësisht mëkatarët, sepse të gjithë më së fundi do të shpëtoheshin në mbretërinë e Perëndisë. Në këtë kohë, anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit nuk dinin më shumë sesa të krishterët e tjerë rreth qiellit dhe ferrit. Në shkurt të vitit 1832, Jozef Smithi dhe Sidni Rigdoni përjetuan një vegim që e ndryshoi në mënyrë domethënëse kuptueshmërinë dhe atë që besonin shenjtoret e ditëve të mëvonshme mbi jetën pas vdekjes. Ky vegim, i shënuar te Doktrina e Besëlidhje 76, zbuloi një ndërthurje të ndërlikuar të dashurisë, mëshirës, drejtësisë e gjykimit të Perëndisë dhe hapi një portë drejt një pikëpamjeje më të përsosur të planit të Atit Qiellor. Për shumë vjet, anëtarët e hershëm të Kishës iu drejtuan këtij vegimi thjesht si “Vegimi”. (Shih Matthew McBride, “The Vision’: D&C 76”, seritë Revelations in Context, 11 mars 2013, history.lds.org.)

Kërkojini një student të japë një përshkrim të shkurtër të asaj që shënohet te Doktrina e Besëlidhje 76. Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Uillford Udraf (1807–1898) dhe ftojini një student ta lexojë me zë të lartë:



“Unë marr parasysht që Doktrina e Besëlidhje [përmban] shpalljet më të perëndishme, të bëra ndonjëherë për familjen njerëzore. Do t’i drejtohem ‘Vegimit’ [te seksioni 76] vetëm, si një zbulues që na jep më shumë dritë, më shumë të vërtetë dhe më shumë parim sesa ndonjë zbulues që përmbahet në ndonjë libër tjetër që e lexuam ndonjëherë. Ajo e bën të qartë për kuptueshmërinë tonë gjendjen tonë të tanishme, nga erdhëm, përse jemi këtu dhe ku do të shkojmë. Çdo njeri mund ta dijë nëpërmjet asaj zbuluese se cila do të jetë pjesa dhe gjendja e tij” (*Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff* [2004], f. 120–121).

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë hyrjen e seksionit për Doktrinën e Besëlidhjet 76. Kërkojini një student tjetër të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 76:15–19.

- Çfarë po bënin Jozefi dhe Sidni që solli si rrjedhojë marrjen e këtij vegim?
- Çfarë mund të mësojmë nga përvoja e tyre rreth vlerës së studimit dhe përsiatjes së shkrimeve të shenjta? (Sigurohuni që studentët të dallojnë lidhjen midis meditimit për shkrimet e shenjta dhe marrjes së zbulësës.)

Shënim: Theksoni se të mësuarit për të përsiatur shkrimet e shenjta është një aftësi e vlefshme e studimit të shkrimeve të shenjta, e cila i jep Frymës së Shenjtë mundësi më të madhe për të na zbuluar të vërtetën.

Doktrina e Besëlidhje 76:1–10

Premtime për besnikët

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 76:1–4. Vëreni klasën ta ndjekë, duke kërkuar fjalë dhe fraza që përshkruajnë Jezu Krishtin. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët ta shenjojnë atë që gjejnë. Shpjegoni se vetitë e Shpëtimtarit, të përshkruara në këto vargje, janë një shembull i një liste të shkrimeve të shenjta. Një listë e shkrimeve të shenjta “është një varg mendimesh, idesh ose udhëzimesh që kanë lidhje ndërmjet tyre. Të kërkuarit për lista në shkrimet e shenjta mund t’i ndihmojë mësuesit dhe studentët të dallojnë pikat kyçe që po i thekson autori” (*Mësimdhënia dhe të Mësuarit e Ungjillit* [2012], f. 23). Vini në dukje se Doktrina e Besëlidhje 76 përmban një numër listash të shkrimeve të shenjta.

- Cilat prej tipareve të Jezu Krishtit, të përmendura te vargjet 1–4, janë më domethënëset për ju? Përse?

Vëreni studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 76:5–10, duke kërkuar premtimet e Zotit për besnikët. Ftojini studentët të vënë re listën e premtimeve te vargjet 6–10. Ju mund të sugjeroni që studentët t’i shenjojnë gjërat në listën e tyre për t’i theksuar premtimet e Zotit.

- Sipas vargut 5, çfarë duhet të bëjmë për ta përjetuar mëshirën, hirësinë dhe nderin e Shpëtimtarit?

Ndihmohuni studentët të përcaktojnë parimin vijues nga studimi i tyre për këto vargje: **Kur e kemi frikë Zotin dhe i shërbejmë Atij me drejtësi, Ai do të na nderojë dhe do të jetë i mëshirshëm ndaj nesh.** Kujtojnë studentët se në këtë kontekst, të kesh “frikë” Zotin do të thotë ta nderosh Atë.

Që t’i ndihmoni studentët ta thellojnë kuptueshmërinë e tyre për këtë parim, bëni pyetjet vijuese:

- Nga premtimet që i përcaktuat prej vargjeve 5–10, cilin do të pëlqenit ta merrnit në mënyrë të veçantë? Përse?
- Çfarë mendoni se do të kishit nevojë të bënit për ta marrë atë bekim?


Jepuni studentëve një çast për të përsiatur përse do të ishte e vlefshme që të përpiqeshin për këto bekime dhe që të vlerësonin se sa mirë po e nderonin Zotin dhe po i shërbenin Atij me drejtësi e vërtetësi.

U vini në dukje studentëve që duke filluar me vargun 11, pjesa e mbetur e seksionit 76 shënon zbulësën e Zotit për “misteret e mbretërisë së tij”, të cilat e “tejkalojnë çdo zgjuarsë në lavdi” (vargu 114). Zbulësia hap për të kuptuarin tonë mrekullitë e përjetësisë, duke na mësuat rreth jetës që do të vijë dhe duke na bërë të njohur atë që kishte qenë e panjohur më parë.

Doktrina e Besëlidhje 76:19–24

Vegimi i Atit dhe Birit

Shpjegoni se Doktrina e Besëlidhje 76 përmban një seri vegimesh. Për t'iu dhënë studentëve një përmbledhje të asaj që Jozef Smithi dhe Sidni Rigdoni e panë në këto vegime, paraqitni figurën shoqëruese ose i siguron çdo studenti një kopje. Shpjegoni se secili objekt në tabelë përqendrohet te një vegim.



Vini në dukje se një nga vegimet që iu hap Jozef Smithit dhe Sidni Rigdonit atë ditë, ishte një vegim i Atit dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit. Paraqitni pyetjet vijuese ose shkruajini ato në tabelë:

Çfarë të vërtetash mësojmë rreth Jezu Krishtit nga kjo zbulesë?
Për cilën prej këtyre të vërtetave mund të dëshmoni? Si e dini që ato janë të vërteta?

Ftojini studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 76:19–24 dhe të marrin parasysh se si ata do t'iu përgjigjeshin pyetjeve në tabelë. Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini studentët të tregojnë përgjigjet e tyre ndaj pyetjeve. Përgjigjet e studentëve mund të ndryshojnë, por sigurohuni që ata i kuptojnë parimet vijuese. **Jezu Krishti është një qenie e gjallë, e përlëvdur. Jezu Krishti është i Vetëmlinduri i Atit. Jezu Krishti është Krijuesi i kësaj bote dhe i botëve të tjera. Banorët e kësaj bote dhe të botëve të tjera janë bij e bija të lindura të Perëndisë.**

Merrni parasysh të tregoni dëshminë tuaj për Shpëtimtarin.

Doktrina e Besëlidhje 76:25–113

Plani i shpëtimit

Shpjegoni se vargjet 25–113 të seksionit 76 na mësojnë të vërteta të mrekullueshme rreth planit të shpëtimit. Ftojini studentët të zgjedhin një grup nga këto vargje siç renditen në tabelë dhe t'iu lexojnë ato me të shpejtë. Ndajini studentët në dyshe dhe kërkojuni që të diskutojnë atë që mësuani ose atë që e gjetën të ishte frymëzuese në vargjet që lexuan. Më pas diskutojeni pyetjen vijuese si klasë:

- Cilat doktrina themelore rreth jetës e vdekjes na ndihmon t'iu kuptojmë Doktrina e Besëlidhje 76? (Studentët mund të përdorin fjalë të ndryshme, por sigurohuni që ata e kuptojnë se **te Doktrina e Besëlidhje 76, ne fitojmë një kuptueshmëri themelore të jetës pas vdekjes dhe se çfarë duhet të bëjmë që të jetojmë sërish në praninë e Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit.**)

Shpjegoni se një nga vegimet më të rëndësishme, të dhëna Jozef Smithit dhe Sidni Rigdonit, ishte ai i mbretërisë çelestiale. Ftojini studentët të lexojnë Doktrinën e Besëlidhjet 76:50–53, duke kërkuar një listë të kërkesave për të hyrë në mbretërinë çelestiale. Ju mund të sugjeroni që studentët t'i shenjojnë ose t'i shënojnë me numra këto kërkesa në shkrimet e tyre të shenjta. Pasi një student tregon atë që ai ose ajo përcaktoi, bëni pyetje si ato që vijojnë:

- Si mendoni, çfarë do të thotë të merrni një "dëshmi [të] Jezusit"? (Të kini besim në misionin shëlbues të Shpëtimtarit dhe të jetoni sipas urdhërimeve të Tij.)
- Çfarë do të thotë të "k[ini] sukses nëpërmjet besimit"? (Të mposhtni tundimet dhe mëkatet nëpërmjet ushtrimit të besimit te Jezu Krishti dhe të duroni besnikërisht deri në fund.)
- Çfarë do të thotë të "vulosen me anë të Shpirtit të Shenjtë të premtimit"? (Fryma e Shenjtë, që është edhe Shpirti i Shenjtë i Premtimit, i dëshmon Atit që ne i kemi marrë siç duhet ordinancat shpëtuese të ungjillit të Tij dhe që ne i kemi mbajtur besnikërisht besëlidhjet që kemi bërë.)

Përmbliidhni Doktrinën e Besëlidhjet 76:54–70 duke shpjeguar se këto vargje renditin shumë prej bekimeve që do t'i marrin banorët e ekzaltuar të mbretërisë çelestiale. Jepuni studentëve pak çaste që t'i lexojnë me të shpejtë këto vargje, duke kërkuar bekime ose kushte të premtuara që janë veçanërisht domethënëse për ta.

- Cili është një bekim i premtuar besnikëve që ka domethënie të veçantë për ju? Përse?
- Si na ndihmon vargu 69 që ta kuptojmë rolin e Shpëtimtarit në jetën e atyre që e trashëgojnë mbretërinë çelestiale? (Secili prej nesh, pavarësisht nga sa shumë përpiqemi, do të dështojë për ta bërë gjithçka që është e nevojshme për të hyrë në mbretërinë çelestiale. Vetëm nëpërmjet flijimit shlyes të Shpëtimtarit mund të pastrohemi nga mëkatet tona dhe të bëhemi të përsosur.)
- Si mund të na ndihmojë njohja e të vërtetave rreth planit të shpëtimit, të shënuara te Doktrina e Besëlidhje 76, për të bërë zgjedhje më të mira në jetë?

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Bojd K. Paker dhe ftojini një student ta lexojë atë me zë të lartë:



"Pa një njohuri të planit të ungjillit, shkelja duket e natyrshme, e pafajshme, madje e justifikuar. Nuk ka mbrojtje më të madhe nga kundërshtari sesa që ne ta njohim të vërtetën – ta njohim planin!" (*Our Father's Plan* [1994], f. 27).

- Në çfarë mënyrash mund të na ndihmojë njohuria e të vërtetave të gjendura te Doktrina e Besëlidhje 76 për të na mbrojtur nga ndikimi i Satanit?
- Në çfarë mënyrash ju ka mbrojtur e bekuar njohuria juaj për planin e Atit tonë Qiellor?

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 76:114–117. Vëreni klasën ta ndjekë, duke kërkuar premtimin që iu jepet atyre që e pastrojnë veten e tyre. Ftojini studentët të përshkruajnë premtimin në atë fragment.

Pasi studentët përgjigjen, paraqitni thënien vijuese nga Profeti Jozef Smith (1805–1844) në lidhje me vegimin e shënuar te Doktrina e Besëlidhje 76:



"Unë mund të shpjegoja njëqind herë më shumë se sa kam shpjeguar ndonjëherë mbi lavditë e mbretërive që m'u shfaqën në vegimin, nëse do të lejohesha dhe nëse njerëzit do të ishin të përgatitur për t'i marrë ato" (në *History of the Church*, 5:402).

Që t'i ndihmoni studentët ta vënë në jetë atë që mësuan në orën mësimore, paraqitni ose shkruani në tabelë frazat e paplota vijuese:

Pas studimit të Doktrinë e Besëlidhjeve 76:

Unë e di që ...

Unë dua të ...

Unë do të ...

Ftojini studentët t'i plotësojnë këto fraza në një fletë letre. Nxitini ata të marrin parasysh nëse zgjedhjet që po i bëjnë, do t'i kualifikojnë ata për të trashëguar mbretërinë çelësiale dhe do t'i ndihmojnë që të kualifikohen për bekime të tjera, të premtuara te Doktrina e Besëlidhjeve 76. Jepni dëshminë tuaj për të vërtetat e diskutuara në klasë sot.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhjeve 76.
- L. Tom Perry, "The Plan of Salvation", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2006, f. 69–72.

Tempulli i Kirtlandit dhe Çelësat e Priftërisë

14

Hyrje

Pas gati tre vjetësh të vështirësisë dhe sakrificës financiare, Tempulli i Kirtlandit u përkushtua më 27 mars 1836. Dukuri të mrekullueshme e shoqëruan përkushtimin dhe një javë më vonë,

lajmëtarët hyjnorë ua rivendosën çelësat e priftërisë Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit. Këto çelësa janë një tipar dallues i Kishës dhe i kanë bekuar miliona njerëz që janë mbledhur në Kishë.

Lexim Konteksti

- Jeffrey R. Holland, “Our Most Distinguishing Feature”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2005, f. 43–45.
- Dejvid A. Bednar, “Me Nder do të Mbjajë një Emër e Qëndrim”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2009, f. 97–100.
- “Glorious Days in Kirtland, 1834–1836”, kapitulli 13 te *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 153–168.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 109:1–28

Shenjtorët sakrifkuan për të ndërtuar Tempullin e Kirtlandit

Tregojuni studentëve një figurë të Tempullit të Kirtlandit (shih *Libri i Figurave Artistike të Ungjillit* [2009], nr. 117; shih edhe LDS.org). Shpjegoni se shenjtorët punuan dhe sakrifkuan për gati tre vjet që ta ndërtonin Tempullin e Kirtlandit. Duke e bërë këtë, ata dëshmuar përbushjen e premtimit të Zotit që, nëse do t’i zbatonin urdhërimet e Tij, ata do të “k[ishin] fuqi për ta ndërtuar atë” (DeB 95:11). Pothuajse 1.000 njerëz morën pjesë në përkushtimin e tempullit, të mbajtur më 27 mars 1836. Lutja përkushtuese, të cilën Jozef Smithi e mori me anë të zbulesës, shënohet te Doktrina e Besëlidhje 109.

Ftojini dy studentë që të lexojnë me radhë, me zë të lartë nga Doktrina e Besëlidhje 109:1–5. Nxiteni klasën ta ndjekë, duke vënë në dukje veçanërisht frazat që përshkruajnë sakrificat e shenjtorëve për ta ndërtuar tempullin. Më pas bëni pyetjet vijuese:

- Çfarë frazash përdori Jozef Smithi për t’i përshkruar sakrificat e shenjtorëve?

Për t’i ndihmuar studentët të kuptojnë më tej sakrificat e bëra nga shenjtorët, kërkoni një student të lexojë me zë të lartë përmbledhjen vijuese:

Midis qershorit të vitit 1833 dhe marsit të vitit 1836, burra e gra punuan krah për krah për të ndërtuar dhe përfunduar shtëpinë e Zotit. Disa punonin me muret, të tjerë mbartnin gurë, të tjerë turrnin fillin e bënin rroba për punëtorët dhe disa punonin me perdet e shtëpisë së Zotit. Ata e bënë të gjithë këtë “që Biri i Njeriut të mund të [kishte] një vend për t’ia manifestuar vetveten popullit të tij” (DeB 109:5). Disa shenjtorë të ditëve të mëvonshme, si Xhon Tenëri, dhanë shumë prej pasurisë së tyre për ndërtimin e tempullit. Në tërësi, tempulli mund të ketë kushtuar gati 40.000 dollarë amerikanë për t’u ndërtuar – një shumë tepër e madhe për atë kohë. Pavarësisht nga kostoja dhe sakrificat, shenjtorët ishin besnikë në punët e tyre për t’u bindur këtij urdhërimi të Zotit (shih DeB 95:11). Tempulli i Kirtlandit ishte një punë dashurie dhe një ushtrim i bindjes, sakrifkimit dhe besimit.

- Çfarë sakrificash na kërkohet të bëjmë sot me qëllim që të gëzojmë bekimet e tempullit?
- Çfarë bekimesh na vijnë në jetën tonë kur sakrifikojmë për ta kryer punën e Zotit?

Që t’ju ndihmojë për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, paraqitni thënien vijuese nga motra Karol S. Tomas, e Presidencës së Përgjithshme të Të Rejave. Kërkojini një student të lexojë me zë të lartë:



© Busath.com

“Sakrifica është një parim mahnitës. Kur ne me gatishmëri i japim kohën, talentet tona dhe gjithçka zotërojmë, ajo bëhet një nga format tona më të vërteta të adhurimit. Ajo mund të zhvillojë brenda nesh një dashuri të thellë për njëri-tjetrin dhe Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin. Nëpërmjet sakrificës, zemrat tona mund të ndryshohen; ne jetojmë më pranë Shpirtit dhe kemi më pak dëshirë për gjërat e botës” (“Sacrifice: An Eternal Investment”, *Ensign*, maj 2001, f. 64).

Ftojini studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 109:12–13 dhe 20–21, duke kërkuar mënyrën se si natyra e shenjtë e tempullit sugjerohet në këtë lutje. Kërkojuni studentëve të tregojnë për atë që iu ra në sy më shumë në këto vargje.

U thoni studentëve që në lutjen përkushtuese, Jozef Smithi i kërkoi Zotit për bekime të veçanta. Ftojini disa studentë që të lexojnë me radhë, me zë të lartë nga Doktrina e Besëlidhje 109:12–15, 22–28. Nxiteni klasën t’i ndjekë dhe të kërkojë bekimet që mund t’iu vijnë atyre që adhurojnë denjësisht në tempull. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët t’i shenjojnë fjalët dhe frazat që iu bien atyre në sy. Më pas diskutoni pyetjet vijuese:

- Nga bekimet që përcaktuat, cili ka domethënien më të madhe për ju? Përse?
- Çfarë doktrine ose parimi mund të mësojmë nga këto vargje? (Sigurohuni që studentët të përcaktojnë parimin vijues: **Kur adhurojmë me besnikëri në tempull, ne mund të marrim mbrojtje dhe fuqi më të madhe ndaj ligësisë së botës.**)

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftojini një student ta lexojë atë me zë të lartë:



© Bednar.com

“Ju lutem mendoni për [Doktrinën e Besëlidhjet 109:24–28] nën dritën e tërbimit të tanishëm të kundërshtarit dhe ... [të] gatishmëri[së] për të marrë mbi vete emrin e Jezu Krishtit dhe bekimin e mbrojtjes premtuar atyre që me nder mbajnë një emër e qëndrim në Tempullin e Shenjtë. Në mënyrë kuptimplote, këto bekime të besëlidhjes janë për gjithë brezat dhe për gjithë përjetësinë. Unë ju ftoj t’i studioni vazhdimisht dhe t’i meditonin plot lutje nënkuptimin e këtyre shkrimeve të shenjta në jetën tuaj dhe për familjen tuaj.

Ne nuk duhet të çuditemi prej përpjekjeve të Satanit që të ndalojë apo zhvlerësojë adhurimin dhe punën në tempull. Djalli e përbuz dëlirësinë dhe fuqinë e shtëpisë së Zotit. Dhe mbrojtja e disponueshme për secilin prej nesh në dhe përmes ordiancave e besëlidhjeve të tempullit qëndron si një pengesë e madhe për planet e liga të Luciferit” (“Me Nder do të Mbajë një Emër e Qëndrim”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2009, f. 99–100).

- Si e keni ndier një rritje në fuqinë shpirtërore si rezultat i adhurimit në tempull?

Ftojini studentët të përsiatin atë që mund të bënin për të marrë më shumë bekime të premtuara atyre që adhurojnë me besnikëri në tempull. Kujtojini studentët që, teksa i përsiatin shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve, zemrat dhe mendjet e tyre do të jenë më të hapura ndaj frymëzimit nga Zoti.

Doktrina e Besëlidhje 110

Jezu Krishti, Moisiu, Elija dhe Eliasi u shfaqën në Tempullin e Kirtlandit

Shpjegoni se Perëndia i shpërbleu sakrificat e shenjtorëve për të ndërtuar Tempullin e Kirtlandit me një derdhje të manifestimeve shpirtërore në ditët përgjatë përkushtimit. Nëse e lejon koha, tregoni shkurtimisht disa histori që gjenden në kapitullin 13 (“Glorious Days in Kirtland, 1834–1836”) të *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), veçanërisht pjesën e titulluar “A Pentecostal Season” (faqet 164–167). Tregojuni studentëve që ndoshta ngjarja më e rëndësishme e atyre ngjarjeve ndodhi më 6 prill 1836, një javë pas përkushtimit të tempullit.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë kreun e seksionit të Doktrina e Besëlidhje 110 dhe ftojini pjesën tjetër të klasës ta ndjekë. Më pas bëni pyetjet vijuese:

- Kujt iu dha ky vegim? Çfarë ishin duke bërë Jozef Smithi dhe Oliver Kaudëri përpara se të ndodhte ky vegim?

Shpjegojuni studentëve që dhjetë vargjet e para të Doktrinës e Besëlidhjeve 110 përbëjnë një vegim të lavdishëm, të dhënë Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit për Shpëtimtarin, i cili iu shfaq atyre që të shpallte pranimin e Tij për Tempullin e Kirtlandit. Ftojini studentët t’i lexojnë në heshtje këto vargje, ndërkohë që kërkojnë të vërteta të rëndësishme lidhur me Shpëtimtarin si edhe tempullin. Pas një kohe të mjaftueshme, bëni pyetjet vijuese:

- Në këto vargje, çfarë është kuptimplote për ju? Përse?
- Sipas vargut 6, Shpëtimtari shpalli: “Zemrat e gjithë njerëzve të mi duhet të gëzohen”. Si mendoni, përse shenjtorët kishin arsye që të gëzoheshin në atë kohë?

Shpjegoni se pasi mbaroi vegimi i Shpëtimtarit, pasuan një seri vegimesh. Në këto vegime, Moisiu, Eliasi dhe Elija iu shfaqën njëri pas tjetrit Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit.

Shkruajeni sa vijon në tabelë:

Moisiu: Doktrinën e Besëlidhjet 110:11

Eliasi: Doktrinën e Besëlidhjet 110:12

Elija: Doktrina e Besëlidhje 110:13–15

Ndajeni klasën në tri grupe. Caktojini secilit grup një nga emrat në tabelë. Ftojini studentët të studiojnë fragmentin përkatës të shkrimit të shenjtë për të mësuar rreth çelësave të veçantë të priftërisë që u vendosën. Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini studentët të tregojnë atë që gjetën.

Shpjegimet vijuese mund t’iu sigurojnë studentëve një kuptueshmëri më të thellë të asaj që kanë lexuar. Ftojini një student ta lexojë me zë të lartë secilën thënie pasi të diskutoni fragmentin përkatës të saj nga shkrimi i shenjtë:

Moisiu: Çelësat e mbledhjes së Izraelit japin autoritetin për ta drejtuar predikimin e ungjillit drejt të katër cepave të tokës. “Është me vend që Moisiu, i cili i udhëhoqi fillimisht fëmijët e Perëndisë drejt tokës së trashëgimisë së tyre, do të ishte ai që do t’i dorëzonte çelësat e mbledhjes së Izraelit dhe të rivendosjes së Kishës” (Russell M. Nelson, “The Gathering of Scattered Israel”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2006, f. 82, shënimi 28 në fund të faqes).

Eliasi: “Një burrë i quajtur Elias me sa duket jetoi në vdekshmëri në kohën e Adamit, i cili ia dha periudhën e kujdestarisë së ungjillit të Abrahamit Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit në Tempullin e Kirtlandit (Ohajo) më 3 prill 1836” (shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Elias”, f. 40). “Eliasi [e solli] sërish ‘ungjillin e Abrahamit’, besëlidhjen e madhe të Abrahamit nëpërmjet së cilës besnikët marrin premtime për rritje të përjetshme, premtime që nëpërmjet martesës çelësiale pasardhësit e tyre të përjetshëm do të jenë në madhësi po aq të panumërt sa rëra në bregdet ose yjet në qiell” (Bruce R. McConkie, “The Keys of the Kingdom”, *Ensign*, maj 1983, f. 22).

Elija: “Kjo fuqi vulosëse e dhënë mbi Elijan, është fuqia që i lidh bashkëshortët e bashkëshortet dhe fëmijët me prindërit për kohën e përjetshme. Është fuqia lidhëse, që ekziston në çdo ordinancë të Ungjillit. ... Është nëpërmjet kësaj fuqie që të gjitha ordinancat për sa i përket shpëtimit lidhen, ose vulosen, dhe është misioni i Elijas që të vijë dhe ta rivendosë atë” (Joseph Fielding Smith, *Elijah the Prophet and His Mission* [1957], f. 5).

Lexoni me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 110:16 dhe nxitini studentët t’ju ndjekin. Vëriini studentët të përcaktojnë se çfarë iu dha Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit në atë kohë (“çelësat e kësaj periudhe të kujdestarisë”). Më pas bëni pyetjet vijuese:

- Sipas vargut 16, çfarë mund të dimë ngaqë këta çelësa janë rivendosur? (Ardhja e Dytë është pranë.)
- Duke mbajtur në mendje vargun 16, përse çelësat e rivendosur nga Moisiu, Eliasi dhe Elija nevojiteshin të rivendoseshin përpara “dit[ës së] madhe dhe [të] tmerrshme të Zotit”?
- Si jeni bekuar nëpërmjet rivendosjes së këtyre çelësave të priftërisë? (Pas përgjigjeve të studentëve, përmbliidhni rëndësinë e rivendosjes së këtyre çelësave duke e thënë këtë parim: **Çelësat e punës misionare, familjeve të përjetshme dhe punës në tempull na ndihmojnë ta përgatitim veten dhe botën për Ardhen e Dytë të Jezu Krishtit.**)

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftoni një student ta lexojë me zë të lartë:



“Priftëria e Perëndisë, me çelësat e saj, ordinancat e saj, origjinën dhe aftësinë e saj hyjnore për të lidhur në qiell atë që lidhet në tokë, është po aq e domosdoshme për Kishën e vërtetë të Perëndisë sa është e pashoqe për të dhe ... pa të nuk do të kishte asnjë Kishë të Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme” (“Our Most Distinguishing Feature”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2005, f. 43).

Tregoni se si jeta juaj është bekuar ngaqë këta çelësa të priftërisë janë rivendosur. Dëshmoni se çelësat e priftërisë janë një tipar dallues i Kishës; ata e veçojnë Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme nga çdo kishë tjetër mbi tokë.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 109:1–28; 110:1–16.
- Jeffrey R. Holland, “Our Most Distinguishing Feature”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2005, f. 43–45.
- Dejvid A. Bednar, “Me Nder do të Mbajë një Emër e Qëndrim”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2009, f. 97–100.

Gjatë viteve 1837 dhe 1838, një shpirt ankimi, grindjeje dhe braktisjeje u përhap mes disa prej udhëheqësve të Kishës dhe anëtarëve në Kirtland të Ohajos dhe në Misurin verior. Problemet u acaruan kur disa njerëz iu kundërvunë haptazi Profetit Jozef Smith. Nga përvojat e shenjtoreve të hershëm, mund të mësojmë se, ndërkohë që hasim kundërshtim, ne marrim forcë shpirtërore kur jetojmë me drejtësi dhe i mbështetim shërbëtorët e Zotit.

Lexim Konteksti

- “Ruhuni nga Frytet e Hidhur të Braktisjes”, kapitulli 27 te *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 337–348.
- Jeffrey R. Holland, “Lessons from Liberty Jail” (takim shpirtëror i Sistemit Arsimor të Kishës, 7 shtator 2008), [lds.org/broadcasts](https://www.lds.org/broadcasts).
- Nil L. Andersen, “Prova e Besimit Tuaj”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 39–42.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 112:10–15

Braktisja në Kirtland të Ohajos

Shkruani fjalët vijuese në tabelë: *i zemëruar, i fyer, xheloz*. Ftojini studentët të mendojnë për raste kur mund t’i kenë përjetuar këto ndjenja.

Paraqitni tregimin vijues dhe ftojini një student që ta lexojë atë me zë të lartë. Kërkojuni studentëve të përcaktojnë situatën që e bëri Tomas B. Marshin të përjetonte ndjenjat e shkruara në tabelë.

Pak kohë pasi Tomas B. Marshi u thirr të ishte një Apostull në vitin 1835, ai u caktua President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Në pranverën e vitit 1837, Presidenti Marsh mësoi se një nga Dymbëdhjetë Apostujt, Plaku Parli P. Prat, kishte planifikuar një mision për në Angli pa udhëzimin e Presidentit Marsh. Presidenti Marsh, i cili ishte në Misuri, u shkroi Plakut Prat dhe anëtarëve të tjerë të Të Dymbëdhjetëve dhe i ftoi ata të takoheshin me të në Kirtland të Ohajos më 24 korrik 1837, që të mund të bashkërendonin planet e tyre për misionet. Megjithatë, një muaj përpara se të ndodhte mbledhja, dy anëtarë të tjerë të Të Dymbëdhjetëve, Pleqtë Hibër C. Kimball dhe Orson Hajd, u nisën për në Angli pasi morën thirrje misioni nga Profeti Jozef Smith. Presidenti Marsh me sa duket ishte i shqetësuar që anëtarët e Të Dymbëdhjetëve po vazhdonin ta predikonin ungjillin në Angli pa përfshirjen e tij.

- Në këtë gjendje, çfarë mund të kishte bërë Presidenti Marsh që t’i shmangte ndjenjat e renditura në tabelë?
- Cilat janë disa rreziqe të lejimit të këtyre ndjenjave që t’i drejtojnë mendimet dhe veprimet tona? (Tregojuni studentëve se ndjenja të tilla janë fyese ndaj Frymës së Shenjtë dhe shpesh çojnë drejt një mëkati më të rëndë.)

Kërkojuni studentit të vazhdojë të lexojë sa vijon:

Presidenti Marsh ia tregoi shqetësimet e tij Profetit Jozef Smith dhe kërkoi këshillën e tij. Në përgjigje, Zoti dha zbulesën e shënuar te Doktrina e Besëlidhje 112.

Në korrik të vitit 1837, kur Zoti e dha këtë zbuluesë, Kisha po përjetonte përçarje, grindje dhe braktisje. Krenaria dhe lakmia i bëri disa anëtarë të Kishës ta kritikonin haptazi Profetin Jozef Smith dhe të vinin në dyshim autoritetin e tij. Disa anëtarë të Kishës, duke përfshirë Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve, madje kërkuan ta hiqnin Jozef Smithin si Presidentin e Kishës.

- Çfarë ndjenjash i bënë disa anëtarë të Kishës që t'i shpërfillnin dëshmitë e tyre për të vërtetën dhe t'i kundërviheshin haptazi Profetit Jozef Smith?

Ftojini studentët të lexojnë Doktrinën e Besëlidhjet 112:10–12, 15, duke kërkuar këshillën që i dha Zoti Presidentit Marsh dhe anëtarëve të tjerë të Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, e cila mund t'i ndihmojë anëtarët e Kishës që ta shmangin bërjen kritikues ndaj udhëheqësve të tyre.

Kërkojuni studentëve të raportojnë atë që gjejnë. Më pas pyetini:

- Si mund t'i ndihmojë këshilla në këto vargje anëtarët e Kishës që ta shmangin bërjen kritikues ndaj udhëheqësve të Kishës? (Teksa studentët i japin përgjigjet e tyre, ndihmojini të kuptojnë parimet vijuese: **Në qoftë se jemi të përulur, Zoti do të na udhëheqë dhe do të na japë përgjigje për lutjet tona. Zoti kërkon që ne t'i mbështetim ata udhëheqës, të cilët mbajnë çelësat për ta kryesuar Kishën.** Ju mund të sugjeroni që studentët të bëjnë një referencë kryq të vargut 15 me Doktrinën e Besëlidhjet 84:35–38. Ju gjithashtu mund të vini në dukje se këshilla për t'i këshilluar anëtarët e Të Dymbëdhjetëve iu dha Presidentit të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve dhe nuk gjen zbatim për anëtarët individualë të Kishës.)

Jepini secilit student një kopje të fletushkës që gjendet në fund të këtij mësimi. Merrni parasysh ta ndani klasën në grupe të vogla dhe ta ftoni secilin grup që të lexojë së bashku pjesën e titulluar “Braktisja në Kirtland: Nevoja për t'i Ndjekur me Besnikëri Udhëheqësit e Kishës”. Kërkojuni studentëve të diskutojnë pyetjet në fund të pjesës, me grupet e tyre.

Ju mund ta mbyllni këtë pjesë të mësimit duke paraqitur dhe diskutuar thënien vijuese nga Presidenti Hibër C. Kimball (1801–1868), i Presidencës së Parë:



“Do t’ju jap një çelës që Vëllai Jozef Smith ishte mësuar ta jepte në Navu. Ai tha se hapi i parë drejt braktisjes fillonte me humbjen e besimit tek udhëheqësit e kësaj kishe dhe mbretërie dhe se, kurdoherë që ta dallonit atë shpirt, ju mund ta dinit se ai do ta çonte zotëruesin e tij në rrugën drejt braktisjes” (*Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 339).

Për ta theksuar rëndësinë e ndjekjes me besnikëri të profetit dhe udhëheqësve të tjerë të Kishës, lexoni përvojën vijuese nga jeta e Brigam Jangut (1801–1877), i cili ishte në atë kohë një anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Ndërkohë që ishin në Kirtland, Presidenti Brigam Jang u takua me një grup të braktisësve, të cilët po komplotonin kundër Profetit Jozef Smith brenda vetë mureve të tempullit. Ai shpalli: ‘Unë u ngrita dhe në një mënyrë të qartë e bindëse u thashë atyre se Jozefi ishte një Profet dhe unë e dija atë, dhe ata mund ta shanin e përgojnin atë sa të donin, ata nuk mund ta shkatërronin caktimin e Profetit nga Perëndia; ata vetëm mund të shkatërronin vetë autoritetin e tyre, të prisnin lidhjen që i mbante ata të lidhur me Profetin dhe me Perëndinë dhe ta fundosnin veten në ferr’ ” (*Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* [1997], f. 79).

Doktrina e Besëlidhje 121:1–10, 16–17; 122:1–9

Kundërshtimi në Misurin Verior

Merrni parasysh t'i mbani studentët në grupe të vogla dhe ta ftoni secilin grup që të lexojë pjesën e dytë në fletushkë të titulluar "Konflikti në Misurin Verior: Mësimi për ta Duruar Mirë Kundërshtimin". Shpjegoni se kjo pjesë përshkruan disa nga veprimet që i çuan shenjtorët drejt dëbimit nga Misuri verior dhe Profetin drejt mbylljes në Burgun Liberti. Kërkojuni studentëve të diskutojnë pyetjet në fund të kësaj pjese me grupet e tyre.

Pasi studentët ta plotësojnë fletushkën, shpjegoni se Doktrina e Besëlidhje 121–123 përmban përzgjedhje nga një letër që Profeti Jozef Smith ua shkroi shenjtorëve pranë fundit të burgimit të tij në Burgun Liberti.

Kërkojuni studentëve që të lexojnë me radhë, me zë të lartë nga Doktrina e Besëlidhje 121:1–6. Vëriuni studentët të kërkojnë pyetjet që Profeti ia shprehu Zotit.

- Çfarë pyetjesh gjetët?

Ftojuni një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 121:7–10, 16–17; 122:7–9. Vëreni klasën ta ndjekë dhe të mendojë rreth mënyrës se si përgjigjet e Zotit për përgjërimet e Jozef Smithit mund ta kenë forcuar Jozefin për t'i bërë ballë kundërshtimit të vazhdueshëm nga armiqët e tij.

Kërkojuni studentëve të shprehin doktrinën dhe parimet që i mësojnë nga vargjet që lexojnë. (Përgjigjet mund të përfshijnë sa vijon: **Nëse e durojmë kundërshtimin mirë në vdekshmëri, Perëndia do të na bekojë tani dhe në përjetësi. Ata që i akuzojnë shërbëtorët e Zotit, janë shërbëtorë të mëkatit. Ne mund të forcohem në sprovat tona kur mbështetemi te Shlyerja e Shpëtimtarit dhe e kujtojmë shembullin e Tij të durimit me besnikëri.**)

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftojuni një student ta lexojë me zë të lartë:



"Parimisht, provat do të jenë të vështira. Mund të ketë ankth, pështjellim, netë pa gjumë dhe jastëkë të lagur me lotë. Por nuk lypset që provat tona të jenë shpirtërisht fatale. Nuk lypset të na largojnë nga besëlidhjet tona dhe nga familja e Perëndisë. ...

Sikurse zjarri i fortë që e shndërron hekurin në çelik, kur ne qëndrojmë besnikë gjatë provave të zjarra të besimit *tonë*, ne përpunohemi dhe forcohem shpirtërisht" ("Prova e Besimit Tuaj", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 41–42).

Ftojuni studentët të mendojnë rreth asaj që kanë bërë ose do të bëjnë për ta mbajtur mend që Perëndia mund t'i forcojë ata kur përjetojnë sprovat ose kundërshtim ndaj besimit të tyre. U lejoni kohë studentëve që të tregojnë përvojat ose mendimet e tyre rreth mbështetjes së Perëndisë gjatë kohëve të vështira.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 112:10–15; 121:1–10, 16–17; 122:1–9.
- Nil L. Andersen, "Prova e Besimit Tuaj", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 39–42.

Të Qëndruarit të Fortë në Kohë Kundërshtimi

Braktisja në Kirtland: Nevoja për t'i Ndjekur me Besnikëri Udhëheqësit e Kishës

Në vitin 1837, shenjtoret në Kirtland të Ohajos përjetuan disa probleme financiare. Për t'i ndihmuar shenjtoret që të ishin më të mbështetur te vetja lidhur me financat e tyre, Jozef Smithi dhe udhëheqës të tjerë të Kishës themeluan një kompani të ngjashme me një bankë dhe e quajtën atë Shoqëria e Sigurisë së Kirtlandit. Për shkak të një depresioni ekonomik mjaft të përhapur gjatë kësaj kohe, shumë banka dështuan anëmbanë Shteteve të Bashkuara. Edhe Shoqëria e Sigurisë së Kirtlandit dështoi në vjeshtën e vitit 1837. Dyqind investues në bankë humbën pothuajse gjithçka, me Jozef Smithin duke pësuar humbjet më të mëdha. Edhe pse Shoqëria e Sigurisë së Kirtlandit nuk u financua nga Kisha, disa prej shenjtorëve e shihnin atë si një bankë të Kishës ose si bankën e Profetit dhe e fajësuan Jozef Smithin për problemet e tyre financiare. Disa madje filluan ta quanin atë një profet të rënë. Por pavarësisht nga dështimi i bankës, shumë të tjerë, të cilët i humbën paratë, vazhduan me besim dhe qëndruan të vërtetë ndaj Profetit.

Një shpirt i braktisjes dhe ankimit filloi të përhapej mes shumë prej shenjtorëve. Deri në qershor të vitit 1838, përafërsisht 200 ose 300 njerëz braktisën e kishin lënë Kishën, duke përfshirë katër Apostuj, Tre Dëshmitarët e Librit të Mormonit dhe një anëtar të Presidencës së Parë. Megjithatë, shumica e shenjtorëve iu përgjigj kësaj periudhe të vënies në provë me besim, po ashtu siç bëri Brigam Jangu. Ata u forcuan nga Zoti dhe mbetën të vërtetë ndaj dëshmitëve të tyre. Shumë prej atyre që u larguan nga Kisha gjatë kësaj periudhe të braktisjes, më vonë u kthyen dhe kërkuan që të bashkoheshin sërish me Kishën e Zotit. Mes tyre ishin Oliver Kaudëri, Martin Harris, Luk Xhonsoni dhe Frederik G. Uilliamsi.

Në mes të këtyre vështirësive në Kirtland, disa braktisën kërkuan ta vrisnin Jozef Smithin. I paralajmëruar nga Shpirti, ai dhe Sidni Ridgdoni u larguan gjatë natës më 12 janar 1838. Armiqtë e tyre i ndoqën për disa ditë, por Zoti i mbrojt. Ata mbërritën me familjet e tyre në Far-Uest të Misurit më 14 mars 1838.

Diskutoni si grup pyetjet vijuese:

- Çfarë parimesh mund të mësojmë nga këto ngjarje rreth mënyrës se si t'i përgjigjemi kundërshtimit në jetën tonë? Çfarë mund të mësojmë nga këto ngjarje rreth mënyrës se si t'i përgjigjemi kundërshtimit kundër Kishës?
- Çfarë mund të bëjmë që të mbetemi besnikë ndaj udhëheqësve të Kishës edhe pse ne mund të dëgjojmë njerëz të tjerë t'i kritikojnë ata?
- Në çfarë mënyrash jeni bekuar ngaqë ju e keni ndjekur profetin?

Konflikti në Misurin Verior: Mësimi për ta Duruar Mirë Kundërshtimin

Në vitet 1837 dhe 1838, disa anëtarë të pakënaqur dhe të shkishëruar të Kishës, që jetonin mes shenjtorëve në Far-Uest, filluan të ngrinin padi gjyqësore kundër Kishës e udhëheqësve të saj dhe ta ngacmonin Kishën. Në qershor të vitit 1838, Sidni Ridgdoni foli me gjaknxehtësi në atë që është bërë e njohur si "Predikimi i Kripës". Ai përdori Mateun 5:13 dhe tha se, në qoftë se kripa e humbet shijen e saj, ajo nuk shërben më për asgjë dhe duhet të flaket tej, duke nënkuptuar se ata që ishin larguar nga Kisha, duhej të flakeshin nga mesi i shenjtorëve. Dy javë më vonë, më 4 korrik, Sidni Ridgdoni dha një fjalim në të cilin ai premtoi se shenjtoret do ta mbronin vetveten edhe sikur të arrinte te një "luftë e shfarosjes". Edhe pse të dy këto fjalime dukej se kundërshtonin udhëzimin e Zotit që të "bëni[n] apel për paqe" (DeB 105:38), që të dy fjalimet u botuan dhe shkaktuan panik të madh mes njerëzve që nuk ishin shenjtoret të ditëve të mëvonshme.

Gjatë kësaj kohe, një i kthyer në besim i quajtur Sampson Avardi, administroi betime të fshehta ndaj atyre që do të bashkoheshin me të në formimin e një grupi plaçkitësish, të quajtur danitë. Avardi i udhëzoi ata që të vidhnin e plaçkitnin njerëzit e Misurit, duke thënë se kjo do të ndihmonte për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë. Avardi i bindi pasuesit e tij që udhëzimet e tij po vinin nga Presidencia e Parë. E vërteta u zbulua më vonë dhe Avardi u shkishërua. Veprimet e Avardit shkaktuan dëm të

rëndësishëm ndaj idesë për Kishën dhe ndihmuan që të çonin drejt burgimit të Profetit në Burgun Liberti.

Në tetor të vitit 1838, një betejë midis disa anëtarëve të Kishës dhe milicisë së Misurit i la disa njerëz të vdekur nga secila palë. Raporte të tepruara të betejës mbërritën te guvernatori Liburn W. Bogsi, guvernatori i shtetit të Misurit, i cili më pas nxori atë që është bërë i njohur si urdhri i shfarosjes: "Mormonët duhet të trajtohen si armiq dhe *duhet të shfarosen* ose të nxirren jashtë nga shteti, nëse është e domosdoshme, për të mirën e përgjithshme" (cituar te *History of the Church*, 3:175). Shpejt, qyteti i Far-Uestit u rrethua nga një milici që i tejkaloi pesëfish forcat e shenjtorëve. Jozef Smithi dhe udhëheqës të tjerë të Kishës u burgosën në Burgun Liberti, ku ata qëndruan gjithë dimrin. Pjesa tjetër e shenjtorëve u detyruan të largoheshin nga shteti.

Diskutoni si grup pyetjet vijuese:

- Çfarë parimesh mund të mësojmë nga këto ngjarje për të na ndihmuar që ta durojmë më mirë kundërshtimin?
- Përse është e rëndësishme për secilin prej nesh që ta ndjekim shembullin e Shpëtimtarit në kohët e krizës ose të kundërshtimit? Çfarë ndodhi në Misurin verior ngaqë disa prej shenjtorëve nuk e bënë këtë?
- Kur i keni parë fjalët ose veprimet e një njeriu që ta ndikojnë dikë tjetër për të pasur një pikëpamje pozitive për Kishën?

16

Shëlbimi i të Vdekurve

Si pjesë e Rivendosjes së të gjitha gjërave në periudhën ungjillore të plotësisë së kohëve, Zoti e rivendosi doktrinën e shëlbimit të të vdekurve nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Kjo doktrinë u rivendos “rresht pas rreshti”. Puna për shëlbimin e të vdekurve është thelbësore për shpëtimin si të të gjallëve, ashtu edhe të të vdekurve dhe Profeti Jozef Smith na mësoi rëndësinë e pjesëmarrjes në këtë punë: “Përgjegjësia më e madhe në këtë botë që Perëndia ka vendosur mbi ne, është që të kërkojmë të vdekurit tanë” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 508).

Lexim Konteksti

- Riçard G. Skot, “Gëzimi i Shëlbimit të të Vdekurve”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 93–95.
- D. Todd Christofferson, “The Redemption of the Dead and the Testimony of Jesus”, *Ensign*, nëntor 2000, f. 9–12.
- “Të Bëhemi Çlirimtarë në Malin e Sionit”, kapitulli 41 te *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], 501–512.
- Matthew S. McBride, “Letters on Baptism for the Dead: D&C 127, 128”, seritë *Revelations in Context*, 29 maj 2013; history.lds.org.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 137

Vegimi i Profetit Jozef Smith për mbretërinë çelestiale

Tregojuni studentëve sfondin historik vijues:

“Në nëntor të vitit 1823, Alvin Smithi, biri më i madh i Lusi Mek Smithit dhe Jozef Smith Plakut, befas u sëmur rëndë dhe gjendej buzë vdekjes. Alvini ishte 25 vjeç, një i ri i fuqishëm dhe i zoti, puna e madhe e të cilit kontribuoi shumë për qëndrueshmërinë financiare të familjes. Nëna e tij e përshkroi atë si ‘një i ri me mirësi dhe gatishmëri të rrallë’, ‘fisnikëria dhe bujaria’ e të cilit bekuan njerëzit rreth tij ‘për çdo orë të jetës së tij’. ...

Duke e ditur se po vdiste, Alvini thirri pranë vëllezërit e motrat dhe u foli secilit prej tyre. Jozefit, që ishte thujse 18 vjeç dhe nuk i kishte marrë ende fletët e arta, Alvini i tha: ‘Unë dëshiroj që ti të jesh djalë i mirë dhe të bësh gjithçka mundesh për të marrë analet. Të jesh besnik për marrjen e udhëzimit dhe mbajtjen e çdo urdhërimi që të jepet. ...’

Kur vdiq Alvini, familja i kërkoi një shërbestari presbiterian në Palmira të Nju-Jorkut, që të kryente shërbesën në funeralin e tij. Meqenëse Alvini nuk kishte qenë pjesëtar i [grumbullimit] të shërbestarit, kleriku shpalli në predikimin e tij se Alvini nuk mund të shpëtohej. Uilliam Smithi, vëllai më i vogël i Jozefit, kujtoi: ‘[Shërbestari] ... aludoi shumë fuqishëm se [Alvini] kishte shkuar në ferr, sepse Alvini nuk ishte anëtar i kishës, por ai që djalë i mirë dhe babait tim nuk i pëlqeu kjo’” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 429, 431).

- Ngaqë doktrina e shëlbimit të të vdekurve nuk ishte rivendosur në kohën e vdekjes së Alvinit, çfarë shqetësimesh mund të kishte pasur familja Smith rreth shpëtimit të Alvinit?

U thoni studentëve se ky mësim do t’i ndihmojë ata të kuptojnë që Zoti e zbuloi doktrinën e shëlbimit të të vdekurve pjesë-pjesë, rresht pas rreshti. Ftojini studentët të

lexojnë në heshtje kreun e seksionit të Doktrina e Besëlidhje 137. Shpjegoni se kjo zbulesë e parapriu përkushtimin e Tempullit të Kirtlandit me vetëm pak muaj. (Ju mund të vini në dukje se në botimin e vitit 2013 të Doktrinës e Besëlidhjeve, disa ndryshime iu bënë kreut të seksionit 137.)

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 137:1–6, ndërkohë që klasa e ndjek. Diskutoni sa vijon:

- Cilët pa Jozef Smithi në mbretërinë çelestiale? (Studentët mund të jenë të interesuar të dinë që babai dhe nëna e Jozef Smithit ishin gjallë në kohën kur u mor ky vegim; në fakt, babai i Jozefit ishte në dhomë me të kur ndodhi zbulesa.)
- Sipas vargut 6, përse u mrekuulla Jozef Smithi që vëllai i tij, Alvini, ishte në mbretërinë çelestiale? (Ju mund të doni t’u kujtoni studentëve se ky vegim u mor disa vite përpara se Jozef Smithi të mësonte rreth doktrinës së shëlbimit për të vdekurit.)

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 137:7–9. Vëreni klasën ta ndjekë dhe të kërkojë një doktrinë që i ndihmoi shenjtorët e ditëve të mëvonshme ta kuptojnë më mirë planin e Perëndisë për t’i shpëtuar fëmijët e Tij.

- Cila është masa paraprake në planin e Perëndisë për ata njerëz si Alvin Smithi, të cilët vdiqën pa pasur mundësinë për ta pranuar ungjillin e Jezu Krishtit ose ordinancën e pagëzimit? (Teksa studentët i japin idetë e tyre, ndihmohini të përcaktojnë doktrinën vijuese: **Gjithë njerëzit që vdesin pa një njohuri të ungjillit, të cilët do ta kishin pranuar këtë njohuri nëse do ta kishin dëgjuar atë, do të trashëgojnë mbretërinë çelestiale.**)
- Çfarë ju mëson kjo doktrinë rreth karakterit të Atit Qiellor dhe dashurisë së Tij për fëmijët e Tij?
- Kur jeni ngushëlluar nga kjo doktrinë? Kur i keni parë të tjerët, ndoshta ata që i mësuat kur ishit misionar, të marrin ngushëllim nga kuptueshmëria e tyre për këtë doktrinë?

Doktrina e Besëlidhje 124:30–34; 127:5–8; 128:1–18; 138:28–37

Ordinancat mëkëmbëse për të vdekurit

Profeti Jozef Smith për herë të parë foli rreth ordinancës së pagëzimit për të vdekurit në një ceremoni varrimi të Sejmur Bransënit më 15 gusht 1840, pak kohë pasi shenjtorët ishin vendosur në Navu të Ilinoisit. Anëtarët e Kishës u habitën dhe u emocionuan kur mësuan për këtë doktrinë të dhënë në zbulesë. Për disa muaj pas shpalljes, shenjtorët kryen pagëzime në lumin Misisipi aty pranë, në emër të njerëzve të tyre të dashur që kishin vdekur (shih *Mësimet: Jozef Smith*, f. 501; *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të [Church Educational System manual, 2003], f. 251).

- Si i shtoi ky predikim kuptueshmërisë në rritje për planin e Atit Qiellor për t’i shpëtuar fëmijët e Tij? (Teksa studentët përgjigjen, shkruani të vërtetën vijuese në tabelë: **Ordinanca shpëtuese e pagëzimit mund të kryhet për ata që nuk e pranuan ungjillin ndërkohë që ishin në vdekshmëri.**)
- Si mendoni se do të ishit përgjigjur nëse do ta kishit dëgjuar Profetin Jozef Smith të fliste rreth doktrinës së pagëzimit për të vdekurit për herë të parë në këtë periudhë të kujdestarisë ungjillore?

Shpjegoni se gjatë konferencës së përgjithshme të Kishës të tetorit 1841, në Navu të Illinoisit, Profeti Jozef Smith shpalli se Zoti dëshironte që shenjtorët ta ndalnin kryerjen e pagëzimeve për të vdekurit derisa pagëzimet të mund të kryheshin në shtëpinë e Tij (shih DeB 124:29–34). Më 8 nëntor 1841, Brigam Jangu, në atë kohë Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, e përkushtoi vaskën në katin përdhes të Tempullit të pambaruar të Navusë dhe anëtarët e Kishës filluan të kryenin pagëzimet mëkëmbëse në emër të të vdekurve.

Kërkojuni studentëve të lexojnë kreun e seksionit për Doktrinën e Besëlidhjet 127, i cili shpjegon se seksioni 127 është një letër nga Profeti Jozef Smith drejtuar shenjtorëve, duke i udhëzuar ata që të mbanin anale të pagëzimeve që i kryenin për të vdekurit. Shpjegoni se, rreth një javë më vonë, Jozefi shkroi një letër tjetër mbi temën e pagëzimit për të vdekurit, e cila gjendet te Doktrina e Besëlidhje 128.

Shkruani në tabelë referencat vijuese të shkrimeve të shenjta. (Mos e përfshini materialin në kllapa; ai është dhënë për ju, mësuesin.)

Doktrina e Besëlidhje 127:5–7; 128:8 (Kur një ordinancë kryhet nga autoriteti i priftërisë dhe një anal i duhur mbahet, ordinanca lidhet në tokë dhe në qiell.)

Doktrina e Besëlidhje 128:6–7 (Anali i ordinancave mëkëmbëse do të përfshihet mes librave që hapen për t'i gjykuar të vdekurit.)

Doktrina e Besëlidhje 128:15, 17–18 (Shpëtimi i paraardhësve tanë të vdekur është thelbësor për shpëtimin tonë.)

Caktojini studentët të lexojnë secilin prej fragmenteve të shkruara në tabelë. Vërinë ata të kërkojnë doktrinën që i kanë shtuar kuptueshmërisë sonë të planit të Perëndisë për shëlbimin e të vdekurve. Ftojini studentët të përmbledhin doktrinën rreth shëlbimit për të vdekurit, që jepet mësim në secilin fragment të shkrimit të shenjtë. Kërkojuni disa studentëve t'i shkruajnë doktrinën në tabelë pranë fragmenteve. Vini në dukje që zbulesat e shënuara te Doktrina e Besëlidhje 127 dhe 128, shprehin një model të zakonshëm që gjendet në Rivendosjen e ungjillit – Zoti i zbulon të vërtetat rresht pas rreshti, në vend që t'i zbulojë të gjitha njëherësh.

Shpjegojuni studentëve që, shumë vite pasi u morën këto zbulesa, Zoti siguroi kuptueshmëri të mëtejshme për planin e Tij për t'i shëlbuar të vdekurit. Në vitin 1918, Presidenti Jozef F. Smith mori një vegim rreth shëlbimit të të vdekurve. Vegimi erdhi kur ai po përjetonte humbjen e birit të tij, Hajrëm M. Smithit, i cili kishte vdekur më herët atë vit, ndërkohë që shërbente si anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.

Ftojini studentët të lexojnë Doktrinën e Besëlidhjet 138:28–37, duke kërkuar të vërteta që iu zbuluan Presidentit Jozef F. Smith lidhur me shëlbimin e të vdekurve.

- Cilat të vërteta rreth shëlbimit për të vdekurit jepen mësim në këto vargje? (Teksa studentët i thonë të vërtetat që i kanë gjetur, sigurohuni që ata e kuptojnë këtë të vërtetë: **Nën drejtimin e Jezu Krishtit, lajmëtarë të drejtë ua mësojnë ungjillin atyre që janë në burgun e shpirtave.**)
- Si na ndihmojnë këto të vërteta shtesë që të kuptojmë se si dikush, i cili ka vdekur pa i marrë ordinancat e ungjillit, i tillë si Alvin Smithi, mund të marrë një trashëgimi në mbretërinë celestiale?

Lexojeni me zë të lartë thënien vijuese nga Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.



"Si anëtarë të Kishës së rivendosur të Krishtit, ne kemi përgjegjësi besëlidhjeje për të gjetur paraardhësit tanë e t'u sigurojmë ordinancat shpëtuese të ungjillit. 'Ata pa ne nuk mund të bëhen të përsosur' (Hebrenjve 11:40; shih edhe *Mësimet: Jozef Smith*, f. 508). Dhe 'as ne nuk mundemi, pa të vdekurit tanë, të bëhemi të përsosur' (DeB 128:15)" ("Zemrat e Fëmijëve Do të Kthehen", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2011, f. 25).

- Përse duhet të jetë një përparësi në jetën tonë puna e shëlbimit të të vdekurve?
- Si ndihmon sigurimi i ordinancave shpëtuese për të afërmit tanë të vdekur, si për ata ashtu edhe për ne, që të bëhemi të përsosur?

Lexoni me zë të lartë thënien vijuese nga Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



"Ndërkohë që puna në tempull dhe e historisë familjare ka fuqinë për t'i bekuar ata përtej velit, ajo ka një fuqi të barabartë për t'i bekuar të gjallët. Ajo ka një ndikim përmirësues mbi të gjithë ata që përfshihen në të. Ata po ndihmojnë në mënyrë të mirëfilltë për t'i ekzaltuar familjet e tyre" ("Breza të Lidhur me Dashuri", *Ensign* ose *Liahona*, maj 2010, f. 93,94).

- Si dëshmon doktrina e shëlbimit të të vdekurve për arritjen e pafundme të Shlyerjes së Jezu Krishtit?

Lexoni me zë të lartë thënien vijuese nga Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



"Zoti i zbuloi Profetit Jozef Smith doktrinën frymëzuese në lidhje me ordinancën e shenjtë të pagëzimit. Ajo dritë erdhi kur kishat e tjera të krishtera jepnin mësim se vdekja përcaktonte në mënyrë të pakthyeshme dhe të përrjetshme fatin e shpirtit. Ato jepnin mësim se të pagëzuarit shpërbleheshin me gëzim të pafund ndërsa gjithë të tjerët përballëshin me mundim të përrjetshëm, pa shpresë për shëlbim. ...

Kjo doktrinë e lavdishme është një tjetër dëshmi e natyrës gjithëpërfshirëse të Shlyerjes së Jezu Krishtit. Ai e bëri shpëtimin të disponueshëm për çdo shpirt të penduar. Shlyerja e Tij e mposhti vdekjen dhe Ai u lejon të vdekurve të denjë që t'i marrin me mëkëmbës të gjitha ordinancat e shpëtimit" ("Gëzimi i Shëlbimit të të Vdekurve", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 93).

- Çfarë përvojash jua kanë mësuar rëndësinë e pjesëmarrjes në punën e shëlbimit të të vdekurve?
- Si është rritur dëshmia juaj ngaqë keni marrë pjesë në punën e shëlbimit të të vdekurve? (Ftojini disa studentë të japin dëshmitë e tyre.)

Nxitini studentët të marrin parasysh se si mund të merrnin pjesë në punën e madhërishtme të shëlbimit të të vdekurve, qoftë nëpërmjet kërkimit të historisë familjare ose nëpërmjet shërbimit si mëkëmbës në kryerjen e ordinancave të tempullit. Jepni dëshminë tuaj që, nëpërmjet punës së bërë në tempujt bashkëkohorë, të gjithë fëmijët e Atit Qiellor mund të marrin të gjitha ordinancat e nevojshme për shpëtimin.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 124:30–41; 127:1–9; 128:1–18; 137:1–10; 138:28–37.
- Riçard G. Skot, "Gëzimi i Shëlbimit të të Vdekurve", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 93–95.

- D. Todd Christofferson, “The Redemption of the Dead and the Testimony of Jesus”, *Ensign*, nëntor 2000, f. 9–12.

Mësimet e Ungjillit në Navu

17

Disa prej viteve të para që shenjtorët i kaluan në Navu të Illinoisit, u shënuan nga paqja dhe begatia. Gjatë kësaj kohe Jozef Smithi mori zbulesa dhe më pas dha mësim e qartësoi disa doktrina që janë të veçanta për Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Këto përfshijnë qëllimin e tempujve, potencialin tonë hyjnor për t'u bërë si Ati Qellor dhe disa prej doktrinave të dhëna mësim në Nenet e Besimit. Ky mësim do t'i ndihmojë studentët të kuptojnë madhësitë e Profetit Jozef Smith, si edhe vetë potencialin tonë hyjnor.

Lexim Konteksti

- “Perëndia, Ati i Përvetshëm”, kapitulli 2 te *Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 39–46.
- “Doctrinal Developments in Nauvoo”, kapitulli 20 te *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 251–262.
- “Becoming Like God”, Gospel Topics, lds.org/topics.

Sugjerime për Mësimdhënien

Nenet e Besimit

Deklarime të rëndësishme të doktrinave të ungjillit

Shpjegoni se në Navu të Illinoisit, Jozef Smithi i shkroi një letër Xhon Uentuorthit, redaktorit të një gazete të quajtur *Chicago Democrat*, i cili kishte kërkuar informacion rreth mormonëve. Në letër, Profeti dha një tregim të historisë së shenjtorëve të ditëve të mëvonshme së bashku me një listë të përmbledhur të bindjeve doktrinale, që më vonë u bënë të njohura si Nenet e Besimit. (Letra e plotë është riprodhuar te *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 465–476.)

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku L. Tom Peri, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftojeni një student ta lexojë me zë të lartë:



“[Nenet e Besimit] janë midis deklarimeve më të rëndësishme dhe me siguri më të sakta të doktrinës në Kishë. Nëse do t'i përdorni si udhëzues për të drejtuar studimet tuaja të ungjillit të Jezu Krishtit, ju do ta gjeni veten tuaj të përgatitur për t'i shpallur botës dëshminë tuaj për të vërtetën e rivendosur. Ju do të jeni në gjendje të deklaroni në mënyra të thjeshta, të drejtpërdrejta dhe të thella bindjet kryesore që i çmoni shumë si një anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme” (“Doktrinat dhe Parimet që Përbahen në Nenet e Besimit”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2013, f. 48).

- Si do ta përmbledhni atë që na mësoi Plaku Peri? (Teksa studentët i japin thëniet e tyre të përmbledhura, ndihmohuni ata të kuptojnë këtë të vërtetë: **Kur i mësojmë doktrinat e dhëna mësim te Nenet e Besimit, ne do të përgatitemi më mirë për t'ua shpallur bindjet tona të tjerëve.**)
- Kur i keni përdorur Nenet e Besimit që t'i ndihmoni të tjerët ta kuptojnë ungjillin?

Ftojeni klasën që të kthehet te Nenet e Besimit dhe t'i lexojë ato në heshtje. Pas një kohe të mjaftueshme, diskutoni pyetjet vijuese:

- Cilin nen të besimit e vlerësoni veçanërisht dhe përse?
- Si ju ndihmojnë doktrinat në Nenet e Besimit që t'ua rrëfejnë udhën dhe t'ua forcojnë dëshminë tuaj që Jozef Smithi ishte një profet i Perëndisë?

Doktrina e Besëlidhje 124:25–28, 37–42

Rivendosja e ordinancave të tempullit

Shpjegoni se pasi shenjtorët ishin vendosur në Navu të Illinoisit, Profeti Jozef Smith mori një urdhërim për të ndërtuar një tempull. Sikurse me tempullin e ndërtuar në Kirtland të Ohajos, kjo detyrë kërkoi sakrifica të mëdha nga shenjtorët e ditëve të mëvonshme.

Ftojini disa studentë të lexojnë me radhë, me zë të lartë nga Doktrina e Besëlidhje 124:25–28, 37–42. Vëreni klasën t'i ndjekë, duke kërkuar mësimet e Zotit rreth arsyes përse shenjtorëve iu nevojitej një tempull. Përpara se t'i analizoni këto vargje, shpjegoni që ato i drejtohen tabernakullit të ndërtuar nga Moisiu dhe populli i tij. Populli i Moisiut nuk kreu pagëzime për të vdekurit. Asnjë punë për të vdekurit nuk u krye derisa Shpëtimtari e themeloi atë punë në botën e shpirtave pas vdekjes së Tij. Më pas pyetini studentët:

- Sipas mësimëve të Zotit në këto vargje, përse shenjtorët në Navu kishin nevojë për një tempull? (Teksa studentët përgjigjen, theksoni këtë doktrinë: **Ordinanca të caktuara shpëtuese janë të pranueshme nga Zoti vetëm nëse kryhen në tempuj.**)

Shpjegojuni studentëve që Tempulli i Kirtlandit “u ndërtua kryesisht për rivendosjen e çelësave të autoritetit” (Joseph Fielding Smith, *Doctrines of Salvation*, përmb. Bruce R. McConkie, 3 vëll. [1954–1956], 2:242). Në Tempullin e Navusë, këta çelës të priftërisë u përdorën për të kryer ordinanca shpëtuese për të gjallët dhe për pagëzimet mëkëmbëse për të vdekurit. Në dy vitet e fundit të jetës së tij, Jozef Smithi ia paraqiti dhurimin [indaumentin] e tempullit një grupi të vogël anëtarësh besnikë. Ai gjithashtu paraqiti ordinancën e vulosjes së një burri dhe një gruaje së bashku për përjetësinë.

- Cilat ordinanca të tempullit përmenden te Doktrina e Besëlidhje 124:39?

Kërkojini një student të lexojë me zë të lartë thënien vijuese. Ftojini klasën të dëgjojë për arsyen përse ordinancat e tempullit janë të rëndësishme në planin e Atit Qiellor:

“Në përgjigje të urdhit të Zotit [për të ndërtuar një tempull në Navu], Profeti dhe shenjtorët përparuan sa më shpejt që mundën për të filluar që të ndërtonin një shtëpi të Zotit. Por Profeti e kuptoi se për ndërtimin do të duheshin vite dhe ai e dinte se shenjtorëve iu duheshin bekimet e plota të tempullit. Si pasojë, më 4 maj 1842, edhe pse tempulli nuk ishte përfunduar, Jozef Smithi ia administroi indaumentin një grupi të vogël vëllezërish besnikë.

Grupi u mbledh në dhomën e madhe, të sipërme të Dyqanit me Tulla të Kuqe të Profetit. ...

Historia e Profetit shënon: ‘E kalova ditën në pjesën e sipërme të dyqanit, ... në këshill me gjeneralin Xhejms Adams, nga Springfildi, patriarkun Hajrëm Smith, peshkopët Njull K. Uitni e Xhorxh Miler, si dhe presidentin Brigam Jang dhe Pleqtë Hibër C. Kimball e Uillard Riçards, duke i udhëzuar ata për parimet dhe rendin e Priftërisë, kujdesin për larjet, vajosjet, indaumentet [dhurimet] dhe komunikimin e çelësave, që i përkasin Priftërisë Aarone, dhe kështu me radhë te rendi më i lartë i Priftërisë Melkizedeke, duke u paraqitur rendin që i përkiste të Lashtit të Ditëve dhe gjithë ato plane e parime përmes të cilave gjithkush mundësohet që të sigurojë plotësinë e atyre bekimeve që kanë qenë përgatitur për Kishën e të Parëlidurit dhe që vijnë e banojnë në prani të Elohimit në botët e përjetshme’” (*Mësimet: Jozef Smith*, f. 441–442).

Pyetini studentët:

- Përse ishte e domosdoshme rivendosja e ordinancave të tempullit?

Teksa studentët përgjigjen, shtojeni të kuptuarin e tyre nëpërmjet leximit të thënies vijuese nga Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Qëllimi kryesor i tempullit është të sigurojë ordinancat e nevojshme për ekzaltimin tonë në mbretërinë celestiale. Ordinancat e tempullit na udhëheqin te Shpëtimtari ynë dhe na japin bekimet që na vijnë përmes Shlyerjes së Jezu Krishtit” (“Bekimet e Tempullit”, *Ensign*, tetor 2009, f. 48).

- Si është bekuar jeta juaj nëpërmjet rivendosjes së ordinancave të tempullit?

Ftojini studentët të përsiatin gjatë javës së ardhshme se si mund ta bëjnë adhurimin në shtëpinë e Zotit një përparësi më të madhe në jetën e tyre.

Psalmeve 82:6; Mateu 5:48; Gjoni 10:32–34; Romakëve 8:16–17; 2 Pjetër 1:3–4; 1 Gjon 3:2–3; Doktrina e Besëlidhje 93:11–20; 132:20

Potenciali ynë hyjnor

Shpjegoni se Bibla shënon fjalët e profetëve të lashtë, të cilët shkruan për potencialin tonë hyjnor. Shkruajini referencat vijuese të shkrimeve të shenjta në tabelë dhe ftojini studentët të lexojnë disa prej tyre e të kërkojnë atë që na mësojnë ato rreth potencialit tonë hyjnor: Psalmeve 82:6; Mateu 5:48; Gjoni 10:32–34; Romakëve 8:16–17; 2 Pjetër 1:3–4; 1 Gjon 3:2–3. Ju mund t’i nxitni studentët t’i kryqëzojnë referencat ose t’i lidhin ato referenca teksa i studiojnë.

Pas një kohe të mjaftueshme, pyetni:

- Çfarë mund të mësojmë nga këto shkrime të shenjta rreth potencialit tonë?
(Ndonëse mund të përdorin fjalë të ndryshme, studentët duhet të kuptojnë këtë doktrinë: **Si fëmijë të Atit tonë Qiellor, ne kemi potencial të bëhemi si Ai.**)
- Cilat fraza në këto vargje e përshkruajnë potencialin tonë hyjnor?

Shpjegoni se potenciali ynë hyjnor na jepet mësim gjithashtu në shkrimin e shenjtë modern. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 93:11–13, 19–20 dhe Doktrinën e Besëlidhjet 132:20. Ndhimojini studentët të kuptojnë këtë doktrinë: **Sikurse Shpëtimtari, ne mund të rritemi hir pas hiri derisa të marrim prej plotësisë së Atit.**

Shpjegoni se një nga predikimet më domethënëse të Profetit Jozef Smith u dha gjatë një konference të përgjithshme të Kishës në prill të vitit 1844. Gjatë këtij predikimi, Profeti shprehu lavdërim për Vëllanë King Follet, i cili kishte vdekur kohët e fundit. Kjo bisedë ka arritur të njihet si diskutimi i King Folletit. U siguron një kopje të fletushkës “Pjesë të Shkëputura nga Diskutimi i King Folletit” të gjithë studentëve. Ftojini ata që t’i lexojnë pjesët e shkëputura dhe të nënvizojnë fjalë e fraza që shpjegojnë përse ne duhet të kërkojmë që ta kuptojmë karakterin e Perëndisë.



Pjesë të Shkëputura nga Diskutimi i King Folletit

Profeti Jozef Smith (1805–1844) na mësoi:



“Nëse njeriu mëson veçse të hajë, të pijë dhe të flejë, si dhe nuk kupton asnjë nga planet e Perëndisë, këto gjëra i kupton dhe shtaza. Ajo ha, pi, fle dhe nuk di asgjë për Perëndinë; ende ajo di po aq sa ne, përveç se kur ne jemi në gjendje të kuptojmë me anë të frymëzimit nga Perëndia i Plotfuqishëm. Nëse njerëzit nuk kuptojnë karakterin e Perëndisë, ata nuk kuptojnë vetveten. ...

Synimi im i parë është të zbuloj karakterin e të vetmit Perëndi të urtë dhe të vërtetë, si dhe çfarë lloj genieje është Ai. ...

Vetë Perëndia ishte një herë siç jemi ne tani, dhe është një njeri i ekzaltuar dhe ulet i kurorëzuar në qiejt atje lart! Ky është sekreti i madh. Nëse veli do të grisej sot dhe Perëndia i madh, që mban këtë botë në orbitën e saj dhe që mban gjithë botët e gjithë gjërat me fuqinë e Tij, do të bëhej i dukshëm, – ju them, nëse do ta shihnit Atë sot, do ta shihnit Atë me formën e një njeriu – si ju vetë, në të gjithë personin, imazhin dhe vetë formën e një njeriu; sepse Adami u krijua sipas vetë modelit, imazhit dhe ngjashmërisë së Perëndisë dhe mori udhëzim, eci, foli e bisedoi me Atë, ashtu si një njeri flet e komunikon me një tjetër” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 42).

“Kjo, pra, është jeta e përhjetshme – të njohësh të vetmin Perëndi të mençur e të vërtetë; dhe ju duhet të mësoni se si të bëheni ju vetë perëndi dhe të bëheni mbretër dhe priftërinj për Perëndinë, ... duke kaluar nga një shkallë e vogël te një tjetër dhe nga një aftësi e vogël te një e madhe; nga hiri në hir, nga ekzaltimi në ekzaltim, derisa të arrini në ringjalljen e të vdekurve, dhe të jeni në gjendje të banoni në flakët e përhjetshme, dhe të uleni në lavdi, siç e bëjnë ata që ulen në fron në fuqinë e përhjetshme” (*Mësimet: Jozef Smith*, f. 232).

Ndihmohuni studentët t’i analizojnë këto mësimet duke pyetur:

- Përse është e rëndësishme për ne që të mësojmë rreth karakterit dhe natyrës së Perëndisë dhe rreth marrëdhënies sonë me Të si Ati ynë Qiellor?
- Cili është procesi i bërjes si Ati ynë Qiellor?

Për ta thelluar kuptueshmërinë e studentëve për potencialin e tyre hyjnor, paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008). Kërkojini një student i ta lexojë atë me zë të lartë:



“I tërë plani i ungjillit është të na udhëheqë drejt dhe tek arritja më e madhe, madje, më së fundi, te perëndishmëria. Kjo përgjegjësi e madhërishe u shqiptua nga Profeti Jozef Smith në predikimin e King Folletit [shih *History of the Church*, 6:302–317] dhe u theksua nga Presidenti Lorenzo Snow. Është ky koncepti i madhërishe dhe i pakrahasueshëm: *Ashtu siç është Perëndia tani, njeriu mund të bëhet!* [Shih *The Teachings of Lorenzo Snow*, përmb. Clyde J. Williams (1984), f. 1.]

Armiqtë tanë na kanë kritikuar që e besojmë këtë. Përgjigjja jonë është që ky koncept i madhërishe në asnjë mënyrë nuk e zvogëlon Perëndinë, Atin e Përhjetshëm. Ai është i Plotfuqishmi. Ai është Krijuesi dhe Qeverisësi i gjithësisë. Ai është më i madhërishe i të gjithëve dhe gjithmonë do të jetë kështu. Por ashtu siç iu uron cilido atë tokësor bijve dhe bijave të tij çdo sukses në jetë, kështu besoj se Ati ynë në Qiell iu uron fëmijëve të Tij që ata të mund t’i afrohen Atij në shtat dhe të qëndrojnë pranë Tij të shndritshëm, me forcë dhe urtësi të perëndishme” (“Don’t Drop the Ball”, *Ensign*, nëntor 1994, f. 48).

Për ta përmbledhur, bëjuni studentëve pyetjet vijuese:

- Çfarë ndryshimi mund të sjellë në jetën tonë që t’i dimë këto të vërteta të rëndësishme rreth Atit Qiellor dhe potencialit tonë hyjnor?

- Ndërsa reflektoni mbi atë që diskutuam sot (Nenet e Besimit, ordinancat e tempullit dhe potencialin tonë hyjnor), si mund t’ju japë të kuptuarit e këtyre të vërtetave një vlerësim për Profetin Jozef Smith? Si mund t’ju ndihmojë të kuptuarit e këtyre të vërtetave që të kuptoni karakterin e Perëndisë dhe marrëdhënien tuaj me Të si Ati juaj në Qiell? (Jepuni studentëve kohë për t’i shënuar mbresat e tyre me shkrim.)

Ftojini studentët që të dëshmojnë ose të tregojnë disa prej mbresave që i shkruan, në qoftë se ato nuk janë tepër vetjake. Mbylleni mësimin duke dhënë dëshminë tuaj për doktrinat e dhëna në këtë mësim dhe për Profetin Jozef Smith si një zbulues i fuqishëm.

Materiale Leximi për Studentin

- Psalmeve 82:6; Mateu 5:48; Gjoni 10:32–34; Romakëve 8:16–17; 2 Pjetër 1:3–4; 1 Gjon 3:2–3; Doktrina e Besëlidhje 93:11–22; 124:25–28, 37–42; 132:20–24.
- “Perëndia, Ati i Përhjetshëm”, kapitulli 2 te *Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 39–46.
- “Becoming Like God”, Gospel Topics, [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics).

18

Shoqata e Ndhmës dhe Kisha

“Shoqata e Ndhmës i përgatit gratë për bekimet e jetës së përjetshme duke i ndihmuar ato të rriten në besimin dhe në drejtësinë e tyre vetjake, të forcojnë familjet e shtëpitë dhe të ndihmojnë ata që janë nevojtarë” (“Qëllimi i Shoqatës së Ndhmës”, lds.org/callings/relief-society/purposes). Ky mësim do t’i ndihmojë studentët ta kuptojnë më mirë krijimin e Shoqatës së Ndhmës dhe qëllimet e saj. Studentët do të shohin gjithashtu që gratë kanë mundësi dhe përgjegjësi të mëdha në ngritjen e mbretërisë së Perëndisë, të cilat janë të veçanta për to.

Lexim Konteksti

- Dallin H. Ouks, “Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2014, f. 49–52.
- M. Russell Ballard, “Men and Women and Priesthood Power”, *Ensign*, shtator 2014, f. 28–33.
- Xhuli B. Bek, “Vizioni i Profetëve lidhur me Shoqatën e Ndhmës: Besimi, Familja, Ndhma”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2012, f. 83–85.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 25

Udhëzimet e Zotit për Ema Smithin

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Spenser W. Kimball (1895–1985) dhe kërkoni një student të lexojë me zë të lartë:



“Shumica e rritjes së madhe që po i vjen Kishës në ditët e fundit, do të vijë ngaqë shumë prej grave të mira të botës ... do të tërhiqen në Kishë në numër të madh. Kjo do të ndodhë deri në shkallën që gratë e Kishës pasqyrojnë drejtësi dhe qartësi në jetën e tyre dhe deri në shkallën që gratë e Kishës të shihen si të dallueshme dhe të ndryshme – në mënyra të gëzuara – nga gratë e botës” (*Teachings of Presidents of the Church*:

Spencer W. Kimball [2006], f. 222–223).

- Çfarë mendimesh keni ndërsa e merrni parasysh këtë thënie?
- A njihni ndonjë grua që është shembull i lumturisë në të jetuarin e drejtë? Si kanë sjellë ato gra një ndryshim në jetën e atyre që i njohin ato?

Shpjegoni se ky mësim do të përqendrohet mbi mënyrat sipas të cilave Shoqata e Ndhmës i bekon bijat dhe bijtë e Atit Qiellor në Kishën e rivendosur të Jezu Krishtit.

Kërkojuni studentëve të kthehen te Doktrina e Besëlidhje 25 dhe të shohin kreun e seksionit për të gjetur personin të cilit Zoti i foli në këtë zbulesë. Më pas lexoni me zë të lartë vargun 3. Shpjegojuni studentëve që, në sytë e Zotit, Ema Smithi ishte një “zonjë e zgjedhur”. Në mbledhjen e parë të Shoqatës së Ndhmës së Grave në Navu, Jozef Smithi shpjegoi se “e zgjedhur do të thotë të përzgjidhesh për një punë të caktuar”. Ai gjithashtu tha se zbulesa e dhënë Ema Smithit u “përmbush me thirrjen e Motrës Ema në Presidencën e Shoqatës [së Ndhmës]” (në *History of the Church*, 4:552–553). Ndajeni klasën përgjysmë dhe ftojuni gjysmën e klasës të lexojë Doktrinën e Besëlidhjet 25:4–9 dhe gjysmën tjetër të lexojë Doktrinën e Besëlidhjet 25:10–15. Ftojuni studentët të gjejnë detyrat e caktuara ose thirrjet që Zoti ia dha Ema Smithit.

Ata mund të bëjnë një listë të këtyre përgjegjësive ose t'i shenjojnë ato në shkrimet e tyre të shenjta. Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini studentët të tregojnë atë që kanë gjetur.

- Si do të luante rol plotësimi i këtyre përgjegjësive në rritjen e Kishës?
- Çfarë bekimi i premtoi Zoti Ema Smithit nëse ajo ishte e bindur ndaj urdhërimeve të Tij?

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 25:16.

- Ndërkohë që kjo ishte një zbuluesë e dhënë Ema Smithit, në çfarë mënyrash mund të zbatohen fjalët e Zotit drejtuar Emës për ne? (Mësimet rreth bindjes dhe rreth parimeve të tjera të ungjillit, të dhëna mësim në këtë zbuluesë, gjejnë zbatim për çdo njeri. [*Shënim*: Shpjegoni se përqasja e shkrimeve të shenjta ndaj vetë përvojave tona është një aftësi e rëndësishme e studimit të shkrimeve të shenjta, e cila na ndihmon që të kuptojmë ngjashmërinë midis përvojave tona dhe atyre të individëve në shkrimet e shenjta.]

Teksa studentët i japin përgjigjet e tyre ndaj kësaj pyetjeje, ndihmohuni ata të kuptojnë të vërtetën vijuese: **Kur i zbatojmë me besnikëri urdhërimet dhe i përmbushim detyrat që na caktohen nga Zoti, ne vërtet do të marrim një kurorë drejtësie.** Ju mund të doni të dëshmoni për këtë të vërtetë.

Shoqata e Ndihmës është një pjesë e rëndësishme e Kishës së rivendosur të Jezu Krishtit

Thuajuni studentëve se Zoti e zbuloi organizimin e Kishës rresht pas rreshti. Si pjesë e këtij procesi, Ai i dha një thirrje shumë të rëndësishme Ema Smithit. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë përmbledhjen vijuese të organizimit të Shoqatës së Ndihmës. Kërkojuni studentëve të dëgjojnë se si vegimi i Profetit Jozef Smith për Shoqatën e Ndihmës e zgjeroi idenë fillestare të grave.

Në Navu, gratë shenjtoje të ditëve të mëvonshme u bekuan me vetë organizatën e tyre në Kishë. Ajo e pati fillimin e saj kur disa gra, të udhëhequra nga Sara Granxher Kimballi, u organizuan të bënin këmisha për burrat që punonin në tempull. Gratë vendosën të organizoheshin zyrtarisht dhe ato i kërkuan Eliza R. Snout të shkruante një akt themelimi për grupin e tyre. Kur Profetit Jozef Smith iu kërkua këshillë, ai u tha atyre se akti i tyre i themelimit ishte i shkëlqyer, por ai ofroi që t'i organizonte gratë në një mënyrë më të mirë. Më 17 mars 1842, Profeti, së bashku me Pleqtë Xhon Tejlror dhe Uillard Riçards, u takuan me 20 gra në dhomën e sipërme të Dyqanit me Tulla të Kuqe, ku Profeti organizoi Shoqatën e Ndihmës së Grave të Navusë. Ema Smithi u zgjodh si presidentja e organizatës, kështu duke përmbushur zbuluesën që e përcaktoi atë si një "zonjë e zgjedhur" (DeB 25:3). Profeti më vonë tha se qëllimi i organizatës ishte të "lehtësonin të varfrit" dhe të "shpëtonin shpirtra" (*Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 479–480).

Më 28 prill 1842, Profeti u takua sërish me motrat. Ai u tha atyre se ato do të merrnin udhëzim nëpërmjet urdhrit të priftërisë dhe më pas shpalli: "Unë jua dorëzoj çelësin juve në emrin e Perëndisë, dhe kjo Shoqatë do të gëzojë, dhe dije e inteligjencë do të burojë që nga kjo kohë" (*Mësimet: Jozef Smith*, f. 481–482).

Mund t'iu vini në dukje studentëve se ata mund t'i lexojnë procesverbalet e mbledhjeve të hershme të Shoqatës së Ndihmës te josephsmithpapers.org/paperSummary/Nauvoo-relief-society-minute-book.

- Si e zgjeroi vegimi i Profetit për aftësinë e Shoqatës së Ndhmës propozimin fillestar të Sara Kimballit?
- Si mendoni, çfarë do të thotë thënia vijuese nga Profeti Jozef Smith: “Unë jua dorëzoj çelësin juve në emrin e Perëndisë?” (Shoqata e Ndhmës u organizua nën drejtimin e priftërisë nga ata që mbanin çelësat e priftërisë.)

Paraqitni thëniet vijuese nga Motra Zina D. H. Jang (1821–1901) dhe Motra Xhuli B. Bek, ish-presidente të përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës, lidhur me qëllimet e Shoqatës së Ndhmës dhe ftojini tre studentë t’i lexojnë thëniet. Kërkojini klasës t’i ndjekë dhe të marrë parasysh se çfarë na mësojnë këto thënie rreth qëllimeve të Shoqatës së Ndhmës.



“Shoqata e Ndhmës ... u organizua fillimisht rreth gjysmë shekulli më parë, nga Profeti Jozef Smith, sipas modelit të Priftërisë së Shenjtë dhe nën drejtimin e saj, për të shpërndarë bekime materiale ndaj të varfërve dhe nevojtarëve: dhe për t’u dhënë kurajë të dobëtëve, dhe për t’i kufizuar të gabueshmit, dhe për zhvillimin më të mirë, dhe për ushtrimin e ndjenjave të dashamirësisë së grave, dhe për ushtrimin e dashurisë hyjnore, që ajo të mund të ketë mundësinë për të fituar forcë shpirtërore dhe fuqi për të përmbushur mirësi më të madhe në punën e shëlbimit të familjes njerëzore” (Zina D. H. Young, “First General Conference of the Relief Society”, *Woman’s Exponent*, 15 prill 1889, f. 172).



Busath.com

“Profeti Jozef Smith përcaktoi qëllimin e Shoqatës së Ndhmës dhe i udhëzoi motrat për qëllimin e tyre. ... E jona është një organizatë që vazhdon të udhëhiqet sot nga profetë, shikues dhe zbulues” (Xhuli B. Bek, “Shoqata e Ndhmës: Një Punë e Shenjtë”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2009, f. 111).

“Pikërisht ashtu si profetët e Zotit u kanë dhënë mësim vazhdimisht pleqve dhe priftërinjve të lartë për qëllimet dhe detyrat e tyre, ata kanë treguar vizionin e tyre për motrat e Shoqatës së Ndhmës. Nga këshilla e tyre është e qartë se qëllimet e Shoqatës së Ndhmës janë për të rritur besimin e drejtësinë vetjake, për të forcuar familjen e shtëpinë dhe për të kërkuar e ndihmuar ata në nevojë. *Besim, familje dhe ndihmë* – këto tri fjalë të thjeshta kanë arritur të shprehin vizionin e profetëve për motrat në Kishë” (Xhuli B. Bek, “Vizioni i Profetëve lidhur me Shoqatën e Ndhmës: Besimi, Familja, Ndhimja”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2012, f. 83).

- Në ç’mënyrë qëllimet e Shoqatës së Ndhmës e bekojnë të gjithë Kishën? (Studentët duhet të përcaktojnë të vërtetën vijuese: **Shoqata e Ndhmës përpiqet të rritë besimin dhe drejtësinë vetjake, t’i forcojë familjet e shtëpitë dhe të sigurojë ndihmë nëpërmjet të kërkuarit e të ndihmuarit të njerëzve nevojtarë.** E tërë Kisha bekohet kur gratë i përmbushin këto qëllime.)
- Si e keni parë Shoqatën e Ndhmës t’i përmbushë qëllimet e saj?

Shfaqeni thënien vijuese dhe kërkojini një studentit ta lexojë atë me zë të lartë:

“Profeti Jozef Smith shpalli: ‘Kisha nuk qe kurrë e organizuar përsosmërisht derisa gratë u organizuan kështu’ [*Mësimet: Jozef Smith*, f. 481]. ...

Përveç Jozef Smithit, profetë të tjerë të ditëve të mëvonshme kanë dëshmuar se organizata e Shoqatës së Ndhmës është një pjesë e frymëzuar e Rivendosjes, nëpërmjet së cilës gratë në Kishë thirren në pozita kishtare për t’i shërbyer njëra-tjetrës dhe për ta bekuar të gjithë Kishën. Presidenti Jozef F. Smith ... tha: ‘Kjo organizatë është krijuar në mënyrë hyjnore, është autorizuar në mënyrë hyjnore, është themeluar në mënyrë hyjnore, është shuguruar në mënyrë hyjnore nga Perëndia për të shërbyer

për shpëtimin e shpirtrave të grave dhe të burrave' [*Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 184]" (*Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* [2011], f. 7).

- Çfarë na mëson kjo thënie rreth rolit që Shoqata e Ndhmës luan në Rivendosjen e ungjillit? (Ndërkohë që studentët përgjigjen, sigurohuni që ata ta kuptojnë këtë të vërtetë, edhe nëse ajo shprehet me fjalë të ndryshme: **Shoqata e Ndhmës është një pjesë e frymëzuar e Rivendosjes së Kishës së Jezu Krishtit**. Shkruajeni këtë të vërtetë në tabelë.)
- Si sjell ndryshim në jetën tuaj njohuria se organizata e Shoqatës së Ndhmës është pjesë e Rivendosjes?
- Si ndihmon pjesëmarrja e grave në thirrjet në Kishë që Kisha të jetë "e organizuar përsosmërisht"?

Gratë dhe Priftëria

Shpjegojuni studentëve se ka disa njerëz që e vënë në pyetje përse gratë nuk shugurohen në detyra të priftërisë. Theksoni se, ndërkohë që nuk e dimë përse gratë nuk shugurohen në detyra të priftërisë, ne vërtet e dimë se gratë marrin pjesë në priftërinë nëpërmjet thirrjeve të tyre të Kishës dhe në shtëpitë e tyre.

Shpërndajini secilit student një kopje të thënies vijuese nga Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe kërkojini një student të lexojë atë me zë të lartë. Ftojini studentët të përcaktojnë mënyra sipas të cilave gratë mund ta ushtrojnë autoritetin e priftërisë:

Gratë dhe Priftëria

Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha:



"Në një fjalim drejtuar Shoqatës së Ndhmës, Presidenti Jozef Filding Smith, në atë kohë Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha këtë: Ndërsa motrave nuk iu është dhënë Priftëria, nuk iu është dhuruar atyre, kjo nuk do të thotë se Zoti nuk u ka dhënë atyre autoritet. ... Një njeri mund të ketë autoritet të dhënë atij ose një motër [autoritet] të dhënë asaj, për të bërë gjëra të caktuara në Kishë, të cilat janë lidhëse dhe tërësisht të nevojshme për shpëtimin tonë, siç është puna që motrat tona bëjnë në Shtëpinë e Zotit. Ato kanë autoritet të dhënë atyre për të bërë disa gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme, të shenjta për Zotin, dhe lidhëse, në mënyrë po aq tërësore sa ç'janë bekimet që jepen nga burrat që mbajnë Priftërinë' [*Relief Society – An Aid to the Priesthood*, *Relief Society Magazine*, janar 1959, f. 4].

Në atë fjalim të shquar, Presidenti Smith tha në mënyrë të përsëritur se grave u është dhënë autoritet. Grave ai u tha: 'Ju mund të flisni me autoritet, sepse Zoti ka vendosur autoritet mbi ju'. Ai gjithashtu tha se Shoqatës së Ndhmës 'i [është] dhënë fuqi dhe autoritet për të bërë shumë gjëra të madhërishe. Puna që ato bëjnë, bëhet nëpërmjet autoritetit hyjnor.' Dhe, sigurisht, puna e Kishës, e bërë nga burra ose gra, qoftë në tempull apo në lagjet ose degët, bëhet nën drejtimin e atyre që mbajnë çelësa të priftërisë. Kështu, duke folur për Shoqatën e Ndhmës, Presidenti Smith shpjegoi: '[Zoti] ua ka dhënë atyre këtë organizatë të madhërishe ku ato kanë autoritet për të shërbyer nën drejtimin e peshkopëve të lagjeve, duke u kujdesur për interesin e njerëzve tanë si shpirtërisht ashtu dhe materialisht' [*Relief Society – An Aid to the Priesthood*, f. 4–5]. ...

Ne nuk e kemi zakon të flasim për gratë që të kenë autoritetin e priftërisë në thirrjet e tyre në Kishë, por çfarë autoriteti tjetër mund të jetë ai? Kur një grua – e re apo e moshuar – veçohet për të predikuar ungjillin si një misionare kohëplotë, asaj i jepet autoritet priftërie për të kryer një funksion priftërie. E njëjta gjë është e vërtetë kur një grua veçohet për të vepruar si nëpunëse ose mësuese në një organizatë të Kishës, nën drejtimin e një personi që mban çelësat e priftërisë. Kushdo që vepron në një detyrë ose



thirrje të marrë nga një njeri që mban çelësat e priftërisë, ushtron autoritet priftërie në kryerjen e detyrave të caktuara atij ose asaj” (“Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë”, *Ensign ose Liahona*, maj 2014, f. 51).

- Çfarë të vërtetash rreth roleve dhe përgjegjësive të grave në Kishë i mësoni nga Plaku Ouks? Teksa studentët i japin përgjigjet e tyre, sigurohuni që ata e kuptojnë këtë të vërtetë: **Kur gratë veçohen për të shërbyer në Kishë, ato marrin autoritetin priftëror për t’i kryer përgjegjësitë e tyre.**)

Për ta thelluar kuptueshmërinë e studentëve dhe ndjenjat e tyre rreth të vërtetave që kanë diskutuar në klasë, ndajini studentët në dyshe dhe kërkoni atyre të diskutojnë sa vijon:

- Si mund ta përmirësojmë atë që themi rreth grave në Kishë, që të pasqyrojë rëndësinë e vërtetë të ndihmesave të tyre?

Ftojini studentët të tregojnë ndjenjat e tyre rreth ndikimit të grave dhe rreth punës që ato bëjnë si dishepulle në mbretërinë e Zotit. Nxitini studentët të veprojnë sipas asaj që kanë ndier gjatë mësimit, në mënyrë të veçantë duke e lartësuar rëndësinë e Shoqatës së Ndhmës në jetën e tyre.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 25
- Dallin H. Ouks, “Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë”, *Ensign ose Liahona*, maj 2014, f. 49–52.
- Xhuli B. Bek, “Vizioni i Profetëve lidhur me Shoqatën e Ndhmës: Besimi, Familja, Ndhma”, *Ensign ose Liahona*, maj 2012, f. 83–85.

Doktrina e Martesës dhe Familjes së Përjetshme

19

Ungjilli i Jezu Krishtit thekson doktrinën që martesë dhe familja shugurohen nga Perëndia. Profeti Jozef Smith dha mësim se çiftet e martuara mund të vazhdojnë si bashkëshort e bashkëshorte pas Ringjalljes. Zbulesa nga Zoti shpjegon se “besëlidhja e re dhe e përjetshme e martesës” (DeB 131:2) është e domosdoshme me qëllim që të merret ekzaltimi. Ky mësim do t’ua bëjë të qartë studentëve se, që një martesë të zgjatë për përjetësinë, një çift duhet të vulojë nga dikush që mban çelësat e priftërisë dhe më pas të jetojnë me drejtësi.

Lexim Konteksti

- Rasëll M. Nelson, “Martesa Çelestiale”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2008, f. 92–95.
- David A. Bednar, “Marriage Is Essential to His Eternal Plan”, *Ensign*, qershor 2006, f. 82–87.
- Joshua J. Perkey, “Why Temple Marriage?” *New Era*, gusht 2013, f. 30–32.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 49:15–17; 131:1–4

“Besëlidhja e re dhe e përjetshme e martesës”

Shënim: Kur e jepni këtë mësim, jini të vëmendshëm që ju mund të keni studentë të cilët kanë pasur një jetë familjare të vështirë ose kanë përjetuar ligështim apo dhembje në lidhje me martesën dhe pasjen e fëmijëve. Mbani parasysh nevojat e këtyre studentëve teksa përgatiteni dhe e jepni mësimin tuaj.

Thuajuni studentëve se, në vitin 1831 në Kirtland të Ohajos, Liman Kopli u bashkua me Kishën. Ai kishte qenë anëtar i Shoqatës së Bashkuar të Besimtarëve në Shfaqjen e Dytë të Krishtit, zakonisht të quajtur shejkëra për shkak të mënyrës së tyre të adhurimit, e cila përfshinte tundjen e trupave të tyre teksa këndonin, kërcenin dhe përplasnin duart sipas muzikës. Ndërkohë që Liman Kopli e besoi ungjillin, ai gjithashtu i besonte akoma disa prej mësimëve të shejkërve. Ai e vizitoi Jozef Smithin dhe, si rrjedhim i vizitës, Zoti i dha Jozefit zbulesën tani të njohur si Doktrina e Besëlidhje 49 më 7 maj 1831. (Krerët e seksioneve në botimet më të hershme të Doktrinës e Besëlidhjeve e dhanë këtë datë si mars 1831. Historianët kanë vërtetuar kohën e fundit se një datë më e saktë është 7 maj 1831.)

Shejkërat e mohonin martesën dhe besonin në të jetuarin e një jete të beqarisë së plotë (duke hequr dorë tërësisht nga marrëdhëniet seksuale). Zoti e korrigjoi këtë doktrinë të rreme në zbulesën dhe gjithashtu i urdhëroi Liman Koplin dhe të tjerë t’ua predikonin ungjillin shejkërve.

Ftojini studentët të lexojnë Doktrinën e Besëlidhjet 49:15–17, duke kërkuar atë që Zoti tha rreth rëndësisë së martesës e familjes. Pyetni:

- Sipas këtyre vargjeve, çfarë na mëson Zoti rreth martesës? (Studentët duhet të përcaktojnë doktrinën vijuese: **Martesa midis një burri dhe një gruaje shugurohet nga Perëndia.**)
- Çfarë mendoni se do të thotë që martesë shugurohet nga Perëndia “që toka të mund të përmbushë qëllimin e krijimit të saj”? (Përgjigjet e studentëve mund të përfshijnë të vërtetat vijuese: **Bashkëshortët e bashkëshortet urdhërohen të**

kenë fëmijë. Toka u krijua që të siguronte një vend ku fëmijët e Perëndisë të mund të jetonin si familje.)

- Si mund të na ndihmonte një kuptueshmëri e të vërtetave të dhëna mësim në këto vargje që të shpjegojmë mësimet e Kishës rreth martesës?

Shpjegoni se vite më pas, kuptueshmëria e shenjtoreve për rëndësinë e doktrinës së martesës dhe familjes së përjetshme u rrit në mënyrë të rëndësishme. Më 16 maj 1843, Jozef Smithi udhëtoi drejt Ramusit në Illinois. Teksa qëndronin në shtëpinë e Beniamin dhe Melisa Xhonsonit, Profeti u dha mësim atyre rreth martesës së përjetshme. Disa nga udhëzimet e profetit të dhëna në Ramus shënohen te Doktrina e Besëlidhje 131. Ftojani një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 131:1–4 dhe më pas pyetni:

- Çfarë duhet të bëjmë me qëllim që të fitojmë shkallën më të lartë të mbretërisë çelestiale? (Studentët duhet të përcaktojnë doktrinën vijuese: **Me qëllim që të fitojmë shkallën më të lartë të mbretërisë çelestiale, ne duhet të hyjmë në besëlidhjen e re dhe të përjetshme të martesës.** Shpjegoni se fjala *e re* në këtë kontekst do të thotë që kjo zbulësë u rivendos sërish në periudhën tonë të kujdestarisë ungjillore. Termi *e përjetshme* do të thotë që kjo besëlidhje gjithmonë ka ekzistuar dhe do të vazhdojë të durojë përmes përjetësisë. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët t'i shkruajnë këto përkufizime në anë të faqes së shkrimeve të tyre të shenjta.)
- Në kohën tonë, si hyjnë një burrë e një grua në këtë “besëlidhje [të] re dhe [të] përjetshme të martesës”?

Theksoni se burrat dhe gratë mund të hyjnë në besëlidhjen e re dhe të përjetshme të martesës vetëm brenda tempujve të shenjtë. Individët që martohen jashtë tempullit, mund të përfshijnë terma të tillë si “të martuar për kohën e përjetësinë” në betimet e tyre të martesës, por Perëndia nuk do t'i nderojë këto martesa në përjetësi.

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ftojani një student ta lexojë me zë të lartë. Nxitini studentët të kërkojnë atë që Plaku Nelson na mësoi rreth arsyes përse martesa e përjetshme është kaq e rëndësishme:



“Tema e martesës debatohet anëmbanë botës, ku mënyra të ndryshme ekzistojnë për jetën bashkëshortore. Qëllimi im që të flas për këtë temë, është të shpall, si një Apostull i Zotit, se martesa midis një burri dhe një gruaje është e shenjtë – ajo shugurohet nga Perëndia. Unë gjithashtu ripohoj virtytin e një martese në tempull. Ajo është lloji më i lartë dhe më i durueshëm i një martese që Krijuesi ynë mund t’ua ofrojë fëmijëve të Tij.

Ndërsa shpëtimi është një çështje individuale, ekzaltimi është një çështje familjare. ...

... Që të kualifikohemi për jetë të përjetshme, ne duhet të bëjmë një besëlidhje të përjetshme dhe të përhershme me Atin tonë Qiellor [shih DeB 132:19]. Kjo do të thotë që një martesë tempulli nuk është vetëm midis bashkëshortit e bashkëshortes; ajo përfaqon një bashkëpunim me Perëndinë [shih Mateu 19:6] (“Martesa Çelestiale”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2008, f. 92–93).

- Çfarë mendoni se do të thotë kjo fjali: “Ndërkohë që shpëtimi është një çështje individuale, ekzaltimi është një çështje familjare”?
- Çfarë do të thotë të përfaqosh “një bashkëpunim me Perëndinë” në një martesë të përjetshme? Si mendoni, përse pasja e një bashkëpunimi me Perëndinë në martesë është e rëndësishme? (Vetëm në martesë bën një individ një besëlidhje me një njeri

tjetër dhe me Perëndinë. Të gjitha besëlidhjet e tjera të ungjillit bëhen midis një individi dhe Perëndisë.)

- Si mund ta lartësojë doktrina e rivendosur e martesës dhe familjes së përjetshme dëshirën e një njeriu për të ndërtuar një martesë të dashur dhe afatgjatë?

Plaku Parli P. Prat (1807–1857), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpjegoi ndikimin që njohuria e kësaj doktrine të rivendosur pati tek ai. Ftojini një student të lexojë sa vijon:



"Ishte prej [Jozef Smithit] që mësova se bashkëshortja e gjirit tim mund të më sigurohej për kohën dhe gjithë përjetësinë. ... Ishte prej tij që mësova se ne mund t'i forconim këto dhembshuri dhe të rriteshim e të zhvilloheshim në to për tërë përjetësinë; ndërsa përfundimi i bashkimit tonë të pafundmë do të ishin pasardhës aq të shumtë sa yjet e qiellit ose sa rëra në bregdet. ... Kisha dashuruar më parë, por nuk e dija përse. Por tani dashurova – me një kthjelltësi – një intensitet të një ndjenje të lartësuar, të ekzaltuar" (*Autobiography of Parley P. Pratt*, bot. Parley P. Pratt Jr. [1938], f. 297–298).

Përpara se të vazhdoni me mësimin, mund të jetë e nevojshme të diskutoni shkurtimisht sa vijon:

"Disa anëtarë të Kishës mbeten beqarë jo për faj të tyre, megjithëse ata dëshirojnë të martohen. Në rast se e shihni veten kështu, jini të sigurt se 'të gjitha gjërat bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë' (Romakëve 8:28). Kur qëndroni i denjë, në një ditë të ardhshme, në këtë jetë ose në tjetrën, do t'ju jepet të gjitha bekimet e një marrëdhënieje të përjetshme familjare" (*Të Vërtetë ndaj Besimit: Një Referim për Ungjillin* [2004], f. 86).

Doktrina e Besëlidhje 132:1–21

Martesa celestiale është thelbësore për ekzaltimin

Shpjegoni se rreth dy muaj pasi Jozef Smithi e dha udhëzimin e shënuar te Doktrina e Besëlidhje 131, ai diktoi zbulesën tani të njohur si Doktrina e Besëlidhje 132. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë hyrjen e seksionit për Doktrinën e Besëlidhjet 132. Shpjegoni se praktika e martesës me shumë gra do të diskutohet në mësimin e ardhshëm. Ftojini një student tjetër të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 132:3–6. Vëreni klasën ta ndjekë dhe të përcaktojë fjalë e fraza që sugjerojnë rëndësinë e hyrjes në besëlidhjen e re dhe të përjetshme të martesës. Diskutoni pyetjet vijuese:

- Cilat fjalë e fraza në këto vargje qartësojnë rëndësinë e martesës së përjetshme?
- Cilat janë pasojat e mospranimit të kësaj doktrine? (Ju mund të doni të shpjegoni se fjala *i mallkuar* do të thotë që një njeri ndalohet në përparimin e tij ose të saj të përjetshëm.)

Shënim: Përdorni disa minuta që të vini në dukje rëndësinë e aftësisë së studimit të shkrimeve të shenjta për të dalluar fjalë e fraza kyçe, aftësi të cilën sapo e kanë përdorur me Doktrinën e Besëlidhjet 132:3–6. Është e rëndësishme që të vini në dukje dhe të kuptoni fjalë e fraza kur i studioni shkrimet e shenjta. Te vargjet 3–6, frazat vijuese janë të rëndësishme për t'u kuptuar: "për të pranuar dhe për t'iu bindur", "duhet t'i binden", "nëse nuk i bindeni asaj besëlidhjeje, atëherë jini ju të mallkuar", "askush nuk mund ta mohojë", "duhet dhe do t'i". Disa nga këto fraza janë edhe shembuj të lidhjeve midis ideve në shkrimet e shenjta. Lidhja tregon një marrëdhënie ose një hallkë midis ideve. Për shembull, vargu 3, tregon kushtet midis ideve të përgatitjes, marrjes e bindjes.

Ftojini studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 132:7–8, duke kërkuar kushtet e ligjit të Zotit që bën të mundur për një bashkëshort e një bashkëshorte të jetojnë si një çift i martuar pas kësaj jete.

- Sipas këtyre vargjeve, çfarë kushtesh janë të domosdoshme për një martesë që të durojë përjetësisht? (Teksa studentët përgjigjen, shkruani të vërtetën vijuese në tabelë: **Kur një besëlidhje bëhet nëpërmjet autoritetit të duhur të priftërisë dhe vuloset me anë të Shpirtit të Shenjtë të Premtimit, ajo do të zgjatë përgjithmonë.**)

Jepuni studentëve përkufizimin vijues për Shpirtin e Shenjtë të Premtimit: “Fryma e Shenjtë është Shpirti i Shenjtë i Premtimit (Veprat e Apostujve 2:33). Ai konfirmon si të pranueshme për Perëndinë veprimet, ordinancat dhe besëlidhjet e drejta të njerëzve. Shpirti i Shenjtë i Premtimit i dëshmon Atit se ordinancat shpëtuese janë kryer siç duhet dhe se besëlidhjet që i shoqërojnë ato, janë mbajtur” (Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Shpirt i Shenjtë i Premtimit”, f. 185; ose scriptures.lds.org).

Për t’i ndihmuar studentët ta kuptojnë këtë parim, merrni parasysht të paraqitni thënien vijuese nga Plaku Brus R. Mek-Konki (1915–1985), i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Të vulosësh është të *miratosh*, të *justifikosh*, ose të *aprovosh*. Prandaj një veprim që vuloset me anë të Shpirtit të Shenjtë të Premtimit, është një veprim që miratohet nga Fryma e Shenjtë; është një veprim që aprovohet nga Zoti; dhe njeriu i cili e ka marrë detyrimin mbi vete, justifikohet nga Shpirti në gjënë që ka bërë. Vula miratuese e aprovimit vendoset mbi një veprim vetëm nëse ata që e bëjnë kontratën, janë të denjë si rezultat i drejtësisë vetjake, për të marrë miratimin hyjnor” (*Mormon Doctrine*, bot. i 2-të [1966], f. 361–362).

Zoti vazhdoi të përvijojë kushtet e domosdoshme për martesën e përjetshme dhe bekimet e saj, siç shënohen te Doktrina e Besëlidhje 132:19–21. Caktojini studentët që të punojnë në dyshe për ta studiuar këtë fragment. Kërkojuni dysheve që të bëjnë dy lista: 1) kushtet për një martesë që të jetë e përjetshme dhe 2) bekimet e marra kur këto kushte përmbushen. Kur të plotësohen, listat mund të përfshijnë sa vijon:

Kushtet për një martesë që të jetë e përjetshme

Martesa duhet të kryhet sipas ligjit të Zotit dhe “besëlidh[es së] re dhe [të] përjetshme [të] martesës”.

Martesa duhet të vuloset me anë të Shpirtit të Shenjtë të Premtimit.

Martesa duhet të kryhet nga një njeri i cili mban çelësat e priftërisë.

Çifti i martuar duhet t’i bindet besëlidhjes së Perëndisë.

Bekimet që do të merren

Çifti i martuar do të ngrihet në Ringjalljen e Parë.

Çifti i martuar do të trashëgojë frone, mbretëri, principata, fuqi, sundime dhe të gjitha lartësitë e thellësitë.

Martesa do të jetë e një force të plotë pas vdekjes fizike.

Çifti i martuar do të kalojë pranë engjëjve.

Çifti i martuar do të ekzaltohet dhe do të ketë lavdi në të gjitha gjërat.

Çifti i martuar do të ketë një “vazhdimësi [të] farës përherë” (familja dhe pasardhësit e tyre do të vazhdojnë gjatë gjithë përjetësisë; ata do të kenë rritje të përjetshme).

Çifti i martuar do të jetë që të dy perëndi dhe nuk do të ketë fund.

Çifti i martuar do të jetë mbi të gjitha gjërat dhe do të ketë gjithë fuqinë dhe të gjitha gjërat do t’iu nënshtrohen atyre.

Diskutoni pyetjet vijuese për t’i ndihmuar studentët të kuptojnë më tej kushtet e nevojshme dhe bekimet e premtuara për një martesë të përjetshme:

- Çfarë mendoni se do të thotë të “duron” në besëlidhjen e martesës? (Ju mund të doni të shpjegoni se një kuptim i fjalës *duron* është të qëndroni ose vazhdoni. Ajo gjithashtu do të thotë të jetoni në përputhje me besëlidhjen.)
- Përse vetëm të qenit të vulosur në tempull nuk është i mjaftueshëm për të arritur një martesë të përjetshme?
- Çfarë mendimesh dhe ndjenjash keni kur merrni parasysh atë që Ati Qiellor po ju premtton juve?

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Martesa çelestiale është një pjesë thelbësore e përgatitjes për jetën e përjetshme. Ajo kërkon që një njeri të martohet me personin e duhur, në vendin e duhur, nga autoriteti i duhur dhe t’i bindet asaj besëlidhjeje të shenjtë besnikërisht. Atëherë një njeriu mund t’i jepet siguri për ekzaltimin në mbretërinë çelestiale të Perëndisë” (“Martesa Çelestiale”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2008, f. 94).

- Si do t’ia shpjegoni dikujt që nuk është anëtar i Kishës, rëndësinë e të qenit të martuar “në vendin e duhur, nga autoriteti i duhur”?
- Bazuar në rëndësinë e doktrinës së martesës dhe familjes së përjetshme, çfarë mund të bëni tani që të përgatiteni për një martesë të përjetshme dhe të ndërtoni marrëdhënie të forta?

Ftojini studentët të marrin parasysh atë që mund të kenë nevojë ta ndryshojnë në jetën e tyre që të përgatiten më mirë për një vulosje në tempull ose për t’i mbajtur besëlidhjet që shoqërohen me atë vulosje. Jepni dëshminë tuaj se të kërkuarit e një martese të përjetshme ia vlen sakrificën dhe përpjekjen tonë.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 49:15–17; 131:1–4; 132:1–24.
- Rasëll M. Nelson, “Martesa Çelestiale”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2008, f. 92–95.
- Joshua J. Perkey, “Why Temple Marriage?” *New Era*, gusht 2013, f. 30–32).

20

Martesa me Shumë Gra

Martesa midis një burri dhe një gruaje është ligji i Zotit, në qoftë se Ai nuk urdhëron ndryshe (shih Jakobi [LiM] 2:27–30). Profeti Jozef Smith u urdhërua ta rivendoste praktikën e martesës me shumë gra, e cila u ushtrua në Kishë për më shumë se gjysmë shekulli deri sa Presidenti Uillford Udraf u frymëzua nga Zotit që të mos e vazhdonte praktikën. Martesa me shumë gra ishte një provë e rëndësishme e besimit për Jozef Smithin dhe për shumicën që e ushtruan atë. Teksa studentët ushtrojnë besim, ata mund të arrijnë të dinë se praktika e martesës me shumë gra në ditët e mëvonshme ishte pjesë e Rivendosijes së të gjitha gjërave.

Lexim Konteksti

- “Plural Marriage in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints”, Gospel Topics, lds.org/topics.
- “Plural Marriage in Kirtland and Nauvoo”, Gospel Topics, lds.org/topics.
- “Plural Marriage and Families in Early Utah”, Gospel Topics, lds.org/topics.
- “The Manifesto and the End of Plural Marriage”, Gospel Topics, lds.org/topics.

Shënim: Këto shkrime te Gospel Topics [Temat e Ungjillit] do t’ju sigurojnë më shumë material nga ai që mund ta jepni mësim në kohën e lejuar. Ju lutemi, jini të vëmendshëm për këtë gjë në përgatitjen dhe dhënien e mësimit tuaj.

Sugjerime për Mësimdhënien

Jakobi [LiM] 2:27–30; Doktrina e Besëlidhje 132:1–2, 34–48, 54, 63

Zoti zbuloi praktikën e martesës me shumë gra

Shpjegoni se në vitin 1831, ndërsa Jozef Smithi po punonte me përkthimin e frymëzuar të Dhiatës së Vjetër, të njohur si Përkthimi prej Joseph Smith-it, ai lexoi se disa nga profetët e lashtë praktikuan martesën me shumë gra (gjithashtu e quajtur poligami). Këta profetë përfshinin Abrahamin, Jakobin, Moisiun dhe Davidin. Jozef Smithi studioi dhe përsiati shkrimet e shenjta për të ditur se si këta profetë u shfaqësuan për këtë praktikë (shih DeB 132:1–2). Zoti i zbuloi përgjigjet e pyetjeve të tij në një zbulësë tani të njohur si Doktrina e Besëlidhje 132. Edhe pse data e kësaj zbulëse është 12 korrik 1843, ka të ngjarë që Jozef Smithi po e merrte zbulësën mbi parimet e shënuara në këtë seksion përgjatë kohës, duke filluar që nga viti 1831.

Ftojini disa studentë që të lexojnë me radhë, me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 132:34–36. Vëreni klasën t’i ndjekë, duke kërkuar arsyen përse Abrahami dhe Sara filluan të praktikonin martesën me shumë gra.

- Sipas vargut 34, përse i dha Sara një grua tjetër Abrahamit? Çfarë na mëson kjo rreth praktikës së martesës me shumë gra? (Ndërsa përgjigjen studentët, shkruani parimin që vijon në tabelë: **Martesa me shumë gra është një praktikë e pranueshme vetëm kur Zoti e urdhëron atë.**)

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Jakobin [LiM] 2:27, 30. Theksoni parimin vijues: **Martesa midis një burri dhe një gruaje është standardi i Perëndisë, në qoftë se Ai nuk urdhëron ndryshe.** Vini në dukje se këto vargje gjithashtu përfshijnë një arsye të dhënë nga Zoti për praktikën e martesës me shumë gra – për ta “rri[tur]

farën për [Zotin]”, duke shtuar numrin e fëmijëve të lindur nga prindër besnikë (shih edhe DeB 132:63).

Shpjegoni se Zoti i zbuloi Jozef Smithit, siç shënohet te Doktrina e Besëlidhje 132:37–43, që kur populli i Tij e ushtron martesën me shumë gra, sepse Ai i ka urdhëruar të bëjnë kështu, ata nuk janë fajtorë për mëkatin e shkeljes së kurorës. Megjithatë, kushdo që e ushtron martesën me shumë gra pa marrë një urdhërim nga Zoti nëpërmjet profetit të Tij, është fajtor për shkeljen e kurorës. U vini në dukje studentëve se fjalët *shkatërrohet, shkatërroj* në vargjet 41 dhe 54 do të thonë që ata që i shkelin besëlidhjet e tyre të shenjta, duke përfshirë besëlidhjen e martesës, do të veçohen nga Perëndia dhe nga populli i besëlidhjes së Tij (shih edhe Veprat e Apostujve 3:22–23; 1 Nefi 22:20).

Ftojini studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 132:40 dhe të përcaktojnë një arsye tjetër të dhënë nga Zoti për praktikën e martesës me shumë gra.

- Sipas vargut 40, çfarë do të bënte Zoti në periudhën e fundit të kujdestarisë ungjillore? (Do t’i “rivendos[te] të gjitha gjërat”.)

Shpjegoni se fjalët “të gjitha gjërat” iu referohen ligjeve dhe ordinancave të ungjillit që ishin zbuluar në periudhat e mëparshme të kujdestarisë ungjillore. Shkruani në tabelë të vërtetën vijuese: **Urdhërimi për ta jetuar ligjin e martesës me shumë gra në ditët e mëvonshme ishte pjesë e Rivendosjes së të gjitha gjërave** (shih edhe Veprat e Apostujve 3:20–21).

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 132:45, 48. Vëreni klasën ta ndjekë, duke kërkuar atë që e bëri të mundur për Jozef Smithin që të merrte pjesë në sjelljen e Rivendosjes së të gjitha gjërave. Ndihmojini studentët të kuptojnë parimin vijues: **Martesa me shumë gra mund të autorizohet vetëm nëpërmjet çelësave të priftërisë, të dhëna Presidentit të Kishës.**

Shpërndajini secilit student një kopje të fletushkës që gjendet në fund të mësimit.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë pjesën e parë në fletushkë të titulluar “Martesa me Shumë Gra”.

- Si mund t’ju ndihmojë të kuptuarit se praktika e martesës me shumë gra iu dha me anë të zbulesës Profetit Jozef Smith, që ta kuptoni më mirë ushtrimin e saj në ditët e hershme të Kishës?

Praktika e martesës me shumë gra ishte një provë besimi

Ftojini gjysmën e klasës të lexojë në heshtje pjesën në fletushkë të titulluar “Një Urdhërim i Vështirë”. Vëreni gjysmën tjetër të klasës të lexojë pjesën e titulluar “Një Provë Besimi”. Më pas diskutoni pyetjet vijuese:

- Cilat janë disa arsye përse Profeti Jozef Smith dhe të tjerët mund të kishin qenë ngurrues që ta zbatonin praktikën e martesës me shumë gra?
- Çfarë përjetuan Jozef Smithi, Lusi Uokeri dhe të tjerët që më së fundi i ndihmuan ata t’i kapërcenin vështirësitë e mëdha, me qëllim që të mund ta pranonin e jetonin ligjin e martesës me shumë gra?

Ftojini disa studentë ta lexojnë me radhë, me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “Jozef Smithi dhe Martesa me Shumë Gra”.

Shpjegojuni studentëve se ka shumë gjëra që nuk i dimë rreth praktikës së martesës me shumë gra në Kishën e hershme. Për shembull, kuptueshmëria jonë e tanishme e termit *vulosje* nuk është pikërisht e njëjtë me kuptueshmërinë e këtij termi në vitet



1840, kur praktika e vulosjes ishte ende e re dhe disa aspekte të praktikës nuk ishin kuptuar tërësisht. Ne e dëgjojmë termin *vulosje* dhe automatikisht mendojmë për *martesën*, por për Jozef Smithin dhe shenjtorët e hershëm, *vulosja* nuk do të thoshte gjithmonë *martesë* në kuptimin e plotë, duke nënkuptuar të jetonin së bashku si bashkëshort e bashkëshorte. Shumë hollësi të praktikës së martesës me shumë gra u mbajtën të fshehta dhe analet historike thjesht nuk japin përgjigje për të gjitha pyetjet tona. Nxitini studentët të studiojnë Materiale Leximi për Studentin, të renditura në fund të mësimit për informacion shtesë rreth praktikës së martesës me shumë gra.

Ju mund të doni t'i kujtoni studentët se teksa studiojnë rreth martesës me shumë gra, ata duhet të mbajnë mend modelin që Profeti Jozef Smith ndoqi në mësimin e vet të ungjillit. Ai studioi, përsiati dhe u lut që të fitonte dituri. Ata gjithashtu duhet të mbajnë mend se shumë informacion i pasigurt rreth martesës me shumë gra ekziston në internet dhe në shumë burime të shtypit. Disa autorë, të cilët shkruajnë rreth Kishës dhe historisë së saj, e paraqesin informacionin jashtë përmbajtjes apo ata përfshijnë të vërteta të pjesshme që mund të jenë çorientuese. Qëllimi i disa prej këtyre shkrimeve është që ta shkatërrojnë besimin.

Deklarata Zyrtare 1

Zoti zbuloi se shenjtorët e ditëve të mëvonshme duhej ta ndërprisnin praktikën e martesës me shumë gra

Shpjegoni se praktika e martesës me shumë gra u zgjerua pasi shenjtorët mbërritën në zonën e Jutas dhe pastaj u ndalua më vonë në përputhje me zbuluesin. Kërkojuni studentëve të lexojnë me radhë, me zë të lartë pjesët në fletushkë të titulluara “Kundërshtimi ndaj Martesës me Shumë Gra” dhe “Manifesti i Dytë”.

- Çfarë pasojash ndeshën shenjtorët e hershëm të ditëve të mëvonshme ngaqë iu bindën urdhërimit të Zotit për ta ushtruar martesën me shumë gra?

Ftojini disa studentë ta bëjnë me radhë duke lexuar me zë të lartë dy paragrafët e fundit të Deklaratës Zyrtare 1 në Doktrinën e Besëlidhjet dhe paragrafët e parë dhe të shtatë nga materiali “Pjesë të Shkëputura nga Tre Fjalime të Presidentit Wilford Woodruff Lidhur me Manifestin”, që pason Deklaratën Zyrtare 1. Më pas pyetini:

- Çfarë u dha mësim Presidenti Udraf shenjtorëve? (Disa nga parimet që i dha mësim, përfshijnë sa vijojnë: **Zoti kurrë nuk do ta lejojë Presidentin e Kishës që ta drejtojë Kishën në udhë të gabuar. Zoti e udhëheq Kishën e Tij nëpërmjet zbuluesit drejtuar Presidentit të Kishës.**)

Sa vijon mund të jetë e dobishme për ta shpjeguar më tej vendimin për t'i dhënë fund praktikës së martesës me shumë gra:



“Presidenti Xhorxh Q. Kanon mendoi mbi procesin zbulues që e solli në dritë Manifestin: ‘Presidenca e Kishës duhet të ecë sikurse ecni ju’, tha ai. ‘Ata duhet t’i bëjnë hapat sikurse ju i bëni hapat. Ata duhet të mbështeten te zbuluesat e Perëndisë kur i marrin ato. Ata nuk mund ta shohin fundin që nga fillimi, sikurse e sheh Zoti.’ ‘Gjithçka që mund të bëjmë’, tha Presidenti Kanon, duke i folur Presidencës së Parë, ‘është të kërkojmë mendjen dhe vullnetin e Perëndisë dhe, kur ajo të na vijë, edhe pse mund të vijë në kundërshtim me çdo ndjenjë që e kemi pasur më përpara, ne nuk kemi asnjë mundësi veçse të hedhim hapat që Perëndia na tregon dhe të mirëbesojmë tek Ai’” (“The Manifesto and the End of Plural Marriage”, Gospel Topics, lds.org/topics).

Mbylleni mësimin duke i pyetur studentët:

- Bazuar në atë që kemi mësuar, si do të përgjigjeshit në qoftë se dikush ju pyeste nëse shenjtoret e ditëve të mëvonshme e ushtrojnë martesën me shumë gra?

Merrni parasysh të lexoni thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008):



“Nëse ndonjë nga anëtarët tanë kapet duke praktikuar martesë me shumë gra, ai shkishërohet, ndëshkimi më i rëndë që Kisha mund të japë. ... Më shumë se një shekull përpara, Perëndia i zbuloi qartësisht profetit të Tij, Uillford Udrait, se praktika e martesës me shumë gra duhet të ndërpritet, që do të thotë se ajo tani është kundër ligjit të Perëndisë. Edhe në vendet ku ligji civil apo fetar e lejon poligaminë, Kisha na mëson se martesë duhet të jetë monogamike dhe nuk i pranon në anëtarësinë e saj ata që praktikojnë martesën me shumë gra” (“What Are People Asking about Us?” *Ensign*, nëntor 1998, f. 71–72).

Paragrafi vijues gjithashtu mund të jetë i dobishëm teksa i diskutoni praktikatat e tanishme të Kishës:

“Në përputhje me mësimet e Jozef Smithit, Kisha e lejon një burrë, gruaja e të cilit ka vdekur, që të vuloset me një grua tjetër kur ai martohet sërish. Për më tepër, anëtarët lejohen të kryejnë ordianca në emër të burrave dhe grave të vdekura, që u martuan më shumë se një herë kur ishin në tokë, duke i vulosur ata me të gjitha bashkëshortet me të cilat ishin martuar ligjërisht. Natyra e mirëfilltë e këtyre marrëdhënieve në jetën që vjen, nuk dihet dhe shumë marrëdhënie familjare do të përzgjidhen në jetën që vjen. Shenjtoret e ditëve të mëvonshme nxiten të mirëbesojnë tek Ati ynë i urtë Qiellor, i cili i do fëmijët e Tij dhe i bën të gjitha gjërat për rritjen dhe shpëtimin e tyre” (“Plural Marriage in Kirtland and Nauvoo”, *Gospel Topics*, lds.org/topics).

Përpara se ta mbyllni mësimin, mund të jetë e nevojshme t’u thoni studentëve se disa njerëz që e kanë braktisur Kishën, po e ushtrojnë sot martesën me shumë gra. Ata i nxitin njerëzit të lutën dhe të përsiatin nëse është e drejtë që të ushtrohet sot martesë me shumë gra. Ne nuk duhet të përipiqemi të marrim zbulësë që është në kundërshtim me atë që Zoti ka zbuluar nëpërmjet profetëve të Tij. Zoti ka zbuluar nëpërmjet profetit të Tij se praktika e martesës me shumë gra ka mbaruar në Kishë. Kushdo që e mbron praktikën e martesës me shumë gra sot, nuk është një shërbëtor i Zotit.

Jepni dëshminë tuaj për Profetin Jozef Smith. Ju mund të doni të dëshmoni se ai e mori dhe iu bind zbulësës nga Perëndia, ashtu siç bënë profetët e lashtë, Abrahami, Isaku dhe Jakobi (shih DeB 132:37).

Materiale Leximi për Studentin

- Jakobi [LiM] 2:27–30; Doktrina e Besëlidhje 132:1–3, 34–48, 54, 63; Deklarata Zyrtare 1.
- “Plural Marriage in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints”, *Gospel Topics*, lds.org/topics.

Merrni parasysh të lexoni sa vijon:

- “Plural Marriage in Kirtland and Nauvoo”, *Gospel Topics*, lds.org/topics.
- “Plural Marriage and Families in Early Utah”, *Gospel Topics*, lds.org/topics.
- “The Manifesto and the End of Plural Marriage”, *Gospel Topics*, lds.org/topics.

Të Kuptuarit e Martesës me Shumë Gra

Martesa me Shumë Gra

“Shenjtoret e ditëve të mëvonshme besojnë se martesa e një burri dhe një gruaje është ligji i qëndrueshëm i Zotit për martesën. Në kohët biblike, Zoti i urdhëroi disa njerëz ta ushtronin martesën me shumë gra – martesën e një burri me më shumë se një grua. Me anë të zbulësës, Zoti e urdhëroi Jozef Smithin të vendoste praktikën e martesës me shumë gra mes anëtarëve të Kishës në fillimin e viteve 1840. Për më shumë se gjysmë shekulli, martesa me shumë gra u ushtrua mes disa shenjtorëve të ditëve të mëvonshme nën drejtimin e Presidentit të Kishës” (“Plural Marriage in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints”, Gospel Topics, Ilds.org/topics).

Një Urdhërim i Vështirë

Eliza R. Snou (1804–1887), presidentja e dytë e përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, u vulos me Profetin Jozef Smith. Ajo shënoi përvojën vijuese në të cilën Profeti Jozef ia mësoi parimin e martesës me shumë gra vëllait të saj, Lorenzo Snout.

“Profeti Jozef ia hapi lirisht zemrën e tij [Lorenzo Snout] dhe përshkroi provën e rëndë sfiduese, mendore, që përjetoi, që të mund të mposhte neveritjen e ndjenjave të tij, rrjedhimi natyror i forcës së edukimit dhe zakonisht shoqëror, lidhur me prezantimin e martesës me shumë gra. Ai e dinte zërin e Perëndisë – ai e dinte se urdhërimi që i dha i Plotfuqishmi, ishte ta vinte në lëvizje – të jepte shembullin dhe ta themelonte martesën Çelestiale me shumë gra. Ai e dinte se nuk kishte për të luftuar e kapërcyer vetëm mendimet e gabuara dhe paragjykimet e veta, por ato të mbarë botës së krishterë, që po e shihnin drejt e në sy; por Perëndia, që është mbi të gjitha, e kishte dhënë urdhërimin dhe Ai duhej të bindej. Prapëseprapë, Profeti ngurroi dhe e shtyu kohë pas kohe, derisa një engjëll i Perëndisë qëndroi pranë tij, me një shpatë të zhveshur, dhe i tha atij se, në qoftë se nuk e vinte në lëvizje dhe e themelonte martesën me shumë gra, Priftëria e tij do të merrej prej tij dhe ai duhej të shkatërrohej! Këtë dëshmi ai jo vetëm që ia tregoi vëllait tim, por edhe të tjerëve – një dëshmi që nuk mund të kundërvihet [kundërshtohet]” (*Biography and Family Record of Lorenzo Snow* [1884], f. 69–70).

Një Provë e Besimit

Shumë njerëz që e patën të vështirë me parimin e martesës me shumë gra, u bekuan me një dëshmim pohues, shpirtëror të së vërtetës së parimit.

“Sipas Helen Mar Kimballit, Jozef Smithi tha se ‘ushtrimi i këtij parimi do të ishte sprova më e vështirë që shenjtoret do të duhej ta vinin ndonjëherë në provë besimin e tyre’. Edhe pse ishte një nga sprovat ‘më të vështira’ në jetën e saj, ajo dëshmoi se kishte qenë ‘një nga bekimet më të mëdha’. . . .

Lusi Uokeri solli ndërmend mundimin e saj të brendshëm kur Jozef Smithi e ftoi të bëhej bashkëshortja e tij. ‘Çdo ndjenjë e shpirtit tim ngriti krye kundër kësaj’, shkroi ajo. Prapëseprapë, pas disa netësh të parehatshme, e rënë në gjunjë në lutje, ajo gjeti lehtësim ndërkohë që dhoma e saj ‘u mbush me një ndikim të shenjtë’, të përafërt me ‘ndriçimin e shkëlqyer të diellit’. Ajo tha: ‘Shpirti im u mbush me një paqe të qetë, të ëmbël, që nuk e njihja kurrë’ dhe ‘lumturia më madhore e pushtoi tërë qenien time’” (“Plural Marriage in Kirtland and Nauvoo”, Gospel Topics, Ilds.org/topics).

Jozef Smithi dhe Martesa me Shumë Gra

Shumë gra u vulosën me Jozef Smithin, por numri i saktë është i panjohur.

“Gjatë epokës në të cilën martesa me shumë gra u ushtrua, shenjtoret e ditëve të mëvonshme bënë dallimin midis vulosjeve për kohën e përjetësinë dhe vulosjeve vetëm për përjetësinë. Vulosjet për kohën dhe përjetësinë përfshinin zotime dhe marrëdhënie gjatë kësaj jete, duke përfshirë në përgjithësi mundësinë për marrëdhënie seksuale. Vulosjet vetëm për përjetësinë vinin në dukje marrëdhënie vetëm në jetën pas kësaj.

... Disa nga gratë që u vulosën me Jozef Smithin më vonë, dëshmuuan se martesat e tyre ishin për jetën e përjetësinë, ndërkohë që të tjera treguan se marrëdhëniet e tyre ishin vetëm për përjetësinë.

Shumica e atyre grave të vulosura me Jozef Smithin ishin midis moshave 20 dhe 40 vjeç në kohën e vulosjes së tyre me të. Më e moshuara, Feni Jang, ishte 56 vjeçe. Më e vogla ishte Helen Mar Kimballi, ... që u vulos me Jozefin disa muaj përpara ditëlindjes së saj të 15-të. Martesa në një moshë të tillë, e papërshtatshme për standardet e sotme, ishte e ligjshme në atë epokë dhe disa gra martoheshin në moshën 15-vjeçare. Helena Mar Kimballi foli për vulosjen e saj me Jozefin si të ishte 'vetëm për përjetësinë', duke sugjeruar se marrëdhënia nuk përfshiu marrëdhënie seksuale. ...

Jozef Smithi u vulos me një numër grash që ishin tashmë të martuara. As këto gra, as Jozefi nuk shpjeguan shumë rreth këtyre marrëdhënieve, edhe pse disa gra thanë se ato ishin vetëm për përjetësinë. Gra të tjera nuk lanë dokumente, duke e bërë të panjohur nëse vulosjet e tyre ishin për kohën e përjetësinë apo ishin vetëm për përjetësinë.

Ka disa shpjegime të mundshme për këtë praktikë. Këto vulosje mund të kenë siguruar një mënyrë për të krijuar një lidhje ose një hallkë të përjetshme midis familjes së Jozefit dhe familjeve të tjera brenda Kishës. Këto lidhje u shtrinë si vertikalisht, nga prindi te fëmija, ashtu dhe horizontalisht, nga një familje tek tjetra. Sot lidhje të tilla të përjetshme arrihen nëpërmjet martesave në tempull të individëve, të cilët gjithashtu vulosen me familjet e tyre të lindjes, në këtë mënyrë duke i lidhur familjet së bashku" ("Plural Marriage in Kirtland and Nauvoo", Gospel Topics, Ilds.org/topics).

Pas vdekjes së Profetit, shumë gra u vulosën me të, të cilat nuk kishin pasur marrëdhënie në vdekshmëri me të.

Kundërshtimi ndaj Martesës me Shumë Gra

Shumë udhëheqës fetarë dhe politikë në Shtetet e Bashkuara e kundërshtuan sistemin e martesës me shumë gra, të cilin ata e konsideronin si të pamoralshëm dhe të paqytetëruar. Shenjtorët e ditëve të mëvonshme u përqeshën në fjalime publike, libra, revista e gazeta. Kongresi i Shteteve të Bashkuara miratoi ligje që e kufizuan lirinë e anëtarëve të Kishës, dhe e dëmtuan Kishën ekonomikisht duke e kufizuar sasinë e pronësisë që mund të zotëronte Kisha. "Këto ligje, së fundi, bënë që oficerët të arrestonin dhe burgosnin burrat që kishin më shumë se një bashkëshorte, dhe t'u mohonin atyre të drejtën për të votuar, të drejtën për privatësi në shtëpitë e tyre dhe gëzimin e lirive të tjera civile" (*Trashëgimia Jonë: Një Histori e Shkurtër e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme* [2010], f. 97). Deri në vitin 1890, qindra prej shenjtorëve besnikë të ditëve të mëvonshme kaluan kohë në burg. Të tjerë u fshehën për t'u shmangur arrestimit dhe burgosjes. Në këto kushte, shumë familje vuajtën nga shqetësimi, brengosja, varfëria dhe uria.

Edhe pse bota i përqeshi ata për ushtrimin e martesës me shumë gra, shumë shenjtorë besnikë të ditëve të mëvonshme e mbrojtën praktikën dhe dëshmuan që ata e dinin se ishte dhënë me anë të zbulesës nga Perëndia nëpërmjet Profetit Jozef Smith.

Këto rrethana të vështira e bënë Presidentin Uillford Udraf që të kërkonte plot lutje udhërrëfimin e Zotit lidhur me praktikën e shenjtorëve të martesës me shumë gra. Në vitin 1889, Presidenti Udraf i udhëzoi udhëheqësit e Kishës ta ndërprisnin mesimdhënien e parimit të martesës me shumë gra. Deri në vitin 1890, u kryen shumë pak martesat me shumë gra dhe këto ishin bërë kundër këshillës së Presidentit Udraf. Megjithatë, disa njerëz botuan artikuj që Kisha ende po e reklamonte praktikën e martesës me shumë gra. Këto artikuj sollën kundërshtim të mëtejshëm kundër Kishës. Në shtator të vitit 1890, Presidenti Udraf nxori një Manifest, që tani njihet si Deklarata Zyrtare 1 te Doktrina e Besëlidhje.

Manifesti i Dytë

"Manifesti [Deklarata Zyrtare 1] shpalli qëllimin e Presidentit [Uillford] Udraf për t'u nënshtruar ligjeve të Shteteve të Bashkuara. Nuk tha asgjë rreth ligjeve të vendeve të tjera. Që nga fillimi i kolonive në Meksikë dhe Kanada, udhëheqësit e Kishës kishin kryer martesat me shumë gra në ato vende dhe pas tetorit të vitit 1890, martesat me shumë gra vazhduan të kryeshin atje në heshtje. ... Nën rrethana të jashtëzakonshme, një numër më i vogël i martesave të reja me shumë gra u kryen në Shtetet e Bashkuara midis viteve 1890 dhe 1904, edhe pse është e paqartë nëse martesat u autorizuan që të kryeshin brenda Shteteve [të Bashkuara]" ("The Manifesto and the End of Plural Marriage", Gospel Topics, Ilds.org/topics).

“Në konferencën e përgjithshme të prillit 1904, Presidenti [Jozef F.] Smith nxori një deklaratë detyruese, të njohur si Manifesti i Dytë, që i bëri martesat e reja me shumë gra të dënueshme me shkishërim” (“Plural Marriage in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints”, Gospel Topics, [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics)).

Pas martirizimit të Jozef Smithit, Plaku Xhon Tejlör, i cili ishte me Jozef Smithin kur u vra, i thuri lavde Profetit (ndoshta në bashkëpunim me një ose më shumë shenjtorë) duke shënuar: “Joseph Smith-i, Profeti dhe Shikuesi i Zotit, ka bërë më shumë, përveç Jezusit vetëm, për shpëtimin e njerëzve në këtë botë, sesa çdo njeri tjetër që jetoi ndonjëherë në të” (DeB 135:3). Ky mësim do t’i ndihmojë studentët që të kuptojnë se si shërbesa e Profetit i përmbushi profecitë e lashta. Ky mësim gjithashtu do të shqyrtojë ndihmesat që bëri Jozef Smithi për shpëtimin e gjithë fëmijëve të Perëndisë.

Lexim Konteksti

- Nil L. Andersen, “Jozef Smithi”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2014, f. 28–31.
- Ted R. Kelister, “Jozef Smithi – Profeti i Rivendosjes”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2009, f. 35–37.
- “D&C 135:3. Joseph Smith Has Done More for the Salvation of Men Than Anyone Other Than Jesus”, *Doctrine and Covenants Student Manual* (Church Educational System manual, 2001), f. 349–350.

Sugjerime për Mësimdhënien

2 Nefi 3:1–21

Misioni i parashuguruar i Jozef Smithit

Kërkojuni studentëve të tregojnë gjënë e parë që ju vjen në mendje kur mendojnë për Jozef Smithin. Ftojini disa studentë që shkurtimisht të tregojnë për një rast kur ata ishin mirënjohës për Profetin Jozef Smith.

Tregojuni studentëve se profeti Nefi shënoi disa këshilla që Lehi ia dha birit të tij, Jozefit. Kjo këshillë shënohet te 2 Nefi 3 dhe përfshin një profeci që Jozefi i Egjiptit e dha lidhur me familjen e Lehit dhe ditët e mëvonshme. Ndoshta Lehi i mësoi këto profeci nga leximi i fletëve prej tunxhi. Te 2 Nefi 3, ne mësojmë se Jozefi i Egjiptit parashikoi misionin e ditëve të mëvonshme të Jozef Smithit. Kërkojini një student të lexojë me zë të lartë 2 Nefin 3:6–9. Nxiteni klasën ta ndjekë dhe të kërkojë mënyrën se si Jozefi i Egjiptit e përshkroi Jozef Smithin.

- Cilat janë disa fjalë ose fraza që Jozefi i Egjiptit i përdori për të përshkruar Jozef Smithin? (Përgjigjet mund të përfshijnë “shikues i zgjedhur”, “vlerësohet shumë”, “[i] madh në sytë e mi” dhe “i madh si Moisiu”. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët t’i shenjojnë këto shprehje në shkrimet e tyre të shenjta; në anë të faqes pranë vargjeve 6–9, ata gjithashtu mund të shkruajnë *Jozef Smithi*.)
- Në çfarë mënyrash ishte Jozef Smithi si Moisiu dhe Jozefi i Egjiptit? (Shih edhe Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 50:24–35 [në fund të Kombinimit Tresh].)
- Sipas vargjeve 7–8, çfarë parashikoi Jozefi i Egjiptit lidhur me shërbesën e Jozef Smithit? (Sigurohuni që studentët e kuptojnë këtë të vërtetë: **Jozef Smithi do të ngrihej lart nga Zoti për t’i sjellë njerëzit te një dituri e besëlidhjeve të Tij dhe për ta bërë punën e Tij.**)

Ftojini studentët të punojnë në dyshe dhe të studiojnë 2 Nefin 3:7, 11–15, 18–21.

Kërkojini secilës dyshe të bëjë një listë të asaj që shkrimet e shenjta thonë se do të bënte Jozef Smithi për të ndihmuar në përmbushjen e veprës së Zotit. Ju mund të doni

të sugjeroni që studentët ta bëjnë këtë listë duke shenjuar fraza të rëndësishme që i gjejnë në këto vargje. Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini disa studentë që të tregojnë atë që gjetën. (Përgjigjet duhet të përfshijnë sa vijon: t'i sjellë njerëzit në njohurinë e besëlidhjeve [vargu 7]; të sjellë në dritë Librin e Mormonit [vargjet 13, 18–21]; t'i bindë njerëzit për vërtetësinë e Biblës [vargu 11]; të bëhet i fortë [vargu 13]; dhe të sjellë popullin në shpëtim [vargu 15].)

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Brigam Jang (1801–1877) dhe ftojini një student ta lexojë me zë të lartë:



“Ishte dekretuar në këshillat e përjetësisë, shumë kohë më parë se të hidheshin themelet e tokës, se ai, Jozef Smithi, duhej të ishte njeriu, në periudhën e fundit ungjillore të kësaj bote, që do t’ia sillte fjalën e Perëndisë njerëzve. ... Zoti e kishte ruajtur atë dhe atin e tij, dhe atin e atit të tij, dhe paraardhësit e tyre të gjithë deri tek ... Adami. Ai e ka vëzhguar atë familje e atë gjak ndërsa ka qarkulluar që nga burimi i tij deri te lindja e atij njeriu. Ai u parachugurua në përjetësi që të kryesonte mbi këtë periudhë të fundit të kujdestarisë ungjillore” (*Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* [1997], f. 343).

Për t’i ndihmuar studentët të ndiejnë të vërtetën dhe rëndësinë e misionit të parachuguruar të Jozef Smithit, diskutoni sa vijon:

- Përse është e rëndësishme për ju të dini se Jozef Smithi u parachugurua dhe u përgatit në jetën para lindjes që të ishte Profeti i Rivendosjes?

Doktrina e Besëlidhje 135:3

Jozef Smithi ka “bërë më shumë, përveç Jezusit vetëm, për shpëtimin e njerëzve”

Kërkojuni studentëve të tregojnë se çfarë do të bënin ose dëshmonin rreth Jozef Smithit nëse do t’iu jepeshin vetëm pak fjali për ta bërë këtë. Shpjegoni se pas vdekjes së Jozef Smithit, një nderim për Jozef Smithin u shkrua dhe më vonë u ruajt për ne në Doktrinën e Besëlidhjet. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë fjalinë e parë të Doktrinës e Besëlidhjeve 135. Pyesni:

- Çfarë e vërtete rreth Jozef Smithit shpallet në këtë fjali? (Studentët duhet të përcaktojnë të vërtetën vijuese: **Jozef Smithi ka bërë më shumë për shpëtimin e njerëzve në këtë botë sesa çdo njeri tjetër përveçse Jezusit.**)

Për t’i rishikuar punën dhe ndihmesat e Profetit Jozef Smith, organizojini studentët në grupe të vogla. Caktojini ata të hedhin një sy të shpejtë përmes Doktrinës e Besëlidhjeve dhe të mendojnë sërish për mësimet e diskutuara në këtë kurs deri në këtë pikë. Kërkojuni atyre të bëjnë një listë të bekimeve dhe doktrinave të rivendosura nëpërmjet Profetit Jozef Smith, të cilat luajnë rol në shpëtimin tonë. Pas një kohe të mjaftueshme, ftojini studentët të përzgjedhin një gjë në listën e tyre dhe t’i tregojnë grupit të tyre se si ajo e ndikon jetën e tyre dhe i çon ata drejt shpëtimit.

Për t’i përmbledhur përgjigjet e studentëve, paraqitni thënien vijuese nga Plaku Ted R. Kelister, i cili shërbeu në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve. Kërkojini një student ta lexojë me zë të lartë ndërsa studentët e tjerë e ndjekin:



“Nëpërmjet Jozef Smithit janë rivendosur gjithë fuqitë, çelësat, mësimet dhe ordinancat e domosdoshme për shpëtim dhe ekzaltim. Nuk mund të shkoni askund tjetër në botë dhe t’i merrni ato. Nuk gjenden në asnjë kishë tjetër. Nuk gjenden në asnjë filozofi të njeriut apo përmbledhje shkencore, apo pelegrinazh vetjak, sado intelektuale të duken.

Shpëtimi gjendet vetëm në një vend, ashtu siç u krijua nga Vetë Zoti, kur tha se kjo është ‘[e vetmja] kishë [e] vërtetë dhe [e] gjallë mbi faqen e tokës’ (DeB 1:30)” (“Jozef Smithi – Profeti i Rivendosjes”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2009, f. 37).

Jepuni studentëve një çast që të përsiatin se si shërbesa e Jozef Smithit ka luajtur rol në vetë shpëtimin e tyre dhe më pas pyesni:

- Në çfarë mënyrash të veçanta mund të ishte jeta juaj e ndryshme pa shërbesën e Profetit Jozef Smith?

Doktrina e Besëlidhje 122:1–2; Joseph Smith – Historia 1:33

Emri i Jozefit do të “mbahej për mirë e për keq mes të gjitha kombeve”

U thoni studentëve se, pavarësisht nga gjithë e mira që përmbushi Jozef Smithi, ai pati shumë kritikues, veçanërisht pranë fundit të jetës së tij. Ky aspekt i jetës së tij gjithashtu u parashikua nga profetët e lashtë (shih, për shembull, 3 Nefi 21:10). Ftojini një student të lexojë me zë të lartë atë që Moroni i tha Jozef Smithit rreth atyre njerëzve që do ta kundërshtonin atë, sikurse shënohet te Joseph Smith – Historia 1:33. Ftojini një student tjetër të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 122:1–2. Ndhimojini studentët të shprehin një të vërtetë që gjendet në këto fragmente duke pyetur:

- Si do ta përmbledhni atë që mësojmë nga këto dy fragmente të shkrimit të shenjtë rreth mënyrës se si njerëzit do t’i përgjigjeshin Jozef Smithit? (Teksa studentët i japin përmbledhjet e tyre të sugjeruara, ndihmojini të kuptojnë këtë të vërtetë: **Ndërkohë që shumë njerëz në botë do ta përmendin Jozef Smithin me përçmim, të drejtët do të kërkojnë bekimet e bëra të mundshme nëpërmjet shërbesës së tij.**)
- Si mendoni, përse Profeti Jozef Smith ka kaq shumë kritikë dhe armiq, edhe pse shumë vite kanë kaluar që nga vdekja e tij? (Një dëshmi për Rivendosjen mbështetet në atë që Jozef Smithi ishte ose jo një profet, i cili kreu punën e Perëndisë. Si rrjedhim, Satani vazhdon të përpiqet për ta diskredituar Jozef Smithin.)

Ftojini një student të lexojë thënien vijuese nga Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Shumë nga ata që nuk e pranojnë punën e Rivendosjes, thjesht nuk besojnë se qenie qiellore u flasin njerëzve në tokë. E pamundur, thonë ata, që fletët e arta të jenë dorëzuar nga një engjëll dhe të jenë përkthyer nga fuqia e Perëndisë. Prej atij mosbesimi, ata e hedhin poshtë me ngut dëshminë e Jozefit dhe disa fatkeqësisht zhyten më tej deri në zhvlerësim të jetës së Profetit dhe përgojim të karakterit të tij.

Ne jemi veçanërisht të trishtuar kur dikush që dikur e nderonte Jozefin, tërhiqet nga bindja e tij apo e saj dhe më pas e merr nëpër gojë Profetin.

‘Ta studiosh Kishën ... përmes syve të braktisësve të saj’, tha një herë Plaku Nil A. Makuell, është ‘njësoj si të intervistosh Judën për të kuptuar Jezusin. Braktisësit përherë na tregojnë më shumë për veten sesa për atë nga e cila janë larguar’ [“All Hell Is Moved” (takim shpirtëror në Universitetin “Brigam Jang”, 8 nëntor 1977), f. 3; speeches.byu.edu]. ...

Komentet negative rreth Profetit Jozef Smith do të shtohen teksa lëvizim drejt Ardhjes së Dytë të Shpëtimtarit. Gjysmë-të-vërtetat dhe mashtrimet e holla nuk do të pakësohen. Do të ketë anëtarë të familjes dhe miq të cilët do të kenë nevojë për ndihmën tuaj. Tani është koha që [të përgatiteni] për t’i

ndihmuar të tjerët që po e kërkojnë të vërtetën" ("Jozef Smithi", *Ensign ose Liahona*, nëntor 2014, f. 28–30).

Diskutoni pyetjet vijuese:

- Përse është e dobishme të jeni të vetëdijshëm se, edhe pse shumë vite kanë kaluar që nga vdekja e Jozef Smithit, armiqtë e Kishës vazhdojnë ta sulmojnë famën e tij?
- Çfarë mund të bëjmë që t'i ndihmojmë ata, të cilët po kërkojnë të vërtetën, për ta ditur se Jozef Smithi është një profet i Perëndisë?

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Nil L. Andersen dhe ftojeni një student ta lexojë me zë të lartë:



"Një kërkues i sinqertë duhet ta shikojë përhapjen e ungjillit të rivendosur si frytin e punës së Zotit nëpërmjet Profetit. ...

Jezusi tha:

'Një dru i mirë nuk mund të japë fryte të këqija, as një dru i keq të japë fryte të mira. ...

Do t'i njihni ... nga frytet e tyre' [Mateu 7:18, 20].

Këto shpjegime janë bindëse, por kërkuesi i sinqertë nuk duhet të mbështetet vetëm tek ato për të vendosur lidhur me kërkimin e tij apo të saj për të vërtetën.

Çdo besimtar ka nevojë për një pohim shpirtëror për misionin dhe karakterin hyjnor të Profetit Jozef Smith. Kjo është e vërtetë për çdo brez. Pyetjet shpirtërore meritojnë përgjigje shpirtërore nga Perëndia" ("Jozef Smithi", *Ensign ose Liahona*, nëntor 2014, f. 29–30).

Jepuni studentëve mundësi që të dëshmojnë për Profetin Jozef Smith duke iu bërë pyetjet vijuese:

- Cilat aspekte të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme i shihni si provë e misionit profetik të Jozef Smithit?
- Çfarë përvojash keni pasur që kanë luajtur rol në dëshminë tuaj për Profetin Jozef Smith?

Mbylleni duke paraqitur thëniet vijuese nga Bathshiba W. Smithi (1822–1910), që shërbeu si presidentja e katërt e përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, dhe nga Presidenti Brigam Jang (1801–1877). Si Motra Smith ashtu edhe Presidenti Jang e njohën Jozef Smithin kur ishte gjallë. Ftojeni një student t'i lexojë këto thënie me zë të lartë:



"Kur e dëgjova Ungjillin, unë e dija se ishte i vërtetë; kur e lexova për herë të parë Librin e Mormonit, unë e dija se ishte i frymëzuar nga Perëndia; kur e pashë për herë të parë Jozef Smithin, unë e dija se qëndroja ballë për ballë me një profet të Perëndisë së gjallë dhe nuk kisha asnjë dyshim në mendjen time rreth autoritetit të tij" (Bathshiba W. Smith, cituar në *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* [2011], f. 34).



"Më vjen të thërras, aleluja, gjithë kohës, kur mendoj se dikur e njoha Jozef Smithin, Profetin që Zoti e ngriti dhe e shuguroi, dhe të cilit i dha çelësat dhe fuqi për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë mbi tokë e për ta mbështetur atë" (cituar në *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 529).

Ftojini studentët të marrin parasysh dëshminë e tyre për Profetin Jozef Smith dhe çfarë mund të bëjnë ata për t'ua treguar të tjerëve atë, qoftë vetë ose duke përdorur mediat shoqërore. Nxitini ata të përcaktojnë dikë të cilit do të donin t'ia thonin këtë dëshmi dhe më pas ndiqeni ecurinë e dëshirës së tyre.

Materiale Leximi për Studentin

- 2 Nefi 3:1–21; Doktrina e Besëlidhje 122:1–2; 135:3; Joseph Smith – Historia 1:33.
- Nil L. Andersen, “Jozef Smithi”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2014, f. 28–31.
- Ted R. Kelister, “Jozef Smithi – Profeti i Rivendosjes”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2009, f. 35–37.

22

Martirizimi i Profetit Jozef Smith

Mospajtuesit brenda Kishës dhe kundërshtarët jashtë Kishës e bënë të ndodhte martirizimi i Profetit Jozef Smith dhe vëllait të tij, Hajrëm Smithit. Vdekjet e tyre i shtuan një vulë të fuqishme dëshmive të tyre për Librin e Mormonit, Doktrinën e Besëlidhjet dhe ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit. Një studim i jetës dhe martirizimit të Profetit Jozef Smith do t'i ndihmojë studentët që të marrin parasysh bekimet e shumta, të cilat Zoti ua ka dhënë atyre nëpërmjet shërbesës së Profetit Jozef Smith, nëpërmjet të cilit Ai e rivendosi ungjillin e Tij në ditët e mëvonshme.

Lexim Konteksti

- Thomas S. Monson, "The Prophet Joseph Smith: Teacher by Example", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2005, f. 67–70.
- "The Martyrdom", kapitulli 22 te *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 273–285.
- "Martirizimi: Profeti e Vulos Dëshminë e Tij me Gjakun e Tij", kapitulli 46 te *Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 563–576.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 135:4–5; 136:36–39

Armiqtë u përpoqën ta vrasin Jozef Smithin



Paraqitni një figurë të Burgut të Karthixhit. Shpjegojuni studentëve që më 27 qershor 1844, Profeti Jozef Smith dhe vëllai i tij, Hajrëmi, i cili ishte Patriarku i Kishës, u martirizuan në burgun e Karthixhit në Ilinois. Jozef Smithi ishte 38 vjeç në kohën e vdekjes së tij dhe Hajrëmi ishte 44.

Ftojuni një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 136:36–39, ndërkohë që klasa e ndjek. Nxitini studentët tekta lexojnë, që të përcaktojnë mënyrën se si Zoti e përmbodhi jetën e Jozef Smithit dhe veprën që kreu ai. Më pas diskutoni pyetjen vijuese:

- Si e përshkroi Zoti jetën dhe veprën e Profetit Jozef Smith? (Përgjigjet e studentëve mund të përfshijnë të vërtetat vijuese: **Jozef Smithi ngriti themelin për veprën e Perëndisë në këtë periudhë të kujdestarisë ungjillore. Profeti Jozef Smith ishte i pafajshëm në kohën e vdekjes së tij dhe ai e kishte përmbushur me besnikëri misionin e dhënë atij nga Perëndia.**)

Për t'i ndihmuar studentët të kuptojnë disa nga ndikimet që e shkaktuan vdekjen e Profetit, tregojuni atyre se shenjtorët jetuan në njëfarë paqeje në shtetin e Ilinoisit për gati tre vjet, por në vitin 1842, ata po përjetonin përsëri kundërshtim. Kundërshtuesit e Kishës përfshinin qytetarë të Ilinoisit, të cilët kishin frikë nga ndikimi politik i shenjtorëve. Të tjerë filluan të kishin gjithnjë e më shumë lakmi për përparimin ekonomik të Navusë dhe ishin kritikues ndaj fuqisë së qeverisë dhe milicisë së qytetit të Navusë. Disa njerëz i keqkuptuan disa doktrina e praktika mormone të veçanta. Mospajtuesit brenda Kishës dhe kundërshtarët jashtë Kishës i ndërthurën përpjekjet e tyre për të luftuar kundër Profetit dhe Kishës.

Shpërndajini secilit student një kopje të fletushkës në fund të këtij mësimi. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “Kundërshtimi ndaj Profetit dhe Kishës”.

Shpjegoni se, sipas ligjeve që ishin në fuqi në kohën e vdekjes së Profetit, asnjë ligj nuk u thye kur u shkatërrua një shtypshkronjë. Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Amendamenti i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara që e zgjeroi sigurinë e lirisë së shtypit për të qenë i mbrojtur ndaj veprimeve të qeverive të qyteteve dhe shteteve, nuk u miratua deri në vitin 1868 dhe nuk hyri në fuqi si çështje e ligjit federal deri në vitin 1931. ... Ne duhet t'i gjykojmë veprimet e pararendësve tanë mbi bazat e ligjeve dhe urdhërimeve e rrethanave të kohës së tyre, jo të kohës sonë” (“Joseph, the Man and the Prophet”, *Ensign*, maj 1996, f. 72).



- Përse është fjalia e fundit në thënien e Plakut Ouks e rëndësishme për t'u kujtuar, kur ne marrim parasysh veprimet e udhëheqësve të hershëm të Kishës? (Ju mund të doni të vini në dukje se shumica e anëtarëve të këshillit të qytetit të Navusë ishin anëtarë të Kishës, por ata po vepronin në aftësinë e tyre si shërbëtorë të zgjedhur civilë kur urdhëruan që të shkatërrohej shtypshkronja. Kisha, si një organizatë, nuk mori ndonjë veprim kundër shtypshkronjës, por këshilli i qytetit e ndërmori veprimin për ta “hequr ... bezdinë” [në *History of the Church*, 6:432]).

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “Jozefi dhe Hajrëmi Akuzohen Padrejtësisht”. Kërkojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 135:4. Vëreni klasën ta ndjekë, duke kërkuar profecinë që bëri Jozef Smithi kur ai udhëtoi drejt Karthixhit.

- Edhe pse çdo njeri i vdekshëm është i papërsosur, çfarë mendoni se do të duhej për dikë që të kishte “një ndërgjegje të paqortueshme përpara Perëndisë dhe kundrejt gjithë njerëzve”? (DeB 135:4).

Shpjegoni se, ndërkohë që Hajrëm Smithi u përgatit të shkonte në Burgun e Karthixhit, ai lexoi Ethërin 12:36–38 dhe më pas e palosi faqen. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 135:5, që është një citim i drejtpërdrejtë i këtyre vargjeve nga Ethëri, ndërkohë që klasa e ndjek. Ftojini studentët të marrin parasysh përse ky fragment i shkrimeve të shenjta do të kishte qenë domethënës për Hajrëmin. Ju mund t'iu sugjeroni studentëve që të shenjojnë ndonjë fjalë ose frazë që iu bie atyre në sy.

- Çfarë fjalësh ose frazash të veçanta në këto vargje nga libri i Ethërit mendoni se do të kishin qenë domethënëse për Hajrëmin, teksa ai përballej me burgimin dhe vdekjen e mundshme?
- Çfarë mendoni se do të thotë fraza vijuese: “Të gjithë njerëzit do të dinë se rrobat e mia nuk janë të njollozura me gjakun tuaj”? (Merrni parasysh që studentët të bëjnë një referencë kryq të vargut 5 me Jakobin [LiM] 1:19 dhe Mosian 2:27 për të zbuluar kuptimin e kësaj fraze. Të mësuarit se si të kryqëzoni referenca të një shkrimi të shenjtë me shkrime të tjera të shenjta, të cilat japin këndvështrim shtesë, është një aftësi e rëndësishme e studimit të shkrimeve të shenjta.)

Kërkojuni studentëve të marrin parasysh se si Jozefi dhe Hajrëmi mund të ishin ndier duke e ditur që i kishin përmbushur thirrjet dhe detyrat e tyre nga Perëndia në mundësinë më të mirë të aftësive të tyre.

- Çfarë mund të mësojmë nga shembujt e Jozef e Hajrëm Smithit, gjë e cila mund të na ndihmonte t'i përmbushim përgjegjësitë që i marrim nga Perëndia?

Doktrina e Besëlidhje 135:1–3, 6–7

Martirizimi në Burgun e Karthixhit dhe nderimet për Jozef Smithin

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë hyrjen e seksionit të Doktrinës e Besëlidhjeve 135. (Ju mund të doni të vini në dukje se ndryshimet midis këtij kreu në botimet e vitit 1981 dhe 2013 të shkrimeve të shenjta pasqyrojnë njohurinë e kohëve të fundit.) Ftojini disa studentë të lexojnë me radhë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 135:1–2 dhe pjesën në fletushkë të titulluar “Martirizimi në Burgun e Karthixhit”. Vëreni klasën t'i ndjekë, tekta këta studentë lexojnë.

- Çfarë mendoni se do të thotë fraza “për ta vulosur dëshminë e këtij libri dhe të Librit të Mormonit”?

Teksa studentët i japin mendimet e tyre, merrni parasysh të shkruani përkufizimin vijues në tabelë: të “vulosësh” është ta krijosh diçka në mënyrë të përhershme, e tillë siç është një dëshmi. Ju mund të doni të sugjeroni që studentët ta shkruajnë këtë përkufizim në shkrimet e tyre të shenjta pranë vargut 1.

Vëreni studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 135:3, 6–7, duke kërkuar disa prej të vërtetave që mësojmë nga kjo shpallje e martirizimit të Jozef e Hajrëm Smithit.

- Çfarë të vërtetash mësuat nga kjo shpallje e martirizimit të Jozef e Hajrëm Smithit? (Studentët mund të përcaktojnë shumë të vërteta, duke përfshirë sa vijon: **Jozef Smithi ka bërë më shumë për shpëtimin e njerëzve në këtë botë, sesa çdo njeri tjetër përveçse Jezu Krishtit. Libri i Mormonit dhe Doktrina e Besëlidhje u sollën në dritë për shpëtimin e botës.**)
- Në çfarë mënyrash të veçanta mendoni se jeta juaj do të ishte e ndryshme pa shërbesën e Profetit Jozef Smith?

Kërkojini një student të lexojë me zë të lartë thënien nga Plaku Dallin H. Oaks, që gjendet në pjesën në fletushkë të titulluar “Nderime për Profetin Jozef Smith”.

- Përse është e rëndësishme të kuptojmë se bashkëpunëtorët e afërt të Jozef Smithit e konsideronin atë të ishte një profet dhe një “burrë i nderuar, i virtytshëm”?

Mbylleni duke iu kërkuar studentëve nëse ndonjërit prej tyre do t'i pëlqente ta jepte dëshminë e tij/saj për Jozef Smithin. Nxitini studentët të kërkojnë mundësi në disa prej ditëve pasuese që t'ua japin të tjerëve dëshminë e tyre për Profetin Jozef Smith dhe rolin e tij në rivendosjen e ungjillit të Jezu Krishtit.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 135:1–7; 136:36–39.
- Thomas S. Monson, “The Prophet Joseph Smith: Teacher by Example”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2005, f. 67–70.
- “The Martyrdom”, kapitulli 22 te *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 273–285.

Martirizimi i Profetit Jozef Smith

Kundërshtimi i Profetit dhe i Kishës

Në qershor të vitit 1844, armiqësia kundër Kishës ishte shtuar shumë. Disa shtetas në Illinois po diskutonin t'i dëbonin shenjtorët nga shteti, ndërkohë që të tjerë po komplotonin ta vrisnin Profetin. Disa prej atyre që po komplotonin kundër Profetit dhe Kishës, ishin ish-anëtarë të Kishës të cilët e kishin braktisur Kishën. Më 7 qershor 1844, Uilliam Lo, i cili kishte shërbyer si Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, dhe braktisës të tjerë shtypën botimin e parë të një gazete të quajtur *Nauvoo Expositor*. Në një përpjekje për ta nxehur publikun kundër Profetit e Kishës, këta burra e përdorën këtë gazetë që të shpifnin për Jozef Smithin dhe udhëheqës të tjerë të Kishës. Jozef Smithi, duke vepruar si kryetari i bashkisë së Navusë, dhe shumica e këshillit të qytetit të Navusë, e kuptoi se gazeta acaruese do të çonte drejt dhunës së turmave kundër qytetit. Ata e shpallën gazetën si një bezi publike dhe urdhëruan që të shkatërrohej shtypshkronja e *Nauvoo Expositor-it*.

Jozefi dhe Hajrëmi Akuzohen Padrejtësisht

“Si rezultat i [shkatërrimit të *Nauvoo Expositor-it*] nga kryetari [i] bashkisë dhe këshilli [i] qytetit, autoritetet e Illinoisit bënë një padi të pabazuar për rebelim kundër Profetit, vëllait të tij Hajrëm dhe zyrtarëve të tjerë të qytetit të Navusë. Guvernatori i Illinoisit, Tomas Ford, i urdhëroi burrat të përballonin gjyqin në Karthixh të Illinoisit, qendra e kontesë, dhe u premtoi mbrojtje. Jozefi e dinte se po të shkonte në Karthixh, jeta e tij do të ishte në rrezik të madh prej turmave që po e kërcënonin atë.

Duke besuar se turmat donin vetëm ata, Jozefi dhe Hajrëmi vendosën të iknin drejt perëndimit për të shpëtuar jetën. Më 23 qershor ata kapërcyen lumin Misisipi, por më vonë po atë ditë, vëllezër nga Navuja e gjetën Profetin dhe i thanë atij se trupa ushtarake do të pushtonin qytetin nëse ai nuk u dorëzohej autoriteteve në Karthixh. Profeti ra dakord ta bënte këtë, duke shpresuar të kënaqte si zyrtarët qeverisës ashtu dhe turmat. Më 24 qershor, Jozef dhe Hajrëm Smithi u lanë lamtumirën familjeve të tyre dhe kalëruan bashkë me zyrtarë të tjerë të qytetit të Navusë drejt Karthixhit, duke iu dorëzuar vullnetarisht zyrtarëve të kontesë në Karthixh një ditë më vonë. Pasi vëllezërit u liruan me kusht për akuzën fillestare, ata u akuzuan pa të drejtë për tradhti kundër shtetit të Illinoisit, u arrestuan dhe u burgosën në burgun e Karthixhit në pritje për të dalë në gjyq. Pleqtë Xhon Tejlor dhe Uillard Riçards, të vetmit anëtarë të Të Dymbëdhjetëve që në atë kohë nuk po shërbenin misionin, u bashkuan vullnetarisht me ta” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 563–565).

Martirizimi në Burgun e Karthixhit

Gjatë ditës së 27 qershorit 1844, një vizitor i kishte dhënë Jozefit një revolver. Teksa turma u përpoq të hynte në dhomën ku mbaheshin Profeti dhe burrat e tjerë, Hajrëmi u godit për vdekje, duke vepruar në mbrojtje të çdonjërit në dhomë. Jozefi kërcëu drejt derës dhe arriti pranë pragut të derës për të qëlluar me pistoletën në korridor. Vetëm tre prej gjashtë plumbave u qëlluan, duke plagosur disa anëtarë të turmës. Atëherë anëtarët e turmës i futën me forcë pushkët e tyre përmes derës gjysmë të hapur dhe Xhon Tejlori u përpoq t'i godiste pas tytat e pushkëve të tyre me një bastun.

Ndërsa grindja në prag të derës u shtua, Xhon Tejlori u përpoq të largohej nga dhoma nëpërmjet një dritareje. Teksa u përpoq të hidhej jashtë nga dritarja, ai u godit në këmbë nga dera dhe po ashtu u godit prej dikujt nga jashtë. Ai ra në dysheme dhe teksa përpiquej të futej nën shtratin pranë dritares, ai u plagos rëndë nga tre plumba të tjerë. Ndërkohë, teksa pushkët u futën përmes derës, Uillard Riçardsi filloi t'i godiste ato me një bastun.

Jozef Smithi atëherë vendosi të përpiquej të largohej nëpërmjet së njëjtës dritare. Ndërsa Uillard Riçardsi vazhdoi ta largonte turmën te dera, Profeti u përkul te dritarja e hapur. Teksa e bënte këtë, ai u godit prej plumbave si nga brenda ashtu edhe nga jashtë burgut. Ai ra jashtë dritares, duke thirrur: “O Zot, Perëndia im!” dhe ra përdhe. Anëtarët e turmës që ishin brenda burgut, nxituan jashtë për t'u siguruar vetë se Jozefi kishte vdekur. Edhe pse nuk kishte anëtarë të Kishës në udhë për në Karthixh, dikush bërtiti: “Mormonët po vijnë!” dhe e tërë turma u largua.

Nderime për Profetin Jozef Smith

Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha:



"Njerëzit që e njihnin më mirë Jozefin dhe qëndruan më pranë tij në udhëheqjen e Kishës, e deshën dhe e mbështetën atë si një profet. Vëllai i tij, Hajrëmi, zgjodhi të vdiste përkrah tij. Xhon Tejlari, gjithashtu atje kur ai u vra, tha: 'Unë dëshmoj para Perëndisë, engjëjve dhe njerëzve se ai ishte një burrë i mirë, i nderuar, i virtytshëm ... – se karakteri i tij privat dhe publik ishte shembullor – dhe ai jetoi dhe vdiq si një njeri i Perëndisë' (*The Gospel Kingdom* [1987], f. 355; shih edhe DeB 135:3). Brigam Jangu shpalli: 'Nuk mendoj se jeton ndonjë njeri në tokë që e njihnte [Jozef Smithin] më mirë se unë; dhe unë kam guximin të them se, përveç Jezu Krishtit, asnjë njeri më i mirë s'ka jetuar ose jeton në këtë tokë' [*Discourses of Brigham Young*, përzgji. John A. Widtsoe (1954), f. 459]" ("Joseph, the Man and the Prophet," *Ensign*, maj 1996, f. 73).

Pranë fundit të jetës së tij, Jozef Smithi ua dha çelësat e priftërisë së kësaj periudhe të kujdestarisë ungjillore anëtarëve të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Pas martirizimit të Profetit, në një mbledhje të mbajtur më 8 gusht 1844, shumë shenjtorë morën një manifestim shpirtëror që u pohoi atyre se Brigam Jangu, i cili ishte Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, duhej të udhëhiqte Kishën. Teksa studentët arrijnë të kuptojnë parimet e shoqëruara me vijueshmërinë në Presidencën e Kishës, ata do të kenë vetëbesim se Zoti e ka zgjedhur dhe përgatitur secilin individ që bëhet President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Lexim Konteksti

- “Succession in the Presidency”, kapitulli 3 te *Teachings of the Living Prophets Student Manual* (Church Educational System manual, 2010), f. 28–41.
- “The Twelve to Bear Off the Kingdom”, kapitulli 23 te *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 286–296.
- Brent L. Top dhe Lawrence R. Flake, “The Kingdom of God Will Roll On’: Succession in the Presidency”, *Ensign*, gusht 1996, f. 22–35.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 107:33; 112:30–32

Apostujt mbajnë çelësat e kësaj periudhe ungjillore

Bëni pyetjen vijuese:

- Si ndryshon procesi i përzgjedhjes së një Presidenti të ri të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme nga mënyra se si mund të zgjidhen udhëheqësit në organizata të tjera?

Informojini studentët se ky mësim do të shqyrtojë transferimin e udhëheqjes së Kishës pas vdekjes së Profetit Jozef Smith. Shpjegoni se, disa vite përpara vdekjes së tij, Profeti kishte marrë zbulesa lidhur me Presidencën e Parë dhe Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve. Kërkojuni studentëve të studiojnë Doktrinën e Besëlidhjet 107:33 dhe 112:30–32 duke kërkuar përshkrimin e Zotit për autoritetin e priftërisë të mbajtur nga anëtarët e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetëve.

- Si e përshkroi Zoti autoritetin e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve? (Sigurohuni që studentët e kuptojnë parimin vijues: **Anëtarët e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve mbajnë çelësat e priftërisë të kësaj periudhe të kujdestarisë ungjillore dhe Të Dymbëdhjetët funksionojnë nën drejtimin e Presidencës së Parë.**)



Shpërndajini secilit student një kopje të fletushkës që gjendet në fund të mësimi. Shpjegoni se Jozef Smithi i harxhoi muajt e fundit të jetës së tij duke u mbledhur shpesh me anëtarë të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve për t'i përgatitur ata që ta udhëhiqnin Kishën. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “Mbledhja me Dymbëdhjetë Apostujt, mars 1844”. Thuajuni studentëve se ky është një rrëfim i shkurtër i një mbledhjeje të mbajtur nga Profeti Jozef Smith me Apostujt dhe udhëheqës të tjerë të Kishës, siç u tregua nga Presidenti Uillford Udraf, i cili ishte një Apostull në atë kohë. Pas leximit, pyetni:

- Si ndihmoi kjo dhënie e çelësave mbi anëtarët e Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve që t'i përgatiste ata për kohën kur Profeti Jozef Smith nuk do të ishte më me ta? (Ata morën të njëjtët çelësa të priftërisë që u mbajtën nga Profeti Jozef.)
- Përse ishte e rëndësishme për Jozef Smithin që t'ua jepte këto çelësa të priftërisë Apostujve përpara vdekjes së tij? (Në atë kohë, Jozef Smithi ishte i vetmi që i mbante të gjithë çelësat e priftërisë së kësaj periudhe të kujdestarisë ungjillore. Nëse ai nuk do t'ua kishte dhënë këto çelësa të tjerëve, atëherë engjëjve do t'iu ishte dashur të vinin sërish në tokë për t'i rivendosur ato.)

Doktrina e Besëlidhje 124:127–128

Brigam Jangu e pasoi Jozef Smithin si President i Kishës

Shpjegoni se, kur Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve u organizua fillimisht në vitin 1835, rendi i vjetërsisë u përcaktua me anë të moshës. Tomas B. Marshi, i cili besohej në atë kohë të ishte Apostulli më i moshuar, u konsiderua si Apostulli më me vjetërsi në detyrë (që atëherë është mësuar se Dejvid W. Pateni ishte në të vërtetë Apostulli më i moshuar).

Kërkojini një studenti të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 124:127–128. Shpjegoni se, në tetor të vitit 1838, Presidenti Marsh e braktisi Kishën dhe u largua prej saj dhe Dejvid W. Pateni vdiq. Brigam Jangu atëherë u bë Apostulli më i vjetër në detyrë, sikurse u shpjegua në këto vargje. Pas përzgjedhjes fillestare të Apostujve dhe duke vazhduar deri në të tashmen, vjetërsia në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve është përcaktuar nga data e shugurimit.

Shpjegoni se, kur Jozef e Hajrëm Smithi u martirizuan më 27 qershor 1844, Të Dymbëdhjetët, përveç Xhon Tejlorit dhe Uillard Riçardsit, ishin në Shtetet e Bashkuara lindore duke shërbyer misione. Brenda tri javësh, megjithatë, të gjithë Apostujt e kishin mësuar lajmin tragjik dhe me nxitim u kthyen për në Navu. Kur Apostujt mbërritën, ata gjetën përshtjellim mes anëtarëve të Kishës se kush do ta udhëhiqte Kishën. Disa anëtarë të Kishës besonin se udhëheqja i ra me të drejtë Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Gjatë muajve të ardhshëm, disa burra shpallën pretendime se ata kishin të drejtën ta udhëhiqnin Kishën. Kërkojuni dy studentëve të lexojnë me zë të lartë pjesët në fletushkë të titulluara “Pretendimi i Sidni Rigdonit” dhe “Pretendimi i Xhejms Strengut”. Teksa klasa dëgjon, ftojini ata të mendojnë për shqetësimet që mund të kishin pasur rreth këtyre pretendimeve nëse ata do të kishin qenë në Navu në atë kohë.

Ndiqeni ecurinë duke i pyetur studentët:

- Përse nuk ishin pretendimet e bëra nga këta njerëz të ligjshme? (Mund t'ju nevojitet të vini në dukje se, edhe pse Sidni Rigdoni ishte një anëtar i Presidencës së Parë, Jozefi nuk ia kishte dhënë atij çelësat e priftërisë.)

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “7 gusht 1844”. Diskutoni me klasën pyetjen vijuese:

- Përse ishte e rëndësishme dëshmia e Brigam Jangut për çelësat e apostullimit? (Pasi studentët të përgjigjen, shkruajeni në tabelë doktrinën vijuese: **Apostujt i mbajnë të gjitha çelësat e priftërisë të nevojshme për të kryesuar mbi Kishën.**)

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “8 gusht 1844, ora 10:00 e mëngjesit”.

- Si i bekoj Zoti shenjtoret që të dinin se cilin kishte caktuar Ai për ta udhëhequr Kishën?
- Si mund ta dimë se udhëheqësit e Kishës sot thirren nga Perëndia? (Pasi studentët të përgjigjen, shkruani në tabelë parimin vijues: **Nëpërmjet Frymës së Shenjtë, ne mund të marrim një dëshmi se ata që e udhëheqin Kishën, janë thirrur nga Perëndia.**)
- Kur e keni ndier Shpirtin t’ju dëshmojë juve se Presidenti i Kishës sot thirret nga Perëndia?

Shpjegoni se gjatë mbledhjes së mbajtur në orën 14:00 më 8 gusht, folën Brigam Jangu dhe Apostuj të tjerë. Vëreni një student të lexojë me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “8 gusht 1844, ora 14:00”.

Shpjegoni se, kur Jozef Smithi vdiq, Brigam Jangu, si Apostulli më i vjetër, menjëherë ishte në gjendje t’i ushtronte të gjithë çelësat e priftërisë. Për më shumë se tre vjet pas martirizimit të Profetit, Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve kryesoi mbi Kishën, nën drejtimin e Brigam Jangut. Më pas, më 5 dhjetor 1847, Brigam Jangu u mbështet si Presidenti i Kishës dhe Presidenca e Parë u riorganizua.

Sidni Rigdoni u vendos në Pitsburg të Pensilvanisë dhe organizoi një Kishë të Krishtit me apostuj, profetë, priftërinj e mbretër. Kjo kishë u shkatërrua në vitin 1847. Dhe, edhe pse pretendimet e Xhejms Strengut për presidencën ishin të rreme, tre nga Dymbëdhjetë Apostujt e mëparshëm – Uilliam E. Mek-Lelini, Xhon E. Pejxhi dhe Uilliam Smithi – e mbështetën atë. Strengu u vra në vitin 1856 nga pasuesit e pakënaqur.

Për t’i ndihmuar studentët ta kuptojnë procesin e vijueshmërisë në Presidencën e Kishës sot, paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Bojd K. Paker, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, rreth asaj që ndodhi pas vdekjes së Presidentit Gordon B. Hinkli. Kërkojini një student ta lexojë thënien me zë të lartë:



“Nuk kishte pyetje për atë që do të duhej të bëhej, as mëdyshje. E dinim se Apostulli më i vjetër në detyrë ishte Presidenti i Kishës. Dhe në atë mbledhje të shenjtë, Tomas Spenser Monsoni u mbështet nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve si Presidenti i Kishës. ... Tani, siç e jep shkrimi i shenjtë, ai është i vetmi burrë në tokë që ka të drejtën të ushtrojë të gjithë ata çelësa. Por ne i mbajmë të gjithë ata si Apostuj. Ka një burrë midis nesh të thirrur e të shuguruar dhe ai bëhet President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme” (“Të Dymbëdhjetë”, *Ensign ose Liahona*, maj 2008, f. 83).

- Pas vdekjes së Presidentit të Kishës, kush do të bëhet gjithmonë Presidenti pasues i Kishës? (Apostulli më i vjetër në detyrë, i cili është Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.)

Disa studentë mund të pyesin veten se kur i merr Presidenti i Kishës çelësat e nevojshëm për ta kryesuar Kishën. Shpjegoni se çdo Apostulli i jepen të gjitha çelësat kur ai fillimisht shugurohet si Apostull. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008):



“Por autoriteti për t’i ushtruar ato çelësa kufizohet te Presidenti i Kishës. Me vdekjen e tij, ai autoritet bëhet veprues në Apostullin më të vjetër në detyrë, i cili më pas emërohet, veçohet dhe shugurohet një profet dhe President nëpërmjet bashkëpunëtorëve të tij të Këshillit të Të Dymbëdhjetëve” (“Come and Partake”, *Ensign*, maj 1986, f. 47).

- Çfarë ndjenjash keni kur e kuptoni se mbretëria e Zotit mbi tokë do të lëvizë përpara me pak ndërprerje pas vdekjes së një Presidenti të Kishës?

Ju mund të doni ta mbyllni këtë mesim duke dëshmuar se të njëjtat çelësa dhe fuqi të priftërisë, që Jozef Smithi ua dha Brigam Jangut dhe anëtarëve të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, mbahen sot nga Presidenti i Kishës, Këshilltarët e tij në Presidencën e Parë dhe anëtarët e Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Ju gjithashtu mund të tregoni se si ju e fituat dëshminë tuaj që udhëheqësit e Kishës thirren nga Perëndia. Ftojini studentët të kërkojnë me lutje që të fitojnë ose të forcojnë dëshmitë e tyre për të vërtetat që i kanë diskutuar sot.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 107:33; 112:30–32; 124:127–128.
- Bojd K. Paker, “Të Dymbëdhjetët”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2008, f. 83–87.
- “The Twelve to Bear Off the Kingdom”, kapitulli 23 te *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 286–296.

Vijueshmëria në Presidencën e Kishës

Mbledhja me Dymbëdhjetë Apostujt, mars 1844

Presidenti Uillford Udraf (1807–1898) tregoi:



“Më kujtohet fjalimi i fundit fare që na mbajti [Jozef Smithi] përpara vdekjes së tij. ... Ai qëndroi në këmbë për rreth tre orë. Dhoma ishte e mbushur si me një zjarr që konsumon, fytyra e tij qe e kthjellët si qelibar dhe ai qe veshur me fuqinë e Perëndisë. Ai na shpjegoi detyrën tonë. Ai na shpjegoi plotësinë e kësaj pune të madhe të Perëndisë; dhe në vërejtjet e tij për ne ai tha: ‘Unë kam pasur të vulosur mbi kokën time çdo çelës, çdo fuqi, çdo parim të jetës dhe shpëtimit që Perëndia i ka dhënë ndonjëherë ndonjë njeriu që ka jetuar ndonjëherë në faqen e tokës. Dhe këto parime dhe kjo Priftëri e fuqi i përkasin kësaj periudhe të shkëlqyer e të fundit ungjillore, të cilën Perëndia i Qiellit ka zgjatur dorën e Tij që ta vendosë në tokë. Tani’, tha ai, duke iu drejtuar Të Dymbëdhjetëve, ‘unë kam vulosur mbi kokën tuaj çdo çelës, çdo fuqi dhe çdo parim që Zoti ka vulosur mbi kokën time.’ ...

Pasi na u drejtua në këtë mënyrë ai tha: ‘Po ju them, barra e kësaj mbretërie tani qëndron mbi supet tuaja; juve ju duhet ta mbani atë në të gjithë botën’” (cituar në *Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 567).

Pretendimi i Sidni Rigdonit

Sidni Rigdoni, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, mbërriti në Navu nga Pitsburgu i Pensilvanisë, më 3 gusht 1844. Ai thirri një mbledhje të veçantë që të mbahej të martën më 6 gusht, me qëllim që

anëtarët e Kishës të mund të zgjidhnin një kujdestar për Kishën. U duk sikur Sidni Rigdoni u përpoq ta mbante këtë mbledhje që anëtarët e Kishës të mund ta miratonin pozitën e tij si kujdestar i Kishës përpara se të Dymbëdhjetë Apostujt, që të gjithë, të ktheheshin nga misionet e tyre në Shtetet e Bashkuara lindore. Për fat të mirë, për shkak të përpjekjeve të Plakut Uillard Riçards dhe Plakut Parli P. Prat, mbledhja u shty për të enjten, më 8 gusht 1844, dhe deri në atë kohë shumica e Apostujve ishin kthyer në Navu.

Sidni Rigdoni shpalli se, ngaqë ai ishte thirrur dhe shuguruar më parë si një zëdhënës për Jozef Smithin (shih DeB 100:9), ishte përgjegjësia e tij që të “kujdesej që kisha po qeveriset në një mënyrë të duhur” (në *History of the Church*, 7:229).

Pretendimi i Xhejms Stregut

Pas vdekjes së Jozef Smithit, Xhejms Stregu, i cili ishte pagëzuar në shkurt të vitit 1844, shpalli se kishte marrë një letër nga Jozef Smithi, që thoshte se Jozefi e kishte caktuar Stregun si pasuesin e tij. Letra ishte një falsifikim, por dukej se përfshinte nënshkrimin e Jozef Smithit dhe ajo i mashtroi disa anëtarë të Kishës kur Stregu ua tregoi atyre. Stregu gjithashtu tha se ai ishte vizituar nga një engjell, i cili i kishte dhënë atij çelësa.

7 gusht 1844

Plëqtë Xhon Tejlör, Uillard Riçards, Parli P. Prat dhe Xhorxh A. Smith ishin tashmë në Navu kur Sidni Rigdoni mbërriti. Shumica e pjesës së mbetur të Apostujve, duke përfshirë Brigam Jangun, u kthyen në Navu mbrëmjen e 6 gushtit 1844. Të nesërmen, më 7 gusht, Apostujt u mblodhën në këshill në shtëpinë e Xhon Tejlorit. Më vonë atë mbrëmje, Dymbëdhjetë Apostujt, këshilli i lartë dhe priftërinjtë e lartë u mblodhën së bashku. Presidenti Jang i kërkoi Sidni Rigdonit që t’ua thoshte mesazhin e tij shenjtoreve. Sidni Rigdoni haptazi shpalli se ai kishte parë një vegim dhe se askush nuk mund ta pasonte Jozef Smithin si President të Kishës. Ai më pas propozoi që ai të caktohej si kujdestari i njerëzve.

Pasi Sidni Rigdoni i përfundoi vërejtjet e tij, Brigam Jangu (1801–1877) tha:



“Unë nuk shqetësohem se kush e udhëheq kishën, ... por një gjë duhet ta di dhe ajo është çfarë Perëndia thotë rreth saj. Unë i kam çelësat dhe mjetet për ta fituar mendjen e Perëndisë për çështjen. ...

Jozefi dhuroi mbi kokat tona gjithë çelësat dhe fuqitë që i përkasin Apostullimit, të cilat i mbante ai vetë përpara se të merrej dhe asnjë njeri apo grup njerëzish nuk mund të hyjnë midis Jozefit dhe Të Dymbëdhjetëve në këtë botë apo në botën që do të vijë.

Sa shpesh u ka thënë Jozefi Të Dymbëdhjetëve: ‘Unë kam hedhur themelin dhe ju duhet të ndërtoni mbi të, sepse mbi shpatullat tuaja qëndron mbretëria’ ” (në *History of the Church*, 7:230).

8 gusht 1844, ora 10:00 e mëngjesit

Më 8 gusht 1844, shenjtoret në Navu u mblodhën në orën 10:00 për ta dëgjuar Sidni Rigdonin të bënte shpalljet e tij si kujdestar i Kishës. Ai u foli mijëra shenjtoreve të mbledhur për një orë e gjysmë, duke shpjeguar përse ai duhej të ishte kujdestari i Kishës. Disa njerëz e përkshkruan fjalimin e tij si jofrymëzues.

Presidenti Brigam Jang foli shkurtimisht dhe tha se ai do të kishte parapëlqyer të kthehej në Navu për të vajtuar për Profetin, sesa për të caktuar një udhëheqës të ri. Ai shpalli se një kuvend i udhëheqësve dhe anëtarëve do të mbahej më vonë atë ditë në orën 14:00. Disa anëtarë të Kishës më vonë dëshmuuan se, kur Brigam Jangu foli, ata e panë pamjen e tij të ndryshonte dhe e dëgjuan zërin e tij të ndryshonte, dhe ai mori mbi vete pamjen dhe zërin e Profetit Jozef Smith.

Emili Smith Hojti kujtoi: “Mënyra e arsyetimit, shprehja e fytyrës, tingëllimi i zërit ma emocionuan tërë shpirtin tim. ... E dija se Jozefi ishte i vdekur. Dhe prapëseprapë, unë shpesh u befasoja dhe pa dashje hodha vështrimin te podiumi që të shihja nëse nuk ishte Jozefi. Nuk ishte, ishte Brigam Jangu” (cituar te Lynne Watkins Jorgensen, “The Mantle of the Prophet Joseph Passes to Brother Brigham: A Collective Spiritual Witness”, *BYU Studies*, vëll. 36, nr. 4 [1996–1997], f. 142).

Uillford Udafi shkroi: “Nëse nuk do ta kisha parë me vetë sytë e mi, nuk do të mund të më kishte bindur askush se nuk ishte Jozef Smithi dhe cilido që i njihje këta dy burra, mund të dëshmojë për këtë” (në *History of the Church*, 7:236).

8 gusht 1844, ora 14:00

Në orën 14:00, mijëra shenjtorë u mbledhën për atë që e dinin se do të ishte një mbledhje e rëndësishme. Brigam Jangu foli haptazi rreth kujdestarisë së propozuar nga Sidni Rigdoni dhe ftohjes së tij kundrejt Jozef Smithit gjatë dy viteve të mëparshme dhe më pas tha:

“Nëse njerëzit duan që Presidenti Rigdon t’i udhëheqë, ata mund ta kenë atë; por unë ju them se Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve i ka çelësat e mbretërisë së Perëndisë në të gjithë botën.

Të Dymbëdhjetët caktohen nga gishti i Perëndisë. Ja ku është Brigami, a janë lëkundur ndonjëherë gjunjët e tij? A janë dridhur ndonjëherë buzët e tij? Ja ku është Hibër [C. Kimballi] dhe pjesa tjetër e Të Dymbëdhjetëve, një trup i pavarur që i kanë çelësat e priftërisë – çelësat e mbretërisë së Perëndisë për t’ia dorëzuar të gjithë botës; kjo është e vërtetë, prandaj Perëndia më ndihmoftë. Ata qëndrojnë pranë Jozefit dhe janë si Presidenca e Parë e Kishës” (në *History of the Church*, 7:233).

Shumë shenjtorë vërejtën se Brigam Jangu u duk dhe u foli si Jozef Smithi, teksa foli atë pasdite. Përveç kësaj mrekullie, shumë shenjtorë gjithashtu e ndien Frymën e Shenjtë t’iu dëshmonte atyre se Brigam Jangu dhe Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve u thirrën nga Perëndia për ta drejtuar Kishën. Në përfundim të kësaj mbledhjeje, shenjtorët në Navu votuan njëzëri për ta mbështetur Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve, me Brigam Jangun si drejtuesin e tyre, për ta udhëhequr Kishën. Megjithatë, jo të gjithë anëtarët e Kishës më së fundi zgjodhën t’i ndiqnin Apostujt. Disa nga njerëzit zgjodhën të ndiqnin në vend të tyre, individë të tillë si Sidni Rigdoni dhe Xhejms Strenqu, të cilët formuan kishat e tyre.

Largimi nga Navuja dhe Udhëtimi drejt Perëndimit

24

Nën udhëheqjen e frymëzuar të Brigam Jangut, shenjtorët e mbaruan ndërtimin e Tempullit të Navusë, ku ata bënë besëlidhje të shenjta përpara se të fillonin udhëtimin e tyre të mundimshëm drejt shtëpisë së tyre të re në Malet Shkëmbore. Këto besëlidhje të tempullit iu dhanë shenjtorëve forcë e frymëzim teksa përballeshin me vështirësi përgjatë udhës. Si trashëgues të trashëgimisë së këtyre shenjtorëve besnikë, ne mund të mësojmë nga shembujt e tyre dhe ta përgatitim udhën për të tjerët që t'i gëzojnë bekimet e ungjillit.

Lexim Konteksti

- Gordon B. Hinckley, “True to the Faith”, *Ensign*, maj 1997, f. 65–67.
- M. Russell Ballard, “You Have Nothing to Fear from the Journey”, *Ensign*, maj 1997, f. 59–61.
- *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 302–314, 329–336.

Sugjerime për Mësimdhënien

Përfundimi i Tempullit të Navusë

Paraqitni një figurë të Tempullit origjinal të Navusë ose përdorni një figurë të Tempullit të ri të Navusë në Illinois (shih *Libri i Figurave Artistike të Ungjillit* [2009], nr. 118). U thoni studentëve se, pasi shenjtorët e ditëve të mëvonshme u larguan nga Navuja, tempulli që kishin ndërtuar, u shkatërrua nga zjarri në vitin 1848 dhe më pas u rrafshua pothuajse plotësisht nga një tornado në vitin 1850. Rreth 150 vjet më vonë, u ndërtua një tempull i ri, i cili dukej mjaft i ngjashëm me origjinalin dhe u përkushtua në qershor të vitit 2002.

Shpjegoni se, pas martirizimit të Jozef Smithit, shenjtorët punuan nën drejtimin e Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve për ta përfunduar Tempullin origjinal të Navusë sa më shpejt që të ishte e mundur. Paraqitni thëniet vijuese dhe ftojini një student t'i lexojë ato me zë të lartë. Ftojini klasën të vërë në dukje sakrificat që bënë shenjtorët për ta ndërtuar Tempullin e Navusë:

“Më shumë se 1.000 burra dhuruan çdo ditë të dhjetë pune. Luiza Dekerit, një vajze të re, i bëri përshtypje që nëna shiti pjatat e saj prej porcelani dhe një jorgan të bukur, si kontributin e saj për tempullin. Shenjtorë të tjerë të ditëve të mëvonshme dhanë kuaj, karro, lopë, mish derri dhe grurë për të ndihmuar në ndërtimin e tempullit. Grave të Navusë iu kërkua të kontribuonin me dhjetëqindarkëshet dhe qindarkat e tyre për fondin e tempullit” (*Trashëgimia Jonë: Një Histori e Shkurtër e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme* [2010], f. 59).

Elisabet Teri Kërbi Hejuardi dha të vetmen pasuri që e kishte për ta dhënë – orën që e pati burri i saj, i cili kishte vdekur kohët e fundit. “E dhashë atë për të ndihmuar Tempullin e Navusë dhe gjithçka tjetër që mund të kurseja, dhe disa dollarë të fundit që i kisha në botë, të cilat së bashku përbënin shumën e gati 50 dollarëve” (cituar te Carol Cornwall Madsen, *In Their Own Words: Women and the Story of Nauvoo* [1994], f. 180).



Shpjegoni se, për shkak të përndjekjes në rritje ndaj shenjtorëve dhe kërcënimeve nga armiqtë e Kishës, udhëheqësit e Kishës shpallën më 24 shtator 1845 se shenjtorët do të largoheshin nga Navuja në pranverën e ardhshme. Pyetini studentët:

- Si mendoni se vendimi për t'u larguar nga Navuja mund t'i kishte ndikuar përpjekjet e shenjtorëve për ta përfunduar tempullin?

Shpjegojuni studentëve që, edhe pse shenjtorët e dinin se do t'u duhej të largoheshin nga Ilinoisi, ata i shtuan përpjekjet e tyre për ta përfunduar tempullin përpara se të largoheshin. Dhomat në tempull u përkushtuan ndërkohë që mbaroheshin, me qëllim që ordinancat të mund të kryheshin sa më shpejt që të ishte e mundur. Përpara vdekjes së tij, Profeti Jozef Smith kishte administruar në ceremoninë e dhurimit [indaumentit] të tempullit për një grup të vogël burrash e grash. Më 10 dhjetor 1845, këta burra e gra filluan të administronin ordinancat e tempullit për anëtarë të tjerë në dhomat e përkushtuara të tempullit. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë dy paragrafët vijues, të cilët përshkruajnë përpjekjet e shenjtorëve dhe të udhëheqësve të tyre për të siguruar që sa më shumë njerëz që të ishte e mundur, t'i mermin ordinancat e tempullit përpara se të largoheshin nga Navuja:

Nga viti 1844 deri në vitin 1846, Presidenti Brigam Jang dhe Dymbëdhjetë Apostujt e bënë përfundimin e Tempullit të Navusë një përparësi të ngutshme. Dhurimet [indaumentet] dhe vulosjet u kryen atje edhe përpara se të përfundohej ndërtimi. Brigam Jangu (1801–1877) shënoi: “Kaq i madh ka qenë ankthi i shfaqur nga shenjtorët për të marrë ordinancat [e Tempullit] dhe kaq i madh ankthi nga ana jonë për t'u administruar atyre, sa unë jam dhënë tërësisht pas punës së Zotit në Tempull natë e ditë, duke mos pasur më shumë se katër orë gjumë në ditë, si një mesatare, dhe duke shkuar në shtëpi vetëm një herë në javë” (në *History of the Church*, 7:567).

Përveç burrave që punonin në tempull, “tridhjetë e gjashtë gra u bënë punonjëse ordinance në Tempullin e Navusë, duke punuar njëzet e katër orë gjatë dimrit të viteve 1845–1846 për të administruar sa më shumë ordinance që të mundeshin përpara eksodit. ‘Punova në Tempull çdo ditë pa pushim derisa ai mbyllej’, kujtoi Elisabet En Uitni, një nga të tridhjetë e gjashtë gratë. ‘Ja kushtova veten time, kohën dhe vëmendjen time atij misioni.’ Duzina grash të tjera lanin rrobat dhe përgatitnin ushqime që ta mbështetnin fizikisht atë ndërmarrje të mrekullueshme” (Carol Cornwall Madsen, “Faith and Community: Women of Nauvoo”, te *Joseph Smith: The Prophet, The Man*, bot. Susan Easton Black dhe Charles D. Tate Jr. [1993], f. 233–234).

Shpjegoni se midis 10 dhjetorit 1845 dhe 2 shkurtit 1846 – data kur shenjtorët filluan të niseshin për udhëtimin e tyre drejt perëndimit – afërsisht 5.615 shenjtorë i morën ordinancat e dhurimit [indaumentit] në Tempullin e Navusë dhe familje të shumta u vulosën atje.

- Çfarë mund të mësojmë nga sakrificat e shenjtorëve për ta përfunduar tempullin, edhe kur e dinin se së shpejti ata do të largoheshin nga Navuja? (Studentët mund të përcaktojnë një larmi parimesh, të tilla si parimi që vijon: **Marrja e ordinancave të tempullit ia vlen gjithë përpjekjen dhe sakrificën tonë të drejtë.** Merreni parasysh ta shkruani këtë në tabelë për ta theksuar.)
- Në çfarë mënyrash mendoni se marrja e ordinancave të tempullit mund t'i kishte përgatitur ata që largoheshin nga Navuja për udhëtimin e tyre për më shumë se 1.600 kilometra që të gjenin strehim në Shtetet e Bashkuara perëndimore?

Për t'ju ndihmuar që t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje, paraqitni thëniet vijuese nga Motra Sara Riç dhe Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe kërkojini një student t'i lexojë ato me zë të lartë:



“Nëse nuk do të kishte qenë për besimin dhe diturinë që na u dha neve në atë tempull, me anë të ndikimit dhe ndihmës së Shpirtit të Zotit, udhëtimi ynë do të kishte qenë si një njeri duke hedhur një hap në errësirë” (Sarah Rich, cituar në *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* [2011], f. 30).



“Paraardhësit tanë pionierë u vulosën së bashku si familje në Navu. Besëlidhjet e tyre me Zotin në Tempullin e Navusë ishin një mbrojtje për ta gjatë udhëtimit të tyre drejt perëndimit, sikurse është për secilin prej nesh sot dhe gjatë gjithë jetës sonë. ...

Për këta shenjtorë të hershëm, pjesëmarrja e tyre në ordinancat e tempullit ishte thelbësore për dëshmitë e tyre, ndërkohë që ata përballëshin me vështirësi, turma të egërsuara, dëbimin nga shtëpitë e rehatshme në Navu dhe udhëtimin e gjatë e të vështirë përpara tyre. Atyre u qe dhuruar fuqi në tempullin e shenjtë. Bashkëshorti e bashkëshortja u vulosën me njëri-tjetrin. Fëmijët u vulosën me prindërit e tyre. Shumë njerëz humbën pjesëtarë të familjes që vdiqën përgjatë rrugës, por ata e dinin se ky nuk ishte fundi për ta. Ata ishin vulosur në tempull për gjithë përjetësinë” (Robert D. Hales, “Temple Blessings”, *New Era*, shkurt 2014, f. 4).


Pyetini studentët:

- Çfarë ndikimi pati marrja e ordinancave të tempullit mbi shenjtorët e hershëm të ditëve të mëvonshme, të cilët u detyruan të bënin udhëtimin e gjatë drejt perëndimit? (Teksa studentët japin përgjigjet e tyre, ndihmojini të kuptojnë parimin vijues: **Ordinancat e tempullit mund të na sigurojnë mbrojtje e forcë kur përballemi me kohë të vështirësisë dhe të fatkeqësisë.**)
- Si ju ka mbrojtur dhe forcuar adhurimi në tempull juve ose ata që njihni gjatë periudhave të sprovsë?

Nxitini studentët të përsiatin rreth asaj që mund të bëjnë për të gjetur mbrojtje dhe forcë më të madhe shpirtërore nëpërmjet adhurimit në shtëpinë e Zotit.

Doktrina e Besëlidhje 136

Udhëzimet e Zotit për ata që udhëtonin drejt perëndimit



Ftojini studentët të kthehen te Hartat e Historisë së Kishës, nr. 6, “Lëvizja e Kishës Drejt Perëndimit” dhe kërkojuni atyre të gjejnë Navunë dhe Lagjet Dimërore. Shpjegoni se për shkak të shiut të shumtë dhe pajisjeve të pamjaftueshme, shenjtorët që u larguan nga Navuja në shkurt të vitit 1846, harxhuan katër muaj për të bërë

udhëtimin prej 480 kilometrash përmes Ajouas. Gjatë kësaj kohe, më shumë se 500 burra shenjtorë të ditëve të mëvonshme – të cilët u bënë të njohur si Batalioni Mormon – ia vunë veshin thirrjes së Presidentit Brigham Jang që të përfshiheshin në Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara për të shërbyer gjatë luftës së Shteteve të Bashkuara me Meksikën. Disa prej burrave u shoqëruan nga gratë dhe fëmijët e tyre. Shërbimi i tyre do të siguronte para për të ndihmuar anëtarët e varfër të Kishës që ta bënin udhëtimin drejt perëndimit, por shumë familje u lanë pa bashkëshortët dhe etërit për një pjesë të udhëtimit të tyre drejt perëndimit. Për këto arsye, udhëheqësit e Kishës vendosën të mos vazhdonin për në perëndim drejt Maleve Shkëmbore deri në pranverën e vitit 1847. Shenjtorët u vendosën në një vend të quajtur Lagjet Dimërore. Ishte atje që Brigham Jangu e mori zbuluesën e shënuar të Doktrina e Besëlidhje 136.

Ftojini disa studentë që të lexojnë me radhë, me zë të lartë nga Doktrina e Besëlidhje 136:1–5. Vëreni klasën t’i ndjekë, duke kërkuar atë që Zoti i udhëzoi shenjtorët të bënin që të përgatiteshin për të vazhduar udhëtimin e tyre drejt perëndimit.

- Si duhej të organizoheshin kompanitë? Si mendoni se ky organizim do t’i kishte ndihmuar shenjtorët në udhëtimin e tyre?
- Si është ky organizim i ngjashëm me mënyrën se si organizohet Kisha sot? (Pasi studentët të përgjigjen, ju mund të doni ta shkruani në tabelë të vërtetën vijuese: **Zoti i organizon shenjtorët e Tij në grupe, me qëllim që çdo njeri të mund të marrë udhërrëfim e përkujdesje.**)
- Çfarë sugjeron vargu 4 rreth mënyrës se si shenjtorët do të merrnin forcë në përpjekjet e tyre që ta përmbushnin vullnetin e Perëndisë?

Caktojini studentët të studiojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 136:6–11, duke kërkuar mënyra se si shenjtorët duhej të organizoheshin që të përkujdeseshin për nevojat e njëri-tjetrit dhe që t’i ndihmonin të varfrit e nevojtarët gjatë udhëtimit drejt perëndimit. Pas një kohe të mjaftueshme, merrni parasysht të bëni pyetjet vijuese për ta udhëhequr diskutimin:

- Cilat fjalë ose fraza të vargjet 6–11 tregojnë se si shenjtorët duhej të kujdeseshin për njëri-tjetrin dhe për nevojtarët? (Ju mund të theksoni fjalët “përgatitur” dhe “përgatisë” të vargjet 6, 7 dhe 9. Kjo do ta tërheqë vëmendjen tek aftësia e studimit të shkrimeve të shenjta për të mësuar se si të dallohet përsëritja.)
- Sipas vargut 11, cilat janë premtimet e Zotit ndaj atyre që përpiqen t’i ndihmojnë të tjerët dhe të përgatitin udhën për ta? (Ndërsa studentët përgjigjen, shkruani në tabelë parimin vijues: **Zoti do të na bekojë kur i ndihmojmë të tjerët dhe e përgatitim udhën për ta.**)
- Kush e ka përgatitur udhën për ju që t’i gëzoni bekimet e ungjillit? Çfarë bënë ata që ta përgatitnin udhën për ju?

Ju mund të doni të shpjegoni se fjala *pionier* mund të përcaktohet si një njeri që shkon përpara për të përgatitur ose hapur udhën për të tjerët që ta ndjekin, domethënë që të gjithë ne mund të jemi pionierë në shumë mënyra. Jepuni studentëve një çast që të përsiatin atë që mund të bëjnë për t’i ndihmuar të tjerët dhe për ta përgatitur udhën për ta që t’i gëzojnë bekimet e ungjillit. Ftojini disa studentë të japin mendimet e tyre. Jepni dëshmi se Zoti dëshiron që ne të përpiqemi gjatë gjithë jetës sonë për të ndihmuar që ta përgatitim udhën për secilin prej fëmijëve të Tij për ta marrë ungjillin dhe për t’u kthyer që të jetojë me Të.

Shpjegoni se shenjtoret iu binden urdhrave të Zotit duke e ndihmuar njëri-tjetrin dhe duke e përgatitur udhën për ata që vinin pas tyre. Grupi i parë i pionierëve u largua nga Lagjet Dimërore më 5 prill 1847. Ata udhëtuan më shumë se 1.600 kilometra dhe mbërritën në luginën e Solt-Lejkut në fund të korrikut të vitit 1847. Më 24 korrik 1847, Presidenti Brigam Jang hyri në luginë dhe mori pohimin që shenjtoret e kishin gjetur shtëpinë e tyre të re.

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Uilliam R. Uolker, një ish-anëtar i Të Shtatëdhjetëve, dhe kërkojini një student të ta lexojë me zë të lartë:



“Nëse jeni apo jo pasardhës i pionierëve, trashëgimia e besimit dhe sakrificës së pionierëve mormonë është trashëgimia juaj. Ajo është trashëgimia fisnike e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme” (“Jeto i Vërtetë ndaj Besimit”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2014, f. 97).

- Si mendoni, përse është e rëndësishme për çdo anëtar të Kishës që të kuptojë se “trashëgimia e besimit dhe sakrificës së pionierëve mormonë” është trashëgimia e tyre, pavarësisht nga prejardhja e tyre?
- Në çfarë mënyrash të mësuarit rreth udhëtimit të pionierëve mormonë mund t’i frymëzojë anëtarët e Kishës sot në përpjekjet e tyre për t’u shërbyer të tjerëve dhe për t’i ndihmuar ata në udhëtimin e tyre për t’u kthyer tek Ati Qiellor?

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) dhe kërkojini një student të ta lexojë me zë të lartë:



“Ne qëndrojmë sot si marrësit e përpjekjes së madhërishme të [pionierëve]. Shpresoj të jemi falënderues. Shpresoj se ne mbartim në zemrat tona një ndjenjë të thellë mirënjohjeje për të gjitha gjërat që ata kanë bërë për ne. ...

Vëllezërit e motrat e mia të dashura, sa të bekuar jemi! Ç’trashëgimi të mrekullueshme që kemi! Ajo përfshiu sakrificën, vuajtjen, vdekjen, vegimin, besimin e diturinë dhe një dëshmi për Perëndinë, Atin e Amshuar dhe Birin e Tij, Zotin e ringjallur, Jezu Krishtin. ...

Ne i nderojmë më mirë ata që kanë shkuar përpara nesh, kur shërbejmë mirë në kauzën e së vërtetës” (“True to the Faith”, *Ensign*, maj 1997, f. 66–67).

Kujtojini studentët se çdo anëtar i Kishës është bekuar nga të tjerët, të cilët e përgatitën udhën për ta që t’i gëzonin bekimet e ungjillit. Nxitini studentët të marrin parasysh atë që mund të bëjnë për t’i përgatitur të tjerët, duke përfshirë pasardhësit e tyre, që të jetojnë me besim e bindje ndaj Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 136.
- Gordon B. Hinckley, “True to the Faith”, *Ensign*, maj 1997, f. 65–67.
- “Besim në Çdo Hap”, kapitulli 6 te *Trashëgimia Jonë: Një Histori e Shkurtër e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme* (2010), f. 69–80.

25

Lufta e Jutas dhe Masakra e Livadheve Malore

Gjatë viteve 1850, tensioni dhe keqkomunikimi midis shenjtorëve të ditëve të mëvonshme dhe zyrtarëve të qeverisë së Shteteve të Bashkuara çuan drejt Luftës së Jutas të viteve 1857–1858. Në shtator të vitit 1857, disa shenjtorëve të ditëve të mëvonshme në Territorin e Jutas jugore dhe anëtarëve të një vargu me karro emigrantësh në udhë e sipër drejt Kalifornisë, iu lindi një mosmarrëveshje dhe shenjtorët e ditëve të mëvonshme, të nxitur nga zemërimi e frika, planifikuan dhe kryen masakrën e rreth 120 emigrantëve. Kjo mizori tani njihet si Masakra e Livadheve Malore.

Lexim Konteksti

- Richard E. Turley Jr., “The Mountain Meadows Massacre”, *Ensign*, shtator 2007, f. 17–21.
- “Peace and Violence among 19th-Century Latter-day Saints”, Gospel Topics, [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics).
- Henry B. Eyring, “150th Anniversary of Mountain Meadows Massacre”, 11 shtator 2007, [mormonnewsroom.org/article/150th-anniversary-of-mountain-meadows-massacre](https://www.mormonnewsroom.org/article/150th-anniversary-of-mountain-meadows-massacre).

Sugjerime për Mësimdhënien

Gjendje e tensionuar krijohet midis shenjtorëve të hershëm të ditëve të mëvonshme dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara


Shpërndajini një kopje të fletushkës në fund të mësimit secilit student. Kërkojini një student të lexojë me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “Rritja e Tensionit Çoi drejt Luftës së Jutas”.

- Nëse ju do të kishit qenë një shenjtor i ditëve të mëvonshme në vitin 1857 dhe do të kishit dëgjuar se një ushtri e madhe po i afrohej qytetit tuaj, çfarë shqetësimesh mund të kishit pasur? (Studentët mund të përmendin se shenjtorët ishin dëbuar dhunshëm nga Ohajo, Misuri dhe Ilinoisi; shumë njerëz kishin humbur zotërimi të vlefshme dhe tokë; dhe disa shenjtorë ishin vrarë ose kishin vdekur gjatë këtyre përndjekjeve. Lajmi i afrimit të ushtrisë shkaktoi që disa shenjtorë të shqetësoheshin se ngjarje të tilla mund të ndodhnin edhe në Juta.)

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “Përgatitja për ta Mbrojtur Territorin”.



Mosmarrëveshje lindi midis shenjtorëve të ditëve të mëvonshme dhe anëtarëve të një vargu me karro emigrantësh



Paraqitni një hartë të ngjashme me atë që tregohet këtu, ose vizatoni një hartë në tabelë.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “Mosmarrëveshje me Vargun e Karrove të Emigrantëve”.

Ftojini studentët të mendojnë për raste kur kanë përjetuar mosmarrëveshje me një njeri tjetër apo me një grup njerëzish. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë 3 Nefin 12:25. Vëreni klasën ta ndjekë, duke kërkuar një parim që Jezu Krishti e dha mësim, i cili mund të na udhëzojë kur përjetojmë gjendje të tensionuar me të tjerët.

- Çfarë mendoni se do të thotë “merru vesh shpejt me kundërshtarin tënd”?

Për t’i ndihmuar studentët ta kuptojnë këtë frazë, ju mund të doni ta vini një student të lexojë me zë të lartë thënien vijuese nga Plaku Dejvid E. Sorensen, i Të Shtatëdhjetëve:



“Shpëtimtari tha: ‘Merru vesh shpejt me kundërshtarin tënd ...’, në këtë mënyrë duke na urdhëruar që t’i zgjidhim herët mosmarrëveshjet tona, përndryshe pasionet e çastit rriten deri në egërsi fizike ose emocionale dhe ne bëhemi robër të zemërimit tonë” (“Forgiveness Will Change Bitterness to Love”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2003, f. 11).

- Si do ta përmbledhnit mësimin e dhënë nga Shpëtimtari te 3 Nefi 12:25? (Ndërsa studentët përgjigjen, shkruani në tabelë një parim të ngjashëm me sa vijon: **Nëse e zgjidhim mosmarrëveshjen me të tjerët sipas mënyrës së Zotit, atëherë ne mund t’i shmangim pasojat e dëmshme të grindjes.**)
- Si mund ta kishin vënë në zbatim këtë parim ata që komplotuan për t’i dëmtuar anëtarët e vargut të karrove?

Vëreni një student të lexojë me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “Rritja e Kundërvënies”.

- Çfarë duhej të kishin bërë udhëheqësit e Kishës në Sidër-Siti kur Uilliam Dejmi i këshilloi të mos e përdornin milicinë? Në çfarë i çoi të bënin më pas mospranimi i

këshillës? (Pasi studentët të përgjigjen, shkruani në tabelë parimin vijues: **Nëse e shpërfillim këshillën për të bërë atë që është e drejtë, atëherë ne bëhemi më të cenueshëm që të bëjmë zgjedhje të gabuara dhe madje mëkatore.** Ju mund të vini në dukje që ka urtësi të madhe në sistemin e këshillëve me anë të të cilit qeveriset Kisha.)

Ftojini disa studentë të lexojnë me radhë, me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “Sulmi mbi Emigrantët” dhe ftojini studentët të kërkojnë mënyrën se si udhëheqësit e Sidër-Sitit vazhduan të bënin zgjedhje mëkatore pasi e shpërfillën këshillën që kishin marrë.

- Çfarë erdhi si pasojë e vendimit të udhëheqësve të Sidër-Sitit për të mos iu bindur këshillës së Uilliam Dejmit, komandantit të milicisë?
- Në këtë pikë, çfarë zgjedhjesh kishin ata që ishin përgjegjës për sulmet? (Ata mund të rrëfenin se ç’kishin bërë dhe të pranonin pasojat ose ata mund të përpiqeshin t’i fshihnin krimet dhe mëkatet e tyre.)

Ftojini studentët të përsiatin pyetjet vijuese:

- Çfarë bëni ju kur bëni diçka të gabuar? A rrëfeni se ç’keni bërë gabim dhe i pranoni pasojat, apo përpiqeni ta fshihni mëkatën nëpërmjet mashtrimit?

Disa shenjtore të ditëve të mëvonshme planifikuan dhe kryen Masakrën e Livadheve Malore

Shpjegoni se anëtarët e Kishës, të përfshirë në sulmet kundër emigrantëve, zgjodhën të përpiqeshin t’i fshihnin mëkatet e tyre. Ftojini klasën të dëgjojë se çfarë ndodhi si rrjedhim i këtij vendimi, ndërkohë që studentët e bëjnë me radhë duke lexuar me zë të lartë pjesët në fletushkë të titulluara “Masakra e Livadheve Malore” dhe “Pasoja Tragjike”.

Shpjegoni se zgjedhjet e disa prej udhëheqësve dhe kolonëve shenjtore të ditëve të mëvonshme në Territorin jugor të Jutas, çuan në Masakrën tragjike të Livadheve Malore. Në dallim nga kjo, udhëheqësit e Kishës dhe të territorit në Solt-Lejk-Siti e zgjidhën mosmarrëveshjen me qeverinë e Shteteve të Bashkuara nëpërmjet bisedimeve paqësore dhe negociatave në vitin 1858. Gjatë kësaj mosmarrëveshjeje – më vonë e quajtur Lufta e Jutas – trupat e Shteteve të Bashkuara dhe milicët e Jutas u përfshinë në veprime ndeshjeje, por kurrë në betejë.

- Si do t’i përmblihdhni zgjedhjet që çuan drejt Masakrës së Livadheve Malore?
- Çfarë parimesh mund të mësojmë nga kjo tragjedi? (Studentët mund të përcaktojnë parime të ndryshme, duke përfshirë sa vijon: **Të zgjedhurit e fshehjes së mëkateve tona mund të na çojë drejt kryerjes së mëkateve të mëtejshme. Të zgjedhurit e fshehjes së mëkateve tona mund të sjellë keqardhje dhe vuajtje.**)

Sigurojini studentët që, në qoftë se kanë filluar të ecin përgjatë një shtegu gabimesh dhe mëkati, ata mund t’i parandalojnë dhembjen dhe keqardhjen e ardhshme duke u kthyer te Zoti dhe duke u penduar për mëkatet e tyre.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë pjesën në fletushkë të titulluar “Udhëheqësit e Kishës Mësuan për Masakrën”.

Shpjegoni se, ngaqë një numër shenjtoreësh vendorë të ditëve të mëvonshme ishin përgjegjës për planifikimin dhe kryerjen e Masakrës së Livadheve Malore, disa njerëz e kanë lejuar këtë ngjarje ta ndikojë për keq pikëpamjen e tyre për të gjithë Kishën.

- Përse është e rëndësishme të kuptojmë se veprimet e gabuara të disa anëtarëve të Kishës nuk e përcaktojnë vërtetësinë e ungjillit?

Ftojini një student të lexojë thënien nga Presidenti Henri B. Ajring, i Presidencës së Parë, që gjendet në pjesën e fletushkës të titulluar “150-Vjetori i Masakrës së Livadheve Malore”.

- Si duhet të përgjigjemi kur mësojmë për raste kur anëtarët e Kishës nuk kanë arritur të jetojnë sipas mësimëve të Jezu Krishtit?

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Helamanin 5:12. Vëreni klasën ta ndjekë, duke kërkuar atë që mund të bëjmë ne për t’i zhvilluar e ruajtur dëshmitë tona, me qëllim që gjatë kohëve të vështira, të tilla si ato kur mësojmë për raste kur anëtarë të Kishës nuk kanë arritur që të jetojnë sipas mësimëve të Jezu Krishtit, besimi ynë nuk do të lëkundet.

- Sipas Helamanit 5:12, çfarë mund të bëjmë për t’i zhvilluar dhe ruajtur dëshmitë tona? (Pasi studentët të përgjigjen, ju mund të doni të shkruani në tabelë parimin vijues: **Ne mund të zhvillojmë dëshmi të forta duke e ngritur besimin tonë mbi themelin e Jezu Krishtit.**)

Për ta ilustruar këtë parim, paraqitni përkufizimin vijues dhe ftojini një student ta lexojë atë me zë të lartë:

“Xhejms Sandersi është stërnipi i ... një prej fëmijëve që i mbijetuan masakrës [dhe është gjithashtu anëtar i Kishës]. ... Vëllai Sanders ... tha se të mësuarit që paraardhësi i tij ishte vrarë në masakrën ‘nuk e ndikoi besimin tim, sepse ai bazohet te Jezu Krishti, jo te ndonjë njeri në Kishë’ ” (Richard E. Turley Jr., “The Mountain Meadows Massacre”, *Ensign*, shtator 2007, f. 21).

- Si mund të na forcojë besimi ynë te Jezu Krishti kur mësojmë për raste kur anëtarë të Kishës nuk kanë arritur të jetojnë sipas mësimëve të Shpëtimtarit?
- Çfarë bëni që ju ndihmon për ta ngritur besimin tuaj mbi themelin e Jezu Krishtit?

Dëshmoni për rëndësinë e të jetuarit të mësimëve të Shpëtimtarit dhe të bazuarit të besimit tonë tek Ai dhe tek ungjilli i Tij. Ftojini studentët të përsiatin se si ata mund ta ngrenë më mirë besimin e tyre mbi themelin e Jezu Krishtit dhe të caktojnë një synim për ta bërë këtë.

Materiale Leximi për Studentin

- “Peace and Violence among 19th-Century Latter-day Saints”, Gospel Topics, [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics).
- Richard E. Turley Jr., “The Mountain Meadows Massacre”, *Ensign*, shtator 2007, f. 17–21.

Lufta e Jutas dhe Masakra e Livadheve Malore

Rritja e Tensionit Çoi drejt Luftës së Jutas

Tre vjet pasi pionierët e parë shenjtore të ditëve të mëvonshme mbërritën në Luginën e Solt-Lejkut, qeveria e Shteteve të Bashkuara organizoi Territorin e Jutas dhe e caktoi Brigam Jangun si guvernatorin e parë të territorit. Në mes të vitit 1857, udhëheqës të shenjtoreve të ditëve të mëvonshme dëgjuan thashetheme se qeveria federale mund ta zëvendësonte Brigam Jangun me një guvernator të ri të Territorit të Jutas, i cili do të mbështetej nga një numër i madh trupash federale. Më 24 korrik 1857 Presidenti Brigam Jang ishte me një grup shenjtoreësh duke festuar përvjetorin e 10-të të mbërritjes së

tyre në Luginën e Solt-Lejkut, kur mori vërtetimin e lajmit të mëparshëm se një ushtri po vinte drejt Solt-Lejk-Sitit.

Në vitet e shkuara, mosmarrëveshjet dhe keqkomunikimet kishin çuar në një gjendje të tensionuar në rritje midis shenjtorëve të ditëve të mëvonshme dhe zyrtarëve të qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Shenjtorët dëshironin të qeveriseshin nga udhëheqës që do t'i zgjidhnin vetë dhe i kishin hedhur poshtë udhëheqësit e caktuar federalë, të cilët nuk kishin të njëjtat vlera me ta, disa prej të cilëve ishin të pandershëm, të korruptuar dhe të pamoralshëm. Disa nga zyrtarët federalë besonin se veprimet dhe sjelljet e shenjtorëve nënkuptonin që ata ishin në kryengritje ndaj qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Xhejms Bjukenën, dërgoi afërsisht 2.500 trupa drejt Solt-Lejk-Sitit për ta shoqëruar guvernatorin e ri në mënyrë të sigurt për në Juta dhe për ta shtypur atë që ai mendoi se ishte një kryengritje mes shenjtorëve. Ky vendim u mor pa informacionin e duhur rreth situatës në Juta (shih *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të [Church Educational System manual, 2003], f. 368–371).

Përgatitja për të Mbrojtur Territorin

Në predikime drejtuar shenjtorëve, Presidenti Jang dhe udhëheqës të tjerë të Kishës i përshkruan trupat që po afroreshin si armiq. Ata patën frikë që trupat mund t'i dëbonin shenjtorët nga Juta, siç ishin larguar më parë nga Ohajo, Misuri dhe Ilinoisi. Presidenti Jang, i cili prej vitesh u kishte kërkuar shenjtorëve të kursenin drithëra, i ripërtëriu udhëzimet e tij me qëllim që ata të kishin ushqime për të ngrënë nëse do të nevojitej të iknin prej trupave. Si guvernator i Territorit të Jutas, ai gjithashtu e udhëzoi milicinë e territorit që të përgatitej për ta mbrojtur territorin.

Mosmarrëveshja me Vargun e Karrove të Emigrantëve

Një varg me karro emigrantësh duke udhëtuar drejt perëndimit nga Arkanzasi për në Kaliforni, hyri në Juta ndërkohë që shenjtorët e ditëve të mëvonshme po përgatiteshin për ta mbrojtur territorin nga trupat në ardhje të Shteteve të Bashkuara. Disa anëtarë të vargut me karro u merrtën ngaqë hasën një kohë të vështirë për të blerë drithërat kaq të nevojshme nga shenjtorët, të cilët ishin udhëzuar ta vinin në ruajtje drithin e tyre. Emigrantët gjithashtu patën mosmarrëveshje me shenjtorët të cilët nuk donin që numri i madh i kuajve dhe qeve të vargut të karrove të përdornin burimet e ushqimit dhe të ujit që shenjtorëve u nevojiteshin për vetë kafshët e tyre.

Gjendja e tensionuar shpërtheu në Sidër-Siti, kolonia e fundit në Juta në rrugën për në Kaliforni. Ndodhën përplasje ndërmjet disa prej anëtarëve të vargut të karrove dhe disa prej shenjtorëve të ditëve të mëvonshme. Disa anëtarë të vargut të karrove kërcënuan se do të bashkoheshin me trupat në ardhje të qeverisë kundër shenjtorëve. Edhe pse kapiteni i vargut të karrove i qortoi shokët e tij që i bënë këto kërcënime, disa udhëheqës dhe kolonë në Sidër-Siti i panë emigrantët si armiq. Kompania e karrove u largua nga qyteti vetëm gati një orë pasi mbërriti, por disa nga kolonët dhe udhëheqësit në Sidër-Siti deshën t'i përndiqnin dhe t'i ndëshkonin burrat që i kishin fyer ata.

Përsheptimi i Kundërvënies

Ngaqë këta shenjtorë nuk e zgjidhën mosmarrëveshjen e tyre me emigrantët sipas mënyrës së Zotit, gjendja u bë shumë më e rëndë. Isak Heiti, kryetari i bashkisë së Sidër-Sitit, majori i milicisë dhe presidenti i kunjtit, kërkoi leje nga komandanti i milicisë, i cili jetonte në koloninë aty pranë, në Parouan, që të thërriste milicinë për t'u ballafaquar me njerëzit që i kishin fyer nga vargu i karrove. Komandanti i milicisë, Uilliam Dejmi, një anëtar i Kishës, e këshilloi Isak Heitin që të mos i përfillte kërcënimet e emigrantëve. Në vend që t'ia vinte veshin kësaj këshille, Isak Heiti dhe udhëheqës të tjerë të Sidër-Sitit vendosën t'ua mbushnin mendjen disa indianëve vendas që ta sulmonin vargun e karrove dhe t'ua vidhnin gjedhët, si një mënyrë ndëshkimi për emigrantët. Isak Heiti i kërkoi Xhon D. Lisë, një anëtar i vendor të Kishës dhe major i milicisë, që ta udhëhiqte këtë sulm dhe që të dy planifikuan t'ua hidhnin fajin indianëve për veprimin.

Sulmi mbi Emigrantët

Isak Heiti ia paraqiti planin për ta sulmuar vargun e karrove një këshilli të udhëheqësve vendorë në Kishë, komunitet dhe milici. Disa anëtarë të këshillit nuk ishin aspak dakord me planin dhe i kërkuan Heitit nëse ishte këshilluar me Presidentin Brigam Jang lidhur me çështjen. Duke thënë se nuk ishte këshilluar, Heiti ra dakord të dërgonte një lajmëtar, Xhejms Haslamin, për në Solt-Lejk-Siti me një letër që shpjegonte gjendjen dhe që kërkonte se çfarë duhej të bëhej. Megjithatë, ngaqë Solt-Lejk-Siti ishte rreth 400 km larg nga Sidër-Siti, do të duhej për lajmëtarin rreth një javë vrapimi të shpejtë me kalë për të arritur në Solt-Lejk-Siti dhe për t'u kthyer në Sidër-Siti me udhëzimet e Presidentit Jang.

Pak kohë përpara se Isak Heiti të dërgonte letrën e tij me lajmëtarin, Xhon D. Lija dhe një grup indianësh e sulmuan kampin e emigrantëve në një vend të quajtur Livadhet Malore. Lija e udhëhoqi sulmin, por e fshehu identitetin e tij, që të dukej se u përfshinë vetëm indianët. Disa prej emigrantëve u vranë ose u plagosën dhe pjesa e mbetur i luftuan sulmuesit e tyre, duke i detyruar Linë dhe indianët të tërhiqeshin. Emigrantët shpejt i tërhoqën karrot e tyre në një rreth të ngushtë, ose një vathë, për mbrojtje. Dy sulme shtesë pasuan gjatë një rrethimi pesëditor mbi vargun e karrove.

Në një rast, milicët e Sidër-Sitit mësuan për dy burra emigrantë që ishin jashtë vathës së karrove. Milicët qëlluan mbi ta, duke e vrarë njërin. Burri tjetër shpëtoi dhe ia solli lajmin kampit të karrove që burra të bardhë ishin të përfshirë në sulmet kundër tyre. Ata që i planifikuan sulmet, u zunë tani në mashtrimin e tyre. Nëse emigrantët lejoheshin të shkonin në Kaliforni, lajmi do të shpërndahej që shenjtorët e ditëve të mëvonshme ishin përgjegjës për sulmin ndaj vargut të karrove. Komplotuesit patën frikë se ky lajm do të sillte pasoja të këqija mbi ta dhe njerëzit e tyre.

Masakra e Livadheve Malore

Në përpjekje për të ndalur përhapjen e lajmit që shenjtorët e ditëve të mëvonshme u përfshinë në sulmet ndaj vargut të karrove, Isak Heiti, Xhon D. Lija dhe udhëheqës të tjerë vendorë të Kishës e të milicisë bënë plan që t'i vrisnin të gjithë emigrantët e mbetur, me përjashtim të fëmijëve të vegjël. Duke e vënë në jetë këtë plan, Xhon D. Lija iu afrua emigrantëve dhe u tha se milicia do t'i mbronte nga sulmet e mëtejshme, duke i drejtuar ata që të ktheheshin përsëri të sigurt drejt Sidër-Sitit. Ndërsa emigrantët po ecnin drejt Sidër-Sitit, milicët u kthyen dhe qëlluan mbi ta. Disa indianë, të rekrutuar nga kolonët, u vërsulën nga vendet e fshehjes për t'u bashkuar me sulmin. Nga rreth 140 emigrantë që ishin pjesë e vargut të karrove, u kursyen vetëm 17 fëmijë të vegjël.

Dy ditë pas masakrës, Xhejms Haslami mbërriti në Sidër-Siti me mesazhin e përgjigjes nga Presidenti Jang, që i udhëzonte udhëheqësit vendorë ta lejonin vargun e karrove të largohej në paqe. Kur Heiti i lexoi fjalët e [Presidentit] Jang, ai derdhi lot si fëmijë dhe mundi të thoshte vetëm fjalët: 'Shumë vonë, shumë vonë' (Richard E. Turley Jr., "The Mountain Meadows Massacre", *Ensign*, shtator 2007, f. 20).

Pasoja Tragjike

Masakra e Livadheve Malore jo vetëm që shkaktoi vdekjen e rreth 120 viktimave, por shkaktoi edhe vuajtje të madhe për fëmijët që mbijetuan dhe për të afërmit e tjerë të viktimave. Disa shenjtorë të ditëve të mëvonshme i morën në shtëpitë e tyre dhe u përkujdesën për fëmijët emigrantë që i mbijetuan masakrës. Në vitin 1859, zyrtarë federalë morën kujdestarinë për këta fëmijë dhe i kthyen tek të afërmit në Arkanzas. Indianët pajutë gjithashtu vuajtën ngaqë u fajësuan padrejtësisht për krimin.

Udhëheqësit e Kishës Mësuan për Masakrën

"Edhe pse Brigam Jangu dhe udhëheqës të tjerë të Kishës në Solt-Lejk-Siti mësuan për masakrën pak kohë pasi ndodhi, kuptueshmëria e tyre lidhur me gjerësinë e përfshirjes së kolonëve dhe hollësitë e tmerrshme të krimit erdhën pjesë-pjesë me kalimin e kohës. Në vitin 1859 ata i liruan nga thirrjet e tyre presidentin e kunjit, Isak Heitin, dhe udhëheqës të tjerë të njohur të Kishës në Sidër-Siti, të cilët patën rol në masakër. Në vitin 1870 ata i shkishëruan Isak Heitin dhe Xhon D. Linë nga Kisha.

Në vitin 1874 një juri gjyqësore territoriale akuzoi nëntë burra për rolin e tyre në masakër. Shumica prej tyre më së fundi u arrestuan, edhe pse vetëm Xhon D. Lija u gjykua, dënua dhe u ekzekutua për krimin.

Një tjetër burrë i akuzuar që u kthye në dëshmitar për shtetin, [në mënyrë vullnetare dëshmoi dhe dha prova kundër të pandehurve të tjerë] dhe burra të tjerë kaluan shumë vjet duke iu shmangur ligjit. Milicë të tjerë, të cilët e kryen masakrën, vepruan gjatë pjesës së mbetur të jetës së tyre me ndjenjën e tmerrshme të fajit dhe të ëndrrave të këqija, të herëpashershme, për atë që kishin bërë dhe parë” (Richard E. Turley Jr., “The Mountain Meadows Massacre”, *Ensign*, shtator 2007, f. 20).

150-Vjetori i Masakrës së Livadheve Malore

Presidenti Henri B. Ajring, i Presidencës së Parë, tha:

“Përgjegjësia për [Masakrën e Livadheve Malore] qëndron me udhëheqësit vendorë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në krahinat pranë Livadheve Malore, të cilët mbanin edhe detyra civile e ushtarake, dhe me anëtarët e Kishës që vepruan nën drejtimin e tyre. ...

... Ungjilli i Jezu Krishtit që ne përkrahim, e urren vrasjen gjakftohtë të burrave, grave dhe fëmijëve. Në të vërtetë, ai përkrah paqen dhe faljen. Çfarë u bë [te Livadhet Malore] shumë kohë më parë nga anëtarë të Kishës sonë përfaqëson një largim të tmerrshëm dhe të pajustificueshëm nga mësimet dhe sjellja e krishterë. ... Pa asnjë dyshim Drejtësia Hyjnore do ta ngarkojë ndëshkimin e duhur mbi ata që ishin përgjegjës për masakrën. ...

... Na bekoftë Perëndia i Qiellit, bijtë dhe bijat e të cilin ne të gjithë jemi, që t’i nderojmë ata që vdiqën këtu duke shtrirë drejt njëri-tjetrit dashurinë e pastër dhe shpirtin e faljes, të cilat i përfaqëson Biri i Tij i Vetëmlindur” (“150th Anniversary of Mountain Meadows Massacre”, 11 shtator 2007, mormonnewsroom.org/article/150th-anniversary-of-mountain-meadows-massacre).

Gjatë shekullit të 20-të, ndërkohë që puna misionare u përhap anembanë tokës, udhëheqësit e Kishës u lutën për udhërrëfim lidhur me kufizimet e shugurimit në priftëri dhe të ordinancave të tempullit për anëtarët e Kishës me prejardhje afrikane. Një zbuluesë përfundimtare u erdhi Presidentit Spenser W. Kimball, këshilltarëve të tij në Presidencën e Parë dhe anëtarëve të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve në Tempullin e Solt-Lejkut më 1 qershor 1978. Teksa studentët marrin pjesë në këtë mësim, ata do ta kuptojnë më mirë se si t'u drejtohen pyetjeve të ungjillit në një mënyrë besnike dhe gjithashtu do të mësojnë rrethanat dhe të vërtetat që lidhen me këtë zbuluesë përfundimtare.

Lexim Konteksti

- Gordon B. Hinckley, "Priesthood Restoration", *Ensign*, tetor 1988, f. 69–72.
- "Race and the Priesthood", Gospel Topics, lds.org/topics.
- Ahmad Corbitt, "A Personal Essay on Race and the Priesthood", pjesët 1–4, seritë Perspectives on Church History, history.lds.org/section/perspectives-on-church-history.

Sugjerime për Mësimdhënien

Hyrje në Deklaratën Zyrtare 2

Diskutimi i pyetjeve të ungjillit në një mënyrë besnike

Paraqitini klasës suaj skenarin vijues:

Mbas shkollës një ditë, Skotit iu afrua një anëtar tjetër i Kishës, të cilit kohët e fundit i kishin lindur disa pyetje rreth doktrinės së Kishës. Skoti ndjeu se ishte në gjendje t'i jepte njëfarë ndihme shokut të tij, por më pas ai pyeti veten se çfarë mund ta bënte ndryshe herën tjetër kur një anëtar i Kishës në një situatë të ngjashme t'i drejtohej atij.

Pyetini studentët se çfarë kanë bërë ata për të ndihmuar anëtarët e Kishës, të cilët iu drejtohen atyre me pyetje të sinqerta rreth Kishës ose doktrinės së saj.

Paraqitni dhe lexoni thënien vijuese nga Presidenti Diter F. Uhtdorf, i Presidencës së Parë:



"Kërkimi është vendlindja e dëshmisë. Disa mund të ndihen në siklet ose të padenjë, sepse kanë pyetje kërkuese në lidhje me ungjillin, por ata nuk duhet të ndihen ashtu. Bërja e pyetjeve nuk është shenjë dobësie; ajo është pararendëse e rritjes.

Perëndia na urdhëron të kërkojmë përgjigje për pyetjet tona dhe lyp vetëm që të kërkojmë 'me një zemër të sinqertë, me qëllim të vërtetë, duke pasur besim në Krisht' [Moroni 10:4]. Kur bëjmë kështu, e vërteta e të gjitha gjërave mund të na shfaqet 'nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë' [Moroni 10:5].

Mos kini frikë; bëni pyetje. Jini kureshtarë, por mos dyshoni! Gjithmonë kapuni fort te besimi dhe te drita që tashmë keni marrë" ("Pasqyrimi në Ujë" [takim shpirtëror i Sistemit Arsimor të Kishës për të rinjtë në moshë madhore, 1 nëntor 2009], f. 7, [ldschurchnewsarchive.com](https://www.lds.org/newsroom/releases/2009/11/091101)).

- Çfarë na mësoi Presidenti Uhtdorf që mund ta ndihmojë dikë, i cili ka pyetje rreth çështjeve doktrimore, historike ose shoqërore lidhur me Kishën? (Ndihmojini

studentët të kuptojnë parimin vijues: **Nëse do të ushtrojmë besim te Jezu Krishti, atëherë pyetjet e sinqerta më së fundi mund të sjellin përgjigje nga Ati ynë në Qiell.)**

Shpjegoni se një nga çështjet historike rreth së cilës disa anëtarë të Kishës kanë pyetje, buron nga një rregullorë e Kishës që ishte në fuqi nga mesi i viteve 1800 deri në vitin 1978, që i kufizonte meshkujt zezakë me origjinë afrikane nga të qenit të shuguruar në priftëri. Gjithashtu i ndalonte gratë dhe burrat zezakë që të merrnin pjesë në ordinancën e dhurimit [indaumentit] ose në ceremonitë e vulosjes në tempull. Ftojani një student të lexojë me zë të lartë deklaratën vijuese, e cila është një pjesë e hyrjes së Deklaratës Zyrtare 2 (që gjendet në Doktrinën e Besëlidhjet). Kërkojuni studentëve të mendojnë rreth mënyrës se si ky informacion mund t’i ndihmojë ata që kanë shqetësime rreth kësaj çështjeje historike.

“Libri i Mormonit na mëson se ‘të gjithë janë njësoj para Perëndisë’ duke përfshirë ‘të zinj dhe të bardhë, sklevër dhe të lirë, burra dhe gra’ (2 Nefi 26:33). Gjatë historisë së Kishës, njerëz të çdo race dhe etnie në shumë vende janë pagëzuar dhe kanë jetuar si anëtarë besnikë të Kishës. Gjatë kohës që jetoi Jozef Smithi, disa anëtarë meshkuj zezakë të Kishës u shuguruan në priftëri. Herët në historinë e saj, udhëheqësit e Kishës e ndaluan dhënien e priftërisë meshkujve zezakë me prejardhje afrikane. Analet e Kishës nuk japin ide të qarta lidhur me zanafillat e kësaj praktike” (hyrja për Deklaratën Zyrtare 2).

- Çfarë të vërtetash të rëndësishme përmban kjo thënie për ata që mund të hasin shqetësim për këtë çështje?

Vini në dukje rreshtin që thotë: “Analet e Kishës nuk japin ide të qarta lidhur me zanafillat e kësaj praktike”. Ndërkohë që disa njerëz mund të sugjerojnë arsye përse meshkujt me prejardhje afrikane nuk u shuguruan në priftëri për njëfarë kohe, ato arsye mund të mos jenë të sakta. Ftojani një student të lexojë thënien vijuese, nga Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Nëse i lexoni shkrimet e shenjta me këtë pyetje në mendje: ‘Përse e urdhëroi Zoti këtë ose përse e urdhëroi atë’, ju gjeni që në më pak se një urdhër në njëqind urdhra, u dha ndonjë arsye. Nuk është modeli i Zotit për të dhënë arsye. Ne [të vdekshmit] mund t’i japim arsye zbulesës. Ne mund t’u japim arsye urdhërimeve. Kur e bëjmë këtë, ne lihemi vetëm. Disa njerëz i dhanë arsye zbulesës për të cilën po flasim këtu [racës dhe priftërisë] dhe në mënyrë të bujshme ato dolën të ishin të gabuara. ...

... Le të mos e bëjmë gabimin që është bërë në të shkuarën, këtu dhe në fusha të tjera, duke u përpjekur t’i japim arsye zbulesës. Arsyet në një shkallë të gjerë na dalin se janë të krijuara nga njerëzit” (*Life’s Lessons Learned* [2011], f. 68–69).

- Përse është e urtë ta shmangim spekulimin mbi arsyet përse individëve të prejardhjes afrikane nuk iu dha priftëria ose nuk iu lejua kryerja e ordinancave të tempullit përpara vitit 1978? (Njeriu flet nga një këndvështrim i kufizuar dhe Perëndia nuk na i ka thënë arsyet.)

Theksoni se sot Kisha i mohon teoritë e përhapura në të shkuarën mbi këtë çështje: lëkura e zezë është një shenjë e mospëlqimit ose mallkimit hyjnor; lëkura e zezë pasqyron veprime të padrejta në jetën para lindjes; martesat me raca të përziera janë mëkat; ose zezakët apo njerëzit e ndonjë race ose etnie tjetër janë më të ulët në njëfarë mënyre nga njerëzit e tjerë. Udhëheqësit e Kishës sot pa asnjë mëdyshje e dënojnë të

gjithë racizmin, të shkuar dhe të tanishëm, në çfarëdo forme. (Shih “Race and the Priesthood”, Gospel Topics, lds.org/topics.)

- Si mund t’i ndihmojë njerëzit besimi i tyre te Jezu Krishti që t’i zgjidhin pyetjet ose shqetësimet e tyre rreth kufizimit të priftërisë që ekzistoi përpara vitit 1978?

Deklarata Zyrtare 2

Bekimet e priftërisë dhe të tempullit iu shtrinë çdo anëtarë të denjë të Kishës

Shpjegoni se përpara vitit 1978, mijëra njerëz me prejardhje afrikane në kombe të ndryshme kishin arritur ta dinin vërtetësinë e ungjillit të rivendosur. Udhëheqësit e Kishës në Solt-Lejk-Siti morën shumë letra nga të kthyer në besim të papagëzuar në Nigeri dhe Gana, të cilët kërkonin që misionarët të dërgoheshin në Afrikë. Për vite, udhëheqësit e Kishës plot lutje e morën parasysh çështjen, por e ndien se koha nuk kishte ardhur ende për të dërguar misionarë në Afrikë. Në Brazil, anëtarët besnikë zezakë ndihmuan për ta ndërtuar Tempullin e San-Paolos, të shpallur në vitin 1975, edhe pse ata e dinin se nuk do të ishin në gjendje të hynin në tempull.

Informojini studentët se Deklarata Zyrtare 2 përmban shpalljen zyrtare të një zbuluese të marrë nga Presidenti Spenser W. Kimball, këshilltarët e tij në Presidencën e Parë dhe dhjetë anëtarë të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Zbuluesa u mor më 1 qershor 1978. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë paragrafin e parë nën fjalët “Të Dashur Vëllezër”. Ftojini klasën ta ndjekë, duke kërkuar atë që udhëheqësit e Kishës thanë se kishin dëshmuar.

- Çfarë kishin dëshmuar udhëheqësit e Kishës anembanë tokës?
- Me çfarë u frymëzuan udhëheqësit e Kishës, ndërkohë që dëshmonin zgjerimin e punës së Zotit?

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë paragrafin pasues, i cili fillon me fjalët “Të ndërgjegjshëm për premtimet”. Ftojini klasën të kërkojë se si vepruan udhëheqësit e Kishës lidhur me dëshirat e tyre të frymëzuara. Pyetni:

- Si vepruan Presidenti Spenser W. Kimball dhe udhëheqës të tjerë të Kishës lidhur me dëshirat e tyre të frymëzuara?
- Sipas tre rreshtave të parë të këtij paragrafi, çfarë dinin udhëheqësit e Kishës rreth kufizimit të priftërisë? (Ata e dinin se një ditë, të gjithë meshkujt e denjë do të kishin mundësinë për ta marrë priftërinë.)

Shpjegoni se, për shumë vjet përpara vitit 1978, duke e ditur se një zbuluese nevojitej me qëllim që të ndodhte ndryshimi, Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve e kishin diskutuar kufizimin e priftërisë dhe ishin lutur rreth tij. Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Spenser W. Kimball (1895–1985) dhe kërkojini një student të lexojë me zë të lartë:



“Çdo ditë unë shkova vetëm dhe me solemnitet e seriozitet të madh në dhomat e sipërme të tempullit dhe atje unë ofrova shpirtin tim dhe ofrova përpjekjet e mia për të ecur përpara me programin. Unë doja të bëja atë çfarë donte Ai. Unë i fola për këtë Atij dhe i thashë: ‘Zot, unë dëshiroj vetëm atë që është e drejtë. Ne nuk po bëjmë ndonjë plan që të jetë emocionues në mënyrë të bujshme. Ne duam vetëm gjënë që Ti vërtet e do dhe ne e duam atë kur Ti e do atë dhe jo deri në atë kohë.’” (*Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* [2006], f. 238).

- Çfarë na mësojnë fjalët e Presidentit Kimball rreth mënyrës sipas së cilës profetët kërkojnë zbulësë? (Pasi studentët të përgjigjen, ju mund të dëshironi ta shkruani në tabelë të vërtetën vijuese: **Profetët kërkojnë vullnetin e Zotit në drejtimin e Kishës.**)

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë dy paragrafet pasuese të Deklarata Zyrtare 2, duke filluar me “Ai i ka dëgjuar lutjet tona”. Vëreni klasën të kërkojë përgjigjen e Zotit ndaj lutjeve të Presidentit Kimball, të këshilltarëve të tij në Presidencën e Parë dhe të anëtarëve të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.

- Cila ishte përgjigja e Zotit ndaj lutjeve të profetit të Tij? (Theksoni mesazhin e Zotit të marrë në këtë zbulësë: **Bekimet e ungjillit të Jezu Krishtit janë të vlefshme për të gjithë fëmijët e Atit Qiellor.**)

Që t’i ndihmoni studentët të kuptojnë se si u mor zbulësja e shënuar të Deklarata Zyrtare 2, lexoni thënien vijuese nga Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008), i cili ishte i pranishëm në ditën kur zbulësja u mor në tempull:



“Pati një atmosferë të shenjtë dhe të shenjtëruar në dhomë. Për mua, u ndie sikur një shteg u hap midis fronit qiellor dhe profetit të gjunjëzuar, të përgjëruar të Perëndisë, me të cilin u bashkuan Vëllëzërit e tij. Shpirti i Perëndisë ishte atje. Dhe me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë, atje, atij profeti i erdhi një siguri se gjëja për të cilën ishte lutur, ishte e drejtë, se koha kishte ardhur dhe se tani bekimet e mrekullueshme të priftërisë duhej t’u shtriheshin burrave të denjë anëmbanë pavarësisht nga prejardhja. ...

Ne të gjithë e dinim se koha kishte ardhur për një ndryshim dhe se vendimi kishte ardhur nga qiejt. Përgjigja ishte e qartë. Pati një unitet të përsosur mes nesh në përvojën tonë dhe në kuptueshmërinë tonë” (“Priesthood Restoration”, *Ensign*, tetor 1988, f. 70).

Shpjegoni se, pak kohë pasi u mor zbulësja që i dha fund kufizimit të priftërisë, misionarët u dërguan në Afrikë. Që atëherë tempuj janë ndërtuar në atë kontinent, mbi njëqind kune janë organizuar dhe qindra mijëra njerëz i kanë marrë ordinancat e ungjillit për veten e tyre dhe për paraardhësit e tyre të vdekur. (Shih, për shembull, “Mormons in Africa: A Bright Land of Hope”, mormonnewsroom.org; “Emerging with Faith in Africa”, pjesët 1–3, lds.org/prophets-and-apostles/unto-all-the-world.)

Paraqitni thënien vijuese nga Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe kërkojini një student të lexojë atë:



“Në çdo kontinent dhe përmes ishujve të detit, njerëzit besnikë po mblidhen në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Dallimet në prejardhjet kulturore, gjuhë, gjini dhe tipare të fytyrës veniten në kotësi kur anëtarët e humbasin veten në shërbim të Shpëtimtarit të tyre të dashur. Shpallja e Palit po përbushet: ‘Sepse të gjithë ju që jeni pagëzuar në Krishtin, Krishtin keni veshur.

Nuk ka as Jude, as Grek, nuk ka as skllav as të lirë, nuk ka as mashkull as femër, sepse të gjithë jeni një në Jezu Krishtin’ [Galatasve 3:27–28].

Vetëm të kuptuarit e Atësisë së vërtetë të Perëndisë mund të sjellë vlerësim tërësor të vëllazërisë së vërtetë të njerëzimit. Ajo kuptueshmëri frymëzon dëshirën për të ndërtuar ura bashkëpunimi në vend të mureve të veçimit” (“Teach Us Tolerance and Love”, *Ensign*, maj 1994, f. 70).

- Si na përgatit ungjilli që të bëhemi të bashkuar me njerëz nga prejardhje të ndryshme?

- Çfarë shembujsh keni parë të anëtarëve të Kishës nga prejardhje të ndryshme duke u rritur së bashku në unitet e bashkëpunim?

Në mbyllje, ftojini studentët të marrin parasysh se si mund të përgjigjeshin nëse ata pyeteshin përse Kisha nuk i shuguroi në priftëri për njëfarë kohe burrat me prejardhje afrikane. Pohoni se është e përshtatshme t'iu shpjegoni të tjerëve se ne nuk e dimë përse filloi kufizimi i priftërisë dhe ne duhet të tregojmë për të vërtetat që vërtet i dimë dhe të dëshmojmë për to.

Materiale Leximi për Studentin

- 2 Nefi 26:33; Deklarata Zyrtare 2.
- "Race and the Priesthood", Gospel Topics, [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics).
- Ahmad Corbitt, "A Personal Essay on Race and the Priesthood", pjesët 1–4, seritë Perspectives on Church History, [history.lds.org/section/perspectives-on-church-history](https://www.history.lds.org/section/perspectives-on-church-history).

27

Përgatitja e Botës për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit

Shpëtimtari një ditë do të kthehet në tokë me fuqi dhe lavdi të madhe. Në përgatitjen për atë ditë të madhërisme, shenjtoreve u mësohet të studiojnë shenjat e ardhjes së Tij dhe të përgatiten për këtë duke qëndruar në vende të shenjta dhe duke e marrë “Shpirtin e Shenjtë si udhëzuesin e tyre” (DeB 45:57). Zoti ka shpallur se Kisha dhe anëtarët e saj kanë përgjegjësi për ta përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit.

Lexim Konteksti

- Nil L. Andersen, “Të Përgatisësh Botën për Ardhjen e Dytë”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2011, f. 49–52.
- Dallin H. Oaks, “Preparation for the Second Coming”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2004, f. 7–10.
- “Preparing for the Second Coming of Christ,” kapitulli 44 të *Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 389–397.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 45:15–46, 56–57

Shenjat që do ta paraprijnë Ardhjen e Dytë

Bëjuni studentëve pyetjen vijuese:

- Si mund ta dalloni se kur është gati për të rënë shi?

Shpjegoni se, ashtu siç ka tregues që na ndihmojnë të dimë se kur do të bjerë shi, ka edhe tregues ose shenja, që na ndihmojnë të dimë se kur do të ndodhë Ardhja e Dytë e Jezu Krishtit. Tregojuni studentëve se, siç shënohet te Mateu 24, Shpëtimtari u takua me dishepujt e Tij në Malin e Ullinjve pak kohë para vdekjes së Tij dhe përshkroi shenjat e Ardhjes së Tij të Dytë. Ai ia përsëriti disa nga këto mësimet Jozef Smithit në kohën tonë, siç shënohet te Doktrina e Besëlidhje 45. Theksojuni studentëve se përgatitja për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit është një temë e rëndësishme përgjatë gjithë Doktrinës e Besëlidhjeve. Ftojini studentët të harxhojnë kohë teksa studiojnë Doktrinën e Besëlidhjet, që të shënojnë mësimet rreth Ardhjes së Dytë dhe të përsiatin mënyrën se si mund të përgatiten ata për të.

Ftojini studentët të lexojnë Doktrinën e Besëlidhjet 45:15–17, duke kërkuar atë që dishepujt e Shpëtimtarit i kërkuan Atij dhe se si u përgjigj Ai.

- Çfarë kërkuan dishepujt nga Jezusi?
- Cila ishte përgjigja e Tij?

Për t’i ndihmuar studentët të përcaktojnë shenjat që do ta paraprinin Ardhjen e Dytë, shkruani referencat vijuese në tabelë:

DeB 45:25–27

DeB 45:28–31, 33

DeB 45:40–43

Ndajini studentët në dyshe dhe i caktoni secilës dyshe një nga fragmentet e shkruara në tabelë. Kërkojuni atyre t'i lexojnë vargjet së bashku, duke kërkuar shenjat e përmendura në ato vargje. Vini në dukje se disa nga shenjat janë plotësuar tashmë ose janë në procesin e plotësimit. Ju mund të doni të jepni informacionin vijues në lidhje me vargun 30: "Epoka në të cilën johebrenjtë kanë përparësi në marrjen e ungjillit, quhet *kohët e johebrenjve*. Në të, njerëzit që nuk janë judenj, ... kanë mundësinë ta pranojnë ungjillin dhe të fitojnë shpëtim përpara se ajo e drejtë duhet t'u jepet, në ndonjë shkallë të konsiderueshme, të paktën, judenjve" (Bruce R. McConkie, *Mormon Doctrine*, bot. i 2-të [1966], f. 721–722).

Pas një kohe të mjaftueshme, kërkojuni dysheve t'ia raportojnë klasës gjetjet e tyre. Ju mund të sugjeroni që studentët t'i vënë në dukje shenjat në shkrimet e tyre të shenjta.

Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 45:34, ndërkohë që klasa e ndjek. Më pas pyetni:

- Kur lexoni ose dëgjoni rreth ngjarjeve ose shenjave që do ta paraprijnë Ardhjen e Dytë, a shqetësoheni ndonjëherë? Përse po ose përse jo?
- Në çfarë mënyrash të mësuarit rreth shenjave të Ardhjes së Dytë të Shpëtimtarit na ndihmon ta mposhtim frikën dhe ankthin në jetën tonë?

Ftojini studentët të lexojnë në heshtje Doktrinën e Besëlidhjet 45:35–38 që të mësojnë përse Shpëtimtari i zbuloi shenjat që do ta paraprijnë Ardhjen e Tij të Dytë.

- Përse është e rëndësishme të dallojmë se kur po përmbushen shenjat e ardhjes së Shpëtimtarit?

Vëriini studentët të kërkojnë mënyra për t'u përgatitur për Ardhjen e Dytë të Krishtit teksa lexojnë Doktrinën e Besëlidhjet 45:32, 39, 56–57. Më pas diskutoni sa vijon:

- Çfarë mësoni nga këto vargje rreth mënyrës se si të përgatiteni për Ardhjen e Dytë? (Teksa studentët japin idetë e tyre, theksoni parimin vijues: **Qëndrimi në vende të shenjta dhe marrja e Shpirtit të Shenjtë si udhëzuesin tonë, janë thelbësore kur ne përgatitemi për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit.**)
- Çfarë duhet të bëjmë me qëllim që ta kemi Shpirtin e Shenjtë si udhëzuesin tonë?
- Si mendoni se një pasues i Jezu Krishtit mund të "qëndroj[ë] në vende të shenjta"? (Vendet e shenjta përfshijnë tempujt, ndërtesat kishtare dhe shtëpitë. Një shtëpi mund të bëhet e shenjtë nëpërmjet lutjes së vazhdueshme personale dhe familjare, studimit të shkrimeve të shenjta, shërbimit dhe mbrëmjes familjare të shtëpisë. Qëndrimi në vende të shenjta shpesh ka të bëjë edhe me mënyrën se si jetojmë. Nëse jetojmë të denjë për shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë, atëherë ne qëndrojmë në një vend të shenjtë. Merrni parasysh të sugjeroni që studentët t'i shkruajnë disa nga këto ide në anë të faqes së shkrimeve të tyre të shenjta te Doktrina e Besëlidhje 45:32.
- Si keni qenë në gjendje të qëndroni në vende të shenjta pavarësisht nga të jetuarit në një botë të ligë?
- Cilat janë disa nga arsyet pse po e prisni me dëshirë Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit? Përse jeni mirënjohës që Shpëtimtari do të vijë përsëri?

Doktrina e Besëlidhje 29:7–9; 34:5–7; 39:19–23

Përgatitja e botës për Ardhjen e Dytë

Kujtojini studentët se titulli i këtij kursi është *Themelet e Rivendosjes*. Pyetini studentët:

- Çfarë lidhjeje ose marrëdhënieje shihni midis Rivendosjes së ungjillit dhe Ardhjes së Dytë të Jezu Krishtit?

Shkruani referencat vijuese në tabelë. Vëriuni studentët t'i studiojnë ato duke kërkuar një temë të përbashkët:

Doktrina e Besëlidhje 29:7–9

Doktrina e Besëlidhje 34:5–7

Doktrina e Besëlidhje 39:19–23

Pas një kohe të mjaftueshme, kërkojuni studentëve të kthehen drejt personit të ulur pranë tyre dhe të diskutojnë atë që këto fragmente të shkrimeve të shenjta kanë të përbashkët. Pyetini disa studentë se si do ta përmbledhnin mesazhin në këto shkrime të shenjta. (Teksa studentët japin idetë e tyre, ndihmojini ata të përcaktojnë e kuptojnë këtë parim: **Kur ua predikojmë ungjillin të tjerëve, ne po ndihmojmë ta përgatitim botën për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit.**)

Kërkojuni studentëve të kthehen te seksioni 29, 34 dhe 39 në Doktrinën e Besëlidhjet dhe të vërejnë datat kur u dhanë zbulesat. Pyetni:

- Sa shpejt pasi u organizua Kisha filloi Zoti ta jepte mësim këtë parim të sapopërcaktuar?

Ftojini një student të lexojë thënien vijuese nga Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Që nga ditët e hershme të Rivendosjes, Vëllezërit kanë qenë shumë seriozë rreth detyrimit të tyre për ta shpallur ungjillin. Në vitin 1837, vetëm shtatë vjet pas organizimit të Kishës, në një periudhë varfërie e përndjekjeje, misionarët u dërguan ta jepnin mësim ungjillin në Angli. Brenda pak viteve në vijim, misionarët ishin duke predikuar në vende kaq të ndryshme si Austri, Polinezinë Franceze, Indi, Barbados, Kili dhe Kinë.

Zoti e ka bekuar këtë punë dhe Kisha po themelohet nëpër botë. ... Dielli nuk perëndon kurrë për misionarët e drejtë që dëshmojnë për Shpëtimtarin. Mendoni për fuqinë shpirtërore të 52.000 misionarëve, të pajisur me Shpirtin e Zotit, që shpallin me guxim se nuk ka ‘asnjë emër tjetër të dhënë, as ndonjë mënyrë tjetër nëpërmjet së cilës shpëtimi mund të vijë ... vetëm në dhe nëpërmjet emrit të Krishtit’ [Mosia 3:17]. ... Bota, në masë të madhe, po përgatitet për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit për shkak të punës së Zotit nëpërmjet misionarëve të Tij” (“Të Përgatisësh Botën për Ardhjen e Dytë”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2011, f. 51).

Diskutoni sa vijon:

- Si i ndihmon njerëzit mesazhi që jepet mësim nga misionarët e Kishës për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit?
- Përse ishte Rivendosja e ungjillit e domosdoshme përpara se Shpëtimtari të mund të vinte sërish në tokë?

Paraqitni thëniet vijuese nga Presidenti Jozef F. Smith (1838–1918) dhe kërkojuni një student t'i lexojë me zë të lartë:



“Ungjilli i mëson njerëzit të jenë të përlur, besnikë, të ndershëm dhe të drejtë përpara Zotit e me njëri-tjetrin dhe në përpjesëtim me sa zbatohen parimet e tij, po ashtu paqe e drejtësi do të përhapen dhe do të vendosen mbi tokë, dhe mëkati, grindja, gjakderdhja e korruptimi i të gjitha llojeve do të ndalojnë së ekzistuari, dhe toka do të bëhet e pastruar dhe do të bëhet një banesë e përshtatshme për qenie qiellore; dhe për Zotin, Perëndinë tonë, që të vijë e të banojë në të, gjë të cilën Ai do ta bëjë gjatë Mijëvjeçarit” (*Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* [1998], f. 394–395).

“Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme ... e sheh si pjesë të misionit të saj për ta përgatitur udhën për ardhjen e mirëfilltë dhe të lavdishme të Birit të Perëndisë në tokë, për të mbretëruar mbi të dhe për të banuar me popullin e Tij” (*Teachings: Joseph F. Smith*, f. 395).

Pyetni sa vijon:

- Gjatë zhvillimit të këtij mësimi, çfarë mendimesh ose mbresash shpirtërore keni pasur rreth përgjegjësisë së Kishës dhe të anëtarëve të saj për ta përgatitur botën për Ardhjen e Dytë?
- Si mendoni se të ndihmuarit e të tjerëve që të përgatiten për Ardhjen e Dytë, do t’ju ndihmojë po ashtu edhe ju të përgatiteni?

Për ta mbyllur mësimin, ftojini disa studentë të tregojnë çfarë kanë bërë për ta shpërndarë mesazhin e Rivendosjes me ata njerëz që nuk janë të besimit tonë.

Materiale Leximi për Studentin

- Doktrina e Besëlidhje 29:7–9; 34:5–7; 39:19–23; 45:15–46, 56–57; 88:81–87.
- Nil L. Andersen, “Të Përgatisësh Botën për Ardhjen e Dytë”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2011, f. 49–52.
- “Preparing for the Second Coming of Christ”, kapitulli 44 te *Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 389–397.

28

Përsheptimi i Punës për Shpëtim

Në vitet e fundit, udhëheqësit e Kishës e kanë theksuar profecinë e Zotit se Ai do ta “përsheptoj[ë] veprën [e Tij]” (DeB 88:73). Puna për shpëtim përfshin punën misionare të anëtarëve, mbajtjen aktivë të të kthyerve në besim, aktivizimin e anëtarëve më pak aktivë, punën në tempull e për historinë familjare dhe mësimdhënien e ungjillit. Ky mësim do t’i ndihmojë studentët të kuptojnë më mirë përgjegjësinë e tyre si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme për të marrë pjesë në këtë veprë.

Lexim Konteksti

- Diter F. Uhtdorf, “A Po Flini Gjatë Rivendosjes?” *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2014, f. 58–62.
- “Përsheptimi i Punës për Shpëtim”, *Ensign*, tetor 2013, f. 36–39.

Sugjerime për Mësimdhënien

Doktrina e Besëlidhje 138:53–56

Zoti po e përshepton punën e Tij

Tregojuni studentëve se, pak kohë përpara vdekjes së tij, Presidenti Jozef F. Smith pati një vegim të botës së shpirtave, i cili shënohet tani si Doktrina e Besëlidhje 138. Ai mësoi se udhëheqësit e periudhës së fundit të kujdestarisë ungjillore dhe “shumë të tjerë” u përgatitën në botën para lindjes për përgjegjësitë e tyre tokësore. Ftojini një student të lexojë me zë të lartë Doktrinën e Besëlidhjet 138:53–56, ndërkohë që klasa e ndjek duke kërkuar përgjegjësitë që iu dhanë këtyre udhëheqësve në botën para lindjes.

- Çfarë përgjegjësish iu dhanë këtyre udhëheqësve në botën para lindjes? Çfarë përgatitjeje morën ata atje?
- Çfarë përgjegjësish mund t’ju jenë dhënë juve në botën para lindjes? Çfarë përgatitjeje mund të keni marrë ju? (Teksa studentët i japin idetë e tyre, ndihmohjini të përcaktojnë këtë parim: **Ne u përgatitëm në jetën para lindjes që të vinim në tokë në plotësinë e kohëve për të punuar për shpëtimin e shpirtave të njerëzve.**)

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Tomas S. Monson dhe kërkojini një student ta lexojë me zë të lartë:



“A e kuptoni se Kisha e rivendosur ishte 98-vjeçare përpara se të kishte 100 kunje? Por më pak se 30 vjet më vonë, Kisha kishte organizuar 100 kunjet e saj të dyta. Dhe vetëm tetë vjet pas asaj Kisha kishte më tepër se 300 kunje. Sot [2014] ne jemi forcuar me mbi 3.000 kunje.

Përse po ndodh kjo rritje me një ritëm të përsheptuar? Mos vallë ngaqë jemi më të njohur? Mos vallë ngaqë kemi godina kishtare të këndshme?

Këto gjëra janë të rëndësishme, por arsyeja përse Kisha po rritet sot është ngaqë Zoti tregoi se kjo do të ndodhte. Te Doktrina e Besëlidhje, Ai tha: ‘Vini re, unë do ta përsheptoj veprën time në këtë kohë’ [DeB 88:73].

Ne, si fëmijë shpirtërorë të Atit tonë Qiellor, u dërguam në tokë në këtë kohë që të mund të merrim pjesë në përshpejtimin e kësaj veprë të madhërisme" ("Hastening the Work", *Ensign*, qershor 2014, f. 4).

- Sipas Presidentit Monson, përse u dërguam në tokë në këtë kohë? (Teksa studentët japin përgjigjet e tyre, ndihmojini të kuptojnë këtë parim: **Ne kemi përgjegjësi për të marrë pjesë në përshpejtimin e punës së Atit Qiellor.**)
- Cilat janë disa nga mënyrat si e keni dëshmuar një "përshpejtim" të punës së Perëndisë? (Ka shumë përgjigje për këtë pyetje, duke përfshirë ndryshimin e moshave për shërbimin misionar, rritjen e numrit të misionarëve, rritjen e numrit të tempujve dhe shtimin e mjeteve që e bëjnë më të lehtë punën e historisë familjare.)

Vini në dukje se këto përgjigje japin provë që Zoti po e përshpejton punën e Tij në të dy anët e velit. Shpjegoni se udhëheqësit e Kishës sot e kanë vënë theksin në pesë fusha brenda punës së shpëtimit dhe kanë kërkuar që secili prej nesh të marrë pjesë në këto fusha me qëllim që të përshpejtohet puna e Perëndisë në këto ditë të fundit. Paraqitni thënien vijuese nga Plaku L. Uitni Klejton, i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, dhe kërkojini një student të ta lexojë me zë të lartë. Bëjeni klasën të përcaktojë pesë fushat që janë pjesë e punës së shpëtimit:



"Profetët dhe apostujt e gjallë na mësojnë se 'anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit dërgohen "për të punuar në vreshtin e tij për shpëtimin e shpirtave të njerëzve" (DeB 138:56). Kjo punë për shpëtimin përfshin punën misionare të anëtarëve, mbajtjen aktive të të kthyerve në besim, aktivizimin e anëtarëve më pak aktivë, punën në tempull e për historinë familjare dhe mësimdhënien e ungjillit' [*Handbook 2: Administering the Church [Manuali 2: Administrimi i Kishës]* (2010), 5.0]" ("The Work of Salvation: Then and Now", *Ensign*, shtator 2014, f. 63).

Ndërkohë që studentët i përcaktojnë pesë fushat, shkruani në tabelë sa vijon:

Puna misionare e anëtarëve
Mbajtja aktive e të kthyerve në besim
Aktivizimi i anëtarëve më pak aktivë
Puna në tempull e për historinë familjare
Mësimdhënia e ungjillit

Doktrina e Besëlidhje 88:73

Secili prej nesh mund të japë ndihmesë për përshpejtimin e punës së Zotit

Kërkojini studentit të lexojë Doktrinën e Besëlidhjet 88:73, ndërsa studentët e tjerë e ndjekin. Më pas u shpjegoni studentëve se secili prej nesh duhet të përpiqet për ta shtuar ndihmesën tonë për përshpejtimin e punës së Zotit. U shpërndani studentëve fletushkën në fund të mësimit dhe shpjegoni se kjo fletushkë do t'i ndihmojë ata të mendojnë rreth mënyrës se si mund ta rritin ndihmesën e tyre. Ftojini studentët të përzgjedhin dhe në heshtje të lexojnë një ose më shumë prej thënieve në fletushkë dhe të përgatiten për t'iu përgjigjur pyetjeve që gjenden në fletushkë.



Pasi studentët të kenë pasur kohë të mjaftueshme për të lexuar e për t'u përgatitur, merrni parasysh ta ftoni një student të lexojë me zë të lartë citimin e parë. Më pas kërkojuni disa studentëve t'i japin përgjigjet e tyre ndaj tri pyetjeve në fletushkë, duke u përqendruar te puna misionare e anëtarëve. Përsëriteni këtë proces me secilin prej pesë citimeve.

Ndihmohini studentët të ndiejnë të vërtetën dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në punën për shpëtim duke bërë pyetjet vijuese:

- Çfarë bekimesh keni marrë kur keni marrë pjesë në një ose më shumë nga këto fusha të punës për shpëtim? Çfarë përvoja keni pasur gjatë pjesëmarrjes në një nga këto fusha, e cila ka qenë veçanërisht domethënëse për ju?

Paraqitni thënien vijuese nga Presidenti Diter F. Uhtdorf, i Presidencës së Parë, dhe ftojini një student ta lexojë me zë të lartë:



"Kur koha jonë në vdekshmëri të përfundojë, për cilat përvoja do të jemi vërtet në gjendje të tregojmë rreth vetë ndihmesës sonë në këtë periudhë domethënëse të jetës sonë dhe në çuarjen më tej të punës së Zotit? A do të jemi në gjendje të themi se i përveshëm mëngët dhe punuam me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën tonë? Apo do të duhet të pohojmë se roli ynë ishte kryesisht ai i një vëzhguesi?" ("A Po Flini Gjatë Rivendosjes?" *Ensign* ose *Liahona*, maj 2014, f. 59).

Ftojini studentët të planifikojnë atë që do të bënin për të marrë pjesë më plotësisht në punën për shpëtimin, duke pyetur:

- Cilat janë disa mënyra se si i keni parë të tjerët të ndihmojnë për ta përsheptuar punën e Zotit?
- Cilat janë disa mënyra se si planifikoni të jepni ndihmesë për përsheptimin e punës së Zotit?
- Si na nxit njohuria dhe dëshmia jonë për Rivendosjen për të marrë pjesë më plotësisht në punën për shpëtimin?

Ftojini disa studentë të tregojnë dhe dëshmojnë për diçka që e kanë mësuar rreth Rivendosjes së ungjillit nëpërmjet studimit të tyre në këtë kurs. Mbylleni duke dëshmuar për vërtetësinë e Rivendosjes së ungjillit nëpërmjet Profetit Jozef Smith.

Materiale Leximi për Studentin

- Diter F. Uhtdorf, "A Po Flini Gjatë Rivendosjes?" *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2014, f. 58-62).
- "Përsheptimi i Punës për Shpëtim", *Ensign*, tetor 2013, f. 36-39.

Përsheptimi i Punës për Shpëtim

Përsiatni pyetjet vijuese në lidhje me secilën nga pesë fushat që janë pjesë e punës për shpëtim:

- Si mund t'i sjellin të tjerët më pranë bekimeve të shpëtimit përpjekjet tuaja në këtë fushë të punës së Perëndisë?
- Çfarë përvojash keni pasur dhe çfarë bekimesh keni marrë kur keni marrë pjesë në këtë fushë të përsheptimit të punës së Zotit për shpëtimin?
- Çfarë mund të bëni, pavarësisht nga thirrja juaj e tanishme në Kishë, që të luani rol në këtë fushë të punës për shpëtimin?

Puna Misionare e Anëtarëve

Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, na mësoi:



“Vëllezër e motra, me aq siguri sa Zoti ka frymëzuar më shumë misionarë për të shërbyer, Ai gjithashtu po zgjon mendjet dhe po hap zemrat e më shumë njerëzve të mirë e të ndershëm për të pranuar misionarët e Tij. Ju tashmë i njihni apo do t’i njihni ata. Ata janë në familjen tuaj dhe jetojnë në lagjen tuaj. Ata ecin duke u shkëmbyer me ju në rrugë, ulen pranë jush në shkollë dhe lidhen me ju në internet. Edhe ju jeni një pjesë e rëndësishme e kësaj mrekullie që po shpaloset.

Nëse nuk jeni një misionar kohëplotë me një etiketë të zezë misionari të kapur në pallton tuaj, tani është koha që ta pikturoni një [të tillë] në zemrën tuaj – të ngjyrosur, siç tha Pali, ‘jo me bojë, por me Frymën e Perëndisë së gjallë’ [2 Korintasve 3:3]. ... Të gjithë ne kemi një kontribut për të bërë për këtë mrekulli” (“Është një Mrekulli”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2013, f. 78).

Mbajtja Aktive e të Kthyerve në Besim

Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpalli:



“Ju dhe unë duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për ta parë që çdo anëtar i Kishës të shoqërohet tërësisht dhe i gëzon të gjitha bekimet që ungjilli ka për të ofruar.

Presidenti Gordon B. Hinkli na ka kujtuar ju dhe mua për përgjegjësinë tonë që të jemi bashkëpunëtorë me Zotin për t’i bërë të ndodhin planet e Tij për Kishën. Në një transmetim satelitor, Presidenti Hinkli tha:

‘Zoti ka vendosur mbi ne një mandat për t’ia mësuar ungjillin çdo krijese. Kjo do të kërkojë përpjekjet më të mira të çdo misionari – kohëplotë dhe të kunjit. Do të kërkojë përpjekjet më të mira të çdo peshkopi, të çdo këshilltari të peshkopit, të çdo anëtari të këshillit të lagjes ...’ (‘Find the Lambs, Feed the Sheep’, *Ensign*, maj 1999, f. 107). Do të kërkojë përpjekjet më të mira të çdo anëtari” (‘Members Are the Key’, *Ensign*, shtator 2000, f. 10).

Aktivizimi i Anëtarëve më Pak Aktivë

“Roli ynë [si anëtarë] është të zhytemi në dashurinë dhe shërbimin për njerëzit rreth nesh – duke ngushëlluar një koleg pune në nevojë, duke ftuar miqtë tanë në një pagëzim, duke ndihmuar një fqinj të moshuar për punën e tij në kopsht, duke ftuar një anëtar më pak aktiv për një vakt ushqimor, ose duke ndihmuar një fqinj për historinë e familjes së saj. Të gjitha këto janë mënyra të natyrshme e të gëzueshme për të ftuar anëtarë më pak aktivë dhe njerëz jo të besimit tonë në jetën tonë dhe, si pasojë, në dritën e ungjillit. Ndarja me ta e momenteve zbatimë dhe atyre të shenjtë në jetën tonë, mund të jetë në të vërtetë mënyra më e efektshme se si secili prej nesh mund të “pun[ojë] në vreshtin e [Jezu Krishtit] për shpëtimin e shpirtave të [burrave dhe grave]’ (DeB 138:56)” (“Përshpejtimi i Punës për Shpëtim”, *Ensign*, tetor 2013, f. 36).

Puna në Tempull dhe për Historinë Familjare

Plaku Kuentin L. Kuk, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim:



“Udhëheqja e Kishës i ka drejtuar një thirrje të qartë brezit të ri që të jetë pararoja në përdorimin e teknologjisë për të përjetuar shpirtin e Elijas, për t’i kërkuar paraardhësit e tyre dhe për të kryer ordianca në tempull për ta. Shumica e punës së rëndë në përshpejtimin e punës së shpëtimin si për të gjallët dhe të vdekurit do të bëhet nga ju të rinj” (“Rrënjët dhe Degët”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2014, f. 46,47).

Mësimdhënia e Ungjillit

“Përgjegjësia për ta dhënë mësim ungjillin nuk kufizohet tek ata që kanë thirrje zyrtare si mësues. Si një anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ju keni përgjegjësinë për ta dhënë mësim ungjillin. Si prind, bir, bijë, bashkëshort, bashkëshorte, vëlla, motër, udhëheqës i Kishës,

mësues në klasë, mësues shtëpie, mësuese vizitore, bashkëpunëtor, fqinj ose mik, ju keni mundësi të jepni mësim. Nganjëherë ju mund të jepni mësim haptazi dhe drejtpërsëdrejti, me anë të gjërave që thoni dhe dëshmisë që jepni. Dhe ju gjithmonë jepni mësim me anë të shembullit” (*Teaching, No Greater Call: A Resource Guide for Gospel Teaching* [1999], f. 3–4).

Fletushkat

Themelet e Rivendosjes (Feja 225)

Materiale Leximi për Studentin

Shënim: Nuk ju kërkohet të lexoni ndonjë nga materialet e sugjeruara që nuk janë në dispozicion në gjuhën tuaj.

Mësimi	Titulli	Materiale Leximi të Sugjeruara
1	Një Punë e Mrekullueshme dhe një Çudi	<ul style="list-style-type: none">Isaia 29:13–14; Amos 8:11–12; 2 Nefi 27:1–5, 25–26; Doktrina e Besëlidhje 1:12–30; Joseph Smith – Historia 1:5–10.Gordon B. Hinckley, “At the Summit of the Ages”, <i>Ensign</i>, nëntor 1999, f. 72–74.<i>Predikoni Ungjillin Tëm: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar</i> (2004), f. 31–36.
2	Vegimi i Parë	<ul style="list-style-type: none">Joseph Smith – Historia 1:1–26.Gordon B. Hinckley, “The Marvelous Foundation of Our Faith”, <i>Ensign</i>, nëntor 2002, f. 78–81.“First Vision Accounts”, Gospel Topics, <i>lds.org/topics</i>.
3	Dalja në Dritë e Librit të Mormonit	<ul style="list-style-type: none">Doktrina e Besëlidhje 17; Joseph Smith – Historia 1:29–54.Neal A. Maxwell, “By the Gift and Power of God”, <i>Ensign</i>, janar 1997, f. 36–41.“Book of Mormon Translation”, Gospel Topics, <i>lds.org/topics</i>.“Coming Forth of the Book of Mormon and Restoration of the Priesthood”, kapitulli 5 te <i>Church History in the Fulness of Times Student Manual</i>, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 52–66.
4	Libri i Mormonit – Gurthemeli i Besimit Tonë	<ul style="list-style-type: none">Doktrina e Besëlidhje 17:6; 19:26; 20:5–12.Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon—Keystone of Our Religion”, <i>Ensign</i>, nëntor 1986, f. 4–7.Jeffrey R. Holland, “Siguri për Shpirtin Njerëzor”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2009, f. 88–90.
5	Rivendosja e Priftërisë	<ul style="list-style-type: none">Joseph Smith – Historia 1:68–72; Doktrina e Besëlidhje 13:1; 84:18–22; 107:1–19.Tomas S. Monson, “Priftëria – një Dhuratë e Shenjtë”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2007, f. 57–60.
6	Organizimi i Kishës	<ul style="list-style-type: none">Doktrina e Besëlidhje 1:30; 20:1–3, 17–37, 68–69.Henri B. Ajring, “Kisha e Vërtetë dhe e Gjallë”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2008, f. 20–24.
7	Shpallni Ungjillin e Përgjithshëm	<ul style="list-style-type: none">Doktrina e Besëlidhje 4:1–7; 18:10–16; 29:4–7; 31:1–12; 33:2–7; 34:5–6; 39:20–23; 88:81.Nil L. Andersen, “Është një Mrekulli”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2013, f. 77–80.
8	Mbledhja e Izraelit të Ditëve të Mëvonshme	<ul style="list-style-type: none">Doktrina e Besëlidhje 37:1–3; 38:31–33; 39:15; 45:62–67; 95:8; 110:9; 115:5–6.Russell M. Nelson, “The Gathering of Scattered Israel”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2006, f. 79–82.
9	Ndiqni Profetin e Gjallë	<ul style="list-style-type: none">Doktrina e Besëlidhje 21:1–6; 28:2, 6–7; 43:1–7; 90:1–6, 16.Kevin R. Dankan, “Pikërisht Mbijetesa Jonë”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2010, f. 34–36.Rasëll M. Nelson, “Mbështetja e Profetëve”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2014, f. 74–77.
10	Kërkoni të Vërtetën	<ul style="list-style-type: none">Doktrina e Besëlidhje 88:118–126; 91:1–6.Diter F. Uhtdorf, “Ç’është e Vërteta?” (takim shpirtëror i Sistemit Arsimit të Kishës, 13 janar 2013), <i>lds.org/broadcasts</i>.David A. Bednar, “Quick to Observe”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, dhjetor 2006, f. 31–36.
11	Zëri i Zotit të Doktrina e Besëlidhje	<ul style="list-style-type: none">Parathënia për Doktrinën e Besëlidhjet; Doktrina e Besëlidhje 1:1–39; 5:10.Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon and the Doctrine and Covenants”, <i>Ensign</i>, janar 2005, f. 24–28.
12	Shkrime të Shenjta Shtesë të Kohës Sonë	<ul style="list-style-type: none">Doktrina e Besëlidhje 1:38; 42:56; 45:60–62; 68:3–5; 76:15–19; 93:53; 94:10.Xhefri R. Holland, “Fjalët e Mia . . . Kurrë s’Pushojnë”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2008, f. 91–94.“Translation and Historicity of the Book of Abraham” [“Përkthimi dhe Historiku i Librit të Abrahamit”], Gospel Topics, <i>lds.org/topics</i>.
13	“Vegimi”	<ul style="list-style-type: none">Doktrina e Besëlidhje 76.L. Tom Perry, “The Plan of Salvation”, <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2006, f. 69–72.

Mësimi	Titulli	Materiale Leximi të Sugjeruara
14	Tempulli i Kirtlandit dhe Çelësat e Priftërisë	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 109:1–28; 110:1–16. Jeffrey R. Holland, "Our Most Distinguishing Feature", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2005, f. 43–45. Dejvid A. Bednar, "Me Nder do të Mbajë një Emër e Qëndrim", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2009, f. 97–100.
15	Forcë në Mes të Kundërshtimit	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 112:10–15; 121:1–10, 16–17; 122:1–9. Nil L. Andersen, "Prova e Besimit Tuaj", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2012, f. 39–42.
16	Shëlbimi i të Vdekurve	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 124:30–41; 127:1–9; 128:1–18; 137:1–10; 138:28–37. Riçard G. Skot, "Gëzimi i Shëlbimit të të Vdekurve", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2012, f. 93–95. D. Todd Christofferson, "The Redemption of the Dead and the Testimony of Jesus", <i>Ensign</i>, nëntor 2000, f. 9–12.
17	Mësimet e Ungjillit në Navu	<ul style="list-style-type: none"> Psalmeve 82:6; Mateu 5:48; Gjoni 10:32–34; Romakëve 8:16–17; 2 Pjetër 1:3–4; 1 Gjoni 3:2–3; Doktrina e Besëlidhje 93:11–22; 124:25–28, 37–42; 132:20–24. "Mësimdhënia dhe të Mësuarit e Ungjillit", kapitulli 2 te <i>Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith</i> (2009), f. 39–46. "Becoming Like God", Gospel Topics, <i>lds.org/topics</i>.
18	Shoqata e Ndihmës dhe Kisha	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 25. Dallin H. Ouks, "Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2014, f. 49–52. Xhuli B. Bek, "Vizioni i Profetëve lidhur me Shoqatën e Ndihmës: Besimi, Familja, Ndihma", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2012, f. 83–85.
19	Doktrina e Martesës dhe Familjes së Përjetshme	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 49:15–17; 131:1–4; 132:1–24. Rusëll M. Nelson, "Martesa Çelestiale", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2008, f. 92–95. Joshua J. Perkey, "Why Temple Marriage?" <i>New Era</i>, gusht 2013, f. 30–32.
20	Martesa me Shumë Gra	<ul style="list-style-type: none"> Jakobi [LiM] 2:27–30; Doktrina e Besëlidhje 132:1–3, 34–48, 54, 63; Deklarata Zyrtare 1. "Plural Marriage in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints", Gospel Topics, <i>lds.org/topics</i>. <p>Merrni parasysh të lexoni sa vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> "Plural Marriage in Kirtland and Nauvoo", Gospel Topics, <i>lds.org/topics</i>. "Plural Marriage and Families in Early Utah", Gospel Topics, <i>lds.org/topics</i>. "The Manifesto and the End of Plural Marriage", Gospel Topics, <i>lds.org/topics</i>.
21	Misioni Profetik i Jozef Smithit	<ul style="list-style-type: none"> 2 Nefi 3:1–21; Doktrina e Besëlidhje 122:1–2; 135:3; Joseph Smith – Historia 1:33. Nil L. Andersen, "Jozef Smithi", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2014, f. 28–31. Ted R. Kelister, "Jozef Smithi – Profeti i Rivendosijes", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2009, f. 35–37.
22	Martirizimi i Profetit Jozef Smith	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 135:1–7; 136:36–39. Thomas S. Monson, "The Prophet Joseph Smith: Teacher by Example", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, nëntor 2005, f. 67–70. "The Martyrdom", kapitulli 22 te <i>Church History in the Fulness of Times Student Manual</i>, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 273–285.
23	Vijueshmëria në Presidencë	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 107:33; 112:30–32; 124:127–28. Bojd K. Paker, "Të Dymbëdhjetët", <i>Ensign</i> ose <i>Liahona</i>, maj 2008, f. 83–87. "The Twelve to Bear Off the Kingdom", kapitulli 23 te <i>Church History in the Fulness of Times Student Manual</i>, bot. i 2-të (Church Educational System manual, 2003), f. 286–296.
24	Largimi nga Navuja dhe Udhëtimi drejt Perëndimit	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 136. Gordon B. Hinckley, "True to the Faith", <i>Ensign</i>, maj 1997, f. 65–67. "Besim në Çdo Hap", kapitulli 6 te <i>Trashëgimia Jonë: Një Histori e Shkurtër e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme</i> (2010), f. 69–80.
25	Lufta e Jutas dhe Masakra e Liva-dheve Malore	<ul style="list-style-type: none"> "Peace and Violence among 19th-Century Latter-day Saints", Gospel Topics, <i>lds.org/topics</i>. Richard E. Turley Jr., "The Mountain Meadows Massacre", <i>Ensign</i>, shtator 2007, f. 17–21.
26	Zbulesa mbi Priftërinë	<ul style="list-style-type: none"> 2 Nefi 26:33; Deklarata Zyrtare 2. "Race and the Priesthood", Gospel Topics, <i>lds.org/topics</i>. Ahmad Corbitt, "A Personal Essay on Race and the Priesthood", pjesa 1–4, seritë Perspectives on Church History, <i>history.lds.org/section/perspectives-on-church-history</i>.

Mësimi	Titulli	Materiale Leximi të Sugjeruara
27	Përgatitja e Botës për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit	<ul style="list-style-type: none"> Doktrina e Besëlidhje 29:7–9; 34:5–7; 39:19–23; 45:15–46, 56–57; 88:81–87. Nil L. Andersen, “Të Përgatisësh Botën për Ardhjen e Dytë”, <i>Ensign ose Liahona</i>, maj 2011, f. 49–52. “Preparing for the Second Coming of Christ”, kapitulli 44 te <i>Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith</i> (1998), f. 389–397.
28	Përsheptimi i Punës për Shpëtim	<ul style="list-style-type: none"> Diter F. Uhtdorf, “A Po Flini Gjatë Rivendosjes?” <i>Ensign ose Liahona</i>, maj 2014, f. 58–62. “Hastening the Work of Salvation”, <i>Ensign</i>, tetor 2013, f. 36–39.



Libri i Mormonit – Gurthemeli i Besimit Tonë



“Gurthemeli i Dëshimit Tonë për Krishtin”

“Libri i Mormonit është gurthemeli në dëshmimin tonë për Jezu Krishtin, i cili është Vetë gurthemeli i çdo gjëje që bëjmë. Ai dëshmon për realitetin e Tij. . . . Dëshmia e tij për Mësuesin është e qartë, e padobësuar dhe plot me fuqi. . . . Shumica e botës së krishterë sot e hedh poshtë hyjninë e Shpëtimtarit. Ata e vënë në pikëpyetje lindjen e Tij të mrekullueshme, jetën e Tij të përsosur dhe vërtetësinë e ringjalljes së Tij të lavdishme. Libri i Mormonit na mëson me terma të qarta dhe të pagabueshme rreth të vërtetës së këtyre të gjithave. Ai gjithashtu na jep shpjegimin më të plotë të doktrinë së Shlyerjes” (Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon – Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 5).

Libri i Mormonit – Gurthemeli i Besimit Tonë



“Gurthemeli i Doktrinës Sonë”

“Në Librin e Mormonit ne do të gjejmë plotësinë e atyre doktrinave që kërkohen për shpëtimin tonë. Dhe ato janë dhënë mësim thjesht dhe qartë në mënyrë që edhe fëmijët të mund t’i mësojnë mënyrat e shpëtimit dhe të ekzaltimit. Libri i Mormonit ofron kaq shumë sa që zgjeron kuptueshmërinë tonë për doktrinat e shpëtimit. Pa të, shumica prej asaj që jepet mësim në shkrimet e tjera të shenjta, nuk do të jetë aq e qartë dhe e çmuar” (Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon – Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 6).

Libri i Mormonit – Gurthemeli i Besimit Tonë



“Gurthemeli i Dëshmisë”

“Libri i Mormonit është gurthemeli i dëshmisë. Ashtu si harku shembet, në qoftë se i hiqet gurthemeli, po kështu edhe e gjithë Kisha qëndron ose bie me vërtetësinë e Librit të Mormonit. . . . Në qoftë se Libri i Mormonit është i vërtetë . . . atëherë duhen pranuar pretendimet ndaj Rivendosjes dhe gjithçka-je që lidhet me të” (Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon – Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 6).



Dallimi i së Vërtetës prej së Gabuarës

Në të gjitha periudhat e kujdestarisë së ungjillit, forcat e ligësisë e kanë kundërshtuar Perëndinë dhe veprën e Tij. Por vepra e Perëndisë nuk do të pengohet. Në këto ditë të mëvonshme, guri është shkëputur nga mali dhe do të “përhapet derisa të ketë mbushur tërë tokën” (DeB 65:2). Megjithatë, ngaqë anëtarë individualë të Kishës mund të mashtrohen, ne secili kemi nevojë t’i “mbaljmë” sytë hapur dhe të lute[mij] gjithnjë” (3 Nefi 18:18).



“Nuk ka nevojë që ju ose unë, në këtë periudhë të ndriçuar, kur plotësia e ungjillit është rivendosur, të lundrojmë [në] dete të paeksploruara apo të udhëtojmë në rrugë të panjohura, në kërkim të së vërtetës. Një Atë i dashur Qiellor na e ka shënuar rrugën dhe na ka siguruar një hartë të pagabueshme – madje *bindjen*. Një ditori për të vërtetën dhe përgjigjet për pyetjet tona më të mëdha na vijnë kur jemi të bindur ndaj urdhërimeve të Perëndisë” (Tomas S. Monson, “Bindja Sjell Bekime”, *Ensign ose Liahona*, maj 2013, f. 89).



“Miqë e mi të dashur – ju lutem, së pari kini dyshim të dyshimet tuaja përpara se të keni dyshim të besimi juaj. Ne kurrë nuk duhet ta lejojmë dyshimin që të na mbajë të burgosur dhe të na largojë nga dashuria hyjnore, paqja dhe dhuratat që vijnë nëpërmjet besimit të Zotit Jezu Krisht” (Diter F. Uhtdorf, “Ejani, Bashkohuni me Ne”, *Ensign ose Liahona*, nëntor 2013, f. 23).



“Satani është mashtruesi i madh, ‘paditësi i vëllezërve’ [Zbulesa 12:10], ati i gjithë gënjeshtrave, [shih Gjoni 8:44], i cili vazhdimisht përpiqet të mashtrtojë që të mund të na mposhtë [shih DeB 50:3]. . . .

Për ata që tashmë e përqafojnë të vërtetën, strategjia e tij kryesore është të shpërndajë farat e dyshimit. Për shembull, ai i ka bërë shumë anëtarë të Kishës të pengohen kur zbulojnë informacion rreth Kishës, që duket se bie në kundërshtim me atë që kishin mësuar më parë.

Kur e përjetoni një çast të tillë, kujtoni se në këtë epokë të informacionit ka shumë që krijojnë dyshim rreth ndonjë gjëje dhe gjithçkaje, në çdo kohë dhe në çdo vend. . . .

. . . Dhe është gjithmonë mirë të mbajmë në mendje që, thjesht sepse diçka botohet në gazetë, shfaqet në internet, përsëritet shpesh ose ka një grup të fuqishëm pasuesish, nuk bëhet e vërtetë.

Nganjëherë deklarata ose informacione jo të vërteta paraqiten në një mënyrë të tillë që duken mjaft të besueshme. . . .

. . . Ajo që mund të duket kundërshtuese tani, në mënyrë të përsosur mund të jetë e kuptueshme kur kërkojmë dhe ma-

rrim më shumë informacion të denjë për t’u besuar” (Diter F. Uhtdorf, “Ç’është e Vërteta?” [takim shpirtëror i Sistemit Arsivor të Kishës, 13 janar 2013], lds.org/broadcasts).



“Kur fillojmë t’i matim praktikat dhe propozimet bashkëkohore kundrejt asaj që dimë nga plani i Perëndisë dhe kushtet paraprake të dhëna në fjalën e Perëndisë dhe mësimet e profetëve të Tij të gjallë, . . . e dimë se kjo na vendos përjetësisht mbi një bazë të sigurt” (Dallin H. Oaks, “As He Thinketh in His Heart” [mbërmje me Plakun Dallin H. Oaks, 8 shkurt 2013], lds.org/broadcasts).



“Në çaste frike apo dyshimi, ose kohë shqetësimi, mos u largoni nga besimi që keni fituar tashmë, edhe pse ai mund të jetë i kufizuar. . . . Kur ato çaste vijnë dhe shqetësimet shfaqen, zgjidhja e të cilave nuk po afrohet menjëherë, *mbahuni fort tek ajo që tashmë e dini dhe qëndroni të paepur derisa vjen dija e mëtejshme*” (Xhefri R. Holland, “Unë Besoj, o Zot” *Ensign ose Liahona*, maj 2013, f. 94).



“Ne mund t’i kujtojmë kërkuesit të sinqertë se informacioni në internet nuk ka një filtër të ‘së vërtetës’. Disa informacione lidhur me Kishën, sado bindëse qofshin, thjesht nuk janë të vërteta” (Nil L. Andersen, “Jozef Smithi”, *Ensign ose Liahona*, nëntor 2014, f. 29).



“Përgjigjet ndaj pyetjeve shpirtërore u jepen individëve që nuk i ngurtësojnë zemrat e tyre; që kërkojnë me besim, duke besuar se do të marrin; dhe që i zbatojnë urdhërimet me zell” (Paul V. Johnson, “A Pattern for Learning Spiritual Things” [bisedë drejtuar arsimtarëve fetarë të Sistemit Arsivor të Kishës, 7 gusht 2012], si.lds.org).



“Të studiuarit e Kishës . . . nëpërmjet syve të braktisëve të saj [është] sikur të intervistosh Judën për të kuptuar Jezusin” (Neal A. Maxwell, “All Hell Is Moved” [takim shpirtëror në Universitetin “Brigam Jang”, 8 nëntor 1977], f. 3, speeches.byu.edu).

Baraspeshimi i Historisë së Kishës

Plaku Stiven E. Snou, i Të Shtatëdhjetëve tha:



“Interneti ka vendosur të gjitha llojet e informacionit në majë të gishtave tanë – të mirë, të keq, të vërtetë, të pavërtetë – duke përfshirë informacionin e historisë së Kishës. Ju mund të lexoni shumë rreth historisë sonë, por është e rëndësishme të lexoni rreth saj dhe ta kuptoni atë në kontekstin e saj. Vështirësia me një pjesë të informacionit në internet është që ajo është jashtë kontekstit dhe ju nuk e shihni me të vërtetë pamjen e plotë.

Informacioni që përpiqet ta poshtërojë Kishën, është në përgjithësi shumë subjektiv dhe i padrejtë. Ne duhet të kërkojmë burime që i përshkruajnë në mënyrë më objektive gjërat që ne besojmë dhe historinë tonë. Disa faqe interneti janë shumë keqdashëse dhe mund të jenë të bujshme në mënyrën se si e paraqesin informacionin. Kërkoni burime nga historianë të njohur e të respektuar, qofshin ata anëtarë të Kishës ose jo.

Disa të rinj zihen në befasi dhe tronditen nga materiali anti-mormon në internet, sepse ata nuk e kanë fortifikuar veten e tyre kundrejt tij. Ata mund të mos kenë shpenzuar kohë të mjaftueshme lidhur me anën shpirtërore, që ta përgatitin dhe forcojnë vetveten për atë që mund të vijë. Kur përvojat jetësore vijë për t’ua lëkundur themelet e ngritura nën vete, është e rëndësishme që ata të bëjnë ato gjëra bazë për të cilat ne gjithmonë flasim: vazhdimin e studimit të shkrimeve të shenjta dhe pasjen e lutjeve domethënëse me Atin tonë Qiellor. Ato gjëra bazë i përgatitin njerëzit për të gjitha llojet e kundërshtimit, duke përfshirë artikujt anti-mormonë që do të vijnë nëpërmjet internetit” (“Balancing Church History”, *New Era*, qershor 2013, f. 21–22).

Baraspeshimi i Historisë së Kishës

Plaku Stiven E. Snou, i Të Shtatëdhjetëve tha:



“Interneti ka vendosur të gjitha llojet e informacionit në majë të gishtave tanë – të mirë, të keq, të vërtetë, të pavërtetë – duke përfshirë informacionin e historisë së Kishës. Ju mund të lexoni shumë rreth historisë sonë, por është e rëndësishme të lexoni rreth saj dhe ta kuptoni atë në kontekstin e saj. Vështirësia me një pjesë të informacionit në internet është që ajo është jashtë kontekstit dhe ju nuk e shihni me të vërtetë pamjen e plotë.

Informacioni që përpiqet ta poshtërojë Kishën, është në përgjithësi shumë subjektiv dhe i padrejtë. Ne duhet të kërkojmë burime që i përshkruajnë në mënyrë më objektive gjërat që ne besojmë dhe historinë tonë. Disa faqe interneti janë shumë keqdashëse dhe mund të jenë të bujshme në mënyrën se si e paraqesin informacionin. Kërkoni burime nga historianë të njohur e të respektuar, qofshin ata anëtarë të Kishës ose jo.

Disa të rinj zihen në befasi dhe tronditen nga materiali anti-mormon në internet, sepse ata nuk e kanë fortifikuar veten e tyre kundrejt tij. Ata mund të mos kenë shpenzuar kohë të mjaftueshme lidhur me anën shpirtërore, që ta përgatitin dhe forcojnë vetveten për atë që mund të vijë. Kur përvojat jetësore vijë për t’ua lëkundur themelet e ngritura nën vete, është e rëndësishme që ata të bëjnë ato gjëra bazë për të cilat ne gjithmonë flasim: vazhdimin e studimit të shkrimeve të shenjta dhe pasjen e lutjeve domethënëse me Atin tonë Qiellor. Ato gjëra bazë i përgatitin njerëzit për të gjitha llojet e kundërshtimit, duke përfshirë artikujt anti-mormonë që do të vijnë nëpërmjet internetit” (“Balancing Church History”, *New Era*, qershor 2013, f. 21–22).

Të Qëndruarit të Fortë në Kohë Kundërshtimi

Braktisja në Kirtland: Nevoja për t'i Ndjekur me Besnikëri Udhëheqësit e Kishës

Në vitin 1837, shenjtoret në Kirtland të Ohajos përjetuan disa probleme financiare. Për t'i ndihmuar shenjtoret që të ishin më të mbështetur te vetja lidhur me financat e tyre, Jozef Smithi dhe udhëheqës të tjerë të Kishës themeluan një kompani të ngjashme me një bankë dhe e quajtën atë Shoqëria e Sigurisë së Kirtlandit. Për shkak të një depresioni ekonomik mjaft të përhapur gjatë kësaj kohe, shumë banka dështuan anëmbanë Shteteve të Bashkuara. Edhe Shoqëria e Sigurisë së Kirtlandit dështoi në vjeshtën e vitit 1837. Dyqind investues në bankë humbën pothuajse gjithçka, me Jozef Smithin duke pësuar humbjet më të mëdha. Edhe pse Shoqëria e Sigurisë së Kirtlandit nuk u financua nga Kisha, disa prej shenjtoreve e shihnin atë si një bankë të Kishës ose si bankën e Profetit dhe e fajësuan Jozef Smithin për problemet e tyre financiare. Disa madje filluan ta quanin atë një profet të rënë. Por pavarësisht nga dështimi i bankës, shumë të tjerë, të cilët i humbën paratë, vazhduan me besim dhe qëndruan të vërtetë ndaj Profetit.

Një shpirt i braktisjes dhe ankimit filloi të përhapej mes shumë prej shenjtoreve. Deri në qershor të vitit 1838, përafërsisht 200 ose 300 njerëz braktisën e kishin lënë Kishën, duke përfshirë katër Apostuj, Tre Dëshmitarët e Librit të Mormontit dhe një anëtar të Presidencës së Parë. Megjithatë, shumica e shenjtoreve iu përgjigj kësaj periudhe të vënies në provë me besim, po ashtu siç bëri Brigam Jangu. Ata u forcuan nga Zoti dhe mbetën të vërtetë ndaj dëshmitëve të tyre. Shumë prej atyre që u larguan nga Kisha gjatë kësaj periudhe të braktisjes, më vonë u kthyen dhe kërkuan që të bashkoheshin sërish me Kishën e Zotit. Mes tyre ishin Oliver Kaudëri, Martin Harris, Luk Xhonsoni dhe Frederik G. Uilliamsi.

Në mes të këtyre vështirësive në Kirtland, disa braktisës kërkuan ta vrisnin Jozef Smithin. I paralajmëruar nga Shpirti, ai dhe Sidni Rigdoni u larguan gjatë natës më 12 janar 1838. Armiqtë e tyre i ndoqën për disa ditë, por Zoti i mbrojti. Ata mbërritën me familjet e tyre në Far-Uest të Misurit më 14 mars 1838.

Diskutoni si grup pyetjet vijuese:

- Çfarë parimesh mund të mësojmë nga këto ngjarje rreth mënyrës se si t'i përgjigjemi kundërshtimit në jetën tonë? Çfarë mund të mësojmë nga këto ngjarje rreth mënyrës se si t'i përgjigjemi kundërshtimit kundër Kishës?
- Çfarë mund të bëjmë që të mbetemi besnikë ndaj udhëheqësve të Kishës edhe pse ne mund të dëgjojmë njerëz të tjerë t'i kritikojnë ata?
- Në çfarë mënyrash jeni bekuar ngaqë ju e keni ndjekur profetin?

Konflikti në Misurin Verior: Mësimi për ta Duruar Mirë Kundërshtimin

Në vitet 1837 dhe 1838, disa anëtarë të pakënaqur dhe të shkishëruar të Kishës, që jetonin mes shenjtoreve në Far-Uest, filluan të ngrinin padi gjyqësore kundër Kishës e udhëheqësve të saj dhe ta ngacmonin Kishën. Në qershor të vitit 1838, Sidni Ridgoni foli me gjaknxehtësi në atë që është bërë e njohur si "Predikimi i Kripës". Ai përdori Mateun 5:13 dhe tha se, në qoftë se kripa e humbet shijen e saj, ajo nuk shërben më për asgjë dhe duhet të flaket tej, duke nënkuptuar se ata që ishin larguar nga Kisha, duhej të flakeshin nga mesi i shenjtoreve. Dy javë më vonë, më 4 korrik, Sidni Rigdoni dha një fjalim në të cilin ai premtoi se shenjtoret do ta mbronin vetveten edhe sikur të arrinte te një "luftë e shfarosjes". Edhe pse të dy këto fjalime dukej se kundërshtonin udhëzimin e Zotit që të "bëni[n] apel për paqe" (DeB 105:38), që të dy fjalimet u botuan dhe shkaktuan panik të madh mes njerëzve që nuk ishin shenjtore të ditëve të mëvonshme.

Gjatë kësaj kohe, një i kthyer në besim i quajtur Sampson Avardi, administroi betime të fshehta ndaj atyre që do të bashkoheshin me të në formimin e një grupi plaçkitësish, të quajtur danitë. Avardi i udhëzoi ata që të vidhnin e plaçkitnin njerëzit e Misurit, duke thënë se kjo do të ndihmonte për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë. Avardi i bindi pasuesit e tij që udhëzimet e tij po vinin nga Presidenca e Parë. E vërteta u zbulua më vonë dhe Avardi u shkishërua. Veprimet e Avardit shkaktuan dëm të rëndësishëm ndaj idesë për Kishën dhe ndihmuar që të çonin drejt burgimit të Profetit në Burgun Liberti.

Në tetor të vitit 1838, një betejë midis disa anëtarëve të Kishës dhe milicisë së Misurit i la disa njerëz të vdekur nga secila palë. Raporte të tepruara të betejës mbërritën te guvernatori Liburn W. Bogsi, guvernatori i shtetit të Misurit, i cili më pas nxori atë që është bërë i njohur si urdhri i shfarosjes: "Mormonët duhet të trajtohen si armiq dhe duhet të shfarosen ose të nxirren jashtë nga shteti, nëse është e domosdoshme, për të mirën e përgjithshme" (cituar te *History of the Church*, 3:175). Shpejt, qyteti i Far-Uestit u rrethua nga një milici që i tejkaloj pesëfish forcat e shenjtoreve. Jozef Smithi dhe udhëheqës të tjerë të Kishës u burgosën në Burgun Liberti, ku ata qëndruan gjithë dimrin. Pjesa tjetër e shenjtoreve u detyruan të largoheshin nga shteti.

Diskutoni si grup pyetjet vijuese:

- Çfarë parimesh mund të mësojmë nga këto ngjarje për të na ndihmuar që ta durojmë më mirë kundërshtimin?
- Përse është e rëndësishme për secilin prej nesh që ta ndjekim shembullin e Shpëtimtarit në kohët e krizës ose të kundërshtimit? Çfarë ndodhi në Misurin verior ngaqë disa prej shenjtoreve nuk e bënë këtë?
- Kur i keni parë fjalët ose veprimet e një njeriu që ta ndikojnë dikë tjetër për të pasur një pikëpamje pozitive për Kishën?



Pjesë të Shkëputura nga Diskutimi i King Folletit

Profeti Jozef Smith (1805–1844) na mësoi:



“Nëse njeriu mëson veçse të hajë, të pijë dhe të flejë, si dhe nuk kupton asnjë nga planet e Perëndisë, këto gjëra i kupton dhe shtaza. Ajo ha, pi, fle dhe nuk di asgjë për Perëndinë; ende ajo di po aq sa ne, përveç se kur ne jemi në gjendje të kuptojmë me anë të frymëzimit

nga Perëndia i Plotfuqishëm. Nëse njerëzit nuk kuptojnë karakterin e Perëndisë, ata nuk kuptojnë vetveten. ...

Synimi im i parë është të zbuloj karakterin e të vetmit Perëndi të urtë dhe të vërtetë, si dhe çfarë lloj qenieje është Ai. ...

Vetë Perëndia ishte një herë siç jemi ne tani, dhe është një njeri i ekzaltuar dhe ulet i kurorëzuar në qiejt atje lart! Ky është sekreti i madh. Nëse veli do të grisej sot dhe Perëndia i madh, që mban këtë botë në orbitën e saj dhe që mban gjithë botët e gjithë gjërat me fuqinë e Tij, do të bëhej i

dukshëm, – ju them, nëse do ta shihnit Atë sot, do ta shihnit Atë me formën e një njeriu – si ju vetë, në të gjithë personin, imazhin dhe vetë formën e një njeriu; sepse Adami u krijua sipas vetë modelit, imazhit dhe ngjashmërisë së Perëndisë dhe mori udhëzim, eci, foli e bisedoi me Atë, ashtu si një njeri flet e komunikon me një tjetër” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 42).

“Kjo, pra, është jeta e përjetshme – të njohësh të vetmin Perëndi të mençur e të vërtetë; dhe ju duhet të mësoni se si të bëheni ju vetë perëndi dhe të bëheni mbretër dhe priftërinj për Perëndinë, ... duke kaluar nga një shkallë e vogël te një tjetër dhe nga një aftësi e vogël te një e madhe; nga hiri në hir, nga ekzaltimi në ekzaltim, derisa të arrini në ringjalljen e të vdekurve, dhe të jeni në gjendje të banoni në flakët e përjetshme, dhe të uleni në lavdi, siç e bëjnë ata që ulen në fron në fuqinë e përjetshme” (*Mësimet: Jozef Smith*, f. 232).

Pjesë të Shkëputura nga Diskutimi i King Folletit

Profeti Jozef Smith (1805–1844) na mësoi:



“Nëse njeriu mëson veçse të hajë, të pijë dhe të flejë, si dhe nuk kupton asnjë nga planet e Perëndisë, këto gjëra i kupton dhe shtaza. Ajo ha, pi, fle dhe nuk di asgjë për Perëndinë; ende ajo di po aq sa ne, përveç se kur ne jemi në gjendje të kuptojmë me anë të frymëzimit

nga Perëndia i Plotfuqishëm. Nëse njerëzit nuk kuptojnë karakterin e Perëndisë, ata nuk kuptojnë vetveten. ...

Synimi im i parë është të zbuloj karakterin e të vetmit Perëndi të urtë dhe të vërtetë, si dhe çfarë lloj qenieje është Ai. ...

Vetë Perëndia ishte një herë siç jemi ne tani, dhe është një njeri i ekzaltuar dhe ulet i kurorëzuar në qiejt atje lart! Ky është sekreti i madh. Nëse veli do të grisej sot dhe Perëndia i madh, që mban këtë botë në orbitën e saj dhe që mban gjithë botët e gjithë gjërat me fuqinë e Tij, do të bëhej i

dukshëm, – ju them, nëse do ta shihnit Atë sot, do ta shihnit Atë me formën e një njeriu – si ju vetë, në të gjithë personin, imazhin dhe vetë formën e një njeriu; sepse Adami u krijua sipas vetë modelit, imazhit dhe ngjashmërisë së Perëndisë dhe mori udhëzim, eci, foli e bisedoi me Atë, ashtu si një njeri flet e komunikon me një tjetër” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 42).

“Kjo, pra, është jeta e përjetshme – të njohësh të vetmin Perëndi të mençur e të vërtetë; dhe ju duhet të mësoni se si të bëheni ju vetë perëndi dhe të bëheni mbretër dhe priftërinj për Perëndinë, ... duke kaluar nga një shkallë e vogël te një tjetër dhe nga një aftësi e vogël te një e madhe; nga hiri në hir, nga ekzaltimi në ekzaltim, derisa të arrini në ringjalljen e të vdekurve, dhe të jeni në gjendje të banoni në flakët e përjetshme, dhe të uleni në lavdi, siç e bëjnë ata që ulen në fron në fuqinë e përjetshme” (*Mësimet: Jozef Smith*, f. 232).

Gratë dhe Priftëria

Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha:



“Në një fjalim drejtuar Shoqatës së Ndhmës, Presidenti Jozef Filding Smith, në atë kohë Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha këtë: Ndërsa motrave nuk iu është dhënë Priftëria, nuk iu është dhuruar atyre, kjo nuk do të thotë se Zoti nuk u ka dhënë atyre autoritet. ... Një njeri mund të

ketë autoritet të dhënë atij ose një motër [autoritet] të dhënë asaj, për të bërë gjëra të caktuara në Kishë, të cilat janë lidhëse dhe tërësisht të nevojshme për shpëtimin tonë, siç është puna që motrat tona bëjnë në Shtëpinë e Zotit. Ato kanë autoritet të dhënë atyre për të bërë disa gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme, të shenjta për Zotin, dhe lidhëse, në mënyrë po aq tërësore sa ç’janë bekimet që jepen nga burrat që mbajnë Priftërinë’ [‘Relief Society – An Aid to the Priesthood’, *Relief Society Magazine*, janar 1959, f. 4].

Në atë fjalim të shquar, Presidenti Smith tha në mënyrë të përsëritur se grave u është dhënë autoritet. Grave ai u tha: ‘Ju mund të flisni me autoritet, sepse Zoti ka vendosur autoritet mbi ju’. Ai gjithashtu tha se Shoqatës së Ndhmës ‘i

[është] dhënë fuqi dhe autoritet për të bërë shumë gjëra të madhërishme. Puna që ato bëjnë, bëhet nëpërmjet autoritetit hyjnor.’ Dhe, sigurisht, puna e Kishës, e bërë nga burra ose gra, qoftë në tempull apo në lagjet ose degët, bëhet nën drejtimin e atyre që mbajnë çelësa të priftërisë. Kështu, duke folur për Shoqatën e Ndhmës, Presidenti Smith shpjegoi: ‘[Zoti] ua ka dhënë atyre këtë organizatë të madhërishme ku ato kanë autoritet për të shërbyer nën drejtimin e peshkopëve të lagjeve, duke u kujdesur për interesin e njerëzve tanë si shpirtërisht ashtu dhe materialisht’ [‘Relief Society – An Aid to the Priesthood’, f. 4–5]. ...

Në nuk e kemi zakon të flasim për gratë që të kenë autoritetin e priftërisë në thirrjet e tyre në Kishë, por çfarë autoriteti tjetër mund të jetë ai? Kur një grua – e re apo e moshuar – veçohet për të predikuar ungjillin si një misionare kohëplotë, asaj i jepet autoritet priftërie për të kryer një funksion priftërie. E njëjta gjë është e vërtetë kur një grua veçohet për të vepruar si nëpunëse ose mësuese në një organizatë të Kishës, nën drejtimin e një personi që mban çelësat e priftërisë. Kushdo që vepron në një detyrë ose thirrje të marrë nga një njeri që mban çelësat e priftërisë, ushtron autoritet priftërie në kryerjen e detyrave të caktuara atij ose asaj” (“Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2014, f. 51).

Gratë dhe Priftëria

Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha:



“Në një fjalim drejtuar Shoqatës së Ndhmës, Presidenti Jozef Filding Smith, në atë kohë Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha këtë: Ndërsa motrave nuk iu është dhënë Priftëria, nuk iu është dhuruar atyre, kjo nuk do të thotë se Zoti nuk u ka dhënë atyre autoritet. ... Një njeri mund të

ketë autoritet të dhënë atij ose një motër [autoritet] të dhënë asaj, për të bërë gjëra të caktuara në Kishë, të cilat janë lidhëse dhe tërësisht të nevojshme për shpëtimin tonë, siç është puna që motrat tona bëjnë në Shtëpinë e Zotit. Ato kanë autoritet të dhënë atyre për të bërë disa gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme, të shenjta për Zotin, dhe lidhëse, në mënyrë po aq tërësore sa ç’janë bekimet që jepen nga burrat që mbajnë Priftërinë’ [‘Relief Society – An Aid to the Priesthood’, *Relief Society Magazine*, janar 1959, f. 4].

Në atë fjalim të shquar, Presidenti Smith tha në mënyrë të përsëritur se grave u është dhënë autoritet. Grave ai u tha: ‘Ju mund të flisni me autoritet, sepse Zoti ka vendosur autoritet mbi ju’. Ai gjithashtu tha se Shoqatës së Ndhmës ‘i

[është] dhënë fuqi dhe autoritet për të bërë shumë gjëra të madhërishme. Puna që ato bëjnë, bëhet nëpërmjet autoritetit hyjnor.’ Dhe, sigurisht, puna e Kishës, e bërë nga burra ose gra, qoftë në tempull apo në lagjet ose degët, bëhet nën drejtimin e atyre që mbajnë çelësa të priftërisë. Kështu, duke folur për Shoqatën e Ndhmës, Presidenti Smith shpjegoi: ‘[Zoti] ua ka dhënë atyre këtë organizatë të madhërishme ku ato kanë autoritet për të shërbyer nën drejtimin e peshkopëve të lagjeve, duke u kujdesur për interesin e njerëzve tanë si shpirtërisht ashtu dhe materialisht’ [‘Relief Society – An Aid to the Priesthood’, f. 4–5]. ...

Në nuk e kemi zakon të flasim për gratë që të kenë autoritetin e priftërisë në thirrjet e tyre në Kishë, por çfarë autoriteti tjetër mund të jetë ai? Kur një grua – e re apo e moshuar – veçohet për të predikuar ungjillin si një misionare kohëplotë, asaj i jepet autoritet priftërie për të kryer një funksion priftërie. E njëjta gjë është e vërtetë kur një grua veçohet për të vepruar si nëpunëse ose mësuese në një organizatë të Kishës, nën drejtimin e një personi që mban çelësat e priftërisë. Kushdo që vepron në një detyrë ose thirrje të marrë nga një njeri që mban çelësat e priftërisë, ushtron autoritet priftërie në kryerjen e detyrave të caktuara atij ose asaj” (“Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2014, f. 51).



Të Kuptuarit e Martesës me Shumë Gra

Martesa me Shumë Gra

“Shenjtoret e ditëve të mëvonshme besojnë se martesa e një burri dhe një gruaje është ligji i qëndrueshëm i Zotit për martesën. Në kohët biblike, Zoti i urdhëroi disa njerëz ta ushtronin martesën me shumë gra – martesën e një burri me më shumë se një grua. Me anë të zbulesës, Zoti e urdhëroi Jozef Smithin të vendoste praktikën e martesës me shumë gra mes anëtarëve të Kishës në fillimin e viteve 1840. Për më shumë se gjysmë shekulli, martesa me shumë gra u ushtrua mes disa shenjtoreve të ditëve të mëvonshme nën drejtimin e Presidentit të Kishës” (“Plural Marriage in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints”, Gospel Topics, [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics)).

Një Urdhërim i Vështirë

Eliza R. Snou (1804–1887), presidentja e dytë e përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, u vulos me Profetin Jozef Smith. Ajo shënoi përvojën vijuese në të cilën Profeti Jozef ia mësoi parimin e martesës me shumë gra vëllait të saj, Lorenzo Snout.

“Profeti Jozef ia hapi lirisht zemrën e tij [Lorenzo Snout] dhe përshkroi provën e rëndë sfiduese, mendore, që përjetoj, që të mund të mposhte neveritjen e ndjenjave të tij, rrjedhimi natyror i forcës së edukimit dhe zakonit shoqëror, lidhur me prezantimin e martesës me shumë gra. Ai e dinte zërin e Perëndisë – ai e dinte se urdhërimi që i dha i Plotfuqishmi, ishte ta vinte në lëvizje – të jepte shembullin dhe ta themelonte martesën Çelestiale me shumë gra. Ai e dinte se nuk kishte për të luftuar e kapërcyer vetëm mendimet e gabuara dhe paragjykimet e veta, por ato të mbarë botës së krishterë, që po e shihnin drejt e në sy; por Perëndia, që është mbi të gjitha, e kishte dhënë urdhërimin dhe Ai duhej të bindej. Prapëseprapë, Profeti ngurroi dhe e shtyu kohë pas kohe, derisa një engjëll i Perëndisë qëndroi pranë tij, me një shpatë të zhveshur, dhe i tha atij se, në qoftë se nuk e vinte në lëvizje dhe e themelonte martesën me shumë gra, Priftëria e tij do të merrej prej tij dhe ai duhej të shkatërrohej! Këtë dëshmi ai jo vetëm që ia tregoi vëllait tim, por edhe të tjerëve – një dëshmi që nuk mund të kundërvihet [kundërshtohet]” (*Biography and Family Record of Lorenzo Snow* [1884], f. 69–70).

Një Provë e Besimit

Shumë njerëz që e patën të vështirë me parimin e martesës me shumë gra, u bekuan me një dëshimim pohues, shpirtëror të së vërtetës së parimit.

“Sipas Helen Mar Kimballit, Jozef Smithi tha se ‘ushtrimi i këtij parimi do të ishte sprova më e vështirë që shenjtoret do të duhej ta vinin në ndonjëherë në provë besimin e tyre’. Edhe pse ishte një nga sprovat ‘më të vështira’ në jetën e saj, ajo dëshmoi se kishte qenë ‘një nga bekimet më të mëdha’. ...

Lusi Uokeri solli ndërmend mundimin e saj të brendshëm kur Jozef Smithi e ftoi të bëhej bashkëshortja e tij. ‘Çdo ndjenjë e shpirtit tim ngriti krye kundër kësaj’, shkroi ajo. Prapëseprapë, pas disa netësh të parehatshme, e rënë në gjunjë në lutje, ajo gjeti lehtësim ndërkohë që dhoma e saj ‘u mbush me një ndikim të shenjtë’, të përafërt me ‘ndriçimin e shkëlqyer të diellit’. Ajo tha: ‘Shpirti im u mbush me një paqe të qetë, të ëmbël, që nuk e njihja kurrë’ dhe ‘lumturia më madhore e pushtoi tërë qenien time’” (“Plural Marriage in Kirtland and Nauvoo”, Gospel Topics, [lds.org/topics](https://www.lds.org/topics)).

Jozef Smithi dhe Martesa me Shumë Gra

Shumë gra u vulosën me Jozef Smithin, por numri i saktë është i panjohur.

“Gjatë epokës në të cilën martesa me shumë gra u ushtrua, shenjtoret e ditëve të mëvonshme bënë dallimin midis vulosjeve për kohën e përjetësinë dhe vulosjeve vetëm për përjetësinë. Vulosjet për kohën dhe përjetësinë përfshinin zotime dhe marrëdhënie gjatë kësaj jete, duke përfshirë në përgjithësi mundësinë për marrëdhënie seksuale. Vulosjet vetëm për përjetësinë vinin në dukje marrëdhënie vetëm në jetën pas kësaj.

... Disa nga gratë që u vulosën me Jozef Smithin më vonë, dëshmuar se martesat e tyre ishin për jetën e përjetësinë, ndërkohë që të tjera treguan se marrëdhëniet e tyre ishin vetëm për përjetësinë.

Shumica e atyre grave të vulosura me Jozef Smithin ishin midis moshave 20 dhe 40 vjeç në kohën e vulosjes së tyre me të. Më e moshuara, Feni Jang, ishte 56 vjeçe. Më e vogla ishte Helen Mar Kimballi, ... që u vulos me Jozefin disa muaj përpara ditëlindjes së saj të 15-të. Martesa në një moshë të tillë, e papërshtatshme për standardet e sotme, ishte e ligjshme në atë epokë dhe disa gra martoheshin në moshën 15-vjeçare. Helena Mar Kimballi foli për vulosjen e saj me Jozefin si të ishte ‘vetëm për përjetësinë’, duke sugjeruar se marrëdhënia nuk përfshiu marrëdhënie seksuale. ...

Jozef Smithi u vulos me një numër grash që ishin tashmë të martuara. As këto gra, as Jozefi nuk shpjeguan shumë rreth këtyre marrëdhënieve, edhe pse disa gra thanë se ato ishin vetëm për përjetësinë. Gra të tjera nuk lanë dokumente, duke e bërë të panjohur nëse vulosjet e tyre ishin për kohën e përjetësinë apo ishin vetëm për përjetësinë.

Ka disa shpjegime të mundshme për këtë praktikë. Këto vulosje mund të kenë siguruar një mënyrë për të krijuar një lidhje ose një hallkë të përjetshme midis familjes së Jozefit dhe familjeve të tjera brenda Kishës. Këto lidhje u shtrinë si vertikalisht, nga prindi te fëmija, ashtu dhe horizontalisht,

nga një familje tek tjetra. Sot lidhje të tilla të përjetshme arrihen nëpërmjet martesave në tempull të individëve, të cilët gjithashtu vulosen me familjet e tyre të lindjes, në këtë mënyrë duke i lidhur familjet së bashku” (“Plural Marriage in Kirtland and Nauvoo”, Gospel Topics, lds.org/topics).

Pas vdekjes së Profetit, shumë gra u vulosën me të, të cilat nuk kishin pasur marrëdhënie në vdekshmëri me të.

Kundërshtimi ndaj Martesës me Shumë Gra

Shumë udhëheqës fetarë dhe politikë në Shtetet e Bashkuara e kundërshtuan sistemin e martesës me shumë gra, të cilin ata e konsideronin si të pamoralshëm dhe të paqytetëruar. Shenjtorët e ditëve të mëvonshme u përqeshën në fjalime publike, libra, revista e gazeta. Kongresi i Shteteve të Bashkuara miratoi ligje që e kufizuan lirinë e anëtarëve të Kishës, dhe e dëmtuan Kishën ekonomikisht duke e kufizuar sasinë e pronësisë që mund të zotëronte Kisha. “Këto ligje, së fundi, bënë që oficerët të arrestonin dhe burgosnin burrat që kishin më shumë se një bashkëshorte, dhe t’u mohonin atyre të drejtën për të votuar, të drejtën për privatësi në shtëpitë e tyre dhe gëzimin e lirive të tjera civile” (*Trashëgimia Jonë: Një Histori e Shkurtër e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme* [2010], f. 97). Deri në vitin 1890, qindra prej shenjtorëve besnikë të ditëve të mëvonshme kaluan kohë në burg. Të tjerë u fshehën për t’iu shmangur arrestimit dhe burgosjes. Në këto kushte, shumë familje vuajtën nga shqetësimi, brengosja, varfëria dhe uria.

Edhe pse bota i përqeshi ata për ushtrimin e martesës me shumë gra, shumë shenjtorë besnikë të ditëve të mëvonshme e mbrojtën praktikën dhe dëshmuan që ata e dinin se ishte dhënë me anë të zbulës nga Perëndia nëpërmjet Profetit Jozef Smith.

Këto rrethana të vështira e bënë Presidentin Uillford Udraf që të kërkonte plot lutje udhërrëfimim e Zotit lidhur me praktikën e shenjtorëve të martesës me shumë gra. Në vitin 1889, Presidenti Udraf i udhëzoi udhëheqësit e Kishës ta ndërprisnin mësimdhënien e parimit të martesës me shumë gra. Deri në vitin 1890, u kryen shumë pak martesat me shumë gra dhe këto ishin bërë kundër këshillës së Presidentit Udraf. Megjithatë, disa njerëz botuan artikuj që Kisha ende po e reklamonte praktikën e martesës me shumë gra. Këto artikuj sollën kundërshtim të mëtejshëm kundër Kishës. Në shtator të vitit 1890, Presidenti Udraf nxori një Manifest, që tani njihet si Deklarata Zyrtare 1 te Doktrina e Besëlidhje.

Manifesti i Dytë

“Manifesti [Deklarata Zyrtare 1] shpalli qëllimin e Presidentit [Uillford] Udraf për t’iu nënshtruar ligjeve të Shteteve të Bashkuara. Nuk tha asgjë rreth ligjeve të vendeve të tjera. Që nga fillimi i kolonive në Meksikë dhe Kanada, udhëheqësit e Kishës kishin kryer martesat me shumë gra në ato vende dhe pas territorit të vitit 1890, martesat me shumë gra vazhduan të kryeshin atje në heshtje. ... Nën rrethana të jashtëzakonshme, një numër më i vogël i martesave të reja me shumë gra u kryen në Shtetet e Bashkuara midis viteve 1890 dhe 1904, edhe pse është e paqartë nëse martesat u autorizuan që të kryeshin brenda Shteteve [të Bashkuara]” (“The Manifesto and the End of Plural Marriage”, Gospel Topics, lds.org/topics).

“Në konferencën e përgjithshme të prillit 1904, Presidenti [Jozef F.] Smith nxori një deklaratë detyruese, të njohur si Manifesti i Dytë, që i bëri martesat e reja me shumë gra të dënueshme me shkishërim” (“Plural Marriage in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints”, Gospel Topics, lds.org/topics).



Martirizimi i Profetit Jozef Smith

Kundërshtimi i Profetit dhe i Kishës

Në qershor të vitit 1844, armiqësia kundër Kishës ishte shtuar shumë. Disa shtetas në Illinois po diskutonin t'i dëbonin shenjtorët nga shteti, ndërkohë që të tjerë po komplotonin ta vrisnin Profetin. Disa prej atyre që po komplotonin kundër Profetit dhe Kishës, ishin ish-anëtarë të Kishës të cilët e kishin braktisur Kishën. Më 7 qershor 1844, Uilliam Lo, i cili kishte shërbyer si Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, dhe braktisës të tjerë shtypën botimin e parë të një gazete të quajtur *Nauvoo Expositor*. Në një përpjekje për ta nxehur publikun kundër Profetit e Kishës, këta burra e përdorën këtë gazetë që të shpifnin për Jozef Smithin dhe udhëheqës të tjerë të Kishës. Jozef Smithi, duke vepruar si kryetari i bashkisë së Navusë, dhe shumica e këshillit të qytetit të Navusë, e kuptoi se gazeta acaruese do të çonte drejt dhunës së turmave kundër qytetit. Ata e shpallën gazetën si një bezdi publike dhe urdhëruan që të shkatërrohej shtypshkronja e *Nauvoo Expositor*-it.

Jozefi dhe Hajrëmi Akuzohen Padrejtësisht

“Si rezultat i [shkatërrimit të *Nauvoo Expositor*-it] nga kryetari [i] bashkisë dhe këshilli [i] qytetit, autoritetet e Illinoisit bënë një padi të pabazuar për rebelim kundër Profetit, vëllait të tij Hajrëmi dhe zyrtarëve të tjerë të qytetit të Navusë. Guvernatori i Illinoisit, Tomas Ford, i urdhëroi burrat të përballonin gjyqin në Karthixh të Illinoisit, qendra e kontesë, dhe u premtoi mbrojtje. Jozefi e dinte se po të shkonte në Karthixh, jeta e tij do të ishte në rrezik të madh prej turmave që po e kërcënonin atë.

Duke besuar se turmat donin vetëm ata, Jozefi dhe Hajrëmi vendosën të iknin drejt perëndimit për të shpëtuar jetën. Më 23 qershor ata kapërcyen lumin Misisipi, por më vonë po atë ditë, vëllezër nga Navuja e gjetën Profetin dhe i thanë atij se trupa ushtarake do të pushtonin qytetin nëse ai nuk u dorëzohej autoriteteve në Karthixh. Profeti ra dakord ta bënte këtë, duke shpresuar të kënaqte si zyrtarët qeverisës ashtu dhe turmat. Më 24 qershor, Jozef dhe Hajrëmi Smithi u lanë lamtumirën familjeve të tyre dhe kalëruan bashkë me zyrtarë të tjerë të qytetit të Navusë drejt Karthixhit, duke iu dorëzuar vullnetarisht zyrtarëve të kontesë në Karthixh një ditë më vonë. Pasi vëllezërit u liruan me kusht për akuzën fillestare, ata u akuzuan pa të drejtë për tradhti kundër shtetit të Illinoisit, u arrestuan dhe u burgosën në burgun e Karthixhit në pritje për të dalë në gjyq. Pleqtë Xhon Tejlor dhe Uillard Riçards, të vetmit anëtarë të Të Dymbëdhjetëve që në atë kohë nuk po shërbenin misionin, u bashkuan vullnetarisht me ta” (*Mësimet të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 563–565).

Martirizimi në Burgun e Karthixhit

Gjatë ditës së 27 qershorit 1844, një vizitor i kishte dhënë Jozefit një revolver. Teksa turma u përpoq të hynte në

dhomën ku mbaheshin Profeti dhe burrat e tjerë, Hajrëmi u godit për vdekje, duke vepruar në mbrojtje të çdonjërit në dhomë. Jozefi kërcëu drejt derës dhe arriti pranë pragut të derës për të qëlluar me pistoletën në korridor. Vetëm tre prej gjashtë plumbave u qëlluan, duke plagosur disa anëtarë të turmës. Atëherë anëtarët e turmës i futën me forcë pushkët e tyre përmes derës gjysmë të hapur dhe Xhon Tejlori u përpoq t'i godiste pas tytat e pushkëve të tyre me një bastun.

Ndërsa grindja në prag të derës u shtua, Xhon Tejlori u përpoq të largohej nga dhoma nëpërmjet një dritareje. Teksa u përpoq të hidhej jashtë nga dritarja, ai u godit në këmbë nga dera dhe po ashtu u godit prej dikujt nga jashtë. Ai ra në dysheme dhe teksa përpiqej të futej nën shtratin pranë dritares, ai u plagos rëndë nga tre plumba të tjerë. Ndërkohë, teksa pushkët u futën përmes derës, Uillard Riçardsi filloi t'i godiste ato me një bastun.

Jozef Smithi atëherë vendosi të përpiqej të largohej nëpërmjet së njëjtës dritare. Ndërsa Uillard Riçardsi vazhdoi ta largonte turmën te dera, Profeti u përkul te dritarja e hapur. Teksa e bënte këtë, ai u godit prej plumbave si nga brenda ashtu edhe nga jashtë burgut. Ai ra jashtë dritares, duke thirrur: “O Zot, Perëndia im!” dhe ra përdhe. Anëtarët e turmës që ishin brenda burgut, nxituan jashtë për t'u siguruar vetë se Jozefi kishte vdekur. Edhe pse nuk kishte anëtarë të Kishës në udhë për në Karthixh, dikush bërtiti: “Mormonët po vijnë!” dhe e tërë turma u largua.

Nderime për Profetin Jozef Smith

Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha:



“Njerëzit që e njihnin më mirë Jozefin dhe qëndruan më pranë tij në udhëheqjen e Kishës, e deshën dhe e mbështetën atë si një profet. Vëllai i tij, Hajrëmi, zgjodhi të vdiste përkrah tij. Xhon Tejlori, gjithashtu atje kur ai u vra, tha: ‘Unë dëshmoj para Perëndisë, engjëjve dhe njerëzve se ai ishte një burrë i mirë, i nderuar, i virtytshëm ... – se karakteri i tij privat dhe publik ishte shembullor – dhe ai jetoi dhe vdiq si një njeri i Perëndisë’ (*The Gospel Kingdom* [1987], f. 355; shih edhe DeB 135:3). Brigam Jangu shpalli: ‘Nuk mendoj se jeton ndonjë njeri në tokë që e njihje [Jozef Smithin] më mirë se unë; dhe unë kam guximin të them se, përveç Jezu Krishtit, asnjë njeri më i mirë s’ka jetuar ose jeton në këtë tokë’ [*Discourses of Brigham Young*, përzg. John A. Widtsoe (1954), f. 459]” (“Joseph, the Man and the Prophet,” *Ensign*, maj 1996, f. 73).



Vijueshmëria në Presidencën e Kishës

Mbledhja me Dymbëdhjetë Apostujt, mars 1844

Presidenti Uillford Udraf (1807–1898) tregoi:



“Më kujtohet fjalimi i fundit fare që na mbajti [Jozef Smithi] përpara vdekjes së tij. ... Ai qëndroi në këmbë për rreth tre orë. Dhoma ishte e mbushur si me një zjarr që konsumon, fytyra e tij qe e kthjellët si qelibar dhe ai qe veshur me fuqinë e Perëndisë. Ai na shpjegoi detyrën tonë. Ai na shpjegoi plotësinë e kësaj pune të madhe të Perëndisë; dhe në vërejtjet e tij për ne ai tha: ‘Unë kam pasur të vulosur mbi kokën time çdo çelës, çdo fuqi, çdo parim të jetës dhe shpëtimin që Perëndia i ka dhënë ndonjëherë ndonjë njeriu që ka jetuar ndonjëherë në faqen e tokës. Dhe këto parime dhe kjo Priftëri e fuqi i përkasin kësaj periudhe të shkëlqyer e të fundit ungjillore, të cilën Perëndia i Qiellit ka zgjatur dorën e Tij që ta vendosë në tokë. Tani’, tha ai, duke iu drejtuar Të Dymbëdhjetëve, ‘unë kam vulosur mbi kokën tuaj çdo çelës, çdo fuqi dhe çdo parim që Zoti ka vulosur mbi kokën time.’ ...

Pasi na u drejtua në këtë mënyrë ai tha: ‘Po ju them, barra e kësaj mbretërie tani qëndron mbi supet tuaja; juve ju duhet ta mbani atë në të gjithë botën’ ” (cituar në *Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 567).

Pretendimi i Sidni Rigdonit

Sidni Rigdoni, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, mbërriti në Navu nga Pitsburgu i Pensilvanisë, më 3 gusht 1844. Ai thirri një mbledhje të veçantë që të mbahej të martën më 6 gusht, me qëllim që anëtarët e Kishës të mund të zgjidhnin një kujdestar për Kishën. U duk sikur Sidni Rigdoni u përpoq ta mbante këtë mbledhje që anëtarët e Kishës të mund ta miratonin pozitën e tij si kujdestar i Kishës përpara se të Dymbëdhjetë Apostujt, që të gjithë, të ktheheshin nga misionet e tyre në Shtetet e Bashkuara lindore. Për fat të mirë, për shkak të përpjekjeve të Plakut Uillard Riçards dhe Plakut Parli P. Prat, mbledhja u shty për të enjten, më 8 gusht 1844, dhe deri në atë kohë shumica e Apostujve ishin kthyer në Navu.

Sidni Rigdoni shpalli se, ngaqë ai ishte thirrur dhe shuguruar më parë si një zëdhënës për Jozef Smithin (shih DeB 100:9), ishte përgjegjësia e tij që të “kujdesej që kisha po qeveriset në një mënyrë të duhur” (në *History of the Church*, 7:229).

Pretendimi i Xhejms Strengut

Pas vdekjes së Jozef Smithit, Xhejms Strengu, i cili ishte pagëzuar në shkurt të vitit 1844, shpalli se kishte marrë një letër nga Jozef Smithi, që thoshte se Jozefi e kishte caktuar Strengun si pasuesin e tij. Letra ishte një falsifikim, por duke se përfshinte nënshkrimin e Jozef Smithit dhe ajo i mashtroi disa anëtarë të Kishës kur Strengu ua tregoi atyre. Strengu gjithashtu tha se ai ishte vizituar nga një engjëll, i cili i kishte dhënë atij çelësa.

7 gusht 1844

Pleqtë Xhon Tejlor, Uillard Riçards, Parli P. Prat dhe Xhorxh A. Smith ishin tashmë në Navu kur Sidni Rigdoni mbërriti. Shumica e pjesës së mbetur të Apostujve, duke përfshirë Brigam Jangun, u kthyen në Navu mbrëmjen e 6 gushtit 1844. Të nesërmen, më 7 gusht, Apostujt u mbledhën në këshill në shtëpinë e Xhon Tejlorit. Më vonë atë mbrëmje, Dymbëdhjetë Apostujt, këshilli i lartë dhe priftërinjtë e lartë u mbledhën së bashku. Presidenti Jang i kërkoi Sidni Rigdonit që t’ua thoshte mesazhin e tij shenjtorëve. Sidni Rigdoni haptazi shpalli se ai kishte parë një vegim dhe se askush nuk mund ta pasonte Jozef Smithin si President të Kishës. Ai më pas propozoi që ai të caktohej si kujdestari i njerëzve.

Pasi Sidni Rigdoni i përfundoi vërejtjet e tij, Brigam Jangu (1801–1877) tha:



“Unë nuk shqetësohem se kush e udhëheq kishën, ... por një gjë duhet ta di dhe ajo është çfarë Perëndia thotë rreth saj. Unë i kam çelësat dhe mjetet për ta fituar mendjen e Perëndisë për çështjen. ...

Jozefi dhuroi mbi kokat tona gjithë çelësat dhe fuqitë që i përkasin Apostullimit, të cilat i mbante ai vetë përpara se të merrej dhe asnjë njeri apo grup njerëzish nuk mund të hyjnë midis Jozefit dhe Të Dymbëdhjetëve në këtë botë apo në botën që do të vijë.

Sa shpesh u ka thënë Jozefi Të Dymbëdhjetëve: ‘Unë kam hedhur themelin dhe ju duhet të ndërtoni mbi të, sepse mbi shpatullat tuaja qëndron mbretëria’ ” (në *History of the Church*, 7:230).

8 gusht 1844, ora 10:00 e mëngjesit

Më 8 gusht 1844, shenjtorët në Navu u mbledhën në orën 10:00 për ta dëgjuar Sidni Rigdonin të bënte shpalljet e tij si kujdestar i Kishës. Ai u foli mijëra shenjtorëve të mbledhur për një orë e gjysmë, duke shpjeguar përse ai duhej të ishte kujdestari i Kishës. Disa njerëz e përshkruan fjalimin e tij si jofrëmëzues.

Presidenti Brigam Jang foli shkurtimisht dhe tha se ai do të kishte parapëlqyer të kthehej në Navu për të vajtuar për Profetin, sesa për të caktuar një udhëheqës të ri. Ai shpalli se një kuvend i udhëheqësve dhe anëtarëve do të mbahej më vonë atë ditë në orën 14:00. Disa anëtarë të Kishës më vonë dëshmuuan se, kur Brigam Jangu foli, ata e panë pamjen e tij të ndryshonte dhe e dëgjuan zërin e tij të ndryshonte, dhe ai mori mbi vete pamjen dhe zërin e Profetit Jozef Smith.

Emili Smith Hojti kujtoi: “Mënyra e arsytimit, shprehja e fytyrës, tingëllimi i zërit ma emocionuan tërë shpirtin tim. ... E dija se Jozefi ishte i vdekur. Dhe prapëseprapë, unë shpesh u befasova dhe pa dashje hodha vështrimin te podiumi që të shihja nëse nuk ishte Jozefi. Nuk ishte, ishte Brigam Jangu”

(cituar te Lynne Watkins Jorgensen, “The Mantle of the Prophet Joseph Passes to Brother Brigham: A Collective Spiritual Witness”, *BYU Studies*, vëll. 36, nr. 4 [1996–1997], f. 142).

Uillford Udrafi shkroi: “Nëse nuk do ta kisha parë me vetë sytë e mi, nuk do të mund të më kishte bindur askush se nuk ishte Jozef Smithi dhe cilido që i njihje këta dy burra, mund të dëshmojë për këtë” (në *History of the Church*, 7:236).

8 gusht 1844, ora 14:00

Në orën 14:00, mijëra shenjtorë u mbledhën për atë që e dinin se do të ishte një mbledhje e rëndësishme. Brigam Jangu foli haptazi rreth kujdestarisë së propozuar nga Sidni Rigdoni dhe ftohjes së tij kundrejt Jozef Smithit gjatë dy viteve të mëparshme dhe më pas tha:

“Nëse njerëzit duan që Presidenti Rigdon t’i udhëheqë, ata mund ta kenë atë; por unë ju them se Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve i ka çelësat e mbretërisë së Perëndisë në të gjithë botën.

Të Dymbëdhjetët caktohen nga gishti i Perëndisë. Ja ku është Brigami, a janë lëkundur ndonjëherë gjunjtë e tij? A janë dridhur ndonjëherë buzët e tij? Ja ku është Hibër [C. Kimballi] dhe pjesa tjetër e Të Dymbëdhjetëve, një trup i pavarur që i kanë çelësat e priftërisë – çelësat e mbretërisë së Perëndisë për t’ia dorëzuar të gjithë botës; kjo është e vërtetë, prandaj Perëndia më ndihmoftë. Ata qëndrojnë pranë Jozefit dhe janë si Presidenca e Parë e Kishës” (në *History of the Church*, 7:233).

Shumë shenjtorë vërejtën se Brigam Jangu u duk dhe u foli si Jozef Smithi, teksa foli atë pasdite. Përveç kësaj mrekullie, shumë shenjtorë gjithashtu e ndien Frymën e Shenjtë t’iu dëshmonte atyre se Brigam Jangu dhe Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve u thirrën nga Perëndia për ta drejtuar Kishën. Në përfundim të kësaj mbledhjeje, shenjtorët në Navu votuan njëzëri për ta mbështetur Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve, me Brigam Jangun si drejtuesin e tyre, për ta udhëhequr Kishën. Megjithatë, jo të gjithë anëtarët e Kishës më së fundi zgjodhën t’i ndiqnin Apostujt. Disa nga njerëzit zgjodhën të ndiqnin në vend të tyre, individë të tillë si Sidni Rigdoni dhe Xhejms Strengu, të cilët formuan kishat e tyre.



Lufta e Jutas dhe Masakra e Livadheve Malore

Rritja e Tensionit Çoi drejt Luftës së Jutas

Tre vjet pasi pionierët e parë shenjtore të ditëve të mëvonshme mbërritën në Luginën e Solt-Lejkut, qeveria e Shteteve të Bashkuara organizoi Territorin e Jutas dhe e caktoi Brigam Jangun si guvernatorin e parë të territorit. Në mes të vitit 1857, udhëheqës të shenjtoreve të ditëve të mëvonshme dëgjjuan thashetheme se qeveria federale mund ta zëvendësonte Brigam Jangun me një guvernator të ri të Territorit të Jutas, i cili do të mbështetej nga një numër i madh trupash federale. Më 24 korrik 1857 Presidenti Brigam Jang ishte me një grup shenjtoreësh duke festuar përvjetorin e 10-të të mbërritjes së tyre në Luginën e Solt-Lejkut, kur mori vërtetimin e lajmit të mëparshëm se një ushtri po vinte drejt Solt-Lejk-Sitit.

Në vitet e shkuara, mosmarrëveshjet dhe keqkomunikimet kishin çuar në një gjendje të tensionuar në rritje midis shenjtoreve të ditëve të mëvonshme dhe zyrtarëve të qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Shenjtoret dëshironin të qeveriseshin nga udhëheqës që do t'i zgjidhnin vetë dhe i kishin hedhur poshtë udhëheqësit e caktuar federalë, të cilët nuk kishin të njëjtat vlera me ta, disa prej të cilëve ishin të pandershëm, të korruptuar dhe të pamoralshëm. Disa nga zyrtarët federalë besonin se veprimet dhe sjelljet e shenjtoreve nënkuptonin që ata ishin në kryengritje ndaj qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Xhejms Bjukenën, dërgoi afërsisht 2.500 trupa drejt Solt-Lejk-Sitit për ta shoqëruar guvernatorin e ri në mënyrë të sigurt për në Juta dhe për ta shtypur atë që ai mendoi se ishte një kryengritje mes shenjtoreve. Ky vendim u mor pa informacionin e duhur rreth situatës në Juta (shih *Church History in the Fulness of Times Student Manual*, bot. i 2-të [Church Educational System manual, 2003], f. 368–371).

Përgatitja për të Mbrojtur Territorin

Në predikime drejtuar shenjtoreve, Presidenti Jang dhe udhëheqës të tjerë të Kishës i përshkruan trupat që po afroreshin si armiq. Ata patën frikë që trupat mund t'i dëbonin shenjtoret nga Juta, siç ishin larguar më parë nga Ohajo, Misuri dhe Illinoisi. Presidenti Jang, i cili prej vitesh u kishte kërkuar shenjtoreve të kursenin drithëra, i ripërtëriu udhëzimet e tij me qëllim që ata të kishin ushqime për të ngrënë nëse do të nevojitej të iknin prej trupave. Si guvernator i Territorit të Jutas, ai gjithashtu e udhëzoi milicinë e territorit që të përgatitej për ta mbrojtur territorin.

Mosmarrëveshja me Vargun e Karrove të Emigrantëve

Një varg me karro emigrantësh duke udhëtuar drejt perëndimit nga Arkanzasi për në Kaliforni, hyri në Juta ndërkohë që shenjtoret e ditëve të mëvonshme po përgatiteshin për ta mbrojtur territorin nga trupat në ardhje të Shteteve të

Bashkuara. Disa anëtarë të vargut me karro u mërzitën ngaqë hasën një kohë të vështirë për të blerë drithërat kaq të nevojshme nga shenjtoret, të cilët ishin udhëzuar ta vinin në ruajtje drithin e tyre. Emigrantët gjithashtu patën mosmarrëveshje me shenjtoret të cilët nuk donin që numri i madh i kuajve dhe qeve të vargut të karrove të përdornin burimet e ushqimit dhe të ujit që shenjtoreve u nevojiteshin për vetë kafshët e tyre.

Gjendja e tensionuar shpërtheu në Sidër-Siti, kolonia e fundit në Juta në rrugën për në Kaliforni. Ndodhën përplasje ndërmjet disa prej anëtarëve të vargut të karrove dhe disa prej shenjtoreve të ditëve të mëvonshme. Disa anëtarë të vargut të karrove kërcënuan se do të bashkoheshin me trupat në ardhje të qeverisë kundër shenjtoreve. Edhe pse kapiteni i vargut të karrove i qorto shokët e tij që i bënë këto kërcënime, disa udhëheqës dhe kolonë në Sidër-Siti i panë emigrantët si armiq. Kompania e karrove u largua nga qyteti vetëm gati një orë pasi mbërriti, por disa nga kolonët dhe udhëheqësit në Sidër-Siti deshën t'i përndiqnin dhe t'i ndëshkonin burrat që i kishin fyer ata.

Përshpejtimi i Kundërvënies

Ngaqë këta shenjtore nuk e zgjidhën mosmarrëveshjen e tyre me emigrantët sipas mënyrës së Zotit, gjendja u bë shumë më e rëndë. Isak Heiti, kryetari i bashkisë së Sidër-Sitit, majori i milicisë dhe presidenti i kunjit, kërkoi leje nga komandanti i milicisë, i cili jetonte në koloninë aty pranë, në Parouan, që të thërriste milicinë për t'u ballafaquar me njerëzit që i kishin fyer nga vargu i karrove. Komandanti i milicisë, Uilliam Dejmi, një anëtar i Kishës, e këshilloi Isak Heitin që të mos i përfillte kërcënimet e emigrantëve. Në vend që t'ia vinte veshin kësaj këshille, Isak Heiti dhe udhëheqës të tjerë të Sidër-Sitit vendosën t'ua mbushnin mendjen disa indianëve vendas që ta sulmonin vargun e karrove dhe t'ua vidhnin gjedhët, si një mënyrë ndëshkimi për emigrantët. Isak Heiti i kërkoi Xhon D. Lisë, një anëtar vendor të Kishës dhe major i milicisë, që ta udhëhiqte këtë sulm dhe që të dy planifikuan t'ua hidhnin fajin indianëve për veprimin.

Sulmi mbi Emigrantët

Isak Heiti ia paraqiti planin për ta sulmuar vargun e karrove një këshilli të udhëheqësve vendorë në Kishë, komunitet dhe milici. Disa anëtarë të këshillit nuk ishin aspak dakord me planin dhe i kërkuan Heitit nëse ishte këshilluar me Presidentin Brigam Jang lidhur me çështjen. Duke thënë se nuk ishte këshilluar, Heiti ra dakord të dërgonte një lajmëtar, Xhejms Haslamin, për në Solt-Lejk-Siti me një letër që shpjegonte gjendjen dhe që kërkonte se çfarë duhej të bëhej. Megjithatë, ngaqë Solt-Lejk-Siti ishte rreth 400 km larg nga Sidër-Siti, do të duhej për lajmëtarin rreth një javë vrapimi të shpejtë me

kalë për të arritur në Solt-Lejk-Siti dhe për t'u kthyer në Sidër-Siti me udhëzimet e Presidentit Jang.

Pak kohë përpara se Isak Heiti të dërgonte letrën e tij me lajmëtarin, Xhon D. Lija dhe një grup indianësh e sulmuan kampin e emigrantëve në një vend të quajtur Livadhet Malore. Lija e udhëhoqi sulmin, por e fshehu identitetin e tij, që të dukej se u përfshinë vetëm indianët. Disa prej emigrantëve u vranë ose u plagosën dhe pjesa e mbetur i luftuan sulmuesit e tyre, duke i detyruar Linë dhe indianët të tërhiqeshin. Emigrantët shpejt i tërhoqën karrot e tyre në një rreth të ngushtë, ose një vathë, për mbrojtje. Dy sulme shtesë pasuan gjatë një rrethimi pesëditor mbi vargun e karrove.

Në një rast, milicët e Sidër-Sitit mësuan për dy burra emigrantë që ishin jashtë vathës së karrove. Milicët qëlluan mbi ta, duke e vrarë njërin. Burri tjetër shpëtoi dhe ia solli lajmin kampit të karrove që burra të bardhë ishin të përfshirë në sulmet kundër tyre. Ata që i planifikuan sulmet, u zunë tani në mashtrimin e tyre. Nëse emigrantët lejoheshin të shkonin në Kaliforni, lajmi do të shpërndahej që shenjtorët e ditëve të mëvonshme ishin përgjegjës për sulmin ndaj vargut të karrove. Komplotuesit patën frikë se ky lajm do të sillte pasoja të këqija mbi ta dhe njerëzit e tyre.

Masakra e Livadheve Malore

Në përpjekje për të ndalur përhapjen e lajmit që shenjtorët e ditëve të mëvonshme u përfshinë në sulmet ndaj vargut të karrove, Isak Heiti, Xhon D. Lija dhe udhëheqës të tjerë vendorë të Kishës e të milicisë bënë plan që t'i vrisnin të gjithë emigrantët e mbetur, me përjashtim të fëmijëve të vegjël. Duke e vënë në jetë këtë plan, Xhon D. Lija iu afrua emigrantëve dhe u tha se milicia do t'i mbronte nga sulmet e mëtejshme, duke i drejtuar ata që të ktheheshin përsëri të sigurt drejt Sidër-Sitit. Ndërsa emigrantët po ecnin drejt Sidër-Sitit, milicët u kthyen dhe qëlluan mbi ta. Disa indianë, të rekrutuar nga kolonët, u vërsulën nga vendet e fshehjes për t'u bashkuar me sulmin. Nga rreth 140 emigrantë që ishin pjesë e vargut të karrove, u kursyen vetëm 17 fëmijë të vegjël.

Dy ditë pas masakrës, Xhejms Haslami mbërriti në Sidër-Siti me mesazhin e përgjigjes nga Presidenti Jang, që i udhëzonte udhëheqësit vendorë ta lejonin vargun e karrove të largohej në paqe. Kur Heiti i lexoi fjalët e [Presidentit] Jang, ai derdhi lot si fëmijë dhe mundi të thoshte vetëm fjalët: 'Shumë vonë, shumë vonë' " (Richard E. Turley Jr., "The Mountain Meadows Massacre", *Ensign*, shtator 2007, f. 20).

Pasojat Tragjike

Masakra e Livadheve Malore jo vetëm që shkaktoi vdekjen e rreth 120 viktimave, por shkaktoi edhe vuajtje të madhe për fëmijët që mbijetuan dhe për të afërmit e tjerë të viktimave. Disa shenjtorë të ditëve të mëvonshme i morën në shtëpitë e tyre dhe u përkujdesën për fëmijët emigrantë që i mbijetuan

masakrës. Në vitin 1859, zyrtarë federalë morën kujdestarinë për këta fëmijë dhe i kthyen tek të afërmit në Arkanzas. Indianët pajutë gjithashtu vuajtën ngaqë u fajësuan padrejtësisht për krimin.

Udhëheqësit e Kishës Mësuan për Masakrën

"Edhe pse Brigam Jangu dhe udhëheqës të tjerë të Kishës në Solt-Lejk-Siti mësuan për masakrën pak kohë pasi ndodhi, kuptueshmëria e tyre lidhur me gjerësinë e përfshirjes së kolonëve dhe hollësitë e tmerrshme të krimit erdhën pjesë-pjesë me kalimin e kohës. Në vitin 1859 ata i liruan nga thirrjet e tyre presidentin e kunjit, Isak Heitin, dhe udhëheqës të tjerë të njohur të Kishës në Sidër-Siti, të cilët patën rol në masakër. Në vitin 1870 ata i shkishëruan Isak Heitin dhe Xhon D. Linë nga Kisha.

Në vitin 1874 një juri gjyqësore territoriale akuzoi nëntë burra për rolin e tyre në masakër. Shumica prej tyre më së fundi u arrestuan, edhe pse vetëm Xhon D. Lija u gjykua, dënua dhe u ekzekutua për krimin. Një tjetër burrë i akuzuar që u kthye në dëshmitar për shtetin, [në mënyrë vullnetare dëshmoi dhe dha prova kundër të pandehurve të tjerë] dhe burra të tjerë kaluan shumë vjet duke iu shmangur ligjit. Milicë të tjerë, të cilët e kryen masakrën, vepruan gjatë pjesës së mbetur të jetës së tyre me ndjenjë e tmerrshme të fajit dhe të ëndrrave të këqija, të herëpashershme, për atë që kishin bërë dhe parë" (Richard E. Turley Jr., "The Mountain Meadows Massacre", *Ensign*, shtator 2007, f. 20).

150-Vjetori i Masakrës së Livadheve Malore

Presidenti Henri B. Ajring, i Presidencës së Parë, tha:

"Përgjegjësia për [Masakrën e Livadheve Malore] qëndron me udhëheqësit vendorë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në krahinat pranë Livadheve Malore, të cilët mbanin edhe detyra civile e ushtarake, dhe me anëtarët e Kishës që vepruan nën drejtimin e tyre. ...

... Ungjilli i Jezu Krishtit që ne përkrahim, e urren vrasjen gjakftohtë të burrave, grave dhe fëmijëve. Në të vërtetë, ai përkrah paqen dhe faljen. Çfarë u bë [te Livadhet Malore] shumë kohë më parë nga anëtarë të Kishës sonë përfaqëson një largim të tmerrshëm dhe të pajustificueshëm nga mësimet dhe sjellja e krishterë. ... Pa asnjë dyshim Drejtësia Hyjnore do ta ngarkojë ndëshkimin e duhur mbi ata që ishin përgjegjës për masakrën. ...

... Na bekoftë Perëndia i Qiellit, bijtë dhe bijat e të cilit ne të gjithë jemi, që t'i nderojmë ata që vdiqën këtu duke shtrirë drejt njëri-tjetrit dashurinë e pastër dhe shpirtin e faljes, të cilat i përfaqëson Biri i Tij i Vetëmlindur" ("150th Anniversary of Mountain Meadows Massacre", 11 shtator 2007, mormonnewsroom.org/article/150th-anniversary-of-mountain-meadows-massacre).



Përsheptimi i Punës për Shpëtim

Përsiatni pyetjet vijuese në lidhje me secilën nga pesë fushat që janë pjesë e punës për shpëtim:

- Si mund t'i sjellin të tjerët më pranë bekimeve të shpëtimit përpjekjet tuaja në këtë fushë të punës së Perëndisë?
- Çfarë përvojash keni pasur dhe çfarë bekimesh keni marrë kur keni marrë pjesë në këtë fushë të përsheptimit të punës së Zotit për shpëtimin?
- Çfarë mund të bëni, pavarësisht nga thirrja juaj e tanishme në Kishë, që të luani rol në këtë fushë të punës për shpëtimin?

Puna Misionare e Anëtarëve

Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, na mësoi:



“Vëllezër e motra, me aq siguri sa Zoti ka frymëzuar më shumë misionarë për të shërbyer, Ai gjithashtu po zgjon mendjet dhe po hap zemrat e më shumë njerëzve të mirë e të ndershëm për të pranuar misionarët e Tij. Ju tashmë i njihni apo do t'i njihni ata. Ata janë në familjen tuaj dhe jetojnë në lagjen tuaj. Ata ecin duke u shkëmbyer me ju në rrugë, ulen pranë jush në shkollë dhe lidhen me ju në internet. Edhe ju jeni një pjesë e rëndësishme e kësaj mrekullie që po shpaloset.

Nëse nuk jeni një misionar kohëplotë me një etiketë të zezë misionari të kapur në pallton tuaj, tani është koha që ta pik-turonin një [të tillë] në zemrën tuaj – të ngjyrosur, siç tha Pali, ‘jo me bojë, por me Frymën e Perëndisë së gjallë’ [2 Korintasve 3:3]. ... Të gjithë ne kemi një kontribut për të bërë për këtë mrekulli” (“Është një Mrekulli”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2013, f. 78).

Mbajtja Aktive e të Kthyerve në Besim

Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpalli:



“Ju dhe unë duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për ta parë që çdo anëtar i Kishës të shoqërohet tërësisht dhe i gëzon të gjitha bekimet që ungjilli ka për të ofruar.

Presidenti Gordon B. Hinkli na ka kujtuar ju dhe mua për përgjegjësinë tonë që të jemi bashkëpunëtorë me Zotin për t'i bërë të ndodhin planet e Tij për Kishën. Në një transmetim satelitor, Presidenti Hinkli tha: ‘Zoti ka vendosur mbi ne një mandat për t’ia mësuar ungjillin çdo krijese. Kjo do të kërkojë përpjekjet më të mira të çdo misionari – kohëplotë dhe të kunjit. Do të kërkojë përpjekjet më të mira të çdo peshkopi, të çdo këshilltari të peshkopit, të çdo anëtari të këshillit të lagjes ...’ (‘Find the Lambs, Feed the Sheep’, *Ensign*, maj 1999, f. 107). Do të kërkojë përpjekjet më të mira të çdo anëtari” (“Members Are the Key”, *Ensign*, shtator 2000, f. 10).

Aktivizimi i Anëtarëve më Pak Aktivë

“Roli ynë [si anëtarë] është të zhytemi në dashurinë dhe shërbimin për njerëzit rreth nesh – duke ngushëlluar një koleg pune në nevojë, duke ftuar miqtë tanë në një pagëzim, duke ndihmuar një fqinj të moshuar për punën e tij në kopsht, duke ftuar një anëtar më pak aktiv për një vakt ushqimor, ose duke ndihmuar një fqinj për historinë e familjes së saj. Të gjitha këto janë mënyra të natyrshme e të gëzueshme për të ftuar anëtarë më pak aktivë dhe njerëz jo të besimit tonë në jetën tonë dhe, si pasojë, në dritën e ungjillit. Ndarja me ta e momenteve zbatimëse dhe atyre të shenjta në jetën tonë, mund të jetë në të vërtetë mënyra më e efektshme se si secili prej nesh mund të “pun[ojë] në vreshtin e [Jezu Krishtit] për shpëtimin e shpirtave të [burrave dhe grave]’ (DeB 138:56)” (“Përsheptimi i Punës për Shpëtim”, *Ensign*, tetor 2013, f. 36).

Puna në Tempull dhe për Historinë Familjare

Plaku Kuentin L. Kuk, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim:



“Udhëheqja e Kishës i ka drejtuar një thirrje të qartë brezit të ri që të jetë pararoja në përdorimin e teknologjisë për të përtuar shpirtin e Elijas, për t’i kërkuar paraardhësit e tyre dhe për të kryer ordianca në tempull për ta. Shumica e punës së rëndë në përsheptimin e punës së shpëtimit si për të gjallët dhe të vdekurit do të bëhet nga ju të rinj” (“Rrënjët dhe Degët”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2014, f. 46,47).

Mësimdhënia e Ungjillit

“Përgjegjësia për ta dhënë mësim ungjillin nuk kufizohet tek ata që kanë thirrje zyrtare si mësues. Si një anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ju keni përgjegjësinë për ta dhënë mësim ungjillin. Si prind, bir, bijë, bashkëshort, bashkëshorte, vëlla, motër, udhëheqës i Kishës, mësues në klasë, mësues shtëpie, mësuese vizitore, bashkëpunëtor, fqinj ose mik, ju keni mundësi të jepni mësim. Nganjëherë ju mund të jepni mësim haptazi dhe drejtpërsëdrejti, me anë të gjërave që thoni dhe dëshmisë që jepni. Dhe ju gjithmonë jepni mësim me anë të shembullit” (*Teaching, No Greater Call: A Resource Guide for Gospel Teaching* [1999], f. 3–4).